

**INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” – PRISHTINË**

KDU: 94 (05)

# **K O S O V A**

45  
2020

**PRISHTINË  
2020**

**REDAKSIA:**

Prof.asoc.dr. Sabit SYLA (kryeredaktor), Prof.asoc.dr. Gjon BERISHA (sekretar i redaksisë), (anëtarë) Akademik Beqir META, Akademik Marenglen VERLI, Akademik Pëllumb XHUFİ, Akademik Frashër DEMAJ, Prof.dr. Hamit KABA, Prof.asoc.dr. Bedri MUHADRI, Prof.asoc.dr. Teuta SHALA - PELI

**Redaktore gjuhësore:**

Shqipe DODA

**Korrektura:**

Teuta ZEQRİ - ALIU

©2020 Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

**Adresa e redaksisë:**

Prishtinë, Lagja Spitalit, p.n  
e-mail: institutihis@hotmail.com  
ueb: <https://ih-rks.org/>  
tel: +383 38 512 392

**THE INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI”- PRISHTINA**

# **K O S O V A**

45  
2020

**PRISHTINA**  
**2020**



## **PËRMBAJTJA - CONTENTS**

### **Exhlale DOBRUNA-SALIHU**

|                                                                    |    |
|--------------------------------------------------------------------|----|
| Dy monumente nga koha romake të zbuluara rishtas në Kosovë.....    | 9  |
| Two monuments from the Roman time discovered lately in Kosova..... | 18 |

### **Emine KALAJA-HAJDARI**

|                                                                         |    |
|-------------------------------------------------------------------------|----|
| Dëshmitë epigrafike të pranisë së hyjnive të lindjes në Dardani.....    | 19 |
| Epigraphic evidence of presence of the eastern dieties in Dardania..... | 33 |

### **Teuta SHALA-PELI**

|                                                                                |    |
|--------------------------------------------------------------------------------|----|
| Roli i klerikëve drishtianë në shërbimet laike gjatë viteve 1917-1496....      | 35 |
| The role of the priest in the secular services during the years 1317-1496..... | 49 |

### **Agron ISLAMI**

|                                                                                                                                             |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Aspekte të jetës socio-ekonomike dhe politike në Kosovë gjatë shekullit XVIII sipas ankesave dhe kërkesave të qytetarëve.....               | 51 |
| Aspects of social, economic and political life in Kosova during the XVIII century according to the complaints and requests of citizens..... | 61 |

### **Marenglen VERLI**

|                                                                                                               |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Shqiptarët përballë ndërkombëtarëve në Paris në mbyllje të konferencës së paqes (14 janar - 3 mars 1920)..... | 67 |
| The great powers diplomacy and the challenge of albanians in january 1920.....                                | 91 |

### **Armend MEHMETI**

|                                                                                              |     |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Aksioni i armatosur i Zogut në Shqipëri - aspekte të mbështetjes Jugosllave e Britanike..... | 93  |
| Zogu's intervention of Albania - in the light of Yugoslav and British support.....           | 110 |

### **Sabit SYLA**

|                                                                            |     |
|----------------------------------------------------------------------------|-----|
| Kosova ndërmjet fuqive të boshtit dhe aleatëve të mëdhenj perëndimorë..... | 111 |
| Kosovo between the Axis powers and the Allies great Western.....           | 131 |

## **Avni REXHA**

Përpjekjet për rimëkëmbjen dhe afirmimin ndërkombëtar të universitetit të Prishtinës gjatë viteve 1991-1998.....133

The efforts to reactivate the university of Prishtina and its international recognition during the years 1991- 1998.....146

## **KUMTESA**

### **Paskal MILO**

Thelbi Evropian i Rilindjes Kombëtare Shqiptare.....151

## **Gjon BERISHA**

Argjipeshkvia e Tivarit dhe çështja “*Primas Serbiae*” si pasojë e vendimeve të Kongresit të Berlinit.....159

## **Eduart CAKA**

Lidhja e Prizrenit dhe formësimi i identitetit shqiptar brenda Perandorisë Osmane.....175

## **Fehari RAMADANI & Fati ISENI**

Aspekte të veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare në kazanë e Tetovës.....185

## **Agron ISLAMI**

Politikat përafruese të Abdylhamitit II karshi shqiptarëve.....203

## **Zeqirja REXHEPI**

Raportet midis fuqive të mëdha dhe Lidhja e Prizrenit.....209

## **Sali KADRIA**

Regjistrimi i popullsisë gjatë vitit 1918 në territorin e Shqipërisë, të okupuar nga autoritetet Austro-Hungareze.....221

## MATERIALE DHE DOKUMNTE

Qerim LITA

Si i përshkroi Remzi Kolgeci ngjarjet e nëntorit 1988 në Kosovë?.....243

## RECENSIONE

### *Një vepër madhore për historinë dhe historiografinë shqiptare*

Fatmira Musaj, “Republika shqiptare 1925-1928”, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë, 2018.

(Alban DOBRUNA).....267

### *Ballafaqimet e një historiani me robërinë dhe historinë*

Jakup Krasniqi, *Ballafaqime historike për çlirim dhe bashkim kombëtar*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2019.

(Miftar KURTI).....273

### *Kontributi atdhetar i Esat Myftarit*

Esat Myftari, *Vdekja jote jeta ime*, Prishtinë, 2020.

(Kosovar BASHA).....277

## IN MEMORIAM

### **Alban DOBRUNA**

In memoriam - Prof. dr. Drita Bakija-Gunga.....285

### **Marenglen VERLI, Beqir META, Sabit SYLA**

In memoriam - Prof. dr. Izber Hoti.....289

## AKTIVITETE

Aktivitetet e Institutit të Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë gjatë vitit 2020 (Sabit SYLA & Gjon BERISHA).....291





**Exhlale DOBRUNA-SALIHU**

## **DY MONUMENTE NGA KOHA ROMAKE TË ZBULUARA RISHTAS NË KOSOVË**

Gjetjet e monumenteve nga antikiteti në Kosovë, qoftë me gërmime arkeologjike, qoftë të rastit, si gjithherë me të dhënat e tyre të vlefshme na befasojnë për të mirë. Kësaj radhe fjala është për dy sosh nga koha romake të gjetura në lokalitete të ndryshme, të cilat u takojnë dy grupeve të mëdha tematike dhe kategorive të ndryshme brenda tyre. Njëri ka të bëjë me një altar votiv, ndërsa tjetri me një stelë mbivarrore, secili me veçantitë e tij në paraqitjet relievore dhe epigrafike, që do të pasojnë gjatë trajtimit të tyre.

### **Altari kushtuar perëndive dhe perëndeshave nga Vendeni (fig. 1)**

Altari u zbulua në vitin 2017 gjatë gërmimeve arkeologjike të Institutit Arkeologjik të Kosovës në *Vendenisin* antik (Gllamnikun e sotëm), ku gjendet edhe sot. Ishte i fragmentuar, por fatmirësisht e kishte të ruajtur kurorën dhe aq më shumë, gjysmën e sipërme të trupit me një pjesë të mbishkrimit sa për të treguar se kujt i përkushtohej dhe nga kush<sup>1</sup>.

Ashtu si te pjesa më e madhe e altarëve në Dardani, është e dekoruar vetëm kurora. Ajo është e profiluar disaradhëshe dhe e zbukuruar e tëra në anën e përparme. Në të dy anët janë skalitur gjysmëpalmetat e stilizuara akroteriale të kornizuara sipër dhe në mes tyre një kantar, nga i cili dalin dy kërcëj urthi të mbledhur në spirale me nga një gjethe, motiv ky shumë i rrallë te altarët. I gjithë ky dekorim

---

<sup>1</sup> Exhlale Dobruna-Saliu, "Altari votiv me formulën përkushtuese "D D" nga Vendenisi", *Koha ditore*, (Prishtinë, 15. 07. 2017), 24.

është punuar në reliev të lartë dhe me kujdes, duke treguar dorën e një gurskalitësi mjaft të talentuar.

Në trup, përfund kurorës, në fushën e paprofiluar dhe të dëmtuar, nga mbishkrimi i skalitur po ashtu me mjaft kujdes kanë mbetur katër rreshta, dy të plotë dhe dy të dëmtuar, që fillojnë me formulën përkushtuese “D D”. Të gjitha shkronjat janë të rregullta me madhësi të njëjtë dhe serife horizontale dhe vertikale. Pos gjentilicit dhe kognomenit,



Fig. 1

pjesa tjetër e ruajtur e tekstit ka shkurtesa, ndërsa sa i takon shenjave të ndarjes së fjalëve (interpunkcionit), një shenjë në trajtë trekëndëshi, por jo e sigurt, mund të bëhet se gjendet në mes emrit dhe gjentilicit. Të gjitha këto tipare<sup>2</sup> flasin se altari u ngrit aty rreth fundit të shek. II, apo decenieve të para të shek. III.

Ky altar, me një trajtim të tillë të kurorës dhe tekstit, mbase nga i njëjti zanatli, paraqet njërin ndër altarët votiv më me mjeshtëri të punuar, jo vetëm në Kosovë, por në gjithë Dardaninë.

Transkribimi i mbishkrimit është: *D(is) d(eabus) / M(arcus) Ulp(i)us / Rufini[anus] / b(ene)f(iciarius) co(n)s(ularis) / [leg(ionis)?] / [v(otum) l(ibens) p(osuit)]*.

Nga ky mbishkrim kuptohet qartë se ky altar iu përkushtua perëndive dhe perëndeshave. Dedikanti ishte beneficjar konsular, por që nuk mund të dihet i cilit legjion ishte për shkak të thyerjes së altarit, apo ndoshta edhe nuk është i shënuar fare. Mirëpo, meqë njëri altar i “*Deae Dardanicae*” nga Vendeni u përkushtua nga një beneficjar i legjionit të katërt flavian (*legio IV Flavia*)<sup>3</sup>, mund të bëhet se edhe këtu kemi të bëjmë po me këtë legjion.

<sup>2</sup> Khr. Petar Petrović, *Paleografija rimskih natpisa u Gornjoj Meziji*, Beograd, 1975, 85-107 për monumente me këto tipare.

<sup>3</sup> Khr. Exhlale Dobruna-Saliu, “Votivna ara Deae Dardanicae i beneficijarna postaja iz Vendenisa”, *Vjesnik Arheološkog muzeja u Zagrebu*, 45, 1, 2012 (2013), 217-224, ku autorja flet gjerësisht për altarët e kushtuar nga ky legjion dhe i VII Claudian në Dardani.

Deri tash ky është monumenti i katërt epigrafik në Dardani që u përkushtohet perëndive dhe perëndeshave me këtë formulë përkushtimi. Njëri është i pranishëm po ashtu në Kosovë i gjetur në Vushtrri, në trevën e Ulpianës, ku kemi të bëjmë me një altar mermeri me kurorë punuar gjithashtu me kujdes dhe të transkribuar që herët me “*D(is) d(eabusque)*”<sup>4</sup>, përkatësisht, më vonë, edhe me “*D(is) D(eabus)*”<sup>5</sup>, dedikuesi i të cilit po ashtu ishte një beneficiar konsular, por këtu i legjionit VII klaudian (*legionis VII Claudiae*). Dy monumente tjera janë të pranishme në pjesët jugore dhe veriore dardane. Një pllakë vjen nga *Scupi* me përkushtimin D E T D, i transkribuar “*D(is) et D(eabus)*”<sup>6</sup> dhe një altar nga *Naissus*, ku, për dallim, përkushtimi vjen i plotë: “[D] *DEABUS*”.<sup>7</sup> Po ashtu altarë kryesisht nga beneficiarët konsularë të po këtij legjioni, përkushtuar perëndive dhe perëndeshave së bashku, por jo me këtë formulë, të cilëve zakonisht iu prinë Jupiteri “*I(ovi) O(ptimo) M(aximo)*”, vetëm dhe në një rast në formën e Trinisë së Kapitolit, hasen në mbarë trevën dardane: *I. O. M. / Iunoni Reg(inae) Min(ervae) sanc(tissimae) ceterisqu[e] / diis deabusquae / omnibus (!) / sacr(um)* nga Bllaca në trevën e Skupit<sup>8</sup>; *I. O. M. et / dis deabusq(ue) / omnibus* nga Graçanica në trevën e Ulpianës<sup>9</sup>; *I. O. M. / ceterisque / dis deabus* nga Banja e Novi Pazarit<sup>10</sup> dhe *I. O. M. / ceteris(que) / dis dea/busque* nga Novi Pazar<sup>11</sup> në trevën e Municipit DD; *I. O. M. / ceterisque dis deabusque [i]mmortalibus* nga Nishevci dhe *I. O. M. / ceterisque / diis deabus/que omnibu[s]*

<sup>4</sup> Nikola Vulić, “Antički spomenici naše zemlje”, *Spomenik Srpske Kraljevske Akademije* (SKA) LXXI (Beograd, 1931), 42, n. 96.

<sup>5</sup> Petar Petrović, *Naissus-Remisiana-Horreum Margi*, in F. Papazoglou (éd), *Inscriptions de la Mésie Supérieure* (IMS) vol. IV, Beograd, 1979, 68.

<sup>6</sup> Borka Dragojević-Josifovska, *Scupi et la région de Kumanovo*, in F. Papazoglou (éd), *IMS* vol. VI, Beograd, 1982, 50, n. 3.

<sup>7</sup> Petrović, *Naissus – Remisiana – Horreum Margi*, 67-68, n. 2.

<sup>8</sup> Vulić, “Antički spomenici naše zemlje”, 208, n. 550; Dragojević-Josifovska, *Scupi et la région de Kumanovo*, 53-54, n. 9.

<sup>9</sup> Vulić, “Antički spomenici naše zemlje”, 195, n. 519.

<sup>10</sup> Ana Šašel – Jare Šašel, *Inscriptiones latinae quae in Iugoslavia inter annos MCMXL et MCMLX repertae et editae sunt*, Situla 5 (Ljubljana, 1963), 43, n. 66.

<sup>11</sup> *L'Année épigraphique* (Paris, 1972), 148, n. 515.

nga Prokupla (*Hammeum*) ne trevën e Naisit<sup>12</sup>, si dhe *I. O. M. ceterisque dis deabusque immortalibus* ne trevën e *Timacum minus-it*<sup>13</sup>.

Emri i dedikuesit përbëhet nga skema trigjymtyrëshe e plotë, e cila, me ndonjë përjashtim të rrallë, haset në mbishkrimet e tri decenieve të para të shek. III<sup>14</sup>. Kognomeni *Rufinianus* është i origjinës latine<sup>15</sup> dhe haset në Ballkan dhe në Itali<sup>16</sup>. Nga trevat fqinje të Dardanisë është i pranishëm në pjesën veriore të Mezisë së Epërme, në qendrën antike *Horreum Margi* (Qupria)<sup>17</sup>, kurse në trevat e tjera ilire, pos Dalmacisë në një rast<sup>18</sup>, deri tash nuk është i pranishëm asnjë rast tjetër<sup>19</sup>. Gjentilici perandorak *Ulpus*, bartës i të cilit është perandori Trajan, prandaj edhe përhapja e këtij gjentilici është i lidhur me ndarjen e të drejtës qytetare nga ana e tij në fund të shekullit I dhe fillim të shekullit II, e në Dardani haset shumë pak dhe bartësit e tij kryesisht ishin vendasit<sup>20</sup>. Po ashtu është i rrallë edhe në trevat e tjera ilire dhe në trevat e tjera të Ballkanit.

Nga ky prezantim do të theksonim se prania e këtij altari në Venden me këtë formulë përkushtimi e rrit numrin e altarëve të kultit përkushtuar perëndive dhe perëndeshave së bashku në Dardani, si dhe e pasuron opusin e altarëve të kultit në këtë vendbanim të antikitetit, sidomos të atyre përkushtuar nga beneficiarët konsularë të stacionuar në këtë stacion. Kjo njëherësh flet se këtu ecuria e zbulimeve të rëndësishme gjithnjë është e pranishme.

<sup>12</sup> Petrović, *Naissus - Remisiana - Horreum Margi*, 98, n. 62 nga Nishevci, 117, n. 101 nga Prokupla.

<sup>13</sup> Nikola Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", *Spomenik SKA*, LXXV (Beograd, 1933), n. 207.

<sup>14</sup> Petrović, *Paleografija rimskih natpisa u Gornjoj Meziji*, 78.

<sup>15</sup> Iiro Kajanto, *The Latin Cognomina* (Helsinki, 1954), 229.

<sup>16</sup> *Onomasticon provinciarvm Europae latinarvm* (OPEL), ex materia ab András Mócsy, Reinhardo Feldmann, Elisabetha Marton et Mária Szilágyi collecta, composuit et correxit Barnabás Lörincz, vol. IV, Wien 2002, 33.

<sup>17</sup> Petrović, *Naissus - Remisiana - Horreum Margi*, 112, n. 90.

<sup>18</sup> Géza Alföldy, *Die Personennamen in der römischen Provinz Dalmatia* (Heidelberg, 1969), 283; OPEL vol. IV, 2002, 33; CIL III, 3178.

<sup>19</sup> Khr. Enver Imamović, *Antički kulni i votivni spomenici na području BiH*, Sarajevo, 1977; Skender Anamali, Hasan Ceka, Élizabeth Deniaux, *Corpus des Inscriptions latines d'Albanie*, École Française de Rome, 2009.

<sup>20</sup> Khr. Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë në kohën romake*, Prishtinë, 1981, 51-52.

### Stela kushtuar bijës nga Peqani i Therandës (fig. 2)

Stela u gjet rastësisht në muajin qershor të vitit 2019 në fshatin Peqan gjatë punimeve me eskavator në truallin e Visar Bytyqit me rastin e ndërtimit të shtëpisë, prej nga pa u dëmtuar fare u bart në Muzeun e Therandës. Është e tëra me përmasa: gjatësi 177cm, gjerësi 38-43cm, trashësi 30cm dhe e ruajtur mjaft mirë<sup>21</sup>.

Si në të shumtën e rasteve në mbarë Dardaninë, kjo stelë përbëhet prej tri komponentëve: fushës relievore me mbarim harkor, së cilës i takon numri më i madh i stelave të kësaj treve, sidomos atyre në Kosovë<sup>22</sup>, ajo mbishkrimore e profiluar dhe e rrethuar me motivin bimor, në këtë rast gjithashtu të urthit, i cili me dy kërcej del nga një vazo, po ashtu kantar në fushën e sheshtë të xokolit, në fund të monumentit, që së bashku me atë të hardhisë, përbëjnë motivin më të shpeshtë të stelave dhe njërën ndër karakteristikat kryesore të tyre në të gjithë Dardaninë<sup>23</sup>.



Fig. 2

<sup>21</sup> Exhlale Dobruna-Saliu, "Monumenti mbivarror që dëshmon rëndësinë e gruas dhe të fëmijës në Dardani", *Koha ditore* (13. 06, 2019), 26-27.

<sup>22</sup> Exhlale Dobruna-Saliu, "Nadgrobne stele s područja Kosova. Arhitekonika i plastika", *Arheološki vestnik* 38 (1987), 193-205 tipi I, 195-197, fig. 1-5, (nga Kosova); e njëjta, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake. Sepulkrale dhe e kultit* 1-2, (Prishtinë, 2003-2005) tipi III, 88-98, 679-748, TT. 42-90 (nga e tërë Dardania).

<sup>23</sup> Fanula Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba*, Djela Centra za balkanološka ispitivanja 30/1 (Sarajevo, 1969), 156-158; Dobruna-Saliu, "Nadgrobne stele s područja Kosova", 194-198; e njëjta, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit*, 126-139.

Në fushën relievore janë skalitur dy buste femrash: një që i takon personit të rritur, e cila e zë tërë fushën dhe, një me përmasa të vogla në gjoksin e saj, që i takon fëmijës, vajzës. Që të dyja janë skalitur në mënyrë mjaft cilësore, sidomos personi i rritur, ku në stilin e punimit mbisundon plasticiteti, proporcionaliteti dhe realizmi. Ajo ka fytyrë rrumbullake me të gjitha tiparet e realizuara me kujdes: sy të mëdhenj në trajtë bajameje me qepalla plastike, hundë natyrale dhe buzë mjaft të plota, si dhe është e krehur sipas tipit të frizurës të cilën e kanë lansuar dy perandreshat e gjysmës së dytë të shek. II, Lucila dhe Krispina (*Lucilla et Crispina*)<sup>24</sup>, ku në këtë rast, sipas tufave të drejta të detajuara me vija të skalitura shpesh, sidomos i përgjigjet asaj të Krispinës. Sa i takon veshjes, kemi të bëjmë me atë autoktone ilire, që këtu përbëhet vetëm me fustanin e njëfishtë, përkatësisht këmishën e gjerë me mëngë të gjata - tipi i dalamatikes (*dalmatica*), i cili me pala të ngushta e të shpeshte vertikale të trajtuara në mënyrë mjaft plastike, që bien nga supet dhe prerja e kornizuar gjysmërrethore rreth qafës, duke e mbuluar krejt gjoksin, i japin një efekt të veçantë dekorativ kësaj veshjeje, e cila ishte e ngjeshur lart dhe shkonte deri në fund të këmbëve, apo përfundi gjunjëve<sup>25</sup>. Njëherit e mban edhe një qafore rruazash. Këtë veshje e hasim edhe në dy raste tjera në Dardani: në një stelë të Dresnikut dhe në një të territorit të Naisit<sup>26</sup>, si edhe në trevën tjetër ilire në brendësi të provincës së Dalmacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës të sotme, në monumente mbivarrore dhe të kultit<sup>27</sup>. Kurse ky tip i qafores në Dardani

<sup>24</sup> Khr. K. Fittschen, *Die Bildnistypen der Faustina Minor und die Fecunditas Augustae*, Göttingen, 1982, 75-81, TT. 44-48 Lucila, 86-87, TT. 53-56 Krispina.

<sup>25</sup> Për këtë veshje khr. Irma Čremošnik, "Nošnja na rimskim spomenicima u Bosni i Hercegovini", *Glasnik Zemaljskog muzeja u Sarajevu* 18 (1963), 109, e cila e quan "fustani i poshtëm", apo i "njëfishtë"; A. Gjergji, "Elemente të përbashkëta të veshjes së viseve të ndryshme ilire dhe vazhdimësia e tyre në veshjet tona popullore", *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve*, Sesion shkencor 3-4 mars 1969, (Tiranë, 1969), 153, e cila e quan "këmishë", "linjë".

<sup>26</sup> Stela e gjetur në Dresnik gjendet në Muzeun Kombëtar të Kosovës në Prishtinë. Për stelën e arealit të Naisit khr. Petrović, *Naissus-Remesiana Horreum Margi*, 99-100, n. 66; Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit*, 719, n. 147, T. 75, fig. 138.

<sup>27</sup> Khr. Dimitrije Sergejevski, "Novi kameni spomenici iz Ustikoline i Rogatice", *Glasnik Zemaljskog muzeja Bosne i Hercegovine* (GZMBiH) 48 (1936), T. I, fig. 11; Čremošnik, "Nošnja na rimskim spomenicima", 108-109, fig. 3 në monumente mbivarrore; Sergejevski, "Iz problematike ilirske umjetnosti", *Godišnjak III*, Centar za Balkanološka ispitivanja 1 (1965), 131, fig. 18 të kultit (Silvani me tri nimfa).

është i pranishëm në pak raste grash në stela.<sup>28</sup> Me të njëjtat tipare është trajtuar edhe vajza. Me këtë mënyrë punimi kjo paraqitje relievore i takon krijimtarisë së artit të shkolluar<sup>29</sup>.

Në fushën mbishkrimore pason mbishkrimi, i cili është i plotë dhe të gjitha shkronjat janë gjithashtu të rregullta me madhësi të njëjtë, serifet e të cilave janë horizontale dhe vertikale. Pos formulës së zakonshme përkushtuese të monumenteve mbivarrore “D M”, që haset në fillim të mbishkrimit dhe i paraprin emrit të ndjerit, dy rasteve të gjentilicet dhe të vjetët, nuk ka shkurtesa, ndërsa të interpunkcioni në katër vende është skalitur nga një gjethe urthi (*hederae distinguentes*). Mirëpo, megjithëse janë të skalitura me mjaft kujdes, ky tekst ka gabime në të shkruar, që flet se kemi të bëjmë me një latinishte të vulganzuar, meqë në kohën kur u skalit teksti i kësaj stele ajo përdorej me të madhe nga popullsia autoktone<sup>30</sup>. Megjithatë, transkribimi i tij nuk paraqet vështirësi: *D(is) M(anibus) / Ulp(ia) Mata / qu(a)e vixit / ann(is) XV / Ael(ia) Andia / fili(a)e [su]ae / piissim(a)e po/sui(t)*.

Nga ky mbishkrim kuptohet se këtë monument ia ngriti nëna bijës se vet shumë të dashur e cila jetoi 15 vjet. Në pajtim me veshjen është kognomeni (tutje emri) *Andia* i nënës që i takon onomastikonit ilir<sup>31</sup>, e cila sipas zakonit edhe pas martesës ruante gjentilicin perandorak që kishte sa ishte vajzë (këtu *Aelia*)<sup>32</sup>. Kurse emri i të bijës *Mata* për herë të parë paraqitet në Dardani<sup>33</sup>, por që mbante gjentilicin *Ulpia*, të cilin

<sup>28</sup> Khr. Vulić, “Antički spomenici naše zemlje”, *Spomenik SKA*, LXXI, 115, n. 280 (Pejë), 215, n. 573 (Shkup); i njëjti, “Antički spomenici naše zemlje”, *Spomenik SKA*, LXXVII, 49, n. 42 (Nish); interpretimi: Dobruna-Saliu, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit*, 712-713, n. 137, T. 70, fig. 129 (Shkup), 713-714, n. 139, T. 70, fig. 130 (Nozrinë të Nishi), 750, n. 194, T. 92, fig. 174 (Pejë).

<sup>29</sup> Khr. Exhlale Dobruna-Saliu, “Realizimet e artit të shkolluar në plastikën portretore të trevës së Dardanisë gjatë kohës romake”, *Saxa loquuntur* (Prishtinë, 2016) 331-349.

<sup>30</sup> Khr. Petar Skok, “Pojave vulgarnog latinskog jezika na natpisima rimske provincije Dalmatiae”, *Starinar* I, (1922), 121 e tutje.

<sup>31</sup> Khr. Hans Krahe, *Lexicon altilyrischer Personnamen* (Heidelberg, 1929), 5; Anton Mayer, *Die Sprache der alten Ilyrier*, I (Wien, 1957), 44.

<sup>32</sup> Khr. H. Thylander, *Étude sur l'épigraphie Latine* (Lund, 1952), 75.

<sup>33</sup> Në trajtën *Matta* së bashku me pandanin *Matto*, i takojnë emrave kelt, khr. Alfred Holder, *Alt-celtischer Sprachschatz* II (vol. 2), (Leipzig, 1904), 478. Këta emra, pos trevave kelte, hasen edhe në treva të tjera, khr. OPEL 3, 2000, 66. I kësaj përkatësie është edhe kognomeni *Mattonia*, i njohur që në Gali, khr. Holder, po aty, i cili në një rast haset edhe në *Delminium* (Dalmaci): CIL III 14320,3 *Tertia*, khr. Alföldy *Die Personennamen*, 98; OPEL 3, 2000, 66.



kryesisht e bartnin vendasit. Në Dardani paraqitet edhe emri *Mataura*<sup>34</sup>, i gjetur në arealin e Skupit, po ashtu deri tash i panjohur. Kurse në trevën e gjerë ilire haset emri *Amata* i gjetur në Risin (*Risinum*, Risni në Bokë të Kotorrit)<sup>35</sup>, i cili është latin, përkatësisht romak<sup>36</sup>, por që nuk tregon se bartësi i tij ka qenë një i huaj, meqë emrat e tillë te popullata vendase kanë depërtuar me anën e dhënies së të drejtës qytetare romake - me ç'rast sidomos ka ndikuar "*Constitutio Antoniniana*"<sup>37</sup> - apo thjesht janë huazuar edhe nga vet *peregrinët*, pasi ajo ishte bërë si modë<sup>38</sup>. Siç shihet, emri nuk tregon gjithherë etnikonin e një personi, për të cilën gjë edhe G. Alföldy me të drejtë konstaton se përkatësia gjuhësore e një emri nuk është e thënë ta përcaktojë edhe origjinën etnike të atij personi<sup>39</sup>. Prandaj, në rastin tonë, megjithëse më parë do të mendonim te emri [A]*mata*, në të mirë të së cilës flet gjentilici i së ndjerës, prapë duhet marrë parasysht edhe emrin *Mata[ura]*.

Bazuar në frizurën e gruas<sup>40</sup>, si dhe tipareve të mbishkrimit<sup>41</sup> këtë stelë, e cila mund të konsiderohet si realizimi më i mirë ikonografik i këtij lloji monumentesh në Kosovë, dhe njëri ndër më të mirët në tërë Dardaninë, duhet datuar në fund të shekullit II, apo në çerekun e parë të shekullit III. Së bashku me rastet e tjera, të gjetura në Dresnik të Klinës, Rahovec, Shkup etj.,<sup>42</sup> ku nëna ia kushton bijës së vet monumentin mbivarror, flasin për rëndësinë e gruas dhe të fëmijës, pa marrë parasysht gjininë në shoqërinë dardane.

<sup>34</sup> Khr. Dragojević-Josifovska, *Scupi et la région de Kumanovo*, 88, n. 62: *Mat/aurae Comi/niae*.

<sup>35</sup> Alföldy, *Die Personennamen*, 147.

<sup>36</sup> Kajanto, *The Latin cognomina*, 284.

<sup>37</sup> Draga Garašanin, *Iliri, Iliri i Dačani* (Beograd, 1971), 29.

<sup>38</sup> Fanula Papazoglu, "O onomastičkoj formuli kod Makedonaca u rimsko doba", *Živa antika* V, 2 (1955), 363-364; Alföldy, *Die Personennamen*, 17.

<sup>39</sup> Alföldy, *Die Personennamen*, 18.

<sup>40</sup> Khr. M. Wegner, "Datierung römischen Haartrachen", *Archäologischer Anzeiger* 53 (1938), 276, 325, i cili thekson se frizurat e perandoreshave romake janë ndihmesë në datimin e monumenteve.

<sup>41</sup> Khr. Petrović, *Paleografia rimskih natpisa u Gornjoj Meziji*, 85-107.

<sup>42</sup> Stela nga Dresniku nuk është e botuar dhe gjendet në Muzeun Kombëtar të Kosovës në Prishtinë; për të tjerat khr. Dobruna-Saliu, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit*, 691, n. 105, T. 54, fig. 97 nga Skupi dhe gjendet në Muzeun Arkeologjik të Shkupit, 701, n. 120, T. 62, fig. 112 nga Rahoveci dhe gjendet në Muzeun Kombëtar të Kosovës në Prishtinë.



\* \* \*

Në fund mund të konstatojmë se rëndësia e këtyre monumenteve - që të dyja të dala nga punëtoritë vendase në fund të shek. II dhe çerekun e parë të shek. III - qëndron në faktin se, në një anë me mënyrën cilësore të punimit tregojnë aftësitë e gurskalitësve vendas dhe, në anën tjetër, secila me tematikën e saj na ofron të dhëna të vlefshme. Altari i Vendenit, duke e rritur numrin e altarëve të kultit përkushtuar perëndive dhe perëndeshave së bashku në Dardani, flet se në këtë trevë ata nderoheshin të pandashëm. Stela e Peqanit me përkushtimin bijës nga nëna me emër dhe veshje ilire, të paraqitura edhe ikonografikisht në formë busti në relief, e rrit numrin e monumenteve mbivarrore të këtij karakteri në Dardani, duke dëshmuar se në këtë trevë bëhet fjalë për një shoqëri të zhvilluar kulturore, ku bota femërore e kishte një vend meritë.

Në këtë punim objekt studimi janë dy monumente nga koha romake të gjetura në lokalitete të ndryshme, të cilat u takojnë dy grupeve të mëdha tematike dhe kategorive të ndryshme brenda tyre. Që të dy i takojnë fundit të shek. II dhe decenieve të para të shek. III dhe janë punuar në mënyrë mjaft cilësore.

**Altari votiv (fig. 1)** u zbulua në vitin 2017 gjatë gërmimeve arkeologjike në *Vendenisin* antik (Gllamniku i sotëm), ku gjendet edhe sot. E kishte të ruajtur kurorën dhe gjysmën e trupit me një pjesë të mbishkrimit përkushtuar perëndive dhe perëndeshave së bashku me formulën përkushtuese “D D” nga një beneficiar konsullar, që paraqet rastin e katërt të kësaj formule në Dardani dhe flet se në këtë trevë ata nderoheshin të pandashëm në grup edhe përmes kësaj formule.

**Stela mbivarrore (fig. 2)** u gjet rastësisht në vitin 2019 në fshatin Peqan dhe tani gjendet në Muzeun e Therandës. Është e tërë dhe e ruajtur mirë. Iu përkushtua bijës nga nëna me kognomen dhe veshje ilire, ku që të dyja në formë busti, janë të skalitura në fushën relievore, që mund të konsiderohet realizimi më i mirë ikonografik i këtij lloji monumentesh në Kosovë. Deri tash në Dardani përbën monumentin e katërt mbivarror të kësaj tematike, duke dëshmuar se në këtë trevë bëhet fjalë për një shoqëri të zhvilluar kulturore, ku bota femërore e kishte një vend meritë.

Në fund mund të themi se rëndësia e këtyre monumenteve - që të dyja të dala nga punëtoritë vendase - qëndron në faktin se, në një anë me mënyrën cilësore të punimit tregojnë aftësitë e gurskalitësve vendas, dhe në anën tjetër, secila me tematikën e saj na ofron të dhëna të vlefshme.

Exhlale DOBRUNA-SALIHU

## SUMMARY

### **TWO MONUMENTS FROM THE ROMAN TIME DISCOVERED LATELY IN KOSOVA**

In this paper, the study objects are two stone monuments from the Roman time, found in different localities, which belong to two big thematic groups and different categories within them. Both of them belong to the end of the II century and first decades of the III century and they are crafted in a really qualitative way.

The cult *ara* (fig.1) was discovered in 2017 during archaeological excavations in the antique *Vendenis* (the present day Gllamnik), where there is today as well. It had the crown and the half of the body with a part of the inscription dedicated to Gods and goddesses together with the dedication formula "D D" from a consular beneficiary, which represents the fourth case of this formula in Dardania and tells that they were honoured unseparated, in group, also through this formula.

The funeral stela (fig. 2) was found occasionally in 2019 in the village of Peqan and now it is in the Museum of Theranda. It is whole and very well preserved. It was dedicated to daughter from mother with Illyrian cognomen and clothing, where both of them are engraved in the relief field, in the form of bust, which can be considered the best iconographic execution of this kind of monuments in Kosova. Until now, in Dardania, this is the fourth gravestone monument of this character, testifying that in this territory there was a culturally developed society, where female world had a deserved place.

The importance of these monuments — both of them coming out from local workshops — relies on the fact that, in one hand, the qualitative way of work shows the skills of the local craftsmen, and in the other hand, each one provides valuable data with its theme.

**Emine KALAJA-HAJDARI**

**DËSHMITË EPIGRAFIKE TË PRANISË SË HYJNIVE TË  
LINDJES NË DARDANI**

Ndryshimet që ndodhen në Dardani pas pushtimit romak, përveç tjerash u manifestuan edhe në botën shpirtërore, duke sjellë kësisoj praktika të reja religjioze, bashkë me to edhe një numër kultesh të religjionit oficial dhe jooficial romak. Në mesin e tyre vend domethënës zinin edhe kultet e ardhura nga Lindja, të cilat adhuroheshin e nderoheshin në gjithë territorin e Perandorisë Romake. Prania e adhurimit të tyre është dëshmuar edhe në truallin dardan. Në mungesë të burimeve literare, për ndriçimin e praktikave religjioze, rrugës së përhapjes dhe nivelit të adhurimit të tyre, sidomos nëpër provinca, burimet kryesore për ndriçimin e këtyre aspekteve mbeten ato epigrafike dhe materiali arkeologjik. Përmbajtja e teksteve epigrafike, forma e tyre, por edhe fakti se ato ngriteshin nga elitat municipale, ushtarët, të liruarit e të tjerë, shërbejnë si burime të rëndësishme përmes të cilave mund të ndërtohen narracione historike të ardhjes dhe përhapjes së formave të besimit edhe në këtë pjesë të botës antike, Dardanisë, që njihet për diversitetin religjioz.

Zbulimet e deritanishme, veçanërisht ato epigrafike dhe ikonografike, japin prova të drejtpërdrejta të përhapjes së kulteve të ndryshme në tërë territorin dardan. Në mbishkrime epigrafike, pos hyjnive romake, greke dhe indigjene, janë paraqitur gjithashtu një grup hyjnishtë lindorë të ardhur në këtë pjesë të Perandorisë Romake si pasojë e rrethanave të ndryshme politike, ekonomike, si dhe për faktin se, Dardania, gjeografikisht, ishte një urë lidhëse në mes Lindjes dhe Perëndimit, dhe si e tillë ajo ishte një zonë ku takoheshin kulte dhe fenomene kulturore e shpirtërore. Këto forma të reja të besimit, përpos

përmes zyrtarëve romakë, ishin sjellë këtu edhe nga ushtarë, tregtarë, udhëtarë dhe aventurierë të të gjitha llojeve.

Nga mbishkrimet epigrafike, të zbuluara deri më tani në këtë hapësirë, na është dëshmuar adhurimi dhe nderimi i kulteve të ndryshme me origjinë nga Lindja, respektivisht nga Azia e Vogël, Siria, Egjipti dhe Persia, të cilat pos që nderoheshin në trajta burimore, ato, sipas *interpretatio romana*, identifikoheshin edhe me perëndi të panteonit romak. Në mesin e hyjnive burimorë nga Lindja që nderoheshin në Dardani, ndër më të rendësishmit ishte *Mitra*, perëndi iraniane e diellit dhe personifikimi i dritës së pamposhtur. Rruga e kalimit dhe përhapjes së këtij kulti indopersian nga vendlindja e tij në Indi, ishte përmes Persisë, dhe pas humbjes së kësaj të fundit, në luftë me Aleksandrin e Madh, u zgjerua në të gjithë botën helene, për t'u përhapur më pastaj përmes Romës në tërë territorin e Perandorisë. Bartësit dhe mbështetësit kryesorë të këtij kulti, i cili ishte edhe rivali i një feje që po lindte, krishterimit, ishin ushtarët. Si kult mitik që ishte, në Dardani kishte ardhur përmes Dakisë dhe Danubit.<sup>1</sup> Ai është dëshmuar epigrafikisht në arealin e Kumanovës,<sup>2</sup> (mbishkrimi nr.1) në një altar, i cili ishte ngritur për shëndet të perandorëve. Monumenti ishte ngirur gjatë udhëheqjes së konsujve Gentiano dhe Basso, nga Apollonides. Ai ishte *contrascriptor* në *vectigalis Illyrici* në stacionin Lamud,<sup>3</sup> si duket edhe në atë të Vizianos. Në një altarë tjetër po nga Kumanova,<sup>4</sup> (mbishkrimi nr. 2) të cilit nuk i dihet dedikuesi, meqë ai është i dëmtuar, kuptojmë së altari ishte ngritur në nderim të Mitrës së shenjtë. Të dhënat arkeologjike sugjerojnë se në Kumanovë mendohet se ruhen gjithashtu mbetjet edhe të dy *mithraeumeve*.<sup>5</sup> Prezenca e këtij kulti është dëshmuar edhe në

<sup>1</sup> Naser Ferri, *Mythologia viva*, Prishtinë, 2012, 127.

<sup>2</sup> Nikola Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", *Spomenik SKA*, LXXI, (Beograd, 1931), 200; Petar Petrović, *Paleografija rimskih natpisa u Gornjoj Meziji*, Beograd, 1975, 130, 9; Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë në kohën romake*, Prishtinë, 1981, 238-239, 157; Emine Kalaja-Hajdari, *Shndërrimet në Dardani gjatë periudhës romake*, Prishtinë, 2017, 282, 212.

<sup>3</sup> Stacioni doganor në Lamud, ishte zonë e trefishtë kufitare, meqë lidhte Mezinë Superiore, Maqedoninë dhe Thrakinë cf: Aleksandra Nikoloska, "Evidence of Oriental cults from the Republic of Macedonia", *Romanisation orental Gods*, MASA, University of Laiden, Skopje, 2015, 267.

<sup>4</sup> Nikola Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", 1934, 29; Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë*, 241, 172; Kalaja-Hajdari, *Shndërrimet në Dardani*, 286, 226.

<sup>5</sup> Milovan Kokić, "Novi tragovi mitrina kulta u južnoj Srbiji", *Glasnik srpskog naučnog društva*, (Skopje, 1933), 1.

municipiumin Ulpiana nga një *ex voto* zbuluar në Janjevë.<sup>6</sup> Në pjesën qendrore të pllakës është paraqitur skena e tauroktonisë (sakrifikimi i demit). Duhet potencuar se, imazhi i tauroktonisë, pak a shumë është i paraqitur në mënyrë të njëjtë në tërë Perandorinë,<sup>7</sup> përkundër që bashkësitë individuale kanë pasur liri për të vizualizuar dhe interpretuar historinë e Mitrës në mënyrë të vet. Në rastin e Ulpianës, Mitra paraqitet duke therur demin, të cilin e sulmojnë një qen dhe një gjarpër. Fakti se pllaka ishte e gdhendur vetëm në njërën anë<sup>8</sup>, lë të hamendësohet që ajo zbuluronte murin e një *Mithraeumi*. Megjithatë, deri më tani nuk janë gjetur ende gjurmët e ndonjë sanktuari në Ulpianë dhe arealin e saj kushtuar Mitrës.

Hyjni tjetër i dëshmuar epigrafikisht në Dardani ishte edhe *Serapisi*, hyjni ky sinkretik greko-egjiptian, hy i diellit dhe pjellorisë, shërimit dhe mjekësisë, si dhe mbrojtës i marinarëve. Ky ishte njëri ndër hyjnitë e huaja që zuri vend në panteonin romak, dhe më pas u përhap në një pjesë të madhe të territoreve të pushtuara nga romakët,<sup>9</sup> përfshi edhe Dardaninë. Në provincën e Mezisë, pjesë e së cilës për një kohë ishte edhe Dardania, përgjithësisht është pak i dëshmuar, sikundër edhe nëpër provincat fqinje. Deri me tani, në territorin e Dardanisë adhurimi i kultit të Serapisit epigrafikisht është dëshmuar në një altar të zbuluar në Zllokuqan (Scup),<sup>10</sup> (mbishkrimi nr. 3) në Dërsnik<sup>11</sup> (mbishkrimi nr. 4) dhe në Zllakuqan të Klinës,<sup>12</sup> (mbishkrimi nr. 5), ndërsa në Ravnë është zbuluar një kokë e mermerit, respektivisht fragmente të një statuje, që mendohet që përfaqëson Serapisin.<sup>13</sup> Bartësit e këtij kulti të ardhur në këtë pjesë të Perandorisë, me gjasë në shekujt II-III pas Kr., fillimisht

<sup>6</sup> Vulić, “Antički spomenici naše zemlje”, 1941-1948, 106.

<sup>7</sup> Lucinda Dirven, “The Mithraeum as tableau vivant”, *Religion in the Roman Empire*, volum I, (Tubingen-Germany 2015), 31.

<sup>8</sup> Emil Čerškov, *Romakët në Kosovë dhe Municipiumi DD te Soçanica*, Prishtinë, 1973, 72.

<sup>9</sup> Lidhur me përhapjen e këtij kulti në Perandorinë Romake cf: Perikles Christodoulou, “Serapis, Isis and the Emperor”, *Romanisation orental Gods*, MASA, *University of Laiden*, (Skopje, 2015), 169.

<sup>10</sup> Borka D. Josifovska, *Inscriptions de la Mésie Supérieure: Scupi et la Région de Kumanovo*, vol. VI, CĚĚNFPUB, (Beograd 1982), 59, 19; Kalaja-Hajdari, *Shndërrimet në Dardani*, 258, 133.

<sup>11</sup> Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë*, 256, 259, 262, 281; Kalaja-Hajdari, *Shndërrimet në Dardani*, 389, 395, 571, 596; Vulić, “Antički spomenici naše zemlje”, 1941-1948, 279.

<sup>12</sup> Ferri, *Mythologia viva*, 72

<sup>13</sup> Zef Mirdita, *Religjioni dhe kultet e dardanëve dhe Dardanisë në antikë*, Zagreb, 2001, 63.

ishin tregtarët, të cilët me rastin e kontakteve tregtare përhapnin edhe kultet e tyre, pastaj ushtarët të cilët e pranuan atë gjatë shërbimit të tyre në provincat lindore, dhe pas përfundimit të shërbimit dhe kthimit, ndikonin në përhapjen e këtij kulti në vendet prej nga vinin, e më vonë si bartës paraqitën edhe skllevërit.

Nga Egjipti vjen poashtu edhe *Izida* (Isis), si hyjnia e jetës bashkëshortore që adhurohej dhe nderohej kudo.<sup>14</sup> Për dallim nga vendet perrreth, ku në ndërim të kësaj hyjnie janë ngritur edhe tempuj,<sup>15</sup> në Dardani, kulti i saj është dëshmuar epigrafikisht vetëm në një altar në Zllakuqan,<sup>16</sup> në arealin e Dërsnikut (mbishkrimi nr. 6), ngritur nga Evfroniys, kurse figurativisht ishte e pranishme edhe në Timacum Minus,<sup>17</sup> ku janë zbuluar dy koka nga mermeri, fragmente të statujave, të cilat mendohet se paraqesin Iziden.

Kult tjetër i njohur lindor, i cili adhurohej në tërë territorin e Dardanisë, është ai i *Dolichenus*,<sup>18</sup> i ngjashëm me Jupiterin. Origjina e këtij kulti duket të jetë Dolichea (provinca Comagene) në veri të Sirisë. Ai është në lidhje me hyjninë *Baal*, i cili fillimisht ishte hyjni i fenomeneve natyrore, për t'u bërë më pastaj zotërues i botës.<sup>19</sup> Shpërndarja e kultit të tij u bë nga ushtarët romakë, të cilët shërbyen në Lindje, ku edhe e pranuan dhe përshtatën këtë kult.<sup>20</sup> Kështu, nga Bali Lindor krijohet *Jupiter Dolichenus*.<sup>21</sup> Kulti i tij është dëshmuar deri më tani epigrafikisht në Ulpianë, (mbishkrimi nr. 7, 8), Prizren<sup>22</sup> (mbishkrimi nr. 9) dhe Kumanovë,<sup>23</sup> (mbishkrimi nr. 10). Dedikimi i zbuluar në

<sup>14</sup> Carla Sfameni, *Isis, Cybele and other oriental gods in Rome in late antiquity*, Stutgard, 2012.

<sup>15</sup> Silvana Blaževska and Jovan Radnjanski, "The temple of Isis at Stobi", *Romanisation orental Gods, MASA, University of Laiden*, Skopje, 2015, 216

<sup>16</sup> Luan Përzhita, Fatmir Peja, "Qendra dhe gjetje arkeologjike të shekujve I-IV", *Harta Arkeologjike e Kosovës I*, Prishtinë 2006, 190.

<sup>17</sup> Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", 1941-1948, 199-200.

<sup>18</sup> Lidhur me shtrirjen dhe adhurimin e këtij kulti në Dardani shih: Emine Kalaja-Hajdari, "Kulti i Jupiter Dolichenus në Dardani", *Kosova*, nr. 43, Instituti i Historisë, (Prishtinë, 2018), 19-24.

<sup>19</sup> Naser Ferri, Besimi dhe kultet në Dardaninë e parakrishterë", *Dardania Sacra* 1, (Prishtinë, 1999), 40.

<sup>20</sup> Dušanka Vučković-Todorović, "Antička Demir Kapija", *Starinar* XII, (Beograd, 1964-65), 178.

<sup>21</sup> Kalaja-Hajdari, "Kulti i Jupiter", 19.

<sup>22</sup> L Annee epigraphique, 1981, 0739; M. P. Speidel, *Arch. Slov*, 31, 1980, Nikola Vulić, 1931, 133, 322; Zef Mirdita, 1981, 261, 297.

<sup>23</sup> *Corpus Inscriptionum Latinarum III*, 8243, (Berlin, 1881)

Ulpianë ishte ngritur nga priftërinjtë e këtij kulti, Victor dhe Dmetrius. Fakti që nderimi i kultit të tij është bërë nga priftërinjtë Victor dhe Demetrius, lë të hamendësohet për mundësinë e pranisë së një tempulli kushtuar kultit të tij në Ulpianë. Kurse, altari votiv nga Kumanova, ishte ngritur gjatë konsulatit të Sabino II dhe Anulino, nga Augusti dhe Iulia Augustae Achilleus për shëndetin e perandorit M. Aureli Antonini Pii. Përderisa në Ulpianë dhe Kumanovë Dolicheno nderohej i vetmuar, në dedikimin nga Prizreni i cili ishte ngritur nga Heracliti Surus, Dolicheno na paraqitet i shoqëruar me hynijtë Asclep, Telesfor dhe Hygia. Pos epigrafikisht, adhurimi i këtij kulti është dëshmuar edhe në material figurativ, siç është rasti i Timacum Minus, ku janë zbuluar disa fragmente të plastikës, ku shihet ky hy i ulur mbi dem.<sup>24</sup> Referuar të dhënave epigrafike, adhurimi i kultit të Dolicheno në territorin e Dardanisë ka qenë i pranishëm deri në shek. III.<sup>25</sup>

Një tjetër kult oriental i cili deri më tani është dëshmuar vetëm në Dardani, përkatësisht në dy mbishkrime në Ulpianë, është ai i *Melanus Cidesius* (mbishkrimi nr. 11, 12), i shfaqur në mbishkrime si *Jupiter Melanus Cidesius*. Në të dy rastet, epiteti i përbashkët është *mel(anus)*,<sup>26</sup> atribut i Zeus Melanos. Ai paraqitet si hy mbrojtës i vendbanimit Mela në Bitini.<sup>27</sup> Epiteti i dytë *cid(iesso)* është trajtë e latinizuar dhe ka të bëjë me Zeus Kidnessos, qytet (Kideiessos) në Frigji, emër ky i cili paraqitet në legjendat e monedhave të qytetit.<sup>28</sup>

Në Ulpianë është dëshmuar edhe një hy tjetër me origjinë nga Frigjia, ai i *Ezzaios*<sup>29</sup> (mbishkrimi nr. 13). Ky monument i ishte kushtuar Zeus Ezaios, nga Apollonius i biri i Menelaos. Ka të ngjarë që mund të bëhet fjalë për hyjni pajtore të qytetit të Aizanoi. Edhe në këtë rast, kemi ngjashmëri me Jupiterin, si mbrojtës i minierave dhe minatorëve. Nderuesit e këtij kulti janë të ardhur nga Anadulli për të punuar në miniera.<sup>30</sup> Në fakt, këto epitete të përdoruara mund të jenë thjesht

<sup>24</sup> Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", 1941-1948, 93.

<sup>25</sup> Zef Mirdita, "Prisutnost orientálnih kultova na području Dardanije", *VAMZ*, 3. s., XXXIV, 37-58, (Zagreb, 2002), 43.

<sup>26</sup> Fatmir Peja, "Epigrafika", *ABKM*, Beograd, 1998, 3.

<sup>27</sup> Fatmir Peja, "Jedan zanimljiv natpis sa Ulpiane", *Buletini i Muzeut të Kosovës*, XII-XIV, (Prishtinë, 1984), 59.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Andras Móscy, *Gesellschaft und Romanisation in der romischen Provinz Moesia Superior*, (Budapest-Amsterdam 1970), 244; Slobodan Dušanić, "Heteroklitičko matalli u natpisima rudničkoog novca", *Živa Antika*, 21, (Skopje, 1971), 258-259; *AE*, 1972, 144, 502; Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë*, 247, 209.

<sup>30</sup> Slobodan Dušanić, (Skopje, 1971), 258 - 259.

emërtime toponimike të vendeve të origjinës së imigrantëve, të cilët përmes tyre dëshironin të ruanin identitetin e tyre etnik dhe kulturor. Praninë e tyre në provincën e Mezisë së Epërme duhet parë si rrjedhim të një vale imigrimesh përgjatë shekullit II nëpër krahinat e pasura me miniera. Gjenerata e parë e të imigruarve greqishtfolës zakonisht nderonin hyjnitë e tyre lokale, pra Zeusin nga vendi i origjinës së tyre, në gjuhën e tyre amtare, në dallim nga pasardhësit e tyre që, pasi fitonin të drejtën e qytetarisë romake, përdornin gjuhën latine dhe Zeusin lokal të tyre e identifikonin me kryehyjnin e panteonit romak, Jupiterin.<sup>31</sup> Kështu, me sa duket, ky hy asnjëherë nuk është pranuar si kult nga autoritetet romake, sepse në asnjë rast nuk është dëshmuar i ngritur për mbrojtje të perandorit apo shtetit, por vetëm dhe gjithnjë për mirëqenien e adhuruesve të tij.

Hyjnesha *Atargatis* (Dea Syria), hyjneshe siriane, personifikonte natyrën, jetën dhe plleshmërinë, ishte e pranishme edhe në Dardani. Kult i saj është dëshmuar se adhurohej në mesin e popullatës së arealit të Scupit,<sup>32</sup> (mbishkrimi nr. 14, 15) nga ku janë zbuluar dy monumente përkushtuar kultit të saj. Monumentin e parë e kishte ngritur një qytetar romak emri i të cilit nuk është ruajtur në tërësi, por emri i qytetit prej nga ai ishte, është ruajtur, dhe ai ishte nga Verona.<sup>33</sup> Ai mund të ketë qenë *dumvir* në koloninë e Scupit. Ndërsa nga monumenti i dytë, kushtuar po kësaj hyjnie, na janë ruajtur dy fjalë, ku thuhet se ky altar i është dedikuar të shenjtës Hyjnisë Syriae. Të dhënat epigrafike sugjerojnë se bartës të këtij kultu ishin skllëvërit, tregtarët dhe ushtarët.

Në grupin e perëndive lindore që adhuroheshin në Dardani ka zënë vend edhe *Quadrivia*, hyjnesha e udhëkryqeve. Përderisa kult i saj ishte shumë i pranishëm në provincat e Germanisë, Panonisë, Dalmacisë dhe Dacisë<sup>34</sup>, në Dardani adhurimi i saj është dëshmuar epigrafikisht deri më tani vetëm në qytetin e Scupit<sup>35</sup> (mbishkrimi nr. 16). Mbishkrimi është tejet i dëmtuar, dhe si rrjedhojë është e pamundur të nxirren më

<sup>31</sup> Aleksandra Bošković-Robert, *Le culte de Jupiter en Mésie Supérieure*, (Tezë doktorate, Paris IV Sorbonne, 13/12/2006).

<sup>32</sup> Borka D. Josifovska, *Inscriptions de la Mésie Supérieure: Scupi et la Région de Kumanovo*, vol. VI, CĖĖNFPUB, (Beograd 1982), 58, 17; Borka D. Josifovska, 1982, 57, 15.

<sup>33</sup> Lenče Jovanova, "On some the Oriental cults in the Skopje-Kumanovo region", *Romanisation oriental Gods, MASA, University of Laiden*, Skopje, 2015, 296.

<sup>34</sup> Josifovska, *Inscriptions*, 57.

<sup>35</sup> Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", 1933, 210; Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë*, 218, 35; Josifovska, *Inscriptions*, 56 - 57, 13.



shumë të dhëna pos emrit të perëndisë. Na është ruajtur po ashtu emri Valens, që më gjasë mund të këtë qenë ngritësi i këtij monumenti.

Një hyjni tjetër i ardhur nga provincat lindore që adhurohej shumë në provincat danubiane është edhe *Sabazio*, hy sinkretik, mbrojtësi nga e keqja. Nderimi i kultit të tij është dëshmuar gjithashtu edhe në Dardani, respektivisht në Timok<sup>36</sup> (mbishkrimi nr. 17), i cili njëherit paraqet edhe rastin e vetëm të adhurimit të tij në tërë provincën e Mezisë. Altari ishte ngritur gjatë konsulatit të M. Antonio Gordiano Augusto dhe Clodio Pompeiano për shëndetin e perandorit, nga Flavius Clemes.

Pos përkushtimeve ku adhuroheshin kulte të perëndive të ndryshme, burimet epigrafike kanë dëshmuar gjithashtu adhurimin e personave të mortshëm. Një rast të tillë e kemi në Municipiumin DD, ku gjatë gërmimeve arkeologjike të zhvilluara në vitet e '60-ta,<sup>37</sup> është zbuluar një monument kushtuar kultit të Antinout, (mbishkrimi nr. 18) bashkë me tempullin kushtuar kultit të tij. Kushtimi ishte ngritur nga kolonët e minierave të argjendit të Municipit DD. Realizimi i punimeve në ndërtimin e tempullit i ishte besuar Telephorit, prokurator dhe i liruar i perandorit. Në kushtim emri i tij ishte shënuar si *Antonioo Heroi*. Mendohet se Antinou ishte mik i perandorit Hadrian, dhe me urdhrin e tij ai ishte flijuar duke rënë në lumin Nil.<sup>38</sup> Perandori e heroizoi atë, duke e ngritur në kult në shenjë respekti për të. Kushtimi dedikuar tij paraqet rastin e vetëm deri më tani në Ballkan, përderisa tempulli i Antinout paraqet të vetmin sanktuar kushtuar hyjnive orientale zbuluar në Dardani.

Si përfundim mund të themi se dëshmitë epigrafike pasqyrojnë qartë prezencën e një komuniteti të ardhur nga Lindja në territorin e Dardanisë që në shekullin e parë, për të arritur fluksin më të madh gjatë shekujve II-III. Bashkë me ta depërtuan edhe kultet e ndryshme në Dardani duke e pasuruar kështu korpusin e hyjnive zyrtarë dhe jozyrtarë të cilët adhuroheshin dhe nderoheshin në këtë pjesë të Perandorisë Romake përgjatë shekujve I-III. Për shkak të përmbajtjes së varfër të mbishkrimeve dhe faktit se një pjesë e madhe e tyre janë të dëmtuara, është e vështirë të përcaktohet statusi i saktë juridik i një numri të madh të këtij komuniteti. Fakti se një pjesë e tyre posedonin *tria nomina* është tregues i qartë se ata zotëronin statusin e qytetarit romak. Në mesin e tyre

<sup>36</sup> Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", 1941-1948, 173; AE 1966, 93, 338; Petrović, *Paleografija*, 142, 40; Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë*, 1981, 292, 490.

<sup>37</sup> Emil Čerškov, *Municipium DD kod Sočanica*, Beograd 1970, 65-66.

<sup>38</sup> Mirdita, *Religjioni dhe kultet e dardanëve*, 60.

kishte gjithashtu edhe zyrtarë të lartë romakë, siç e kemi rastin e *dumvir* nga Scupi, pastaj *procurator* nga Municip DD dhe zyrtarin doganor, *contrascriptor* nga stacioni doganor Lamund. Prezencën e tyre në Dardani, pos si tregtarë, zejtar etj., para së gjithash duhet parë në kontekst të eksploatimit të minierave. Është i njohur fakti se me ardhjen e romakëve kemi një intensifikim të eksploatimit të minierave në Dardani. Kësisoj, administrata romake solli një numër ekspertësh në fushën e minierave, ku si të preferuar ishin ata nga Lindja për shkak të përvojës që e posedonin në fushën e eksploatimit të minierave. Prandaj, edhe rritja e numrit të tyre gjatë shekullit II-III konsiston me rritjen e nivelit të eksploatimit të minierave gjatë kësaj periudhe.

Në favor të këtij argumenti flasin edhe gjetjet epigrafike, ku shumica e dedikimeve kushtuar kulteve të këtyre perëndive vinë pikërisht nga zonat e pasura me minierave. Në anën tjetër, prania e diversitetit religjioz, pos që shfaq anën tolerante të Romës karshi bindjeve të ndryshme religjioze, është tregues i qartë i një larmie të pasur etnik dhe kulturor. Një shumëllojshmëri të tillë e pasqyrojnë edhe tekstet e mbishkrimeve epigrafike, ku vërehet prezenca e qytetarëve të ardhur nga provinca të ndryshme romake, qoftë nga Lindja apo Perëndimi, të cilët kishin lidhur interesat e tyre politike dhe ekonomike me Dardaninë, fakt i cili shpërfaqë potencialin dhe rëndësinë që kishte Dardania në planin ekonomik për vetë Perandorinë Romake.

Referuar burimeve epigrafike, por edhe materialit arkeologjik, prania e adhurimit të kulteve orientale nuk mund të përcillet pas shekullit III. Mungesa e kushtimeve të tilla duket të ketë ardhur si rezultat i procesit të romanizimit. Kësisoj, gjenerata e parë e të imigruarve adhuronin perënditë e tyre burimore, por kjo nuk ndodhte me gjeneratat pasuese, të cilët, në ndikimin e një akulturimi intensiv, hyjnitë e tyre i identifikonin me ato romake duke ndikuar që përgjatë rrjedhës së kohës të akulturoheshin plotësisht dhe adhuronin vetëm perëndi romake. Një element tjetër duket të ketë qenë edhe kriza ekonomike dhe politike që përfshiu Perandorinë Romake gjatë kësaj periudhe, dhe si pasojë e zhvendosjes së ekonomisë xehetare në plan të dytë, ku si pasojë, rajoni humbë atraktivitetin që posedonte dikur në rrafshin ekonomik dhe politik. Por, nuk duhet lënë pa potencuar edhe ndikimin e madh që pati krishterimi si një religjion i cili gjithnjë e më shumë po zinte teren në raport me kulte pagane.

## Supplementum epigraphicum

### 1. Kumanovë

|                      |                                               |
|----------------------|-----------------------------------------------|
| 1. [ ]M              | <i>D(eo) S(oli) M(ithrae), /</i>              |
| 2. FANO MAG          | <i>Fano mag(no) /</i>                         |
| 3. PRO SAL AVG[[G]]  | <i>prosal(ute) Aug[g(ustorum)]</i>            |
| N[[N]]               | <i>n[n(nostrorum duorum)], /</i>              |
| 4. APOLLONIDES       | <i>Apollonides /</i>                          |
| 5. EORUND VECT IL    | <i>eorund(em)vect(igalis) II</i>              |
| 6. Lyr SER / SC      | <i>lyr(ici)ser(vus),[c](ontra)sc(ripor)</i>   |
| ST                   | <i>stat(ionis) /</i>                          |
| 7. LAMUD QVAM VOVE   | <i>Lamud(i) quam vove</i>                     |
| 8. RAT / SC STA VIZI | <i>Rat c(ontra)sc(ripor) stat(ionis) Vizi</i> |
| 9. ANS VIZ           | <i>(ani)</i>                                  |
| 10. GENTIA           | <i>Gentia/</i>                                |
| 11. NO ET            | <i>no et /</i>                                |
| 12. BASSO [ ]        | <i>Basso co(n)s(ulibus)</i>                   |

### 2. Kumanovë

|                 |                     |
|-----------------|---------------------|
| 1. [ ]EO SANCT/ | <i>[D]eo sanct/</i> |
| 2. O MITHRAE    | <i>o Mithrae</i>    |

### 3. Zllokuqan -Scupi

|                           |                        |
|---------------------------|------------------------|
| 1. <i>ἐΠΗΚΩΦ ΣΑΡΑΠΗ /</i> | <i>ἐπηκώφ Σαράπι /</i> |
| 2. <i>ΔΙΕΥΧΑΡΙΣΤΗΡΙΟΝ</i> | <i>ιεὺχαριστήριον</i>  |

**4. Dërsnik**

- |            |                |
|------------|----------------|
| 1. SERAPI  | <i>Serap</i>   |
| 2. INVICTO | <i>Invicto</i> |

**5. Zllakuqan**

- |                |                      |
|----------------|----------------------|
| 1. MAGNO NV    | <i>Magno Nu/</i>     |
| 2. MINI ET CON | <i>mini / et con</i> |
| 3. SERVATORI   | <i>servatori /</i>   |
| 4. SERAPI      | <i>Serapi</i>        |

**6. Zllakuqan**

- |          |                    |
|----------|--------------------|
| 1. DAEAE | <i>Daeae /</i>     |
| 2. ISIDI | <i>Isidi /</i>     |
| 3. EVFRO | <i>Evfro</i>       |
| 4. NIVS  | <i>nivs /</i>      |
| 5. VOTUM | <i>votum/ [---</i> |
| 6. [     | <i>[</i>           |

**7. Ulpianë**

- |                      |                                    |
|----------------------|------------------------------------|
| 1. I O M             | <i>I(ovi) O(ptimo) M(aximo) /</i>  |
| 2. D[ ]I[ ]ENO       | <i>D[ol]i[ch]eno(?) /</i>          |
| 3. IV[ ] EL CELE [ ] | <i>IV(?)[-]E(?)L Cele</i>          |
| 4. [ ]R MIS [ ]      | <i>[r?] / [--]MIS /</i>            |
| 5. [ ] SL [ ]        | <i>[v(otum)] s(olvit) l(ibens)</i> |
|                      | <i>m(erito)]</i>                   |

## 8. Ulpianë

- |                         |                                                         |
|-------------------------|---------------------------------------------------------|
| 1. I O M D              | <i>I(ovi) O(ptimo) M(aximo)</i><br><i>D(olicheno) /</i> |
| 2. PRO SALUTE D[[D NN]] | <i>pro salute d(ominorum)</i><br><i>nn(ostrorum)</i>    |
| 3. IMP AVG              | <i>Imp(eratorum)</i><br><i>Augg(ustorum) /</i>          |
| 4. VICTOR DEMETRI ET DE | <i>Victor Demetri et De /</i>                           |
| 5. METRIVS AMBIBI SAECE | <i>metrius Ambibi, sac[e]r /</i>                        |
| [ ]                     | <i>[ ]</i>                                              |
| 6. DOTES EIVSDEM DEI SV | <i>dotes eiusdem deis s(olverunt)</i><br><i>v(otum)</i> |

## 9. Prizren

- |                           |                                                         |
|---------------------------|---------------------------------------------------------|
| 1. AS                     | <i>As/</i>                                              |
| 2. CLEP[ ]                | <i>clep[i]o /</i>                                       |
| 3. O                      | <i>O</i>                                                |
| 4. [ ]                    | <i>[ ]</i>                                              |
| 5. [ ]                    | <i>[ ]</i>                                              |
| 6. [ ]                    | <i>[ ]</i>                                              |
| 7. SO[ ]                  | <i>[Teles/phoro Hy]giae] / so-</i><br><i>[...] /</i>    |
| 8. HERACLITI SV           | <i>Heracliti (filius) Su/</i>                           |
| 9. RVS ET PRO             | <i>rus, et pro /</i>                                    |
| 10. GENIO DOLICENI        | <i>Gen(io) I(ovis) / O(ptimi)</i><br><i>Dolicheni /</i> |
| 11. PATERNO DEO ET GEN    | <i>paterno deo et Gen(io) /</i>                         |
| 12. CORTIS VOTVM LIBENS F | <i>cortis votum libens f(ecit)</i>                      |

## 10. Kumanovë

- |                       |                                                         |
|-----------------------|---------------------------------------------------------|
| 1. [ O M D            | <i>I(ovi) O(ptimo) M(aximo)</i><br><i>D(olicheno) /</i> |
| 2. PRO SALVUTE        | <i>pro salute /</i>                                     |
| 3. IMP M AVRELI       | <i>Im(peratoris) M. Aureli /</i>                        |
| 4. ANTONINI PII       | <i>Antonini Pii /</i>                                   |
| 5. AVG ET IVLIAE      | <i>Aug(usti) et Iulia</i>                               |
| 6. AVG MATRI KAST     | <i>Aug(ustae) matri kast(rorum), /</i>                  |
| 7. ACHILLEVS EORVN    | <i>Achilleus eor(un</i>                                 |
| 8. DEM SERVIVS POS    | <i>dem) ser-vus, pos(uit) /</i>                         |
| 9. KAL NOVEMBRI [ ]   | <i>Kal(endis) Novembr[es] /</i>                         |
| 10. SABIANO II ET ANV | <i>Sabino II et Anu/</i>                                |
| 11. LINO COS          | <i>lino / co(n)s(ulibus)</i>                            |

## 11. Ulpian

- |             |                                   |
|-------------|-----------------------------------|
| 1. I O M    | <i>I(ovi) O(ptimo) M(aximo) /</i> |
| 2. MEL CID  | <i>Mel(ano) Cid(ieso) /</i>       |
| 3. AEL OCTA | <i>Ael(ius) Octa</i>              |
| 4. VIANUS   | <i>vianus /</i>                   |
| 5. VET CVM  | <i>vet(eranus) cum /</i>          |
| 6. SVIS VP  | <i>suis v(otum) p(osuit)</i>      |

## 12. Ulpianë

- |             |                                   |
|-------------|-----------------------------------|
| 1. I O M    | <i>I(ovi) O(ptomo) M(aximo) /</i> |
| 2. MEL CID  | <i>Mel(ano) Cid(iesso) /</i>      |
| 3. M AVR OC | <i>M. Avr(relius) Oc/</i>         |
| 4. TAVIUS   |                                   |
| 5. EX VOTO  |                                   |

*tavius /*  
*ex voto*

### 13. Ulpian

- |                    |                        |
|--------------------|------------------------|
| 1. ΑΠΟΛΛΩΝΙΟΣ/     | <i>Απολλώνιος/</i>     |
| 2. ΜΕΝΕΛΑΟΥ/Α/     | <i>Μενελάου/ ά/</i>    |
| 3. ΝΕΣΤΗΣΕ ΤὸΝΒ/   | <i>νέστησε τὸν β/</i>  |
| 4. ΩΜὸΝ ΘΕῶ; ΔΙ; / | <i>ωμὸν θεῶ; Δι; /</i> |
| 5. ἘΖΖΑῖω ΕὖΧΗΝ    | <i>Ἐζζαῖω εὖχην</i>    |

### 14. Scupi

- |                               |                                                                                 |
|-------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|
| 1. ] L F PVB RE               | <i>[...] L(ucii) f(ilius), Pub(lilia) Re/</i><br><i>[---] Verona con[---] /</i> |
| 2. [ [ VERONA CON             | <i>[de]c(urio)</i>                                                              |
| 3. [ ] [ ] C QVAESTOR<br>IIVR | <i>quaestor II v(i)r col(oniae)</i>                                             |
| 4. [ ] FEL DAR HOC TPL        | <i>Fl(aviae)fel(icis)Dar(danorum) hoc</i><br><i>t(em)pl(um)/</i>                |
| 5. [ ]NSA SVA FAC CVR         | <i>[impe]nsa sua fac(iendum)</i><br><i>c(uravit)</i>                            |
| 6. [ ] EAE SYRIAE             | <i>[D]eae Syriae</i>                                                            |

### 15. Scupi

- |                |                         |
|----------------|-------------------------|
| 1. [ ]ANCTI[ ] | <i>S]antc[issimae]</i>  |
| 2. [ ]EAE [ ]  | <i>[D]eae] Syriae ?</i> |

### 16. Scupi

- |                   |                                    |
|-------------------|------------------------------------|
| 1. QVADR SA [ ]   | <i>Quadr(ivis?) sa[crum] / ...</i> |
| 2. [ ] VALENS [ ] |                                    |
| 3. [ ]V[ ]NVS[ ]  |                                    |
| 4. [ ] V [ ]      |                                    |

*Valens /*

[ ]V[ ]NVS[ ]

*v(otum) [s(olvit) l(ibens) m(erito)]*

## 17. Timok

- |                     |                                   |
|---------------------|-----------------------------------|
| 1. PRO SALVTE IMP   | <i>Pro salute imp(eratoris) /</i> |
| 2. FLAVIV[ ] CLEMES | <i>Flaviu[s] Clemes /</i>         |
| 3. SABA[ ]O PATE    | <i>Saba[zi]o Pate/</i>            |
| 4. RNO A[ ] POSV    | <i>rno A[ug(usto)] posu/i[t</i>   |
| 5. I[ ]O[ ]         | <i>I[ ]O[ ]</i>                   |
| 6. GORDIANO         | <i>M. Ant]o[nio] /</i>            |
| 7. EVG ET C[ ]      | <i>Gordian(o) /</i>               |
| 8. POMP COS         | <i>Aug(usto) et C[lodio] /</i>    |
|                     | <i>Pomp(eiano) co(n)s(ulibus)</i> |

## 18. Soğanicë

- |                       |                                              |
|-----------------------|----------------------------------------------|
| 1. ANTINOO HE[ ]      | <i>Antinno he[roi aedem ( ?) iussu] /</i>    |
| 2. IMP CAESARIS T [ ] | <i>Imp(eratoris) Caesaris, T(ariani</i>      |
| 3. ET L AELII [       | <i>Hadriani Aug(usti)], /</i>                |
| 4. ]COLONI ARG [ ]    | <i>et L(ucii) Aelii, [Caesaris Aug(usti)</i> |
| 5. CVRANTE            | <i>f(iii)], /</i>                            |
| TELESPH[ ]            | <i>coloni arg(entariarum)</i>                |
| 6. PROC AUG LIB FEC   | <i>[Dardanicarum?], /</i>                    |
|                       | <i>curante</i>                               |
|                       | <i>Telesph[oro</i>                           |
|                       | <i>proc(uratore), Aug(usti) lib(erto),</i>   |
|                       | <i>fec(erunt)</i>                            |



Emine KALAJA-HAJDARI

## SUMMARY

### **EPIGRAPHIC EVIDENCE OF PRESENCE OF THE EASTERN DIETIES IN DARDANIA**

New religious practices appeared in Dardania after Roman invasion. Archaeological and epigraphic material is the main source demonstrating to us that in the territory at hand, people worshipped a number of Eastern cults, from Asia Minor, Syria, Egypt and Persia. Such cults had made their way to Dardania as a result of various political, economic factors as well as a result of the fact that given Dardania's location, it presented a bridge between the west and the east, where cultures and religions met.

Of the Eastern deities worshipped in Dardania, *Mitra*, an Iranian god of sun, was the most important. *Serapis* was also present in Dardania, which was a syncretic Greco-Egyptian deity of sun, fertility, health and medicine. *Izida*, the god of marriage, comes from Egypt. Another eastern cult, worshipped in Dardania was *Dolichenus*, as well as *Melanus Cidesius*, and *Ezzaios*. *Atargatis*, a Syrian deity, personifying nature, life and fertility was also present, as was *Quadrivia*, a crossroads' god, and *Sabazio*, a syncretic god, protector from evil. Epigraphic sources have also brought to light the practice of worshipping mortals, as was the case with *Antonioo Heroi*.



Teuta SHALA-PELI

## ROLI I KLERIKËVE DRISHTIANË NË SHËRBIMET LAIKE GJATË VITEVE 1317-1496

Gjatë mesjetës Drishti edhe pse qytet relativisht i vogël, u dallua për një jetë aktive kishtare. Meqë brenda territorit të vet përfshinte një numër të konsiderueshëm të objekteve kishtare, si: katedrale, kisha dhe manastire, natyrisht se nuk munguan as klerikët e shumtë të cilët kanë luajtur rol kyç në organizimin dhe zhvillimin e proceseve të shumta jo vetëm me karakter kishtar, por edhe laik. Një fakt i tillë, është tregues se në Drisht pushteti civil krahas atij kishtar ishte i përqendruar pothuajse tërësisht në duart e klerit drishtian, pushtet ky i cili me kalimin e kohës u përforcua gjithnjë e më shumë, varësisht nga ngjarjet dhe zhvillimet e ndryshme politike që ndodhën si në Shqipëri ashtu edhe në vendet fqinjë, të cilat u reflektuan edhe në qytetin e Drishtit.

Në burimet historike dhe literaturën që i referohet periudhës mesjetare, në qytetin e Drishtit përmendën këto objekte kishtare: katedralja e Shën Marisë (*sancte Marie de Driuasto*)<sup>1</sup> dhe ajo e Shën Gjergjit (*sancto Gorgy de Driuasto*),<sup>2</sup> pastaj kishat: e Shën Françeskut

---

<sup>1</sup> Ludovicus Thalloczy-Costantinus Jeriček-Emilianus Sufflay, *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, vol. II, Vindobonae 1913-1918, ribotim në Prishtinë nga Ekskluzive 2002, 99, 252, 615, 656, 745. (Më tej: *Acta Alb.*, II.); *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëllimi I, përgatitur nga Injac Zamputi, Luan Malltezi, Tiranë 1987, 333, 427. (më tej: *Dokumente për historinë I*).

<sup>2</sup> *Acta Alb.*, II/ 656, 745; Giuseppe [Josephi] Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, 25 vol., Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, 1967-1972 (më tej: AAV), AAV, p. II, t. XVII, nr. 4057, 227; *Dokumente për historinë I*, 427; Milan Šufflay, “Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme”,

(*sancti Francisci*),<sup>3</sup> Shën Shëlbuemit (*sancti Saluatore*),<sup>4</sup> Shën Prendës (*sancta Veneranda*),<sup>5</sup> Shën Kryqit (*sancte Crucis*),<sup>6</sup> Shën Nikollës (*sancte Nicolai*),<sup>7</sup> Shën Mërisë Veteris (*sancte Marie Veteris*),<sup>8</sup> Shpirtit të Shenjtë (*Sancti Spiritus*),<sup>9</sup> Shën Stefanit,<sup>10</sup> si dhe manastiret e Shën Benediktit (*sancti Benedicti*)<sup>11</sup> dhe Shën Gjonit (*sancti Johani*).<sup>12</sup>

Që nga gjysma e dytë e shekullit XIV, në Drisht filloi që të vërehet rritja e rolit dhe ndikimit të klerit në shërbimet civile, për arsye se në këtë kohë në Drisht kleri fiton sundimin civil mbi qytetin.<sup>13</sup> Pikërisht përqendrimi i pushtetit civil-laik në duart e klerit në Drisht, kishte bërë që shpesh në burimet historike që i referohen mesjetës të hasim të dhëna edhe për rolin e klerit drishtian në shërbime të ndryshme laike-civile, si: noter, në gjyqësi, qoftë si gjykatës apo si pjesëmarrës, si në gjyqet kishtare ashtu edhe në ato shekullare (laik); në ekonomi; si mësues; në testamente si hartues, epitrop (zbatues) dhe dëshmitar; në zhvillimet politike si diplomat, si dhe si luftëtar duke mbrojtur qytetin e Drishtit përball Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane. Pra, kisha, respektivisht kleri në Drisht, kishte ndikim në një varg sferash të

---

*Illyrisch-Albanische Forschungen*, Band I, München 1916, 262. (më tej: Šufflay, “Die Kirchenzustände”).

<sup>3</sup> Acta Alb., II/47, 728; Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, *Illyrisch-albanische Forschungen*. Bd. 1, Wien 1916, 112 (më tej: Jireček, Skutari); *Dokumente për historinë I*, 333; *Statutet dhe urdhëresat e kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit*, përgatitur nga Musa Ahmeti & Etleva Lala, Tiranë 2009, 55. (më tej: *Statutet dhe urdhëresat*).

<sup>4</sup> Šufflay, “Die Kirchenzustände”, 262; *Statutet dhe urdhëresat*, 55.

<sup>5</sup> Acta Alb., II / 656, *Statutet dhe urdhëresat*, 55.

<sup>6</sup> Sime Ljubić, *Listine o odnosajih izmedju juznoga Slavenstva i mletacke republike. Knjiga IX: od godine 1423 do 1452*, (Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium, Zagreb 1890), 158. (Më tej: Ljubić, *Listine, IX*). Acta Alb., II/ 99; AAV, p. II, t. XVII, nr. 4057, 227.

<sup>7</sup> AAV, p. II, t. XVII, nr. 4057, 226.

<sup>8</sup> Acta Alb., II/ 728.

<sup>9</sup> *Statutet dhe Urdhëresat kapitulli XI*, 150.

<sup>10</sup> Gjon Berisha, *Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI-XV*, Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, Prishtinë 2017, 367. (Më tej: Berisha, *Arbërorët*).

<sup>11</sup> Acta Alb., II/ 119.

<sup>12</sup> Augustin Theiner, *Monumenta Slavorum Meridionalium historiam ilustrantia I*, Romae 1863, dok.308, 320; Acta Alb., II/119, 329, 728; AAV, p. III, t. 21, nr. 5785, 133; Theodor Ippen, *Denkmäler verschiedener Altersstufen in Albanien*, Wiss. Mitt. Bosnien u. Herzegowina. 10, Wien, 1907, 6.

<sup>13</sup> Milan Šufflay, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë kryesisht në mesjetë*, Tiranë: Onufri, 2009, 108-109 (më tej: Šufflay, *Qytetet*).

rëndësishme, duke shërbyer si pikëmbështetje për proceset ekonomike, politike, kulturore, juridike e më gjerë të këtij qyteti, të cilat ishin shtyllat kryesore për zhvillimin e tij gjatë mesjetës. Në këtë punim, për aq sa na lejojnë të dhënat e kohës, do të prezantojmë disa nga shërbimet laike të klerikëve drishtianë qoftë në Drisht ashtu edhe jashtë tij, që nga fillimi i shekullit XIV e deri pas rënies së tij nën sundimin osman.

Një ndër profesionet laike ku kleri drishtian kishte mjaft ndikim ishte ai i noterit. Për dallim prej qyteteve bregdetare, si: Durrësi (1243), Ulqini (1261), Shkodra (1330), në të cilat vepronin noterët laikë,<sup>14</sup> apo nga Tivari dhe Ulqini, ku noterët ishin italianë,<sup>15</sup> në Drisht profesioni i noterit ushtrohej nga klerikët të cilët medoemos duhej që të ishin nga Drishti, pra, këto ishin dy parimet themelore mbi bazën e të cilave ishte e rregulluar që të ushtrohej ky profesion në qytetin e Drishtit.

Aktivitetin e klerit drishtian si noterë, për aq sa na ofrojnë dokumentet dhe literatura të cilat i kemi në dispozicion për këtë çështje, mund ta përcjellim në periudhën kohore 1317-1496. Përveçse në Drisht ka pasur raste kur priftërinjtë drishtianë kanë shërbyer si noterë edhe në vende të tjera jashtë Shqipërisë. Një rast i tillë ndeshet që në fillim të shekullit XIV. Fjala është për një prift nga Drishti të quajtur Andrea, i cili në vitin 1317 përmendet si noter në ishullin Lagosta,<sup>16</sup> i cili ishte nën pushtetin e Dubrovnikut.<sup>17</sup>

Të dhënat më të hershme për klerikët drishtianë të cilët kanë shërbyer si noterë në qytetin e Drishtit, i ndeshim në vitin 1353. Këto të dhëna i referohen dokumentit të 18 qershorit të vitit 1353, që ka të bëjë me emërimin e një guvernatori nga kapitulli i Drishtit, me ç'rast, si nënshkrues i atij dokumenti përmendet noteri publik i Drishtit, prifti (presbyteri) Gjon (*presbyteri Johannis publici iurati notarii*).<sup>18</sup> Pesëmbëdhjetë vjet pas kësaj, në vitin 1368, në Drisht si noter përmendet ipeshkvi i Ipeshkvisë së Drishtit, Gjoni. Se a është fjala për të njëjtin person për të cilin folëm më lart, apo për dy persona të ndryshëm, dokumentet në të cilat jemi mbështetur, si ai i vitit 1353 ashtu dhe ai i

<sup>14</sup> Oliver Jenes Schmitt, *Arbëria Venedike 1392-1479*, Tiranë 2007, 140-141 (më tej: Schmitt, *Arbëria*).

<sup>15</sup> *Statutet dhe urdhëresat*, 62.

<sup>16</sup> Konstantin Jireček, "Skutari und sein Gebiet im Mittelalter", *Illyrisch-albanische Forschungen*. Bd. 1, Wien 1916, 112-113. (Më tej: Jireček, Skutari).

<sup>17</sup> Šufflay, *Qytetet*, 160.

<sup>18</sup> Acta. Alb., II/ 98: "

vitit 1368, nuk na mundësojnë që ta pohojmë këtë. Pavarësisht kësaj, është dëshmuar se në qytetin e Drishtit në periudhën kohore 1353-1442, kanë shërbyer tre noterë, të cilët ishin klerikë vendas.<sup>19</sup>

Sidoqoftë, ipeshkvi Gjoni i cili me sa duket ishte nga familja Lepore, familje e njohur fisnike nga Drishti,<sup>20</sup> si ipeshkëv në Ipeshkvinë e Drishtit kishte shërbyer trembëdhjetë vjet, nga viti 1360 deri në vitin 1373.<sup>21</sup> Gjatë shërbimit të tij si ipeshkëv, Gjoni ushtroi edhe detyrën e noterit të qytetit. Ipeshkvin Gjoni, në cilësinë e noterit të qytetit të Drishtit e ndeshim në një dokument të vitit 1368. Në këtë dokument i cili mbanë datën 16 mars 1368, përmenden dokumente të nënshkruara nga ipeshkvi Gjoni, noter publik i qytetit të Drishtit (*...Johannis publici notarii comunis Driuasti...*).<sup>22</sup>

Klima politike e krijuar në fund të shekullit të XIV në Shqipërinë e Veriut, si rezultat i zhvillimeve politike, u reflektua edhe në punën e noterëve të Drishtit. Në fund të shek. XIV qyteti i Drishtit i cili në atë kohë qeverisej nga familja feudale e Balshajve, u ndodh përballë dy rreziqeve të mëdha, në njërin anë ishte Republika e Venedikut e në anën tjetër ishin sulmet e njëpasnjëshme të ushtrisë osmane. I ndodhur në një situatë të tillë, Gjergji II Strazimiri, në vitin 1396, në bazë të një marrëveshjeje u detyrua që t'ua dorëzojë venedikasve qytetet e Shkodrës dhe të Drishtit, në mënyrë që këto të mos binin në duar të turqve.<sup>23</sup>

Vendosja e sundimit venedikas në qytetin e Drishtit ndër të tjera u shoqërua edhe me pakënaqësi të shumta edhe nga radhët e noterëve, ngase sundimi i ri provojë që të sillte edhe ndryshime sa i përket çështjes së noterëve. Kjo ndodhi për faktin se sundimi venedikas u përpoq në Durrës dhe në Shqipërinë e Veriut të zhdukte noteriatin e vendit.<sup>24</sup>

Një politikë të tillë Republika e Venedikut synonte që ta realizonte përmes planit të saj, ku së bashku me qeveritarët venedikas në

<sup>19</sup> Šufflay, *Qytetet*, 160.

<sup>20</sup> Conrad Eubel, *Hierarchia catholica medii aevi, sive Summorum pontificum, S.R.E. cardinalium, ecclesiarum antistitum series ab anno 1198 usque ad annum 1431 perducta e documentis tabularii praesertim Vaticani collecta, digesta*, I. Monasterii 1913, 227: "*Johannes (Andreas) de Leporibus...*".

<sup>21</sup> Daniele Farlato; Jacobo Coletto, et. al. *Illyrici Sacri*, vëll. VII, Venetiis 1817, 236 (më tej: *Illyrici Sacri VII*).

<sup>22</sup> Acta Alb., II/237: ".

<sup>23</sup> Ljubić, *Listine*, IV, 365-369; Acta Alb., II/555; AAV, p. I, t. 2, nr. 611, 309: "*Quod debeant accipi loca que nobis dre uult Dominus Gergius Strazimiri, ut ea non uadant ad mannus Turcorum cum modis, declaracionibus et capitulis, ut ibi...*".

<sup>24</sup> Šufflay, *Qytetet*, 163.

Shqipëri u vendosën edhe noterët shoqërues, të cilët shërbenin për dy vite aq sa edhe qeveritarët, dhe largoheshin së bashku me ta.<sup>25</sup>

Me vendosjen e sundimit të tyre në Drisht, venedikasit në shtator të vitit 1396, krijojnë një zyrë pushteti.<sup>26</sup> Në vazhden e këtyre masave, në krye të këshillit të Drishtit caktohet që të vendoset një pushtetar venedikas,<sup>27</sup> i cili me të marrë detyrën filloi që të pengonte punën e noterit të Drishtit dhe t'i favorizonte ata venedikas, duke mos lejuar që noteri i Drishtit të bënte shkresa testamente dhe akte, ndërsa noterët venedikas për akte të tilla u merrnin banorëve aq të holla sa u pëlqente, duke shkelur kështu normat e zakonshme të kohës.<sup>28</sup> Meqenëse një plan i tillë hasi në kundërshtim të vendasve, Venediku u detyrua që në vitin 1397, një vit pas vendosjes së sundimit të tij në Drisht, që t'u jep leje drishtianëve që të mbanin noterin e tyre dhe t'i jepnin punë.<sup>29</sup>

Lidhur më këtë, më 5 korrik të vitit 1397, Venediku u kthen përgjigjeje lajmëtarëve të qytetit të Drishtit për disa çështje të brendshme të atij qyteti. Ndër çështjet që përmendën në pikën e katërt dhe të pestë të dokumentit në fjalë është edhe ajo e noterit.<sup>30</sup>

Në vitet në vijim dokumentet e kohës dëshmojnë për rolin e noterit të Drishtit në zhvillimet politike që ndodhën në këtë qytet pas vdekjes së Balshës III. Siç është e njohur, qyteti i Drishtit në periudhën kohore 1396-1421, na paraqitet herë nën zotërimin e familjes feudale të Balshajve e herë nën zotërimin e Republikës së Venedikut. Në vitin 1421 Republika e Venedikut duke përfituar nga vdekja e Balshës III (1421), arriti që të shkëpuste disa nga zotërimet e Balshajve dhe t'ua bashkëngjiste ato domeneve të veta në Shqipëri, në mesin e të cilave ishte edhe qyteti i Drishtit. Duke iu referuar të dhënave dokumentare, vërehet

---

<sup>25</sup> Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas 1392-1478 (Aspekte të jetës së tyre)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë-Instituti i Historisë, Tiranë 1988, 213 (më tej: Malltezi, *Qytetet*).

<sup>26</sup> Acta Alb., II/566.

<sup>27</sup> Jireček, "Skutari", 112.

<sup>28</sup> Acta Alb., II/591. Malltezi, *Qytetet*, 214.

<sup>29</sup> Šufflay, *Qytetet*, 163.

<sup>30</sup> Ljubić, *Listine*, IV, 408; Acta Alb., II/591: "...*Ad quartum et quintum de facto sui notarii soliti sibi conficere instrumenta, testamenta et cartassuas, que potestas noster vult modo confici per suum notarium, et de solutionibus, quas accipit; respondeatur, quod sumus contenti et placet nobis, quod dictus suus notarius debeat facere eis cartas suas et testamenta sua ad beneplacitum suum, et quod non astringantur per nostros rectores ad eundem ad notarios suos, nisi quantum procedat de eorum beneplacito, dummodo dictus notarius sit legalis et bonus, cui notario suo providebunt de sua solutione, sicut soliti sunt...*"

se qyteti i Drishtit që nga korriku i vitit 1421 përmendet si qytet në kuadër të zotërimeve të Venedikut.<sup>31</sup> Megjithatë, Republika e Venedikut nuk pati një sundim të qetë në këtë qytetet deri në vitin 1442, kur edhe u nënshkruan dokumentet që përcaktonin kushtet nën të cilat qyteti i Drishtit kalonte nën sundimin e Venedikut. Këto dokumente u nënshkruan më 5 gusht të vitit 1442, midis përfaqësuesve të Republikës së Venedikut dhe përfaqësuesve të Komunës së Drishtit, të përbërë nga Bellacius Ungari (*Bellacius Vngaro*), Bellus Prekali (*Bellus Precalo*, gjykatës), Teodor Kilanci (*Theodorus Chilanzo*, gjykatës), Gjon Bello (*Johannes Bello*), Nikollë Skaputari (*Nicolaus Scaputaro*) dhe prifti Pal si noter i qytetit.<sup>32</sup> Tre vjet pas nënshkrimit të kësaj aktmarrëveshjeje, noter i qytetit të Drishtit prifti Pal (Pal Martushi), në shtator të vitit 1445 u detyrua të shkonte në Venedik për të kërkuar që qeveritarët e Drishtit ta njihnin atë si noter të komunës sikundër ishte zgjedhur prej saj dhe sikundër kishte dhe garancinë zyrtare (aktin përkatës) nga zyrtarët e lartë venedikas.<sup>33</sup> Siç e kemi potencuar në fillim të këtij studimi, kemi ndeshur në disa raste kur klerikët nga Drishti kanë shërbyer si noterë edhe jashtë Drishtit. Raste të tilla përmenden edhe në Venedik pas rënies së Drishtit nën sundimin osman më 1479, ku një pjesë e klerit drishtianë që mërgoi në Venedik kishte fatin që të integrohet në jetën kishtarë të atij vendi. Në mesin e tyre përmendet Jakob Sapa nga Drishti, i cili ishte famullitar e noter në kishën e Shën Mërisë Mëmë e Zotit nga viti 1487 deri në vitin 1496.<sup>34</sup>

Në sferën juridike klerikët drishtianë kishin ndikim edhe në gjyqësi. Persona të caktuar nga radhët e klerit ishin të detyruar që të merrnin pjesë në gjyqe, si kishtarë ashtu edhe shekullare. Lidhur me këtë në *Statutet dhe urdhëresat e kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit*, në kapitullin IV dhe V të këtyre statuteve, në të cilat përcaktoheshin detyrat e rektorit dhe të prokuratorit thuhej se që të dy si rektori ashtu edhe prokuratori, duhej që të merrnin pjesë në cilindo gjyq, si kishtar ashtu edhe shekullar (laik), madje rektori kishte të drejtë që të kthente dënimet, apo të jepte dënime të tjera për ata që nuk i bindeshin. Ai i kontrollonte të ardhurat brenda

<sup>31</sup> AAV, p. II, t. 11, nr. 2503, 6: “*ad regimen terrarium driuasti antibari e dulcinij nuper recuperatarum mittantur rectores sicut prius*”.

<sup>32</sup> AAV, p. II, t. 17, nr. 4057, 226: “*...Nobiles et Egregij viri Ciuitatis driuasti videlicet Ser Bellacius Vngaro ser Bellus precalo Judex, Theodorus chilanzo Judex, Johannes Bello, et ser Nicolaus scaputaro, ac presbiter Paulus notarius Ciuitatis...*”.

<sup>33</sup> Malltezi, *Qytetet*, 214-215.

<sup>34</sup> Lucia Nadin, *Shqiptarët në Venedik. Mërgim dhe integrim 1479-1552*, Tiranë: Shtëpia Botuese “55”, 2009, 55. (më tej: Nadin, *Shqiptarët*).



kanonikes ngado që vinin.<sup>35</sup> Kur jemi tek fusha e gjyqësorit, duke ju referuar *Statuteve të Drishtit*, për më tepër, kleri drishtianë kishte ndikim veçanërisht në çështjet gjyqësore të karakterit kishtar.

Në *Statutet e Drishtit*, hasim në disa dispozita të cilat përcaktonin çështjet që duheshin të gjykoreshin brenda kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit, një pjesë e të cilave gjykohej nga rektori, i cili me sa duket ishte i autorizuar dhe kishte të drejtën për të gjykuar të gjithë ata persona të cilët nuk ju përmbaheshin rregullave që ishin të përcaktuara në kuadër të *Statuteve të Drishtit*.

Që në kapitullin e parë të këtyre statuteve, në të cilin flitet për respekt të ndërsjellët qoftë nga të rinjtë ndaj të moshuarve dhe anasjelltas, rektori ishte i autorizuar që t'i dënonte të gjithë ata persona të cilët nuk i përmbaheshin këtij rregulli, "*kundërvajtësi të dënohet në kapitull prej rektorit dhe prej pleqve sipas fajit*".<sup>36</sup> Gjithashtu, nenet e këtyre statuteve flasin për një sërë dënimesh që parashiheshin si për ata që janë vjedhës dhe mashtrues në punët e kanonikes (kapitulli XXIII),<sup>37</sup> si dhe për persona të dhunshëm, si për shembull: parashiheshin dënime për të gjithë ata që i binin tryezës më grusht

<sup>35</sup> *Statutet dhe urdhëresat*, kapitulli IV, Një segment tjetër që mund ta veçojmë te këto dy statute është edhe besueshmëria ndaj atyre që gjykojnë të tjerët. Në kapitullin 34 të statuteve të Drishtit "*Ata që gjykojnë të tjerët të betohen që do të japin vendime pa njollë*", thuhet: "*Ata që gjykojnë të tjerët duhet të mos kenë urrejtje. Nëse urdhëresat tona janë të qarta që të njihet lehtë dënimi që duhet dhënë, sepse mund të ndodhë që t'i vihet faji një të pafajshmi, betohemi dhe i japim fjalën njëri-tjetrit për hir të mëshirës së Perëndisë se me ndihmë të Zotit do të gjykojmë drejt dhe do të hetojmë me zell se kush është fajtor dhe kush jo dhe do t'i zbatojmë vendimet e statuteve duke iu shmangur urrejtjes, simpatisë, ndërhyrjes ose shpërblimit*"; kapitulli V: "*Prokuratori ka, pra për detyrë të marrë në dorëzim me shkrim të gjitha objektet që ndodhen në kanoniken tonë; të kujdeset për kultivimin e vreshtave dhe të pronave tona me urdhër të rektorit; të kërkojë të ardhurat dhe t'i depozitojë në kanonikë; të kursejë dhe të shpenzojë sipas rregullit tonë, dhe për çdo gjë që sheh se është e dobishme të lajmërojë rektorin, që të mund të marrë masat e duhura sipas rastit; të mbaj mirë llogari për të ardhurat dhe për shpenzimet...*".

<sup>36</sup> *Statutet dhe urdhëresat*, kapitulli I: "... Të rinjtë t'i nderojnë pleqtë si prindër, dhe pleqtë t'i duan të rinjtë si bijtë e vet dhe ata që janë të një moshe apo aty afër të respektojnë njëri-tjetrin si vëllezër. Kundërvajtësi të dënohet në kapitull prej rektorit dhe prej pleqve sipas fajit".

<sup>37</sup> *Statutet dhe urdhëresat*, kapitulli XXIII: "*Askujt s'i lejohet të vjedhë ose të mashtrtojë gjërat tona. Kundërvajtësi të dëbohet për një vit në rast se dëmi nuk do të jetë i madh dhe dënimi të fillojë me pakicë derisa të paguajë dyfishin e asaj që është vjedhur ose mashtruar. Nëse dëmi do të jetë më i madh, atëherë dënimi të jepet më i rëndë në kapitull, sipas fajit të kryer*".

në zemërim e sipër (kapitulli XXVIII),<sup>38</sup> si dhe për atë person që rrahin një person tjetër (kapitulli XXIX).<sup>39</sup> Po ashtu dënoheshin edhe të gjithë ata persona që luanin zare apo ndonjë lojë tjetër të pandershme (kapitulli XXXVII).<sup>40</sup> Për të qenë gjykimet e drejta dhe të paanshme, ata që gjykonin të tjerët betoheshin se do të japin vendime pa njollë (kapitulli XXXIV),<sup>41</sup> duke shprehur në këtë mënyrë besueshmërinë e atyre që gjykonin të tjerët.

Priftërinjtë drishtianë në raste të caktuara i mbronin të drejtat e qytetarëve drishtianë kur ato u mohoheshin nga qeveritarët venedikas që shërbenin në Drisht. Në një dokument të 7 prill të vitit 1407, kur një gruajë të quajtur Marabona nga Drishti, i ishte bërë e padrejtë nga një zëvendësposdesta i Drishtit, lidhur me testamentin e bashkëshortit të saj, përmendet prifti Moisi (*Moyses*) nga Drishti, i cili në emër të zonjës Marabona (*Marabone*), së vesë së zotit Mikel Berla (*Michaelis Berla*), banuese në Drisht, ishte ankuar kundër burrit fisnik, zotit Pal Bonci (*Paulus Bonci*), i cili kishte qenë zëvendësposdesta i Drishtit, duke pohuar: “...se ai zoti Pal, në kundërshtim me formën e testamentit të Mikel Berlës dhe të dy vendimeve të marra prej pararendësve të tij, në favor të testamentit në fjalë, në kundërshtim edhe me atë që mund dhe duhej të bënte, i ka prishur dhe anuluar ato vendime me anë të një vendimi që ai mori...”.<sup>42</sup> Këta shembuj janë një dëshmi dhe tregues i

<sup>38</sup> Statutet dhe urdhëresat, kapitulli XXVIII: “Nëse ndonjëri, në zemërim e sipër i bie tryezës me grusht, kërkojmë që të dëbohet për aq javë sa i ka rënë tryezës. Po për më tepër, ai duhet të dëbohet nga shtëpia me turp, ashtu siç e meriton guximi [kokëfortësia] e tij, dhe pastaj duhet të ndëshkohet për fjalë dhe vepra që mund të ketë kryer padrejtesisht. Kush ofendon në mënyra të ndryshme, është mirë të ndëshkohet në mënyra të ndryshme”.

<sup>39</sup> Statutet dhe urdhëresat, kapitulli XXIX: “... zbërthimin e kësaj çështjeje dhe dënimin që duhet dhënë ia lëmë kapitullit. Ne urdhërojmë që të nesërmen, po jo në ditë feste, rektori t’i thërrasë duke i kërcënuar me privimin e rangut të tyre dhe menjëherë të merren masat që fajtorët të arrijnë dënimin e duhur”.

<sup>40</sup> Statutet dhe urdhëresat, kapitulli XXXVII: “Asnjëri s’duhet të guxojë të luaj zareshe ose ndonjë lojë tjetër të pandershme me të holla. Dënimi: dëbim prej shtatë ditësh për çdo herë”.

<sup>41</sup> Statutet dhe urdhëresa, kapitulli XXXIV: “Ata që gjykojnë të tjerët duhet të mos kenë urrejtje. Nëse urdhëresat tona janë të qarta që të njihet lehtë dënimi që duhet dhënë, sepse mund të ndodhë që t’i vihet faji një të pafajshmi, betohemi dhe i japim fjalën njëri-tjetrit për hir të mëshirës së Perëndisë se me ndihmë të Zotit do të gjykojmë drejt dhe do të hetojmë me zell se kush është fajtor dhe kush jo dhe do t’i zbatojmë vendimet e statuteve duke iu shmangur urrejtjes, simpatisë, ndërhyrjes ose shpërblimit”.

<sup>42</sup> Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV, vëllimi II (1406-1410), pjesa e parë, përgatitur nga Injac Zamputi, Pranvera Bogdani, Tiranë 2019, 124 (më tej: Dokumente për historinë II): “...quod jedem ser paulus contra formam testamenti

mirë se kleri në qytetin e Drishtit gjatë mesjetës kishte shtrirë ndikimin e tij në fushën e së drejtës, duke ushtruar profesionin e noterit dhe gjyqtarit.

Krahas gjyqësisë, klerikët drishtianë u dalluan edhe në fushën e ekonomisë. Në dobi të zhvillimit ekonomik, ata u dalluan si në mbledhjen e taksave, ashtu edhe në pagimin e tyre. Në qytetin e Drishtit gjatë mesjetës klerikët ushtronin edhe detyrën e mbledhësit të taksave, siç kemi rastin e ipeshkvit Nikollë Suma, i cili për vite me radhë kishte ushtruar si klerikë detyrën e mbledhësit të taksave në zonat malore të qarkut të Drishtit.<sup>43</sup> Në dobi të ekonomisë, Nikollë Suma, kishte kontribuar edhe si ambasador i Gjon Kastriotit, i cili në cilësinë e ambasadorit më 14 janar të vitit 1430, kishte prezantuar në Raguzë një ofertë në lidhje me taksat dhe doganën.<sup>44</sup> Edhe më 19 janar të vitit 1430, Nikollë Suma në Raguzë kishte zhvilluar bisedime në lidhje me doganat.<sup>45</sup>

Përveç këtyre, kishte raste kur kleri në Drisht ishte i detyruar që të paguante taksa edhe përkundër kërkesave që bënin për t'u liruar nga ato pagesa. Në vitin 1372, kur ipeshkvit e Tivarit ishin liruar nga pagesa e të dhjetave për shkak të gjendjes ekonomike, ipeshkvi i Drishtit, Gjoni, kishte paguar 11 dukate.<sup>46</sup>

Me vendosjen e sundimit venedikas në qytetin e Drishtit më 1396, Sinjoria kishte vendosur që popullsia e Drishtit t'u paguante atyre të dhjetën mbi frytet, drithërat, verën, vajin etj., që prodhonin në tokat e tyre.<sup>47</sup> Si rrjedhojë e këtij vendimi, kishte raste kur taksën e të dhjetës

*eiusdem Michaelis berla, et duarum Sententiarum latarum in Fauorem dicti testamenti per precessores suos, contra id quod facere poterat et debebat cassauerat et annullauerat ipsas quidem Sententiam, per vnam suam Sententiam quam tullerat...*

<sup>43</sup> Schmitt, *Arbëria*, 580; Oliver Jenas Schmitt, "Marrëdhëniet e Venedikut me kishat para dhe gjatë luftës shqiptaro-osmane, roli i tyre dhe depërtimi i humanizmit në Shqipëri, *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë 2003, 10 (më tej: Schmitt, Marrëdhëniet e Venedikut).

<sup>44</sup> Jorga, *Notes II*, pp.257-258; Gjon Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut: dokumente*, Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, Prishtinë 2018, XIX (më tej: Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu*): "Mention d'un envoye de "Juani Castriot". Cet envoye, nomme Nicola, etait venu avec des offres "pro gabellis et dohannis..."

<sup>45</sup> Jorga, *Notes et extraits II*, 257-258; Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu*, XXI: "Le 19, on négocie avec lui touchant les douanes..."

<sup>46</sup> Illyrici *Sacri VII*, 237.

<sup>47</sup> Malltezi, *Qytetet*, 70.

ishin të detyruar që ta paguanin edhe institucionet kishtare, edhe përkundër kërkesave që bëheshin për t'u liruar nga ajo.

Në vitin 1403, abacia e Shën Gjonit të Shtojit (*abatie sancti Johannis de Strilalio*), me anën e ambasadorit të komunës së Drishtit kishte kërkuar që të liroheshin nga e dhjeta zotërimet e saja. Një kërkesë e tillë u bë për faktin se abacia në fjalë zotërimet e veta ia jepte fshatarëve për t'i punuar me qira. Krahas qirasë, fshatarët detyroheshin, si të gjithë shtetasit e tjerë, t'i paguanin të dhjetën shtetit. Pikërisht këto të dhjeta kërkonte për vete abacia.<sup>48</sup> Mirëpo, Senati kishte refuzuar një kërkesë të tillë, duke mos e liruar nga pagesa e të dhjetës abacinë e Shën Gjonit. Në përgjigjen e Senatit të Venedikut të datës 7 maj të vitit 1403, në kapitullin e njëmbëdhjetë një kërkesë e tillë refuzohej me arsyetimin se “*nuk na duket e drejtë as e arsyeshme t'i shkarkonim ata, edhe shtetasit e tjerë tanë do të kërkonin një nder të tillë të cilin ndershmërisht nuk do të mundnim t'ua mohonim*”.<sup>49</sup>

Një kërkesë për t'u liruar nga taksat e kishte bërë në vitin 1410 edhe ipeshkvi i Drishtit, i cili kishte arritur që të siguroi nga sindikët venedikas *Robert Mauroceno* dhe *Jakob de Ripa*, që të çlirohej nga çdo detyrim fshati i Shën Mërisë së Ipeshkvisë së Drishtit dhe banorët e tij, sepse ishin shumë të varfër për shkak të shterpësisë së vendit dhe se në kohë të mëparshme nuk paguanin detyrime të tilla.<sup>50</sup>

Krahas shërbimeve fetare-kishtare, klerikët drishtianë gjatë mesjetës u dalluan edhe në luftë për mbrojtjen dhe çlirimin e Drishtit. Rreshtimi i tyre në ushtri erdhi si rrjedhojë e rrezikut që ju kanos qytetit të Drishtit fillimisht nga venedikasit e më vonë edhe nga osmanët. Sipas zakoneve të vjetra të Drishtit, klerikët drishtianë ishin të përjashtuar prej shërbimit ushtarak. Mirëpo, më vendosjen e sundimit venedikas në Drisht, venedikasit kishin kërkuar që edhe klerikët të përfshiheshin në shërbimin ushtarak. Për këtë kërkesë të venedikasve, Komuna e Drishtit kishte reaguar duke kërkuar nga Venediku që presbiteri dhe klerikët të mos rëndoheshin me shërbimet e rojës dhe angari të tjera siç bëjnë

<sup>48</sup> *Dokumente për historinë I*, 333; Malltezi, *Qytetet*, 72.

<sup>49</sup> *Dokumente për historinë I*, 333: “... *Ad vendecimum Capitulum in quo petunt, quod possessiones Abatie sancti Johannis de strilalio de districtu driuasti non teneantur soluere decimam etc. Respondetur, quod postquam dicte possessiones ipsius Abbatie affictantur rusticis qui eas laborant, et dant affictus abbati, et decimas nostris Rectoribus de laboribus suis sicut faciunt alij subditi nostri non uidetur nobis iustum nec rationabile, absoluere ipsos a dicta decima quia si absolueremus eos alij etiam subditi nostri peterent similem gratiam quam non possemus eis honeste denegare...*”.

<sup>50</sup> Malltezi, *Qytetet*, 72.

shekullarët.<sup>51</sup> Lidhur më këtë kërkesë, në vendimin e Senatit të Venedikut të datës 5 korrik 1397, në pikën e nëntë thuhet se “*presbyteri dhe kleri të bëjnë roje dhe shërbime të tjera angarie porsì laikët*” (...*presbyter et clerici faciant custodias et alias angarias tamquam saeculares...*).<sup>52</sup> Gjithashtu, Senati ishte i mendimit se klerikët duhet të vazhdonin ta kryenin edhe në të ardhmen këtë shërbim, “*pasi duke ruajtur qytetin, ata ruanin para së gjithash veten dhe pasurinë e tyre*”.<sup>53</sup>

Rrethanat e krijuara në qytetin e Drishtit pas vendosjes së sundimit venedikas ndikuan që edhe klerikët drishtianë të bashkoheshin përkrah fisnikëve vendas (Balshës III) në luftë kundër vendosjes së këtij sundimi. Në fillim të shek. XV, Balsha III në luftën e tij kundër sundimit venedikas, u përkrahë edhe nga kleri katolik i Drishtit. Përkrah forcave të Balshës III në luftë kundër sundimit venedikas ishin radhitur: Pal Ungri (*Paulus Ungarus*),<sup>54</sup> Gjon Basilaçi (*Johannes Basilaçio*) dhe nipi i tij Pjetri, edhe ai prift,<sup>55</sup> si dhe Nikollë Desku (*Nicolaus Descho*).<sup>56</sup>

Meqenëse përpjekjet e para të Balshës III gjatë viteve 1404-1405, për çlirimin e Drishtit dhe qyteteve, si: Shkodrës, Tivarit dhe Ulqinit përfunduan më rivendosjen e këtyre qyteteve nën sundimin venedikas, sundim ky i cili u karakterizua me masa të rrepta, që goditën para së gjithash ata që konsideroheshin përkrahës të Balshës III. Mes atyre që e pësoi në atë kohë, ishte Pal Ungri. Ai u largua prej Drishtit nga komandantët ushtarakë venedikas dhe u internua bashkë me persona të tjerë kryengritës në Venedik ku jetoi në gjendje të rëndë e të vështirë.<sup>57</sup> Në vitin 1410, Pal Ungri më anë të një letre njoftohet nga dogji i Venedikut, se ai mund të kthehej në atdhe. Por, Zyra e Avokatisë së Shtetit ishte e bindur se Pal Ungri ishte autori i trazirave të rënda të shkaktuara në Drisht kundër sundimit venedikas (*idem presbiter Paulus*

<sup>51</sup> Ibid, 99.

<sup>52</sup> Ljubić, *Listine*, IV, 409; Acta. Alb., II/591: “... *Ad nonum et ultimum, quod presbyteri et clerici non graventur in faciendo custodias et alias angarias, sicut faciunt seculares...*”.

<sup>53</sup> AAV, p. I, t. 3, nr. 690, 70: “...*quod ipsi faciant et observent sicut fecerunt hucusque, nam custodientibus eis civitatem, custodiunt se et bona sua...*”.

<sup>54</sup> Pranvera Bogdani, *Balshajt lufta e principatës së Balshajve dhe të sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV*, Akademia e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë, Tiranë 2018, 117 (më tej: Bogdani, *Balshajt lufta e principatës*).

<sup>55</sup> AAV, p. II, t. 5, nr. 1438, 250.

<sup>56</sup> AAV, p. II, t. 6, nr. 1647, 123.

<sup>57</sup> Bogdani, *Balshajt lufta e principatës*, 117.

*Ungarus fuit causa magni scandali in dicto loco contra honorem et statum ducalis dominii nostri).*<sup>58</sup>

Po ashtu, edhe priftërinjtë Gjon Basilaçi (*Johannes Basilaçio*) dhe nipi i tij Pjetri, u dënuan me internim në Shkodër. Më 29 maj të vitit 1409, vetëm Gjon Basilaçi (*Johannes Basilaçio*) u lejua të kthehej e të jetonte në Drisht (*Presbiter Johannes basilaçio de driuasto confinatus extra driuastum licentietur quod possit redire driuastum*).<sup>59</sup>

Pothuajse një fat të ngjashëm pati edhe prifti Nikollë Desku (*Nicolaus Descho*), i cili ishte dënuar nga autoritetet venedikase me dëbim të përhershëm “nga Drishti dhe nga gjithë Shqipëria”.<sup>60</sup> Më vonë, edhe Nikollë Desku, si shumë klerikë e qytetarë të tjerë drishtianë, u lirua nga akuzat dhe në vitin 1421, ai ishte midis përfaqësuesve të Drishtit që nënshkruan në Venedik dokumentin që konfirmonte të drejtat e privilegjet e qyteteve.<sup>61</sup>

Klerikët drishtianë, luajtën rol të rëndësishëm edhe në luftë kundër vendosjes së sundimit osman jo vetëm në qytetin e Drishtit, por edhe në viset tjera në Shqipëri. Ndër ta u dalluan: kleriku Eugen Suma, i cili kontribuoi në qëndresën katolike kundër osmanëve,<sup>62</sup> pastaj ipeshkvi Nikollë Suma i cili ishte dalluar në mbrojtjen e qytetit të Drishtit. Për

<sup>58</sup> AAV, p. II, t. 6, nr. 1559, 56.

<sup>59</sup> AAV, p. II, t. 5, nr. 1438, 250: “ 1409. V. 29. *Presbiter Johannes basilaçio de driuasto confinatus extra driuastum licentietur quod possit redire driuastum... Sapientes ordinum Capta. Cum alias per ser Andream Lauredano potestatem nostrum driuasti fuerint confinati extra driuastum quidam presbiter Petrus, et presbiter Johannes basilaçio, quod deberent stare in Scutaro, et ultra hoc fuissent sibj accepta et retenta bona sua. Et dictj presbiterj, qui sunt patruus et nepos venerint ad presentiam dominij, ostendentes innocentiam suam, Et dominatio, Cognito eos fore Insontes, fecerit eis restituj dicta sua bona, Et modo ipsi vellent, quod vnus eorum videlicet Nepos posset reuertj, ad domum suam, tute et impune, Vadit pars, consideratis predictis, quod dictus presbiter Johannes licentietur, quod possit redire driuastum, et ibi stare secure, non obstante confinemente predicta, Remanente hic in venetijs, dicto presbitero petro, et non recedente absque licentia dominij. Et sic scribatur et Mandetur potestatej driuasti, quod debeat illum acceptare, ac permittere habitare in dicta terra, ut solebat ante quam confinatus esset per precessorem suum”.*

<sup>60</sup> AAV, p. II, t. 6, nr. 1647, 123.

<sup>61</sup> AAV, p. II, t. 10, nr. 2481, 291-295: “ *Comes et Capitaneus Scutari, et eius districtus, pacta, petiones, et conuentiones infrascriptas, productas, et petitas, ab infrascriptis de driuasto, sibi concessas, et firmatas, vt infra facimus. Concludimus, et firmamus, vice et nomine prefati ducalis dominij, cum venerabilibus et circumspectis viris, dominis presbiteris, Johanne baselatio, Nicolao Desco, et nobilibus viris, et prouidis”.*

<sup>62</sup> Schmitt, “Marrëdhëniet e Venedikut”, 9.

këtë qëllim, Nikollë Suma në vitin 1467 kishte udhëtuar në Venedik për t'i parashtruar Senatit plane të përpikta për fortifikimin e qyteteve të tyre,<sup>63</sup> ndërsa në vitin 1474 i kishte shërbyer trimërisht vendit të tij.<sup>64</sup>

Në luftë për mbrojtjen e Drishtit nga osmanët ishte dalluar edhe kanoniku dhe arqidhaku i Drishtit, i cili njëherit ishte edhe djali i madh i Nikollë Ungrit vojvodës së qytetit të Drishtit. Më 9 gusht të vitit 1480, e ëma e tij kishte kërkuar nga Venediku që të bashkëveprojë për lirimin e djalit të madh të saj, kanonik dhe arqidhjak i Drishtit, i cili ishte zënë rob nga turqit.<sup>65</sup> Turqit kishin kërkuar 100 dukate për ta liruar. Prandaj me vendim të Senatit, të datës 9 gusht 1480, i ishte dhënë shuma prej 100 dukate për lirimin e tij.<sup>66</sup> Në mbrojtjen e Drishtit ishte dalluar edhe prifti Luka Spiro nga Drishti.<sup>67</sup>

Kontributi i klerit drishtianë e bashkë më të edhe niveli i përgatitjes profesionale ishte shumëdimensional, kjo vërehet nga fokusimi dhe angazhimi i tyre në sfera të ndryshme të jetës. Në këtë aspekt, krahas profesioneve të ndryshme që i ushtruan, klerikët drishtianë ushtruan edhe profesionin e mësuesit. Klerikët drishtianë kishin njohuri në gramatikë si dhe aftësi në të lexuar ngase një gjë e tillë u kërkohej nga Statutet e Drishtit, përkatësisht më rastin e zgjedhjes së kanonikëve përveç tjerash kërkohej që personi që zgjidhej në këtë pozitë të njohur gramatikën ose të paktën të jetë lexues.<sup>68</sup>

Duke qenë të pajisur më këto njohuri, klerikët drishtianë ndikuan edhe në përhapjen e arsimit si dhe në ngritjen e shkollave. Në këtë drejtim u dallua famullitari Teodori nga Drishti (*Theodor de Drivasto*), i cili në vitin 1388 përmendet se kishte ngritur një shkollë fillore në Stanjo

<sup>63</sup> Malltezi, *Qytetet*, 133; Schmitt, *Arbëria*, 580; Schmitt, "Marrëdhëniet e Venedikut, 11.

<sup>64</sup> Schmitt, *Arbëria*, 581.

<sup>65</sup> *Dokumente të shekullit XV për historinë e Shqipërisë vëll. IV (1479-1506)*, pjesa I (1479-1499), Përgatitur nga Injac Zamputi, Tiranë 1967, dok. 57 (më tej: *Dokumente të shekullit XV*).

<sup>66</sup> Nadin, *Shqiptarët*, 44-45.

<sup>67</sup> *Dokumente të shekullit XV*, 177.

<sup>68</sup> *Statutet dhe urdhëresat*, kapitulli XLV: "...Edhe të mos ketë asgjë që të bjerë në kundërshtim me cilësitë e një kanoniku, d.m.th të mos jetë i pezulluar a në njëfarë mënyre i paaftë ose i çrregullt, apo i pandershëm si p.sh. konkubinar, kumarxhi, frekuentues pijetoresh apo pijanec, idhnak, i tërbuar, skandaloz, i njohur për vjedhje apo për ndonjë poshtërsi tjetër kanonike etj. Dhe të njohë gramatikën ose të paktën të jetë lexues...".

(*Stagno*) në Raguzë,<sup>69</sup> në të cilën prej vitit 1388 e deri në fillim të shekullit XV shërbeu si mësues (*magister scholarum in Stagno*).<sup>70</sup>

Në dokumente na del se Teodori për ta zhvilluar veprimtarinë e tij si mësues në Stanjo, ishte ndihmuar financiarisht nga autoritetet e Raguzës. Për këtë qëllim, më 19 dhjetor të vitit 1388, Këshilli i Vogël i Raguzës kishte marrë vendim që t'i jepen 10 perperë Teodorit (Theodorit), për qiranë e shtëpisë, në të cilën duhet të mbajë shkollarët e Stanjos që t'u mësojë lexim e shkrim.<sup>71</sup>

Bazuar në tërë atë që u tha më lart përkitazi me rolin e klerikëve drishtianë në shërbimet laike gjatë viteve 1317-1496, mund të nxjerrim këto konkluzione: angazhimi i klerit drishtas në shërbime të ndryshme laike është një tregues se kleri në Drisht gjatë mesjetës, saktësisht gjatë periudhës që kemi marrë për trajtim në këtë punim, kishte pothuajse tërësisht ndikim në pushtetin laik.

Nga analiza e veprimtarisë së tyre në çështjet me karakter laik-civil, klerikët drishtianë me angazhimin e tyre ndihmuan në: fushën e gjyqësisë, qoftë si gjykatës apo si pjesëmarrës në cilindo gjyq, si kishtar ashtu edhe shekullar (laik), si dhe si noter; në politikë, duke marrë pjesë në nënshkrimin e marrëveshjeve politike siç është ajo e vitit 1442, kur Drishti kalonte nën sundimin e Venedikut; në ekonomi, kryesisht kontribuan në mbledhjen e taksave; si luftëtarë u angazhuan në mbrojtjen e qytetit të Drishtit, si nga venedikasit ashtu edhe nga osmanët; si mësues ndikuan në përhapjen e arsimit si dhe në ngritjen e shkollave.

Klerikët drishtianë përveç shërbimeve laike-civile në Drisht, ata në këto shërbime, konkretisht si noterë dhe mësues, ndeshen edhe jashtë Drishtit, siç kemi rastin e priftit Andrea, i cili në fillim të shekullit të XIV përmendet si noter në ishullin Lagosta, si dhe rastin e famullitarit Teodor, i cili që nga fundi i shekullit XIV kishte shërbyer si mësues në Stanjo (Dubrovnik). Të gjitha këto qartazi tregojnë se angazhimi i klerit drishtianë në shërbimet laike ishte shumëdimensional.

<sup>69</sup> Šufflay, *Qytetet*, 94.

<sup>70</sup> Irmgard Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters", *Beiträge zur Südosteuropaforschung anlässlich des I. internationalen balkanologenkongresses in Sofia*. München 1966, 367, 371.

<sup>71</sup> Acta Alb., II/435: "*In eodem consilio (minore) captum fuit, quod dentur yperperi X Teodoro filio d(omi)ni Nicole de Drivasto pro affictu domus, in qua debet tenere scolares in Stagno, pro docendo (!) eos legere et scribere*".



Teuta SHALA-PELI

**THE ROLE OF THE PRIEST IN THE SECULAR SERVICES  
DURING THE YEARS 1317-1496**

During the Middle Ages Drishti, although a relatively small town, was distinguished for an active church life. Since within its territory it included a considerable number of church buildings such as: cathedrals, churches and monasteries, of course there were also many Priests who played a key role in organizing and developing many processes not only ecclesiastical but also secular. In this paper, as far as the data of the time allowed us, we have presented some of the secular services of the Drishta Priests both in the city of Drisht and outside it, from the beginning of the XIV century until after its fall under Ottoman rule. The involvement of the Priests in the city Drisht in various secular services is an indication that the Priests in Drisht during the Middle Ages exactly during the period we received for treatment in this paper had almost entirely influence on secular power. From the analysis of their activity in matters of secular-civil character, the Priests of Drishta with their engagement helped in: the field of judiciary either as a judge or as a participant in any trial both ecclesiastical and secular (secular), as well as a notary; in politics by participating in the signing of political agreements such as that of 1442 when the city of Drishti came under the rule of Venice; in the economy mainly contributed to tax collection; as warriors engaged in the defense of the city of Drishti by both the Venetians and the Ottomans; as teachers influenced the spread of education as well as the establishment of schools. The Priests of Drishta, in addition to the secular-civil services in Drishta, those in these services, specifically as notaries and teachers also met outside Drishta, as we have the case of the priest Andrea, who in the early XIV century is mentioned as a notary on the island of Lagosta, and the case of the parish priest Teodor, who since the end of the XIV century had served as a teacher in Stanjo Dubrovnik. All this clearly shows that the involvement of the Priest in the secular services was very dimensional.



**Agron ISLAMI**

**ASPEKTE TË JETËS SOCIO-EKONOMIKE DHE POLITIKE NË  
KOSOVË GJATË SHEKULLIT XVIII SIPAS ANKESAVE DHE  
KËRKESAVE TË QYTETARËVE**

Parimi bazë i shteteve klasike islame të Lindjes së Mesme ishte drejtësia. Ky parim edhe tek osmanët zë një vend të rëndësishëm. Sa më shumë që Sulltani pranonte ankesat e qytetarëve, aq më shumë çmohej personaliteti i tij. Forma e pranimi dhe e ushtrimit të ankesave dhe kërkesave ndryshonte varësisht nga statusi dhe mundësia e qytetarit për të iu ofruar Sulltanit. Sikur bie fjala: të huajt që operonin në kryeqytet nën statusin e tregtarit, ndiznin zjarre në afërsi të Sarajit Osman me qëllim të alarmimit të sulltanit për padrejtësitë që iu bëheshin atyre; qytetarët e kryeqytetit osman, ankesat e tyre ia drejtonin sulltanit kur ai ishte duke shkuar në lutjen javore të së premtes, apo kur dille për gjueti. Ndërsa, ata të zonave më të thella ankesat dhe kërkesat e tyre i dërgonin në formë të shkruar.

Burimi kryesorë i këtij punimi janë 7 dokumente në gjuhën osmane të papublikuara deri më tani, që për tematikë kanë ankesat dhe kërkesat e qytetarëve/nënshtetasve osman të territorit të Kosovës gjatë shekullit XVIII. Shumica e këtyre ankesave/kërkesave kanë marrë përgjigje zyrtare nga organet e mbikëqyrura direkt nga sulltani osman në Stamboll. Këto burime nga arkivi osman, nxjerrin në pah dimensionin social, ekonomik, financiar dhe pronësor të qytetarëve të Kosovës gjatë shekullit në fjalë.

**1. Hyrje**

Kushtetuta me të cilën udhëhiqej Perandoria Osmane, përbëhej nga dy komponentë kryesorë: *Sheriatin*, i cili bazohej në librin e shenjtë të fesë islame, Kur'anin dhe Orf (örf)'in, i cili për mbështetje kishte traditën e vjetër të shteteve të hershme turke dhe atyre të Lindjes së Mesme. *Örfi*, përfshinte ligjet apo kodex-et të cilat nxirreshin në emër të Sulltanit, që për synim kishin lehtësimin e jetës së nënshtetasve dhe që nuk guxonin të binin ndesh me legjislacionin e *Sheriatit*.<sup>1</sup> Mbi këtë bazë shohim se kemi të bëjmë me sundimtar absolut, patrimonial, i cili fuqinë e merrte nga Zoti dhe i përgjigjej vetëm Atij. Andaj, edhe ishte i vetmi autoritet dhe më i larti që mund t'i jepte fund një padrejtësie në tokë.<sup>2</sup> Pra, Sulltani ishte institucioni i fundit, të cilit nënshtetasit osman në mënyrë të drejtpërdrejt mund t'i drejtoheshin për të marrë drejtësi.

Sipas principit klasik të shtetit, drejtësia (*adalet*) ishte themeli i administrimit të mirë të shtetit. Ky detaj është regjistruar qysh në shekullin XI në njërën ndër veprat më të hershme të shkruara në turqishten e vjetër (*Kutadgu Bilig*), ku ndër të tjera thuhet: “*fshatari, që nuk jeton me sigurinë e jetës dhe të pronës, nuk mund të prodhoj, e për pasojë i bie dhe kapaciteti taksapagues. Në një situatë të tillë, për të mbajtur buxhetin gjithmonë përplot me para, bëhet e domosdoshme që sundimtari të sillet me maturi ndaj fshatarit - raja dhe ndaj tij të aplikoj një administrim me drejtësi*”.<sup>3</sup>

Mbi bazën e parimit të drejtësisë, autoriteti më i lartë i një kazaje ishte *kadiu*, i cili emërohej me dekret perandorak (*berat*) nga ana e sulltanit, dhe nga ai kërkohet që të ndaj drejtësinë sipas ligjeve në fuqi. Ai, drejtonte të gjitha çështjet e juridiksionit në kaza, sikur vjen fjala: mbikëqyrte dhe merrte vendime për mosmarrëveshjet e mundshme ndërmjet qytetarëve, sipas kërkesave bënte kurorëzime dhe shkuroëzime, nxirrte vendime për caktimin e një mbikëqyrësi (*Vekil*) për ruajtjen e pasurive të fëmijëve bonjakë deri sa të arrinin moshën madhore, përkujdesej për ruajtjen e çmimeve në tregje, kumtonte urdhëresat dhe kërkesat që vinin nga ana e kryeqytetit etj. Pra, kadiu, përveçse ishte autoritet i drejtësisë, vendimet e të cilit ekzekutoheshin me ndihmën e sanxhakbeut, kishte edhe kompetencën e njëjtë me të kryetarit të sotëm të Komunës.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Halil Inalcık, “Örfi-Sultanî Hukuk (Kanûn) ve Kanûnnâmeler”, *Osmanlı Tarihinde İslamiyet ve Devlet*, (İstanbul 2016), 57-58.

<sup>2</sup> Dritan Egro, *Ligji Osman ndër Shqiptarët e Mesjetës së Vonë* (Tiranë: 2012), 18.

<sup>3</sup> Egro, *Ligji Osman*, 18-19.

<sup>4</sup> Joseph Schacht, “Mahkeme”, *İslam Ansiklopedisi-MEB*, C. VII, (İstanbul: 1993), 147-149.

Lëndët e trajtuara nga ana e kadiut ruheshin në defterë të veçantë, të cilat njihen si *Sherijje* apo *Sixhilate*. Ky fond i defterëve është njëri ndër burimet më të rëndësishme për sa i përket jetës sociale, ekonomike dhe politike të kazave osmane dhe për fatin e keq, Sixhilatet e Kosovës deri më tani nuk janë gjetur në Kosovë. Megjithatë, studiuesi i mirënjohur Hasan Kaleshi<sup>5</sup> na informon për një koleksion të veçantë oriental, i cili ruhet në Bibliotekën e Universitetit të Beogradit, dhe duke qenë se sipas këtij informacioni ky fond i takon myftinisë së Pejës, mbase mund të jenë edhe Sixhilatet e Pejës dhe të zonave përreth.

Siç u paraqit më sipër, Shkalla e Parë për kërkimin e drejtësisë në nivelin lokal, respektivisht në kaza ishte kadiu. Ky kishte edhe ndihmësit e tij, naibët të cilët shkonin nëpër zonat jashtë kazasë, respektivisht nëpër fshatra, ku si përfaqësues të Kadiut kishin autoritetin e ndarjes së drejtësisë në emrin e tij.<sup>6</sup> Por, në rast se palët nuk mbeteshin të kënaqura me gjykimin e Naibit, mund të kërkonin që çështja të shkonte te kadiu, dhe në rastet kur nuk pajtoheshin as me vendimet e këtij të fundit, ata mund t'i drejtoheshin sulltanit me shkresë, ose duke shkuar personalisht në kryeqendër (Stamboll) për të kërkuar drejtësi. Në këtë rast, ankesat në formë të shkruar trajtoheshin nga autoritetet qendrore të mbikqyrura nga Sulltani dhe përgjigja kthehej në formë të vendimit të prerë, i cili kategorikisht duhej të ekzekutohej nga ana e autoriteve të sanxhakut ose kazasë.

## **2. Disa ankesa dhe kërkesa të qytetarëve të Kosovës të trajtuara në Divanin Osman gjatë shekullit XVIII**

<sup>5</sup>Kosova Nikad i Danas, (Beograd: 1973), 478.

<sup>6</sup>Për info më të zgjërura rreth sistemit të Gjykatave osmane shih. Ismail Hakkı Uzunçarşılı, *Osmanlı Devletinin İlmiye Teşkilâtı*, (Ankara:1965); Abdülaziz Bayındır, *İslam Mahkeme Usulu*, (İstanbul: 1966); İsmail Hakkı Uzunçarşılı, *Osmanlı Devleti'nin İlmiye Teşkilâtı*, (Ankara:1984); Joseph Schacht, "Mahkeme", *İslam Ansiklopedisi-MEB*, C. VII, (İstanbul: 1993), 147-149; İlber Ortaylı, "Osmanlı Devletinde Kadı", *Dianet İslam Ansiklopedisi*, V.24, (İstanbul: 2001); Gazmend Rizaj, "Roli i Kadiut në Sistemin Administrativ- Gjyqësor të Perandorisë Osmane gjatë shekujve XV-XVIII me vështrim të posaçëm në Arnautllëk", *Gjurmime albanologjike: Seria e shkencave historike* 14-1984 (1985): 93-110; Agron Islami, "1579 Numarali Rodosçuk (Tekfurdağı) Şer'iyye Sicilinin Transkripsyonu ve Değerlendirmesi" (Tezë Masteri, Sakarya Üniversitesi), 5-35; Agron Islami-Ayten Ardel, "Defterët e Kadiut Osman (Sixhilatet) – Një Dokument i Rëndësishëm për Historishkrimin e Jetës Sociale dhe Ekonomike të Qyteteve Shqiptare në shek. 15-19, Shembulli i Manastirit", *Java e Shkencës*(Prishtinë:2013), 474-480.

Për studiuesin shqiptar tani më është e njohur e vërteta mbi saktësinë e regjistrimeve osmane të ekonomive familjare, rezultatet e të cilave ruheshin në fondin e defterëve të *Tahririt*,<sup>7</sup> dhe krahas kësaj ajo aplikonte edhe regjistrimin e ngjarjeve ditore, të cilat në fillim ruheshin në defterët *Myhimme*, dhe më vonë, përkatësisht nga fillimi i shek. XVII, varësisht prej tematikave krijohen fonde të reja.<sup>8</sup> Si rezultat i laramanisë së tematikave, sot në arkivin osman kemi fonde të ndryshme të cilat përmbajnë të dhëna me interes për historinë sociale, ekonomike dhe politike të nënshtetasve osman. Një fond me rëndësi për këto tematika, e përbëjnë edhe ankesat dhe kërkesat e qytetarëve/nënshtetasve osman të territorit të Kosovës.

Duke u nisur nga numri i madh i shkresave prej ankesash të qytetarëve nga Kosova, shohim se këta të fundit ishin mirë të informuar për të drejtat e tyre dhe këtë e kishin shfrytëzuar mjaftë mirë, madje edhe për çështje shumë të thjeshta, siç është rasti i një vendimi të marrë karshi ankesës së disa fshatarëve të besimit islam, të cilët vinin nga rrethina e kazasë së Prishtinës. Këta, ankoheshin në Stamboll për fqinjin e tyre jo mysliman, i cili nuk kishte kujdes ndaj derrave të tij të cilat kishin shkaktuar dëme nëpër shtëpitë e tyre, madje siç thuhet në ankesë kafshët në fjalë ishin futur edhe në *mesxhid* (vendfalje). Ankesa, merr përgjigje në muajin prill të vitit 1743, me ç'rast kërkohet nga Kadiu i Prishtinës që konform *fetfasë* (mendimit të dijetarit islam), këtij pronari t'i ndalohej nxjerrja jashtë e kafshëve të lartcekura.<sup>9</sup> Duke qenë se nuk kemi arritur të gjejmë ankesën, por vetëm përgjigjen e ankesës (e cila në arsyetueshmëri jep informacionin e detajuar nga të ankesës), nuk mund ta dijmë se kush ishte ushtrues i ankesës, por nga vendimi kuptojmë se, ankesa ishte bërë në emër të të gjithë fshatarëve të dëmtuar. Megjithatë, përmbajtja e vendimit në fjalë, e bënë të qartë faktin se, prona private dhe ajo e përbashkët kishte vlerë të madhe, dhe si e tillë konsiderohej e paprekshme nga kushdo, pavarësisht besimit fetar, njëherit shihet se, autoriteti zyrtar i drejtësisë në Stamboll i ka kushtuar vëmendje bashkëjetesës së qytetarëve të konfesioneve të ndryshme fetare dhe si

<sup>7</sup> Halil Inalcik, *Sûret-i Defter-i Sancak-i Arvanid*, (Ankara:1987); Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI (studime dhe dokumente)*, (Tiranë: 1983); Ferid Duka, *Shekujt Osmanë në Hapësirën Shqiptare (studime dhe dokumente)*, (Tiranë; 2016); Iljaz Rexha, *Venbanimet dhe Popullsia Albane e Kosovës (sipas Defterëve Osmane të shekullit XV)*, (Prishtinë: 2016).

<sup>8</sup> Halil Inalcik, "Şikayet Hakkı: Arz-i Hâl ve Arz-i Mahzarlar", *Osmanlı'da Devlet, Hukuk ve Adalet*, (İstanbul: 2000), 48-51.

<sup>9</sup> Başbakanlık Osmanlı Arşivi (BOA) A.DVNSAHKR. d. 112/1009, Prill 1743.

rezultat nuk shohim që ka pasuar ndonjë dënim/gjobë për dëmet e shkaktuara nga ana e këtyre kafshëve, me përjashtim të ndalesës për ti nxjerrur jashtë, pas këtij vendimi.

Një ankesë tjetër, e cila nxjerrë në pah dimensionin gjinorë, së cilës i ishte kthyer përgjigja në vitin 1764, ishte ushtruar nga ana Asijes nga Prishtina. Ajo, ankohej në emër të vajzës së saj, Bunit. Kjo e fundit, në vitin 1756 ishte martuar me Mahmudin nga Prizreni. Pas një kohe të shkurtër për shkak të kushteve të vështira ekonomike, bashkëshorti, Bunin e ktheu në shtëpinë e babait të saj në Prishtinë dhe në prani të dëshmitarëve kishte thënë: *“Në rast se nuk kthehem brenda 20 ditëve, le të kuptohet se Buni më nuk është nën kurorën time”*. Pasi që Mahmudi nuk ishte kthyer më tek gruaja e tij, e ëma e Bunit, pas tre viteve, përkatësisht në vitin 1759, nga gjykata e Prishtinës kishte siguruar një konfirmim, që ish-burri i Bunit (Mahmudi) nuk kishte më asnjë të drejtë bashkëshortore ndaj të bijës dhe se nuk kishte asnjë pengesë për ta fejuar ateme Ebu Bekir Aga-në nga Prishtina. Ky i fundit, gjatë lidhjes së kurorës kishte premtuar 350 kurush dhuratë martesë (*mehir*), ari dhe rroba të ndryshme nusërie. Mirëpo, edhe Ebu Bekir Agaja ishte ndarë nga Buni dhe nuk i kishte përmbushur premtimet e dhëna në fejesë. Asija, ankesën e saj e kishte bërë në shkallën më të lartë të drejtësisë në Stamboll, me ç’rast kërkonte që të vihej drejtësia në të drejtën e bijës së saj, për përfitimin e dhuratës martesore (*mehr-i mueccel*), rrobave të nusërisë dhe të drejtën e pagesës në rastet e ndarjes (*iddet nafakasi*). Në përgjigje të ankesës së Asijes thuhej se, *“... i akuzuari (Ebu Bekir Agaja A.I.), nuk i është përgjigjur ftesës së gjyqit të Prishtinës dhe për këtë çështje janë dhënë dy fetfa, përmes së cilës urdhërohet kadiu i Prishtinës ta gjente Ebu Bekirin dhe ky i fundit t’ia kompenson të drejtat (e lartcekura A.I.) ish-gruas së tij, Bunit”*.<sup>10</sup> Në këtë rast, marrja si referencë e mendimit të dijetarit islam, respektivisht fetfa-së, shpërfaqë edhe peshën dhe respektimin e ligjeve të sheriatit në çështjet e drejtësisë në raport me të drejtën e gruas në një shtet islam, siç ishte Perandoria Osmane.

Dokumentacioni zyrtar osman i shekullit XVIII, argumenton gjendjen e brishtë sociale, ekonomike dhe politike të shtetit osman, i cilinë atë kohë karakterizohej me keqpërdorim të detyrës nga ana e zyrtarëve shtetëror, dhunimi i fshatrave nga ana e grupimeve të cubave (*Eşkıyâ*), rritja e tatimeve të shumta të cilat ishin ngarkesë e

<sup>10</sup>BOA.A.DVNSAHKR.d. 12/59, tetor 1764.

papërbalueshme e qytetarëve,<sup>11</sup> e që siç do të shihet në ankesën pasuese, edhe luftërat Austro-Osmane (1683-1699) kishin shkaktuar dëme të pariparueshme ekonomike tek qytetarët e Kosovës, gjë që e rëndonte edhe më shumë jetën e tyre. Karshi këtyre presioneve të papërbalueshme, jo rrallëherë drejtoheshin ankesa në shkallën më të lartë të drejtësisë në Stamboll. Një ankesë të kësaj natyre e kishin ushtruar banorët e Prishtinës me datë 12 korrik 1698. Siç thuhet në dokument, ankesa është dërguar në emër të rajës së vjetër (*kadîm re'âya*) të qytetit të Prishtinës. Pas detajeve mbi gjendjen e vështirë ekonomike të rajës, që siç thuhet në ankesë, kjo gjendje kishte ardhur si rezultat i pushtimit të qytetit nga ana e të pafeve (*istila-i küffar*), ku shumë nga banorët e kishin pësuar me jetët e tyre, dhe të gjallëve nuk iu kishte mbetur asgjë nga pasuritë e mëparshme. Në vazhdim të kësaj shkrese prej ankese thuhet se: “*pasi që Sulltani pranoi njoftimin (i'lâm) për gjendjen tonë na fali (liroi A.I) nga taksa e Lonikut*<sup>12</sup>, dhe për këtë si dëshmi kemi Fermanin e Lartë Sulltanor. Mirëpo që nga viti 1696/97 ne jemi regjistruar si raje e ngarkuar edhe me tatimin e avarëzit<sup>13</sup> dhe nuzulit,<sup>14</sup> (por që) përkundër asaj se ne që nga fillimet e sundimit osman (hîn-i fetihten berü) jemi regjistruar si raje e ngarkuar vetëm me taksen e Lonikut, ku për çdo vit japim nga dy akçe për kokë banori, tani nga ne kërkohet që të japim edhe taksën e avarëzit dhe nuzulit ... ne jemi dakord që të japim taksen e Lonikut, por jemi të pafuqishëm për taksa tjera, andaj kërkojmë që të keni mëshirë për rajën e mjerë dhe të bëni faljen e taksave shtesë të avarëzit dhe nuzulit.”<sup>15</sup> Ankesa në fjalë, përveç që shpërfaq gjendjen e vështirë ekonomike të qytetarëve të Prishtinës pas luftërave Austro-Osmane, nxjerrë në pah edhe rritjen e taksave të reja osmane ndaj rajës.

Një tematikë tjetër e ankesave të qytetarëve nga Kosova është edhe ajo ndaj keqpërdoruesve të detyrës zyrtare. Një dëshmi të tillë e hasim në vitin 1742, e cila ka të bëjë me ankesën e parisë së Prizrenit karshi pashallarëve me prejardhje nga Gjakova. Ankesën që do ta trajtojmë më poshtë jep informacion edhe për një ankesë paraprake të ushtruar kundrejt Ali Pashë Gjakovës, që për rezultat, qendra kishte marrë hapat dhe e kishte shkarkuar pashain nga pozita e mytesarifit të

<sup>11</sup>Yücel Özkaya, *18. Yüzyılda Osmanlı Toplumu*, (İstanbul: 2010), 11.

<sup>12</sup>Loniku është taksë e veçantë vetëm për rajen e cila banonte në zonat e minierave.

<sup>13</sup>Taksë e jashtëzakonshme.

<sup>14</sup>Rezerva ushqimore që shteti osman i blinte me para nga populli dhe i mbante të gatshme gjatë kohës që ushtria ndodhej në fushata ushtarake.

<sup>15</sup>BOA. IE.MDN. 2/144. Më 12.08.1698.



Prizrenit. Në ankesën në fjalë shohim se qytetarët e Prizrenit i ishin drejtuar sulltanit, në lidhje me shqetësimin e tyre për gjakovarin Mahmud Pashazade Aliun, i cili aso kohe ishte emëruar në pozitën e mytesarifit të Prizrenit. Këta qytetarë që deri atëherë taksën e hazerijës,<sup>16</sup> e kishin paguar në tre këste të ndara, pashai i ri ua kishte obliguar t'i paguanin tre këste të plota përnjëherë. Po ashtu, në emër të dhuratës dhe ushqimeve për pashain si taksë shtesë (e re) paguanin edhe 2 qese akçe, si dhe 500 keyl<sup>17</sup> grurë. Siç u tha edhe më lartë, pas ankimit të qytetarëve në raport me sjelljet e këtij pashai prej mytesarifi të Prizrenit, qendra e shkarkoi Ali Pashën dhe në vend të tij emëron të vëllain e tij, Ahmed Pashën. Por, për fatin e keq të prizrenasve, Ahmed Pasha doli të jetë edhe më i padrejtë se i vëllai. Ai me të ardhur në pozitë, pa të drejtë, nga populli kishte mbledhë 3 këstet e taksës së hazerijës, në emër të taksës së ashtuquajtur dhuratë (*ikram*) 500 *esedi kurush*<sup>18</sup>, në emër të dhuratës së ushqimeve 1200 keyl grurë, 200 frymë dele dhe 150 qerre kashtë. I njëjti, së bashku me 500 cuba shqiptar dhe 500 (cuba) tjerë të udhëhequr nga Haxhi Hasan Pashazade Tahir Beu, dhe i afërmi i tij (*akrabası*) Murat Beu, kishin mbajtur të rrethuar Prizrenin për 10 ditë, me ç'rast nga minaret e xhamive me armë plagosën dhe vranë disa burra dhe gra. Njëherit, këta djegën edhe tre lagje të qytetit, plaçkiten çifligun e Jakup Agës, si dhe shkatërruan edhe 3 fshatra në rrethinë të Prizrenit.<sup>19</sup> Ankesa në fjalë, është nënshkruar nga 30 personalitete të Prizrenit, duke filluar nga imamët, hatibët, myezinët, tregtarët etj., dhe nuk dihet nëse edhe kjo ankesë ka marrë përgjigje nga qendra, pasi që nuk kemi arritur të gjejmë një vendim në raport me këtë ngjarje.

Një vendim tjetër i muajit gusht të vitit 1764, kishte ardhur si rezultat i ankesës së ushtruar nga qytetarët e Vushtrrisë, Prishtinës dhe Novobërdës. Këta qytetarë në ankesën e tyre theksonin se përkundër asaj se kishin dhënë taksën e *seferijjes*<sup>20</sup> dhe obligimet tjera karshi shtetit, vushtrriasi Sylejman Aga, prishtinasi Ismail Beu dhe novobërdasit Sylejman Aga dhe Adil Beu kishin krijuar afri me disa kadinjë dhe naibë të kazave, ku për katër vite me radhë kishin mbledhur taksa të shumta në emër të shtetit, ndërsa për vetët e tyre (*kendi nefisleri içun*) ua kishin marrë edhe nga shtatë-tetë qind (*yedi-sekizer yuz*) akçe. Pas trajtimit të

<sup>16</sup> Taksë e jashtëzakonshme, që merrej në kohëra lufte.

<sup>17</sup> Kejli është njësi matëse e grurit.

<sup>18</sup> Monedh osmane.

<sup>19</sup> BOA. A.DVN.MHM. 1/55, më 1742

<sup>20</sup> Taksë e luftës.

ankesës së qytetarëve të kazave të lartpërmendura, ishte marrë vendim që; kjo praktikë e mbledhjes së taksave të padrejta të ndalet dhe fajtorët të gjykojnë në gjykatat e kazave në fjalë. Ekzekutimin e vendimit urdhëroreshin ta bënin Valiu i Rumelisë së bashku me kadinjët dhe naibët e kazasë së Vushtrrisë, Prishtinës dhe Novobërdës.<sup>21</sup>

Një tematikë tjetër e ankimesve ishte ajo e problemeve me moskthimin e borgjeve, apo hua-marrjeve, siç është rasti me artarin jo mysliman Sehikun<sup>22</sup>, i cili kishte ushtruar ankesë kundrejt Haxhi Ebu Bekir Agasë nga Prishtina. Ky i fundit, në vitin 1760 kishte marrë 900 kurush borxh nga Sehiku dhe nuk pranonte t'ia kthente. Ankimimit të tij i kishte ardhur përgjigja në formë vendimi në muajin gusht të vitit 1761. Në vendimin e drejtuar kadinjëve të Prishtinës, urdhërohej gjetja e Ebu Bekrit dhe shlyerja e borxhit nga ana e tij ndaj Sehikut.<sup>23</sup> Në kushte normale, mosmarrëveshjet e llojit të tillë do duhej të zgjidheshin nga ana e kadiut të kazasë së Prishtinës, por, duke qenë se tanimë është i njohur fakti se në periudhën e pas luftërave Austro-Osmane (1683-1699), administrata osmane përballej me problemet e mos kontrollit të plotë ndaj zyrtarëve të saj, dhesi rezultat i keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga ana e kadinjëve të kazave,<sup>24</sup> edhe ankesat e qytetarëve bëheshin direkt në Divanin osman.

Një moment unik i kërkimit të së drejtës dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë përbënë rasti i kërkesës së Sherife Emine nga Prizreni. Zonja Sherife Emine, siç thekson në kërkesën e saj zyrtare ishte nga pasardhëset e Mehmed Pashë Prizrenit, i cili kishte qenë nga themeluesit e vakëfit në Prizren, e që siç dihet, vakëfet kishin statutin e pronave private dhe si të tilla ishin të paprekshme edhe nga vetë sulltani.<sup>25</sup> Mbi këtë të drejtë ligjore, zonja në fjalë kërkonte që t'i rikthehej e drejta e administrimit me vakëfin e themeluar nga gjyshi i saj dy shekuj më parë. Kërkesën e mbështeste në vakfijën-dokumentin themeltarë të vitit 1567, ku sipas saj në këtë dokument ishte precizuar kushti që vakëfi të administrohej nga ana e bijve dhe bijave të tij (themeluesit) deri në përjetësi. Nga përgjigjet që janë dhënë mbi të njëjtën shkresë-kërkesë të Sherife Emine Hanmit, e cila mbanë datën 25

<sup>21</sup> BOA. A. DVNSAHKR. d. 21/131, Gusht 1764.

<sup>22</sup> Emri mund të lexohet Sehik ose Sehin.

<sup>23</sup> BOA.A.DVNSAHKR.d.17/108, Gusht 1761.

<sup>24</sup> Gazmend Rizaj, "Roli i Kadiut në Sistemin Administrativ- Gjyqësor të Perandorisë Osmane gjatë shekujve XV-XVIII me vështrim të posaçëm në Arnautllëk", *Gjurmime albanologjike: Seria e shkencave historike* 14-1984 (1985): 104-105.

<sup>25</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, V. I (Tiranë:2002), 523.

janar 1766, kuptohet se kjo kërkesë deri në dhjetorin e vitit 1766 është trajtuar nga 11 zyre të cilat kanë dëshmuar se një vakëf i tillë nuk është i regjistruar në fondet e tyre të vakëfeve në Stamboll.<sup>26</sup>

Siç u pa më lartë, nga letërkëmbimi i vitit 1766 nënkuptohet se zonja prizrenase Sherife Emine e kishte humbur luftën për rikthimin e të drejtës së administrimit me vakëfin. Por, katër vite më vonë kemi hasur një vendim në lidhje me të njëjtën çështje, e që nënkuptohet se kjo zonjë, nuk kishte ndaluar së kërkuari të drejtën e saj. Vendimi i dërguar Mytesarifit dhe kadiut të Prizrenit për ekzekutim është i muajit tetor të vitit 1770. Në të thuhet: *“Zonja Sherife Emine, e cila është nga trashëgimtarët e prizrenasit të ndjerit Mehmed Pashës, ka dërguar kërkesë në Sudde-i Saadet (Derën e Drejtësisë, A.I.)..., Mehmed Pasha, i cili është themelues i vakëfit dhe i cili në dokumentin themeltarë ka vënë kushtin që vakëfi të udhëhiqet-administrohet nga bijë dhe bija të tij deri në përjetësi dhe në të njëjtin dokument është paraparë edhe pagesa ditore prej 10 akçesh për administratorin e vakëfit ... pa të drejtë, kjo përgjegjësi i është dhënë Abdylvehhabit”*. Në vazhdim të vendimit në fjalë, shohim se pas insistimit të zonjës në fjalë, Kadiaskeri i Rumelisë kishte emëruar një zyrtar me emrin Ali që të bëjë verifikimin e dokumentit themeltarë të vakëfit në sixhilatet-regjistrat e kadiut në Prizren. Pas hulumtimit, zyrtari kishte vërtetuar pretendimin e zonjës Sherife Emine. Mbi bazën e këtyre të gjeturave, në vendimin e muajit tetor të vitit 1770, kërkohej nga Kadiu dhe Mytesarifi i Prizrenit që të ekzekutojnë kërkesën legjitime të zonjës Sherife Emine.<sup>27</sup>

### 3. Konkluzion

Osmanët, të cilët deri në shekullin XIX shtetin e tyre e quanin *Devlet-i Aliyye-i Osmaniyye* (Shteti i Lartë Osman), konsideronin se ishin sinonim i shtetit të së drejtës dhe këtë sinonim ta aplikonin përmes institucionit të *Shejhul Islamit* dhe *Kadiut*, të cilët kishin krijuar edhe mekanizmin e të drejtës së ankesës dhe kërkesës për çdo qytetar-nënshtetas osman.

Ankesat dhe kërkesat e qytetarëve të Kosovës para së gjithash japin informacion të dorës së parë për studiuesin për sa i përket jetës sociale, ekonomike dhe politike në Kosovës gjatë shekullit XVIII. Mbi bazën e shembujve që u trajtuan më lartë mund të sjellim përfundime se

<sup>26</sup>BOA. C. MF.14/685, më 25 janar 1766.

<sup>27</sup>BOA.A.DVNSAHKR.d. 16/105, Tetor 1770.

sistemi i drejtësisë osmane gjatë shekullit XVIII ishte mjaftë efikas në përgjigje, dhe vendimet që ishin marrë karshi ankesave dhe kërkesave reale të ushtruara nga qytetarët e kazave të ndryshme të Kosovës favorizonin ankuesit, si palë e dëmtuar.

Sa i përket informacionit historik që ofrojnë ankesat dhe kërkesat e trajtuara më lartë, shohim se kemi të bëjmë me një bashkëpunim qytetar të konfesioneve të ndryshme fetare në Kosovë, dhe me një kulturë të lartë qytetare, ku zgjidhjen e problemeve e bënin përmes rrugëve institucionale dhe nuk ngatërroheshin mes vete, siç është rasti i fshatarëve të Prishtinës karshi kultivuesit të derrave, si dhe rasti tjetër i ankesës së nënshtetasit jo mysliman ndaj nënshtetasit mysliman për mos shlyerjen e borxhit. Shembulli i dytë, po ashtu nga qytetarët e Prishtinës, përveç që jep informacion për sistemin e taksimit të rajës së zonave të minierave vetëm me taksën e Lonikut, dëshmon edhe vuajtjet dhe dëmtimet ekonomike që pësuan prishtinasit nga luftërat e shkaktuara në mes osmanëve dhe austro-hungarezëve (1683-1699). Rasti i ankesës së prizrenasve karshi pashallarëve gjakovarë, shpërfaq elementin e gjendjes së brishtë politike dhe sociale në Kosovë, ku zyrtarët osman rrethonin qytete pa ndonjë frikë nga qendra. Më pas, vendimet karshi kërkesave të zonjave siç është rasti i znj. Asije dhe Emine Sherifes vë në pah dimensionin gjinorë të kohës në raport me kërkimin e të drejtave të tyre. Njëherit, lufta e zonjës Emine Sherife nga Prizreni për drejtësi, përveç se shpërfaqë elanin e lartë të një femre të shekullit XVIII për të udhëhequr me vakëfin/fondacionin e themeluar shekuj më parë nga gjyshërit e saj, ofron edhe informacion biografik për prejardhjen e vërtetë të Mehmet Pashës, që disa studiues, kryesisht turq, e trajtojnë si personalitet osman me prejardhje nga zonat e Anadollit, që ka qeverisur me Prizrenin.


### Faksimile nga ankesat/kërkesat dhe vendimet e qytetarëve të Kosovës:



1. Vendimi ndaj ankesës së znj. Asije, në raport me të drejtën e vazhës së saj Bunit për kompensimin e të drejtës së dhuratës martesore dhe dhuratës së ndarjes.



2. Kërkesa e znj. Emine Sherife nga Prizreni për të drejtën e udhëheqjes me vakëfin/fondacionin e Mehmet Pashë Prizrenit si trashëguese e tij.



3. Ankesa e parisë së Prizrenit kundrejt pashallarëve gjakovarë:

Agron ISLAMI

## SUMMARY

### **ASPECTS OF SOCIAL, ECONOMIC AND POLITICAL LIFE IN KOSOVA DURING THE XVIII CENTURY ACCORDING TO THE COMPLAINTS AND REQUESTS OF CITIZENS**

The basic principle of the classical Islamic states of the Middle East was the justice. This principle also occupies an important role among the ottomans. The more the Sultan accepted the complaints of the citizens, the more his personality was valued. The way citizens complained to the Sultan differed from their status and the opportunity to approach the Sultan. For example: the foreigners who operated in the capital under the status of a merchant, lit fires near the Ottoman Palace in order to alert the Sultan to the injustices done to them; the citizens of the Ottoman capital addressed their grievances to the Sultan while he was going to the weekly Friday prayer (Cuma), or when he went hunting. Whereas, those who lived in the deepest areas of the empire, sent their complaints and requests in the written form.

The main sources for this paper are 7 (seven) documents written in the Ottoman language. Documents are unpublished so far and their topics consist of the complaints and requests of ottoman citizens in the territory of Kosova during the XVIII century. Most of these complaints / requests have received official responses from the bodies directly supervised by the Ottoman Sultan in Istanbul. These sources from the Ottoman archive, highlight the social, economic, financial and property dimension of the citizens of Kosova during the XVIII century.

These complaints and requests, first of all, provide first-hand information on the social, economic and political life in Kosovo during the XVIII century. Based on the examples we have discussed in the paper, we can conclude that the Ottoman justice system during the eighteenth century was quite efficient in response, and decisions that were made based on real complaints and requests filed by citizens of different kazas of Kosova, favoured the complainants, as an injured party.



In terms of historical information, we see that we are dealing with a civic cooperation of different religious denominations in Kosovo, who had a high civic culture as they solved problems through institutional ways and did not confront each other. Such is the case of the villagers of Prishtina against the pig farmer, as well as the other case of the complaint of the non-Muslim citizen against the Muslim citizen for not repaying the debt. The second example also comes from the citizens of Prishtina, in addition to providing information about the Raja taxation system of mining areas only with the Lonik tax, also proves the struggle and economic damages suffered by the people of Prishtina, which were caused by the wars between the Ottomans and the Austro - Hungarians (1683-1699).

The case of the Prizren people complaining against the pashas of Gjakova, reveals the element of the fragile political and social situation in Kosovo, where Ottoman officials surrounded cities without any fear of the center. Whereas, decisions following the requests of ladies such as the case of Mrs. Asije and Mrs. EmineSherife, highlights the gender dimension of time in relation to demand for their rights. Meanwhile, the struggle of Mrs. EmineSherife from Prizren for justice, in addition to revealing the high elan of a woman of the XVIII century to lead the waqf / foundation founded centuries ago by her grandparents, also provides biographical information about the true origin of Mehmet Pasha, who some scholars, mainly Turks, treat him as an Ottoman personality from the areas of Anatolia, who ruled Prizren.



**KUD: 94(496.5) .085/.086 (093.2)  
930.2(420) :94(496.5) .085/.086**

**Marenglen VERLI**

**SHQIPTARËT PËRBALLË NDËRKOMBËTARËVE NË PARIS  
NË MBYLLJE TË KONFERENCËS SË PAQES  
(14 JANAR - 3 MARS 1920)**

**Rreziku i asgjësimit të shtetit të pavarur shqiptar pas Luftës së Parë  
Botërore**

Konferenca e Paqes në Paris, organizuar pas Luftës së Parë Botërore nga fuqitë fituese, Franca, Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Japonia, ndër të tjera trajtoi edhe problemet e kufijve dhe të statutit të shteteve të Ballkanit dhe në kuadër të tyre edhe “çështjen shqiptare”.

Autorë të shumtë e kanë bërë objekt të studimit dhe kanë dhënë opinionet e veta qoftë për Konferencën në përgjithësi, qoftë për aspekte të ndryshme të saj. Për “çështjen shqiptare”, ndër autorët shqiptarë më të njohur, janë dëshmuar me studime të thelluara profesorët: Muin Çami, Paskal Milo, Arben Puto etj., të cilët i kanë kushtuar kësaj teme monografi, pjesë monografish dhe artikuj të shumtë<sup>1</sup>.

Është e njohur përgjithësisht ecuria e trajtimit të çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes. Ndonëse asnjëherë në konfliktin botëror, Shqipëria ishte planifikuar të asgjësohej. Ricungimi i kufijve të caktuar për të në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, më 1913 në

---

<sup>1</sup> Muin Çami, *Shqipëria në Konferencën e Paqes (1919-1920)*, monografi e papërfunduar në dorëshkrim (1990); Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë (1912-1939)*, vëllimi I, Tiranë: Toena, 2013; Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009.

interes të fqinjëve tokësorë e detarë (Greqia, shteti Serbo-Kroato-Slloven dhe Italia), si edhe dhënia e asaj që mbetej nën protektoratin apo mandatin e Italisë, do të thoshte fund i pavarësisë. Delegacioni zyrtar shqiptar i Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, që shkoi në Paris, shumë shpejt u bind se jo vetëm korrigjim të padrejtësive të mëparshme ndaj Shqipërisë nuk do të kishte, por rreziku i ri ishte kërcënues deri në fatalitet. Pozicioni i tërheqjes dhe i lëshimeve nuk solli fryt. Për Fuqitë e Mëdha, veçanërisht për Francën dhe Britaninë, Shqipëria duhej të sakrifikohet sërish për të normalizuar situatën në rajon.

Akordi apo kompromisi i 13-14 janarit 1920 ishte pika kulmore e më të keqes. Në mungesë të përfaqësuesit të SHBA-së, Franca, Britania e Madhe dhe Italia miratuan një variant zgjidhjeje që e kundërshtuan jo vetëm SHBA-në, por edhe Jugosllavia. Pikërisht që nga ky moment zhvillimet në terrenin shqiptar, të diplomacisë dhe të lëvizjes popullore, morën një drejtim interesant, për të cilin historiografia ka vend ende të thellojë vështrimin. Ky artikull synon të hedhë dritë për një periudhë disajvare pas kompromisit të 14 janarit, që ndikoi dukshëm në rritjen e rolit të faktorit shqiptar lidhur me marrjen e vendimeve për të ardhmen e Shqipërisë.

\*

\*                      \*

### **Situata dhe reagimi i shqiptarëve pas kompromisit të 13-14 janarit 1920**

Tentativat e tri Fuqive të Mëdha evropiane, Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë, të sforcuara deri në nivelet më të larta, me pjesëmarrjen edhe të kryeministrave përkatës, për t'i gjetur një zgjidhje "Çështjes së Adriatikut", prodhuan kompromisin e 13 janarit të vitit 1920. Me disa retushime, që synonin të siguronin edhe miratimin jugosllav, ai u paraqit në formën e plotë më 14 janar 1920.

Ishte fat për shqiptarët, që delegacioni jugosllav për shkak të kontradiktave të brendshme midis kroatit Ante Trumbiq (ministër i Jashtëm) dhe serbit Nikolla Pashiq (kryeministër), nuk pranoi të hiqte dorë nga Fiumja për të pranuar kompensime në Shqipëri. Kjo ngecje e procesit për një marrëveshje midis Italisë dhe shtetit SKS rreth caktimit të kufijve fuste në lojë SHBA-në, që nuk kishin firmosur kompromisin e 13-14 janarit, por që do të qenë detyruar ta pranonin, nëse jugosllavët dhe italianët do të binin dakort për zgjidhjen e ofruar nga diplomacia franko-britanike.

Përmbajtja e diskutimeve dhe kompromisit të 13-14 janarit ishin shokuese për shqiptarët. Aty ishte firmosur katastrofa dhe asgjësimi i arritjeve të viteve 1912-1913. L. Bumçi, M. Frashëri, dr. Turtulli, Luigj Gurakuqi, Pandeli Evangjeli, Mithat Frashëri etj., u ndjenë të zhgënjyer e të tradhtuar nga fuqitë evropiane. Vendi i vetëm ku mund të apelonin ishin SHBA-ja.

Pas telegramit të përmendur të 12 janarit dërguar presidentit Uillson, më 14 janar u përgatit një telegram tjetër. L. Bumçi në emër të delegacionit e adresoi atë më 15 janar te sekretari i Departamentit të Shtetit R. Lansing. “Konferenca me qëllim që të rregullojë konfliktin italo-jugosllav, theksohej në telegram, nuk u shqetësua aspak të flirtojë popullin e vogël e të dobët shqiptar, duke ofruar territorin e tij si kompensim për qëllimet imperialiste të fqinjëve të vet. Viktima nuk ka armë të tjera për mbrojtje veç parimeve të shpallura nga presidenti Uillson në emër të popullit të madh amerikan. Populli shqiptar në këtë moment të madh ankthi kërkon me ngulm mbështetjen e fuqishme e të drejtë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës”<sup>2</sup>.

Po atë ditë, më 15 janar, ndonëse pa shpresa, delegacioni shqiptar i dërgoi një letër tjetër edhe Klemansoit<sup>3</sup>. Në të shprehej dhimbja që ndjenin shqiptarët nga nëpërkëmbja e plotë dhe mosrespektimi i parimeve amerikane të përvetësuar nga Konferenca lidhur me respektimin e parimeve të kombësisë dhe të drejtës për vetëvendosje. Përsëri dhe si gjithmonë me një gjuhë të vetëpërmbajtur, pavarësisht nga presionet e datës 12 janar, që i ishin bërë nga përfaqësuesit e qarqeve të ndryshme patriotike në atdhe dhe nga diaspora, L. Bumçi i shprehte shqetësimin Zh. Klemansosë për mënyrën si po trajtohej çështja shqiptare: “Shqipëria e krijuar më 1913 si shtet i pavarur, neutral e i garantuar, shkruhej në letrën e kryetarit të delegacionit shqiptar, ka një të drejtë të fituar dhe nuk mund të shohë pa protestuar shkatërrimin e pavarësisë dhe integritetit të saj. Italia nuk ka asnjë të drejtë legjitime mbi Vlorën... Greqia dhe Jugosllavia nuk kanë asnjë të drejtë mbi pjesët e tjera të territorit shqiptar. Dhënia e mandatit mbi Shqipërinë... është në kundërshtim me klauzolën e nenit 22 të Traktatit të Versajës. Ndërhyrja në çështjet shqiptare e fqinjëve, përfundonte letra, ...do të cenojë

<sup>2</sup> P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 451-452, citon Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1920, dosja (më tej: D.). 34, fl. 216.

<sup>3</sup> AMPJ, V. 1920, D. 34, fl. 33-34; Shih edhe P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 449-450.

pavarësinë e saj dhe kjo nuk do të mungojë të provokojë turbullira në Ballkan”<sup>4</sup>.

Një ditë më pas, më 16 janar, L. Bumçi, do të adresonte dy letra të tjera, njërin për Zhyl Kambonin, diplomatin francez me rol të rëndësishëm në Konferencë, kurse tjetrën për kryetarin e Lidhjes së Kombeve, organizatës së re ndërkombëtare që ishte krijuar me nismën amerikane në ditët e Konferencës.

Në letrën e parë kryetari i delegacionit shqiptar i shfaqte francezit deziluzionin dhe hidhërimin që ai nuk e kishte mbajtur premtimin e dhënë lidhur me kufirin verior të Shqipërisë<sup>5</sup>. Kurse në letrën drejtuar kryetarit të Lidhjes së Kombeve, L. Bumçi kërkonte mbrojtjen e kësaj organizate kundër vendimeve të Konferencës së Paqes në dëm të Shqipërisë. “Kombi shqiptar, i zhytur në trishtim më të thellë nga vendimet që Konferenca e Paqes po merr lidhur me Shqipërinë, duke konsakruar ndarjen e saj... thuhej në letrën e sipërpërmendur, përshëndet me entuziazëm inaugurimin e veprimtarisë së Lidhjes së Kombeve, në të cilën ka vendosur gjithë shpresat e veta për ruajtjen e të drejtave të saj të marra nëpër këmbë”. E hartuar në frymën e qëndrimit të moderuar, të ndjekur në vazhdimësi, ku ishin forcuar notat e diziluzionit e, madje, të fatalitetit, letra përfundonte: “Delegacioni shqiptar proteston në emër të drejtësisë..., kërkon me lutje të përvuajtur mbrojtjen e Lidhjes së Kombeve... dhe shpreson se ajo nuk do të lejojë që të kryhet një padrejtësi e tillë”<sup>6</sup>.

Përçapjet e intensifikuara pas mbledhjes, që delegatët shqiptarë bënë më 14 janar, prodhuan edhe letra e telegrame të tjera. Duke konsideruar shpresë të vetme SHBA-ja, me firmën e L. Bumçit, më 17 janar, iu dërgua një letër edhe ambasadorit amerikan në Paris e në Konferencë, H. Uolles (H. Wallace), i cili vizitohej rregullisht nga anëtarët e delegacionit shqiptar. Letra shoqërohej me një thirrje të përfaqësuesve të Korçës për të përforcuar idenë se rregullimi i “Çështjes së Adriatikut” duke sakrifikuar e copëtuar Shqipërinë kishte krijuar një përshtypje të hidhur te populli i saj. Uollesit me këtë rast i kujtohej

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> AMPJ, V. 1920, D. 34, fl. 40-41. Letër e L. Bumçit, dt. 16 janar 1920; Shih edhe P. Milo, *Politika e jashtme ...*, vëll. I, f. 450.

<sup>6</sup> Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi MPJ, D. 2. Letër e L. Bumçit për kryetarin e Lidhjes së Kombeve, dt. 16 janar 1920; Shih edhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar (1918-1920)* (Përmbledhje dokumentesh), redaktor përgjegjës Muin Çami, botim i Institutit të Historisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, vëll. II, dok.25, f. 37.

memorandumi që i ishte dërguar më 8 nëntor 1919, i shoqëruar me dokumente, të cilat dëshmonin qëndrimin e banorëve të Shqipërisë së Veriut për të mos pranuar zgjedhë të huaj<sup>7</sup>.

SHBA nuk kishin qenë në një mendje me partnerët evropianë për çështjen e Shqipërisë së Jugut. Në Memorandumin amerikano-franko-britanik të 9 dhjetorit, ata vërtet nuk ndanin ndonjë mendim ndryshe për çështjen e sovranitetit të Italisë në Vlorë dhe të mandatit mbi Shqipërinë, por nuk pajtoheshin me dhënien e Korçës Greqisë dhe të Shqipërisë së Veriut Jugosllavisë. Këtë çarje në pikëpamjet e të Mëdhenjve, delegacioni shqiptar u përpoq ta shfrytëzonte për të shpëtuar diçka nga arritjet e vitit 1913.

Zëvendësimi i Zh. Klemansoit nga A. Milerand (A. Millerand) i dha rast delegacionit shqiptar të tentonte diçka me kryeministrin e ri të Francës. Natyrisht politika franceze e kishte thënë fjalën e vet, megjithatë, për të mos lënë asgjë mangut në veprimtarinë që kishte marrë përsipër, delegacioni, më 19 janar 1920, përsëriti thirrjen që të pengohej padrejtësia që po i bëhej popullit shqiptar duke copëtuar Shqipërinë në interes të fqinjëve<sup>8</sup>.

Për situatën kritike në Konferencën e Paqes lidhur me çështjen shqiptare, L. Bumçi do të njoftonte disa ditë më pas, më 22 janar 1920, Qeverinë e Përkohshme në Durrës. “Lajmet e fundit... janë të dëshpërueshme, - informonte ai - Konferenca për të ndrequr punën e Adriatikut, bëri një projekt i cili konsakron therORIZIMIN e Shqipërisë. Ne protestuam me fuqi kundër kësaj padrejtësie, por zëri ynë nuk mjafton për ta ndalur zbatimin e saj. Megjithëqë kurrë nuk kemi ushqyer shpresa të mëdha, vijonte më tej letra, ...por prapë nuk besonim se puna jonë mund të dalë kaq keq”. Pasi theksonte se premtimet dhe shpresat e dhëna nga anëtarë të delegacionit amerikan e italian “u zhdukën njëra pas tjetrës”, L. Bumçi, duke iu bërë me dije kolegëve në Durrës se të dy variantet për zgjidhjen e çështjes shqiptare, qoftë projekti apo kompromisi i 14 janarit 1920, qoftë Traktati i Londrës i vitit 1915, “që të dy janë fort të këqij për ne dhe... do të humbasim gjysmën e vendit”, i nxiste t’ia bënin të njohur popullit rrezikun, që “të protestojnë si t’u duket më mirë”<sup>9</sup>. Kryetari i delegacionit shënonte posaçërisht se “duhet të

<sup>7</sup> AMPJ, V. 1920, D. 34, fl. 44. Letër e L. Bumçit, dt. 17 janar 1920, për ambasadorin amerikan në Francë.

<sup>8</sup> Po aty, fl. 46.

<sup>9</sup> AQSH, F. MPJ, D. 322. Njoftimi i L. Bumçit për Qeverinë e Përkohshme në Durrës, dt. 22 janar 1920; Shih edhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar*, vëll. II, përgatit për botim M. Çami etj., Instituti i Historisë, Tiranë: 1975, dok. 35, f. 48-49.

lajmëroni dhe popullin e Korçës e të Shkodrës, që të mund të marrin masat, që do t'u duken më të mira për mbrojtjen e interesave kombëtare”<sup>10</sup>.

Në Shqipëri, ndërkohë, ishin ndërgjegjësuar për vendimet katastrofike të Konferencës për Shqipërinë dhe po zotëronte pikëpamja se duheshin radikalizuar qëndrimet kundër copëtimit të mëtejshëm të Shqipërisë së 1913. Madje më 21 janar kishte filluar punimet Kongresi i Lushnjës, që më 28-31 janar, në kushtet kur përpjekjet diplomatike për ripohimin e pavarësisë së shtetit shqiptar dhe të tërësisë së tij tokësore nuk dhanë rezultat, mori përsipër organizimin e qëndresës së brendshme popullore. Anëtarë të Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, që vepronin në Shqipëri, veçanërisht Fejzi bej Alizoti, Myfit Libohova e Mustafa Kruja, u përpoqën hapur qysh më 12 janar ta pengonin organizimin e Kongresit<sup>11</sup>, por pa sukses. Urdhrat dhe qarkoret e lëshuara nga data 13 janar e në vijim, vrasjet politike si ajo e Abdyl Ypit, madje edhe kërkesa drejtuar Komandës së ushtrisë italiane në Shqipëri për të ndërhyrë, nuk prodhuan ndonjë rezultat<sup>12</sup>. Konsulli britanik Iden ndoqi punët e Kongresit, kurse autoritetet italiane deklaruan se nuk do të ndërhynin. Vetëm më 31 janar, ditën kur Kongresi përfundoi punimet, një inspektor i Komandës italiane në nënzonën veriore të Vlorës, i dërgoi një letër kryetarit të Kongresit, në emër të gjeneral Piaçentinit, me të cilën ai e njoftonte se “nuk mund të njihte zyrtarisht vendimet e marra nga delegatët... në Lushnje, për arsye se nuk i rezulton që pozita e tyre të jetë legale. Me qëllim që të mbahet qetësia publike, përfundonte letra... u bëj thirrje zotërinjve delegatë të pezullojnë mbledhjen dhe të kthehen në vendet e tyre”<sup>13</sup>.

Por tashmë Kongresi e kishte përfunduar punën e tij. Qeveria e Durrësit ishte shpallur e rrëzuar. Ndër të tjera ajo u fajësua se “tue u mbështetë në politikë të veçantë, shtini në një situacion të keq gjendjen

<sup>10</sup> *Po aty*.

<sup>11</sup> AQSH, F. Drejtoria e Punëve të Brendshme (DPB), D. 197, dok.14. Informacion i inspektorit të përgjithshëm Avni Dabulla, dt. 12 janar 1920, dërguar nga Berati Delegacisë së Punëve të Brendshme; Shih edhe *Lufta e popullit ...*, vëll. II, dok. 15, f. 26.

<sup>12</sup> AQSH, F. Kongresi i Lushnjës, D.2. Urdhër i firmosur nga F. Alizoti për ndalimin e mbledhjes së Kongresit të Lushnjës, dt. 13 janar 1920; Shih edhe *Lufta e popullit...*, vëll. II, dok. 23, f. 35; *Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941*, botim i Drejtorisë së Arkivave të Shtetit të PPSH, Tiranë: 1959, f. 18-19.

<sup>13</sup> AQSH, F. Kongresi i Lushnjës, D. 2, dok. 21. Letër e inspektorit të Komandës italiane, dt. 31 janar 1920.



politike të Shqipërisë”<sup>14</sup>. Kongresi gjithashtu kundërshtoi projektet e Konferencës së Paqes që cenonin pavarësinë dhe tërësinë tokësore të shtetit shqiptar dhe u shpreh për pavarësinë e plotë të Shqipërisë, kundër çdo mandati ose protektorati të huaj. Në telegramin e protestës adresuar kryetarit të Konferencës së Paqes, Kongresi shpalli se shqiptarët ishin gati të bënin “të gjitha sakrificat, të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut të tyre, kundër çdo vendimi që do të vinte në rrezik tërësinë tokësore dhe pavarësinë e tyre të plotë”<sup>15</sup>. Me këtë vendim, Kongresi iu kundërvu si planeve të Konferencës për ta vendosur Shqipërinë nën mandatin e një fuqie të huaj, ashtu edhe projekteve të delegacionit shqiptar të Qeverisë së Durrësit për të vënë në krye të shtetit shqiptar një princ italian, ose për ta vendosur atë nën “mbrojtjen” e Lidhjes së Kombeve, siç kishte propozuar ky delegacion më 22 janar në një notë drejtuar Konferencës<sup>16</sup>.

Kongresi, ndonëse shtypi francez kishte informuar qysh më 22 janar se 21 janari kishte shënuar fundin e Konferencës së Paqes<sup>17</sup>, më 29 janar zgjodhi që delegacioni në Paris, “pranë Konferencës së Paqes” të përbëhej nga L. Bumçi, Mehmet Konica dhe dr. Turtulli (kryetari u la të zgjidhej midis tyre)<sup>18</sup>. Delegacionit do t’i duhej në vijim të punonte sa në Londër edhe në Paris, ku ndërkohë u përqendrua puna, përkatësisht e tre kryeministrave evropianë dhe ambasadorëve të Fuqive të Mëdha.

Ndërkohë, që rrjedha e ngjarjeve në Shqipëri finalizohej me Kongresin e Lushnjës, në Paris, ashtu si delegacioni shqiptar përpiqej të gjente një rreze shprese te qëndrimi i panjësuar amerikan me partnerët evropianë për çështjen shqiptare, edhe jugosllavët trokitën në të njëjtën portë. Ultimatumit i Fuqive të Mëdha evropiane e vuri në pozitë të vështirë delegacionin jugosllav, sepse qoftë projekti i 14 janarit 1920, qoftë Traktati i Londrës i vitit 1915, nuk ishin opsione të mira për të. Më 16 janar Trumbiqi i kërkoi mbështetje ambasadorit amerikan. Dublimi i

<sup>14</sup> *Lufta e popullit ...*, vëll. II, dok. 50, f. 63-67. Vendimet e Kongresit të Lushnjës, sipas procesverbale të Kongresit.

<sup>15</sup> *Historia e popullit shqiptar...*, vëll. III, f. 145.

<sup>16</sup> *Po aty*.

<sup>17</sup> AQSH, F. MPJ, D. 322, dok.716. Njoftim i L. Bumçit nga Parisi, dt. 22 janar 1920. “Konferenca mori fund, a më mirë e nderoi fytyrën... tani e tutje ajo do të jetë përfaqësuar prej mbledhjes së ambasadorëve që gjenden në Paris. Kjo do të merret me punët e vogla dhe për ato të mëdhatë do të mblidhen ngandonjëherë kryeministrat”; Arbër Hadri, *Presidenti Uillon dhe çështja shqiptare (Politika e SHBA-së në Konferencën e Paqes në Paris (1919-1920)*, botim i Institutit të Historisë Prishtinë: 2011, f. 175.

<sup>18</sup> *Lufta e popullit shqiptar për çlirim ...*, vëll. II, dok. 50, f. 64.

ankesave, të adresuara nga shqiptarët përkatësisht më 12 janar (Uillsonit), 14 janar (Lansingut) dhe 17 janar (Uollesit) dhe jugosllavët më 16 janar (Uollesit), e nxitë diplomacinë amerikane të vepronte. Duke u ndjerë e anashkaluar, ajo përmes Sekretarit të Shtetit, Lansing, u komunikoi Ll. Xhorxhit dhe Zh. Klemansosë, me anën e një memorandumit, se “Çështja e Adriatikut” nuk mund të definohej pa shprehur pikëpamjen e vet edhe SHBA-ja, përkatësisht presidenti Uillson<sup>19</sup>.

Përgjigjja justifikuese e evropianëve nuk u pëlqye nga amerikanët. Më 27 janar ata njoftuan se do të shpreheshin më tej për “Çështjen e Adriatikut” dhe nxitën delegacionin jugosllav të mos thyhej përballë ultimatumit për të miratuar projektin e 14 janarit<sup>20</sup>.

Ndoshta në dijeni të ankesës jugosllave të 16 janarit pranë ambasadorit amerikan Uolles, ndoshta nxitur dhe nga diplomacia jugosllave, më 17 janar sikurse u përmend, pasoi letra e L. Bumçit për Uollesin. Por pati nisma për të bashkërenduar ndonjë qëndrim me jugosllavët edhe jashtë ambienteve të Konferencës. Më 25 janar, Komiteti “MKK” në Shkodër mori vendim për të bërë përpjekje për bisedime me jugosllavët me qëllim që të dilej nga gjendja kritike në të cilën ndodhej çështja shqiptare. Në mbledhje të kryesisë së Komitetit ishte vendosur që kryetari i Komitetit, Kadri Prishtina dhe Bajram Fevziu të takoheshin fshehurazi “me partinë që do një marrëveshje me Jugosllavinë” për të marrë vesh “se mbi ç’baza dhe në çfarë kushtesh mund të arrihet marrëveshja me jugosllavët”<sup>21</sup>.

Në fund të janarit 1920, Komiteti “MKK” duke llogaritur të përfitonte nga kontradiktat italo-jugosllave rreth Shqipërisë, vendosi të hynte drejtpërdrejt në bisedime me përfaqësuesin e Beogradit, Nishiq. Baza mbi të cilën palët do të mund të merreshin vesh, sipas Komitetit, ishte: “E para - veç ndihmës që [Jugosllavia] do të japë për luftimet që do të bëjnë shqiptarët për ta nxjerrë Italinë nga Shqipëria e për ta shpëtue Vlonën, ç’interes mund t’u sigurojë shqiptarëve? E dyta - në rast se shqiptarët bajnë një shërbim, tue e nxjerrë Italinë nga Ballkani, serbët a e

<sup>19</sup> P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 453; Shih edhe Tomaso Titoni, Vuorio Scialoja, *L'Italia alla Conferenza della Pace*, Discorsi e documenti a cura di Amedeo-Gianini, Roma: 1921, f. 153-154.

<sup>20</sup> R. L. Woodal, *The Albanian problem during the Peacemaking (1919-1920)*, Memphis State University, Ph.d., 1978, f. 220; Shih edhe P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 454.

<sup>21</sup> AQSH, F. Komiteti “MKK”, D. 53. Vendim i Komitetit “MKK”, dt. 25 janar 1920; shih dhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim ...*, vëll. II, f. 51-52.

pranojnë në parim që Kosova të bashkohet me Shqipninë e si një qeveri me e shti në Konfederacionin Jugosllav?”<sup>22</sup>

Shqiptarët kërkonin një shteg shpëtimi. Hapat e ndërmarrë gjatë fundit të dhjetorit dhe gjatë janarit, që nga takimi i L. Bumçit me Papën<sup>23</sup>, deri te promemoret e adresuara për U. Uillonin, Zh. Klemansonë etj., para dhe pas kompromisit të përmendur të janarit, nuk kishin dhënë rezultat. Angazhimi i qarqeve të ndryshme të politikës shqiptare, për të bashkëpunuar me qarqet drejtuese të Beogradit, ku bënte pjesë edhe kryesia e Komitetit “MKK”, ishte një tentativë për të shfrytëzuar mungesën e konsensusit italo-jugosllav për zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut”, edhe pse diheshin rreziqet që sillte afrimi me Jugosllavinë. Forcat jugosllave me pretekstin e pranisë së forcave të armatosura italiane në Shqipëri mbanin “kufirin strategjik” në brigjet e Drinit të Zi, përtej vijës së caktuar nga Konferenca e Londrës në vitin 1913 dhe, hera-herës, depërtonin edhe më në brendësi të trevave shqiptare, sikurse ndodhi në fillim të janarit, kur u ripushtuan krahinat e Nikaj-Mërturit<sup>24</sup>, por alternativat e favorshme për zgjidhjen e duhur të çështjes shqiptare mungonin.

Duke ndjerë se situata në rajon kishte pasur një evoluim në favor të Jugosllavisë, veçanërisht pas nxitjes amerikane që ta kundërshtonin ofertën dhe ultimatumin franko-britanik, delegacioni jugosllav në Paris, më 28 janar hodhi poshtë kërkesat e Fuqive të Mëdha evropiane<sup>25</sup>. Madje për të fituar kohë Qeveria jugosllave dha dorëheqjen. Kështu në fund të janarit tentativat për zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut” u kthyen në pikën e nisjes. Sigurisht ishte qëndrimi i SHBA-së dhe këmbëngulja personale e U. Uillonit që, edhe pse shumë i sëmurë e pothuajse i paralizuar, nuk reshti së komunikuari me Lansingun dhe Polkun përmes së shoqes, që përcaktuan falimentimin e projektit franko-britanik të 14 janarit. Por, padyshim, luajtën rol edhe kundërshtimi këmbëngulës jugosllav dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare brenda vendit, që njëherësh iu kundërvu synimeve e veprimeve italiane, greke e jugosllave.

<sup>22</sup> AQSH, F. Komiteti “MKK”, D.8.

<sup>23</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 138.

<sup>24</sup> AQSH, F. DPB, D. 250, dok. 89. Njoftim i prefekturës së Shkodrës, dt. 26 janar 1920, për Delegacinë e Punëve të Brendshme, rreth ripushtimit të Nikaj-Mërturit nga ushtria serbe; shih edhe *Lufta e popullit...*, vëll. II, dok. 40, f. 53.

<sup>25</sup> Ivo Lederer, *La Jugoslavia della Conferenza della pace al Trattato di Rapallo (1919-1920)*, Milano: 1966, f. 266.

### **Kongresi i Lushnjës dhe përpjekjet e diplomacisë shqiptare në shkurt-mars 1920, për të penguar ricopëtimin e Shqipërisë**

Kongresi i Lushnjës, me vendimet e rëndësishme të njohura, që mori, është dëshmia më e plotë për evoluimin e situatës në Shqipëri. Ndër aktet e para që miratoi ky Kongres ishte telegrami që i dërgoi më 30 janar Konferencës së Paqes, në të cilin protestohej kundër vendimit të marrë nga Britania e Madhe, Franca dhe Italia, për copëtimin e Shqipërisë midis Jugosllavisë, Greqisë dhe Italisë<sup>26</sup>. Në vijim, në telegram theksohej se Kuvendi kërkonte për Shqipërinë “një pavarësi të plotë me kufijtë etnografikë dhe natyralë, duke korrigjuar kështu padrejtësitë që janë bërë nga Kongresi i Berlinit dhe nga Konferenca e Ambasadorëve më 1913”. Theksohej gjithashtu se “Kuvendi vendosi të mos pranojë asnjë mandat ose protektorat të huaj”<sup>27</sup>. Në paragrafin e fundit të tekstit të telegramit dëshmohej vendosmëria për vendimet e marra. “Shqiptarët janë të gatshëm të bëjnë të gjitha sakrificat, thuhej në telegram, të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut të tyre kundër çdo vendimi që mund të verë në rrezik tërësinë tokësore dhe pavarësinë e tyre të plotë”<sup>28</sup>.

Në të njëjtën ditë, më 30 janar, Kongresi i Lushnjës, i drejtoi një protestë të ngjashme edhe Senatit italian. Në të shprehej zemërimi kundër planeve antishqiptare në Konferencën e Paqes dhe njëkohësisht vendosmëria për të mbrojtur me çdo kusht të drejtat kombëtare<sup>29</sup>. “Lajmi i frikshëm... ndezi kudo zemërimin e tërbuar dhe mërinë e shenjtë të popullit shqiptar, theksohej në protestën drejtuar Senatit italian, Kuvendi i kombit i mbledhur në Lushnje... i dha fund me një zë t’u thotë përfaqësuesve të ndershëm të Italisë se në dejtë e popullit shqiptar s’ka pushuar akoma së lëvrituri gjaku i kulluar i Skënderbeut, që të mundin pra stërnipat e tij të ulnin kokën e të poshtërohen, aq sa të bëhen një koloni e përvuajtur italiane e të përdoren si shpërblim për të ngopur lakmitë imperialiste të fqinjëve të tyre lakmonjës; ...shqiptarët dinë të vdesin për të mos shkuar nga njëra dorë në tjetrën si tufë delesh, e të bëhen plaçka e atyre që drejtojnë sot diplomacinë e Evropës”<sup>30</sup>.

<sup>26</sup> AQSH, F. MPJ, D. 7. Telegrami i firmosur nga kryetari i Kuvendit Kombëtar të Shqipërisë, Aqif pashë Elbasani, dt. 30 janar 1920; shih edhe *Lufta e popullit...*, vëll. II, dok. 46, f. 58-59.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> *Kuvendi*, Romë, viti III, nr. 70, 21 shkurt 1920, f. 3.

<sup>30</sup> Po aty.

Më 31 janar, Aqif pashë Elbasani, në emër të Kongresit të Lushnjës, informoi për vendimet e marra edhe presidentin e SHBA-së, Uillson dhe, me një telegram të dytë, Kongresin Amerikan. Në këto telegrame kërkohej mbështetja e fuqisë përtej Atlantikut për të shpëtuar pavarësinë e Shqipërisë dhe integritetin e saj territorial. Një telegram tjetër i adresoi U. Uillsonit edhe kryeministri Sulejman Delvina, i porsazgjedhur nga Kongresi i Lushnjës. Telegramet nga Lushnja shkuan gjithashtu në drejtim të kryeqyteteve të Fuqive të tjera të Mëdha<sup>31</sup>.

Në emër të delegacionit shqiptar, telegrame për presidentin e SHBA-së dhe Kongresin Amerikan, dërgoi nga Parisi edhe L. Bumçi<sup>32</sup>.

Për njohjen e opinionit publik botëror dhe të qarqeve politike të Fuqive të Mëdha, posaçërisht të SHBA-së, Italisë etj., me vendosmërinë e shfaqur në Shqipëri për të mos pranuar vendimet e Konferencës së Paqes në dëm të popullit shqiptar, shërbyen në këtë kohë një mori protestash, thirrjesh e deklaratash të nisura nga kolonitë shqiptare dhe nga miqtë e Shqipërisë.

Në telegramin e Kryesisë së kolonisë shqiptare të Rumanisë, dërguar Senatit të SHBA-së, kërkohej prej tij të dëgjohej thirrja e “dëshpëruar për të ndaluar një krim të tillë kundër popullit të lashtë shqiptar, pavarësia e të cilit u njoh më parë në Londër më 1913”<sup>33</sup>.

Më 29 janar, Edit Durham shkruante në gazetën, që botohej në Londër, “Daily Herald”, se Fuqitë Aleate në Paris “ndodhen në pikën e kryerjes së një krimi ndërkombëtar, të vjedhjes së pavarësisë së një vendi të vogël”<sup>34</sup>. Kurse, më 12 shkurt Komiteti i punëtorëve shqiptarë në SHBA dhe në Kanada, në një letër drejtuar Komitetit drejtues të Partisë Socialiste Italiane, i bënte thirrje të luftonte kundër synimeve imperialiste të qeverisë italiane ndaj Shqipërisë. Pasi vinte në dukje apatinë dhe mosangazhimin e socialistëve italianë për t’i prerë rrugën “marrëzisë ekspansioniste, etjes për pushtime të imperializmit italian”, letra përfundonte se të ngresh zërin kundër “krimit të përbindshëm që po bën Qeveria italiane e Romës, do të thotë ... t’i shërbesh më shumë sesa Shqipërisë, demokracisë dhe Italisë”<sup>35</sup>.

<sup>31</sup> P. Milo, *Politika e jashtme ...*, vëll. I, f. 456.

<sup>32</sup> *Po aty*, Telegrame të dt. 30 janar 1920.

<sup>33</sup> AQSH, F. Kolonia e Rumanisë, D.125; shih edhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim ...*, vëll. II, dok. 51, f. 67.

<sup>34</sup> AMPJ, viti 1920, dos. 34, f. 127.

<sup>35</sup> AQSH, F. MPJ, D. 322. Letër e dërguar nga Lozana më 12 shkurt 1920, në emër të Komitetit të punëtorëve shqiptarë në SHBA dhe Kanada.

Jo të gjithë e morën seriozisht reagimin e shqiptarëve, publikuar përmes përfaqësuesve të tyre në Lushnje, Paris apo nga kolonitë e diasporës. Por, në qarqet më të interesuara për zgjidhje sa më realiste të çështjeve të Ballkanit, zëri i shqiptarëve nuk kaloi pa jehonë. Në rrethanat komplekse, kur kishin reaguar edhe jugosllavët dhe kur SHBA-ja ndihej e fyer nga anashkalimi i aleatëve evropianë në marrjen e vendimeve për “Çështjen e Adriatikut”, presidenti amerikan U. Uillson, më 10 shkurt u ktheu përgjigje kolegëve evropianë për memorandumun e tyre të 23 janarit. Ai theksonte si zgjidhjen më të mirë Memorandumin e 9 dhjetorit 1919 dhe kundërshtonte kompromisin e 14 janarit 1920, që i siguronte Italisë sovranitet në Fiume dhe në Istria. Për sa i përket Shqipërisë, Uillsoni i qëndronte pikëpamjes se Memorandumi i 9 dhjetorit “ruan në një masë të gjerë unitetin e shtetit shqiptar”, kurse kompromisi i 14 janarit “e ndan popullin shqiptar midis tri fuqive të huaja pavarësisht nga protestat e tij të fuqishme”<sup>36</sup>. Presioni i SHBA-së dukej qartë, kur u kujtonte kolegëve evropianë se Memorandumi i 9 dhjetorit ishte caku i koncesioneve që mund të ofronin amerikanët<sup>37</sup>.

Ndërkohë që shkëmbimi i pikëpamjeve të kundërta midis amerikanëve dhe evropianëve për “Çështjen e Adriatikut” e, në kuadër të saj, për çështjen shqiptare, do të vijonin gjatë shkurtit të vitit 1920 dhe më pas<sup>\*</sup>; shqiptarët brenda dhe jashtë Shqipërisë bënë të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur rrezikun e asgjësimit të atdheut. Gjatë shkurtit 1920 një varg protestash të tjera pasuan ato të janarit. Në një protestë të fillimit të shkurtit, dërguar Komandës italiane në Durrës, Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës kërkonte të mos pengohej vendosja e saj në Durrës<sup>38</sup>. Më 3 shkurt përfaqësuesit e kolonive shqiptare të Rumanisë dhe të Turqisë, që ndodheshin në Paris, i kërkonin kryetarit të delegacionit qeveritar shqiptar aty, që një pjesë e anëtarëve të tij të kthehej në Shqipëri për të informuar popullin mbi projektet e hartuara në Konferencën e Paqes për copëtimin e vendit “me qëllim që

<sup>36</sup> Adriaticus, *La Question Adriatique*, Recueil de documents officiels, Paris: 1920, f. 123-129; T. Tittoni, V. Scialoja, *L'Italia alla Conferenza della Pace* ..., f. 157-161.

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>\*</sup> Përgjigje e dr. Lloid Xhorxhit dhe A. Mileranit e 17 shkurtit; reagimi i U. Uillsonit i 25 shkurtit; kundërpërgjigja e franko-britanikëve e 26 shkurtit, etj.; Shih Adriaticus, *La question Adriatique*..., f. 130-133, 138-144, 145-147; Shih edhe Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit* (Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik), vëll. II, Tiranë: 8 Nëntori, 1987, dok. 24, f. 148-250, dok. 25, f. 250-253, dok.26, f. 254-255.

<sup>38</sup> AQSH, F. Prefektura e Durrësit, D. 1; Shih edhe *Lufta e popullit* ..., dok. 56, f. 70.

vetë populli të mund të shprehë mendimin e vet dhe të veprojë si duhet”<sup>39</sup>.

Nga letra bëhet e qartë se qysh në një mbledhje të organizuar më 21 janar ishte miratuar vendimi që delegacioni të zvogëlohej në tre vetë dhe të tjerët do të duhej të niseshin sa më shpejt në Shqipëri për të sqaruar popullin mbi situatën e vështirë të krijuar nga politika e Fuqive të Mëdha. “Mirëpo, thuhej në letër, na duket se një vendim i tillë nuk është marrë parasysh. Përpara një ngurrimi të tillë dhe këtyre shtyrjeve me sot e me nesër, në çastin më vendimtar dhe më kritik në të cilën ndodhet Shqipëria, e quajmë për detyrë, theksonin përfaqësuesit e kolonive, t’i parashtrijmë vëmendjes suaj se një qëndrim i tillë mund të ketë pasojë shumë të dëmshme për vendin tonë...”<sup>40</sup>.

Nuk dimë nëse delegacioni shqiptar në Paris me L. Bumçin, M. Konicën dhe M. Turtullin në përbërje kishte dijeni për qëndrimin e presidentit amerikan pasqyruar në përgjigjen për kryeministrat e Britanisë së Madhe dhe Francës, të dt. 10 shkurt 1920, lidhur me memorandumun e tyre të 23 janarit. Sidoqoftë ai tashmë ishte nën presion gjithnjë e më të madh të përfaqësuesve të kolonive të diasporës shqiptare dhe të ngjarjeve politike në Shqipëri.

Pavarësisht nga faktorët nxitës, delegacioni shqiptar më 11 shkurt tentoi sërish të ndikonte te Fuqitë e Mëdha. Në këtë datë ai i dërgoi një telegram të ri kryeministrit britanik D. Llojd Xhorxh, njëherësh kryetar i Konferencës së tre kryetarëve të qeverive aleate, që vepronte në Londër në vijim të punëve të Konferencës së Paqes të Parisit të mbetura për t’u zgjidhur. Në telegram kërkohej të hiqej dorë nga plani për copëtimin e Shqipërisë dhe për asgjësimin e pavarësisë së saj<sup>41</sup>. Pasi përsëriste argumentet që provonin të drejtat e shqiptarëve për t’u vetëqeverisur, për të mbrojtur pavarësisë dhe për të mos lejuar prekjen e kufijve të tyre, nga fqinjët që kishin pasur “gjithnjë qëllime aneksioniste” e që “s’kishin lënë salvime e rrëime pa kryer”, delegacioni theksonte: “*Po i drejtohem pra për herën e mbrame edhe një thirrje të nxehtë ... kryeqeveritarëve të tri kombeve të mëdha ... që në zgjidhjen e çështjes shqiptare të mos pranojnë masa të tjera përveç atyre që përkojnë me drejtësinë e me vullnetin e*

<sup>39</sup> AQSH, F. MPJ, D.2. Letër e dt. 3 shkurt 1920, firmosur nga Pandeli Evangjeli për koloninë e Bukureshtit dhe Halil Gjirokastra për koloninë e Turqisë; shih edhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim ...*, vëll. II, dok. 59, f. 72-73.

<sup>40</sup> Po aty.

<sup>41</sup> *Shqipnia përpara Konferencës së Paqes*, Ble i Dytë, Shkodër: Shtypshkronja Franceskane, 1921, f. 65-67.

*popullit shqiptar...*<sup>42</sup>. Në telegram tërhiqej vëmendja se shqiptarët besonin në aftësitë e tyre për t'u vetëqeverisur dhe ndihmën e kërkonin "të kufizohet vetëm në dërgimin në Shqipëri të disa ekspertëve civilë e ushtarakë të caktuar prej Shoqërisë së Kombeve por që të mos jenë prej shteteve të interesuar". Vetëm zgjidhja e drejtë e çështjes shqiptare, shkruanin në fund të telegramit delegatët shqiptarë, do t'i shërbente "forcimit të paqes në Ballkan dhe sigurimit të së mbarës e së mirës për të gjithë popujt që rrojnë aty"<sup>43</sup>.

Në të njëjtën ditë, më 11 shkurt, delegacioni shqiptar, përsëri me firmën e kryetarit L. Bumçi i dërgonte një notë proteste përfaqësuesve të fuqive kryesore evropiane, me anën e së cilës hidhte poshtë pretendimin e përsëritur se populli shqiptar ishte "i papjekur" për vetëqeverim. "Me notat e 15 dhe 19 janarit, theksonte L. Bumçi, delegacioni shqiptar pati rastin të protestojë para Konferencës së Paqes kundër projektit të [14 janarit] hartuar nga tri Fuqitë e Mëdha, lidhur me zgjidhjen e "Çështjes së Adriatikut", projekt që parashikon copëtimin e Shqipërisë.... i cili është në kundërshtim flagrant me klauzolat e Konferencës së Londrës të vitit 1913..."<sup>44</sup>.

Nota e sipërpërmendur jepte gjerësisht argumentet përse duhej ndryshuar qëndrimi në zgjidhjen e çështjes shqiptare. Aty përmendeshin këmbëngulja italiane, e pamotivuar realisht, për të aneksuar Vlorën dhe për të marrë mandatin mbi Shqipërinë, mandej shkatërrimet që kishte sjellë pushtimi i përkohshëm i trupave jugosllave e greke në viset që pretendonin për t'i aneksuar Beogradi e Athina.

Te argumentet e karakterit "moral", sikurse shënohej në notë, numërohej edhe shkëlja e dispozitave ligjore të Lidhjes së Kombeve (neni 220), lidhur me kriteret që përcaktonin vendosjen e një popullit nën mandat.

Në notën e 11 shkurtit, adresuar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha, delegacioni shqiptar nënvizonte edhe argumentet politike, për të cilat duhej respektuar pikëpamja shqiptare për zgjidhjen e çështjes. Ndër to renditej ruajtja në të ardhmen e paqes në Ballkan, dhe për pasojë paqes në mbarë botën.

<sup>42</sup> Po aty.

<sup>43</sup> Po aty.

<sup>44</sup> AQSH, F. MPJ, D. 6(26). Notë e delegacionit shqiptar, dt. 11 shkurt 1920, dërguar Mileranit, kryeministër dhe ministër i Jashtëm i Francës. Nga përmbajtja e notës ajo është përgatitur e dërguar edhe krerëve të Fuqive të tjera të Mëdha evropiane.



Duke arsyetuar përse Shqipëria nuk kishte pasur stabilitet në vitet pas krijimit të saj, çka kishte frymëzuar mendimin se shqiptarët nuk ishin të zot të vetadministroheshin delegacioni shqiptar numëronte gjashtë faktorë. Sipas tij, Shqipëria pas krijimit, edhe në kufijtë e përcaktuar në Londër, nuk ishte zbrazur kurrë nga ushtritë e huaja, të cilat me terror të vazhdueshëm kishin shkatërruar vendin e kishin sjellë destabilitet. Përveç ballkanasve në këtë drejtim kishte ndikuar edhe rivaliteti midis Austro-Hungarisë dhe Italisë për dominim, që kishin sjellë përçarje me propagandën e zhvilluar në Shqipëri. Presioni i tyre mbi Princ Vidin dhe qeverinë e tij e kishte paralizuar qeverisjen efikase të vendit dhe kishte rrënuar autoritetin e kryetarit të shtetit. Për të njëjtën gjë kishte ndikuar edhe veprimtaria e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, arsyetonte në notë delegacioni shqiptar, pasi anëtarët e tij u pozicionuan sipas interesave të kundërta të shteteve që përfaqësonin.

Tejkalimi i kompetencave nga kreu i misionit të oficerëve holandezë dhe mosbindja e tij ndaj urdhrave të qeverisë, theksohej më tej në notë, ishte gjithashtu faktor që kishte ndikuar në destabilitetin e vendit. Përmendej gjithashtu, edhe ndikimi negativ që përcolli mosrealizimi i premtimit që Fuqitë e Mëdha i bënë shtetit të ri, për ta kredituar me një hua prej 70 milionë frangash. “Shkurt, në të tilla kushte të mjerueshme u ndodh Shqipëria në çastin kur shpërtheu, Lufta Botërore, që pati si pasojë dhunimin e asnjësisë dhe pushtimin e territorit të saj nga ushtritë e huaja, shprehej delegacioni shqiptar. Çdo vend tjetër, që do të ndodhej në hapin e parë të jetës së tij politike në të tilla kushte, nuk kishte si t’u shpëtonte pasojave të hidhura ...”<sup>45</sup>

Së fundi, delegacioni shqiptar i lutej Fuqive të Mëdha, t’i kishin parasysh faktet e paraqitura para se t’i konsideronin shqiptarët “të paaftë të vetëqeverisen” dhe para se të vendosnin “të dënojnë një popull të tërë të humbë pavarësinë dhe kombësinë e tij”. Nota përfundonte me konstatimin se “e vetmja mënyrë për të ruajtur paqen në Ballkan dhe rendin e qetësinë në Shqipëri, është dhënia e pavarësisë ... ruajtja e tërësisë së saj tokësore ... zbrazja e plotë... e tokave të saj nga ushtritë e huaja, si edhe ripohimi i asnjësisë së Shqipërisë, duke e garantuar atë nga Lidhja e Kombeve ...”<sup>46</sup>

Nota, sikurse shihet, nuk përmbante elementë të rinj të paparaqitur më parë, por çështja kishte hyrë në një rreth vicioz dhe delegacionit shqiptar nuk i ngelej veçse të këmbëngulte, duke shpresuar

<sup>45</sup> Po aty.

<sup>46</sup> Po aty.

në mosmarrëveshjen italo-jugosllave dhe veçanërisht në diskordancën e diplomacisë amerikane me atë të tre Fuqive të Mëdha të Evropës.

Më 11 shkurt 1920, anëtarët e delegacionit zyrtar shqiptar në Paris, L. Bumçi dhe M. Turtulli, dërguan edhe një raport tjetër, këtë herë në adresë të Aqif pashë Elbasanit. Përmes tij ata informonin për situatën në të cilën ndodhej çështja shqiptare për momentin<sup>47</sup>.

Në raport theksohej se Konferenca e Paqes nuk e pati biseduar kurrë çështjen shqiptare në mënyrë të veçantë, por të lidhur me çështje të tjera, duke e trajtuar si një mjet shpërblimi për të sheshuar mosmarrëveshjet midis fqinjëve të Shqipërisë. Rreth një vit, raportonin më tej L. Bumçi e M. Turtulli, u kapërcyen disa herë rreziqe të mëdha, por deri kohët e fundit nuk ishte marrë ndonjë vendim.

Gjatë kësaj periudhe, delegacioni sipas raportuesve, kishte vepruar gjithnjë në mbrojtje të të drejtave të kombit shqiptar, të përmbledhura në kërkesat për integritetin brenda kufijve etnikë, në independencën dhe në sovranitetin e vendit. Në raport këmbëngulej se, delegacioni “nuk kishte pranuar kurrë as ma të voglin lëndim (cenim - M. V.) të këtyne të drejtave”<sup>48</sup>.

Delegatët, raportonin më tej, se situata ndryshoi pas Memorandumit të SHBA-së, Britanisë dhe Francës, të 9 dhjetorit 1919, paraqitur Italisë si opsion për zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut” e në kuadër të saj edhe të çështjes shqiptare. Duke i dërguar Aqif Pashës në zarin që përmbante raportin edhe kopjen e Memorandumit, të cilin dr. Turtulli e kishte siguruar prej delegatit jugosllav Trumbiq, dy delegatët shënonin se pikërisht me Memorandumin në fjalë tri Fuqitë e Mëdha i njihnin Italisë pushtimin dhe sovranitetin mbi qytetin dhe krahinën e Vlorës si edhe mandatin mbi Shqipërinë. Pasi trajtonin përfitimet që siguronte Jugosllavia e Greqia nga Memorandumi i 9 dhjetorit (përkatësisht për të parën, e drejta e daljes tregtare në Shqipërinë e Veriut, kurse për të dytën aneksimi i trevës së Gjirokastrës dhe diskutimi për Korçën), L. Bumçi dhe M. Turtulli i vinin në dukje Aqif Pashës se, lidhur me kufijtë jugorë dhe veçanërisht me rivënien në diskutim të fatit të Korçës, deri para disa ditësh u kishte munguar informacioni.

Në mbledhjet e mbajtura fillimisht në Londër e pastaj në Paris, krerët e Britanisë, Francës dhe Italisë, thuhej më tej në raport, nuk e

<sup>47</sup> AQSH, F. MPJ, D.8 (26). Raport i L. Bumçit dhe M. Turtullit, dt. 11 shkurt 1920, dërguar nga Parisi Aqif Pashë Elbasanit; shih edhe *Lufta e popullit...*, vëll. II, dok, 68, f. 86-87.

<sup>48</sup> *Po aty*.

morën parasysh Memorandumin e 9 dhjetorit dhe preferuan një projekt të 13 janarit, të përgatitur nga D. Llojd Xhorxhi, i cili vendoste për copëtimin e Shqipërisë<sup>49</sup>.

Për sa i përket qëndrimit të Jugosllavisë, theksohej se ishte kundër projektit të 13 janarit, por ajo njëherësh i përmbahej idesë që, nëse Shqipëria copëtohej, do të kërkonte pjesë, madje nuk do të kënaqej me territorin deri në lumin Drin, por do të donte “edhe ma tepër”.

L. Bumçi dhe M. Turtulli vinin në dijeni Aqif Pashën, se eksperti i delegacionit britanik, Liper, më 22 janar u kishte thënë atyre dhe Mehdi Frashërit, që të bëhej një kërkesë, sipas së cilës Korça e Shkodra të mos aneksoheshin nga Greqia e Jugosllavia, “por të liheshin nën mandatin e këtyre mbretërive”. Ndërkohë, eksperti amerikan Harrison, të cilin e kishin pyetur për këtë çështje i kishte këshilluar jo zyrtarisht që mos lëviznin nga qëndrimi i parë dhe të mos pranonin asnjë lëshim ndaj tërësisë së vendit. Më vonë edhe eksperti italian Kastoldi u kishte thënë se Italia ishte gati të bënte disa lëshime në interes të Shqipërisë, që t’i detyronte edhe fqinjët e tjerë të hiqnin dorë nga kërkesat e tyre, por ata nuk i besonin pa marrë siguri nga qëndrime zyrtare. Raportuesit i dërgonin Aqif Pashës, bashkëngjitur me raportin, edhe notën e 11 shkurtit dërguar kryeministrave të tre Fuqive të Mëdha, që ishin mbledhur përsëri në Londër.

Rreth dy javë më vonë më 29 shkurt L. Bumçi dhe M. Turtulli i raportonin sërish Aqif pashë Elbasanit rreth bisedimeve të fundit për çështjen shqiptare<sup>50</sup>. Në këtë letër dy delegatët pranojnë se kanë dijeni për vendimet e Kongresit të Lushnjës, nga një letër e dërguar më 28 janar 1920 nga Eshref Frashëri, zëvendëskryetari i qeverisë së dalë nga Kongresi, por që atyre ajo u kishte mbërritur më 16 shkurt. Kjo do të thotë se ata e dinin nga data 16 shkurt se ishin zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës, anëtarë të Këshillit të Lartë\*. Gjithashtu e dinin se kolegu i tyre Mehmet Konica, i cili ndodhej në Londër, ku ishte zhvendosur trojka e të Mëdhenjve të Evropës për të diskutuar çështjet e mbetura ende nga Konferenca e Parisit, ishte emëruar ministër i Jashtëm dhe se për të tre ata ishte vendosur se duhej të qëndronin aty ku ishin, për të mbrojtur çështjen shqiptare.

<sup>49</sup> Po aty. Bashkëngjitur raportit, Aqif Pashës i dërgohej, krahas Memorandumit të 9 dhjetorit, edhe projekti i 13 janarit, sipas versionit të botuar në gazetën “Le Temps”.

<sup>50</sup> AQSH, F. MPJ, D.5 (26). Letër e L. Bumçit dhe M. Turtullit, dt. 25 shkurt 1920 për Aqif Pashën; shih edhe *Lufia e popullit...*, vëll. II, dok. 94, f. 132-133.

\* Përbëhej nga Aqif Pashë Elbasani, imzot Luigj Bumçi, dr. Mihal Turtulli dhe Abdi bej Toptani.

Është disa e paqartë përse në letrën e datës 25 shkurt flitet për njoftime të marra nga letra e dt. 28 janar e Eshref Frashërit kur vendimet e sipërpërmendura të Kongresit të Lushnjës i përkasin datave 30 dhe 31 janar. Gjithashtu duket e çuditshme që vendimet e Kongresit t'u kenë mbërritur vetëm përmes kësaj letre që udhëtoi për dy javë.

Gjithsesi, përmes prononcimit të dy delegatëve, që e përfundojnë letrën adresuar Aqif Pashës duke paraqitur vendimin e tyre “të premë e të patundshëm” për dorëheqjen si delegatë të Shqipërisë në Konferencën e Paqes dhe lutjen “për të emnue sa më shpejt delegatë të tjerë”<sup>51</sup>, krijohet përshtypja se ata e konsideronin të mbyllur misionin e tyre diplomatik në Paris, ku kishin shërbyer në emër të qeverisë së mëparshme të Durrësit, por, ndoshta, edhe për faktin se Konferenca e Paqes e Parisit tashmë ia kish lënë vendin takimeve të Trojkës së kryeministrave evropianë në Londër, Konferencës së Ambasadorëve në Paris dhe veprimtarisë së Lidhjes së Kombeve.

Në letrën e 25 shkurtit, L. Bumçi dhe M. Turtulli theksonin ndër të tjera se kishin vepruar në përputhje, “një me një, me programin e vendosur prej mbledhjes së Lushnjës” dhe se në “këtë udhë do të vijojmë për sa kohë do të mbetemi këtu”. Më tej ata informonin për bisedimet që po zhvilloheshin në Londër midis kryeministrave të Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë dhe për dy nota që presidenti i SHBA u kishte dërguar partnerëve evropianë<sup>52</sup>. Të informuar me sa duket prej M. Konicës, që ndodhej në Londër, L. Bumçi dhe M. Turtulli i bënin të ditur Aqif Pashës se nota e parë përmbante kundërshtimin amerikan për shkeljen nga franko-britanikët të Memorandumit të përbashkët të 9 dhjetorit 1919. Por, shpreheshin dy delegatët shqiptarë, “dhantë zoti, u baftë ndonjë ndryshim me rranjë, pse edhe zgjidhja e parapame prej mendores së përmendun, e që ka pëlqimin e Amerikës, Shqipërisë i sjell dëm të madh”<sup>53</sup>.

Konferenca e Paqes pas një viti veprimtarie, i mbylli punimet në Paris pa i përfunduar të gjitha çështjet që duhet të zgjidhte. Konferenca e kryeministrave të tri Fuqive të Mëdha evropiane, e mbledhur për çështjet kryesore në Londër e San Remo, dhe Konferenca e Ambasadorëve në Paris, do të vijonin të merrnin vendime. Do të duhej të angazhoheshin më tej, ndër të tjera, edhe për çështjen shqiptare, apo vargun e problemeve të ndryshme të saj. Do të angazhohej gradualisht edhe Lidhja e Kombeve.

<sup>51</sup> *Po aty*.

<sup>52</sup> Owen Pearson, *Albania and King Zog, Independence, Republic and Monarchy (1908-1939)*, The Centre for Albanian Studies, London: 2005, f. 141.

<sup>53</sup> *AQSH*, F. MPJ, D. 5 (26). Letra e L. Bumçit dhe M. Turtullit, dt. 26 shkurt 1920.

Çështja shqiptare do të trajtohej në këto instanca edhe për disa muaj, madje ndonjë problem edhe për disa vjet, por kjo periudhë nuk është objekt i këtij artikulli.

Shkurtimisht mund të përmendet se delegacioni shqiptar në Paris, tashmë përfaqësues i qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, i vijoi përpjekjet për një zgjidhje sa më të drejtë të çështjes shqiptare. Në këtë kuadër nuk u ndalën takimet, dërgimi i telegrameve, letrave, notave e memorandumëve ndaj përfaqësuesve të fuqive botërore vendimmarrëse.

Në një letër të datës 24 shkurt 1920, dërguar nga Parisi kryeministrit të Britanisë së Madhe, njëherazi kryetar i Konferencës së tre kryetarëve të qeverive aleate në Londër, D. Lloid Xhorxhit, kryetari i delegacionit shqiptar L. Bumçi, e vinte në dijeni mbi mbledhjen e Kongresit të Lushnjës dhe vendimet e tij.

Më 2 mars 1920 pasoi një notë në adresë të presidentit të SHBA-së<sup>54</sup>. L. Bumçi këtë herë shprehej kundër zgjidhjes që Memorandumi i 9 dhjetorit 1919, i iniciuar nga diplomacia amerikane, i jepte çështjes shqiptare. Në telegram, shkruhej se delegacioni shqiptar shprehte “përshtypjen e tij të hidhur lidhur me planin për t’i dhënë Gjirokastrën Greqisë dhe për të vënë në diskutim trevën e Korçës”. Pasi bënte prezantimin e përkatësisë etnike dhe fetare të rajonit në fjalë, tashmë të përsëritur shpeshherë, se ndër 290 mijë banorë, 170 mijë ishin shqiptarë myslimanë dhe të tillë ishin edhe shumica e 120 mijë të krishterëve, nota theksonte se “provincat në fjalë ishin njohur si shqiptare nga Konferenca e Londrës më 1913”, madje ishin pranuar si të tilla edhe nga ish ministrat grekë Zografos e Karapanos, në Konferencën e organizuar më 1914 në Korfuz, në prani të Komisionit Ndërkombëtar<sup>55</sup>. Prandaj nënvizohej në notë, kalimi i tyre nën sovranitetin grek, do të sillte “skllavërimin e së paku dyqind mijë shqiptarëve”, që do të futeshin “nën zgjedhën e padurueshme të grekëve”.

Duke e konsideruar të padrejtë copëtimin e shumë viseve shqiptare më 1913 dhe pasojat përreth një milion banorëve shqiptarë të tyre, L. Bumçi në notën e 2 marsit nënvizonte se po të ndodhnin cungime të tjera “saktifikat e imponuara Shqipërisë do të ishin vdekjeprurëse”.

<sup>54</sup> Po aty, Notë e delegacionit qeveritar shqiptar në Paris, dt. 2 mars 1920 për presidentin e SHBA; shih edhe *Lufta e popullit ...*, vëll. II, dok.102, f. 139-140.

<sup>55</sup> Është fjala për bisedimet që filluan në Korfuz, më 9 maj 1914, midis Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, të autorizuar nga Qeveria shqiptare, dhe përfaqësuesve të “Lëvizjes së Vorio-Epirit”, që përfunduan më 17 maj 1914 me nënshkrimin e Protokollit të Korfuzit.

Përfaqësuesit shqiptarë në Paris e dinin se diplomacia amerikane, duke firmosur Memorandumin e 9 dhjetorit 1919, ishte pajtuar me humbjen e Gjirokastrës në favor të Greqisë dhe me diskutimin e të ardhmes së Korçës, prandaj ofronin një gjetje, apo formulë të re kompromisi. “Shteti shqiptar është gati t’u njohë popullsisve të këtyre viseve, nën garancinë dhe mbikëqyrjen e Lidhjes së Kombeve, të gjitha të drejtat që u përkasin bashkësive etnike ose që kanë të bëjnë me besimet e tyre”<sup>56</sup> shkruhej në notën e 2 marsit. Më tej atje ripërsëritej, apo i ritërhiqej “vëmendja dashamirëse” presidentit Uillson, se aneksimi i Vlorës dhe krahinës së saj nga Italia ishte “në kundërshtim me të drejtën dhe vullnetin e popullit shqiptar, që u shpreh në mënyrën më të qartë edhe një herë në Asamblenë Kombëtare të Lushnjës më 28 të janarit ...”. Propozimi i delegacionit shqiptar për sa i përkiste ndërtimit të hekurudhës në Shqipërinë e Veriut që do t’i shërbente Jugosllavisë, konsistonte në ndërtim nga shteti shqiptar me kapitale të huaja, kurse përdorimin e lirë të saj do ta garantonte Lidhja e Kombeve<sup>57</sup>.

Një ditë më pas, më 3 mars, L. Bumçi së bashku me M. Turtullin i nisën një letër tjetër Aqif Pashës, me të cilën e njoftonin për gjendjen në të cilën ndodhej çështja shqiptare në atë moment në optikën e Fuqive të Mëdha. Fillimisht ata e informonin se ishin “tue vazhdue gjithnjë në punë” dhe do të vijonin të punonin derisa të emëroheshin zëvendësit e tyre. Më tej i dërgonin notat e shkëmbyera midis Uillsonit dhe Ll. Xhorxhit e A. Milerandit, të cilat ato ditë ishin botuar nga media. Në tekstin e letrës duket qartë zhgënjimi i thellë, që u kishte sjellë Konferenca e Paqes, me mënyrën sesi i kishte nëpërkëmbur interesat e Shqipërisë e të kombit shqiptar, deri me diskutimet dhe projektet më të fundit. “Sikurse keni për ta pa edhe ju vetë, shkruanin dy delegatët, dyshimet dhe frikën që rrokull një vjetë kemi pasë mbi qëllimet e liga të qeverive të mëdha kundër nesh, po vërtetohen mjerisht, një nga një të gjitha”<sup>58</sup>.

Trajtimi i çështjes shqiptare në projektin apo kompromisin e 14 janarit 1920, theksonin më tej dy delegatët, ishte vazhdë e qëndrimit të Francës dhe Britanisë së Madhe, që nga marsi i vitit 1919. Qysh atëherë Parisi dhe Londra kërkonin t’i kalonte Greqisë, Korça dhe Gjirokastra.

<sup>56</sup> Po aty.

<sup>57</sup> Po aty.

<sup>58</sup> AQSH, F. MPJ, D. 5 (26). Letër e L.Bumçit dhe M.Turtullit për Këshillin e Lartë (Aqif Pashën), dt. 3 mars 1920; shih edhe *Lufta e popullit ...*, vëll.II, dok. 103, fl. 141-143.

Por, Shqipëria pësonte edhe nga Memorandumi i 9 dhjetorit 1919, firmosur nga dy fuqitë e sipërpërmendura dhe SHBA-ja. Humbja e Gjirokastrës dhe Vlorës, vënia në diskutim e Korçës dhe caktimi i mandatit etj., gjithashtu do të ishin katastrofë për Shqipërinë. Por, notat e fundit midis krerëve të shteteve të sipërpërmendura, të cilat e trajtonin çështjen midis këtyre dy opsioneve, tregojnë se për ne situata mbetet “fort e rrezikshme”, konkludonin L. Bumçi dhe M. Turtulli. Gjithsesi, arsyetonin ata, “mbasi nuk kemi tjetër mbrojtje përveç Z. Uillon, nuk kemi mund të kundërshtohemi drejt projektit të tij; po jemi përpjekë që t’i japim të kuptojë se sipas atij projekti Shqipëria do të futet nën zgjedhë të huaj”<sup>59</sup>.

Dy delegatët informonin gjithashtu se po bënë të pamundurën të lobonin “me të gjitha mënyrat pranë miqve të paktë”, që mund të gjendeshin. Ishte fjala për personalitete të jetës publike e politike të Francës e të Britanisë, dashamirës të kombit shqiptar, ose miq personalë të tyre “që merren me punët e Ballkanit”. Nesër do të duhet të shkojmë në Londër për pak ditë, informonin më tej L. Bumçi dhe M. Turtulli, “që të veprojmë në mes të qarqeve politike angleze me anën e miqve që kemi atje e të kardinalit të Londrës”<sup>60</sup>.

Të bën përshtypje fakti, se me gjithë kushtet e vështira në të cilat vepronin, delegatët shqiptarë arrinin të siguronin një informacion të vlefshëm mbi hapat që ndërmerre diplomacia e Fuqive të Mëdha për çështjen shqiptare. “Konferenca e Londrës, ndërmjet kryetarëve të tri qeverive të besëlidhuna po vijon gjithnjë, i shkruanin ata Aqif Pashës; disa gazeta thonë se në këto ditë do të përndahet për t’u mbledhur prapë në fund të marsit”. Mandej e vinin në dijeni, se në bazë të lajmeve që jepnin gazetatat amerikane kishin mësuar se presidenti i SHBA-së kishte përgatitur një notë rreth “Çështjes së Adriatikut” mbi bazën e qëndrimit të Memorandumit të 9 dhjetorit, e cila pritej të mbërrinte shpejt në Londër.

Nuk dihet nëse nota e sipërpërmendur e 2 marsit e dërguar telegrafisht nga L. Bumçi, mbërriti në duart e U. Uillonit, por dihet se më 6 mars presidenti amerikan dha një përgjigje përfundimtare për “Çështjen e Adriatikut”<sup>61</sup>. Është nota për të cilën kishte pasur njoftime në shtypin amerikan e për të cilën i raportonin Aqif Pashë Elbasanit më 3 mars, dy delegatë shqiptarë.

<sup>59</sup> Po aty.

<sup>60</sup> Po aty.

<sup>61</sup> O. Pearson, *Albania and King Zog...*, f. 142.

Duke përkrahur propozimin për bisedime direkte italo-jugosllave, që të rrafshonin kontradiktat midis tyre, kreu i Shtëpisë së Bardhë, kishte theksuar se çështja shqiptare “nuk duhet futur në diskutimin e propozuar midis Italisë e Jugosllavisë” dhe se ai “nuk do të miratonte asnjë plan që do t’i jepte Jugosllavisë një kompensim territorial në pjesën veriore të Shqipërisë, për atë që mund t’i shkëputej gjetiu”.

Për sa i përkiste kërkesës jugosllave për një dalje ekonomike në Shqipërinë Veriore, U. Uillsoni deklaronte se qëndronte në linjën e Memorandumit të 9 dhjetorit 1919, “i cili, sipas pikëpamjes së tij, ka dispozitat e nevojshme për t’iu përgjigjur nevojave të Jugosllavisë”<sup>62</sup>.

Vendosmëria e presidentit të SHBA-së i detyroi aleatët evropianë të tërhiqen. Këmbëngulja e tij përreth dy muaj i erdhi në ndihmë njëherësh si Jugosllavisë edhe Shqipërisë. Jugosllavia kishte tani rastin të negocionte drejtpërdrejt me Italinë, kurse për Shqipërinë rreziku i copëtimit u shty dhe shqiptarët fituan një kohë shumë të vlefshme, që ditën ta shfrytëzonin. Pas ditëve të para të marsit nuk do të kishte më përpjekje kolektive të Fuqive të Mëdha për të marrë vendime për statusin dhe kufijtë e Shqipërisë. Italia dhe Jugosllavia hynë në negociata të drejtpërdrejta për të gjetur një zgjidhje kompromisi për “Çështjen e Adriatikut”, kurse Britania e Madhe dhe Franca, u ndjenë të lehtësuara që e lanë gjetjen e marrëveshjes në mirëkuptimin midis dy të interesuarve problematikë. Deri në marrëveshjen e Rapallos që do të arrihej në nëntor<sup>63</sup>, shqiptarët patën kohën dhe fatin të eliminonin rreziqet e shumta. Pasi kishte nënshkruar protokollin e gushtit me Qeverinë shqiptare, që u shoqërua me heqjen dorë nga pretendimet në Shqipëri, Qeveria italiane nuk mund të lejonte të realizoheshin aty pretendimet e Jugosllavisë dhe Greqisë.

\*\*\*

Çështja shqiptare do të vijonte të mbetej kështu e pazgjidhur edhe pas mbylljes së punimeve të Konferencës së Paqes të zhvilluar në Paris deri në janar 1920, edhe pas Konferencës së Londrës në vijim, të kryeministrave të Britanisë së Madhe, të Francës dhe të Italisë, dhe pas

<sup>62</sup> Po aty; Adriaticus, *La Question Adriatique ...*, f. 149-150; shih edhe A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, dok.26, f. 255-257. Notë e Uillsonit e dt. 6 mars, në përgjigje të notës së aleatëve të dt. 26 shkurt 1920.

<sup>63</sup> Vuk Vinaver, *Jugosllavija i Francuska izmetju Dva Svetsko Rata* (Da li je Jugoslavija bila francuski “satelit”), ISI, Beograd: 1985, f. 26-27.



Konferencës së San Remos që mbledhi sërisht Ll. Xhorxhin, A. Milerandin dhe F. Nitin, më 18 - 25 prill 1920.

Ngecja në zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut”, që u tentua të realizohej nga negociatat midis Italisë e Jugosllavisë mbi bazën e përmbajtjes së Memorandumit të 9 dhjetorit 1919, vijoi të mbante pezull edhe zgjidhjen e çështjes shqiptare.<sup>64</sup>

Ndërkohë që delegacioni shqiptar në Paris dërgonte drejt San Remos një telegram me të cilin i bënin thirrje përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha evropiane të respektonin pavarësinë dhe integritetin territorial të Shqipërisë<sup>65</sup>, Qeveria e Sulejman Delvinës dhe Regjenca, të dala nga Kongresi i Lushnjës, përpiqeshin përmes përshëndetjeve e falënderimeve të ndikonin te krerët e diplomacisë amerikane, te U. Uillsoni, R. Lansingu etj.

Përparësia që Shqipëria dhe diaspora shqiptare në Amerikë u dha marrëdhënieve me SHBA-në, u shfaq edhe në caktimin e një komisioneri në Uashington (Kostandin Çekrezi), i cili u pranua në kontakte jozyrtare nga Departamenti i Shtetit. Në fillim të majit 1920 Mehmet Konica, ministër i Jashtëm i qeverisë Delvina ndërkohë, kryetar i delegacionit shqiptar, i bënte thirrje U. Uillsonit të mos e kërkonte më zbatimin e Memorandumit të 9 dhjetorit 1919.

Këmbëngulëse në synimin për ruajtjen e pavarësisë dhe tërësinë territoriale, të vendit Qeveria shqiptare bëri demarshe për të paraqitur kërkesat e veta kombëtare e për të propozuar vendosjen e marrëdhënieve diplomatike edhe në Beograd, Athinë e Romë<sup>66</sup>.

Ndërkohë në Britaninë e Madhe po shtohej interesi për Shqipërinë. Prania jo pasive e kryediplomatit britanik në Shqipëri, Iden (Eden) gjatë përgatitjeve dhe zhvillimit të punimeve të Kongresit të Lushnjës në dhjetor 1919 - janar 1920<sup>67</sup>, misionet e Harold Temperlit

<sup>64</sup> Pietro Pastorelli, *L'Albania nella politica estera italiana 1914-1920*, Editore Jovere, Napoli: 1970, f. 284-285; Shih edhe P.Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 469.

<sup>65</sup> AMPJ, V. 1920, D. 34/1, fl. 407. Telegram i Mehmet Konicës në cilësinë e kryetarit të delegacionit shqiptar, dërguar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në San Remo.

<sup>66</sup> P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 471-473.

<sup>67</sup> Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Kujtime dhe vlerësime historike, përgatiti për botim Marenglen Verli, Tiranë: Marin Barleti, 1935, f. 184, 194. Sipas S. Vllamasit në dhjetor 1919, në takimin në Gjirokastër me Javier Hurshitin dhe Beso Gegën, kryetari i Bashkisë, deklaroi konfidencialisht se Qeveria britanike dëshironte formimin e një qeverie kombëtare në vend të asaj të Durrësit “që është vegël e italianëve”. Po ky bashkëkohës shënon në kujtimet e tij se diplomati Eden, njëherësh i “Inteligjencies Services”, prezent në Kongresin e Lushnjës, “kaloi disa orë ankthi, derisa u kuptua mirë, qëllimi i milicisë shqiptare kundër Kongresit”; shih edhe

(Harold Temperley)\* në Tiranë, në maj dhe në shtator 1920, tregonin interesimin e Londrës, jo thjesht për të pasur një informacion të besueshëm për gjendjen e brendshme në Shqipëri. Të bën përshtypje se raportet e britanikëve të dërguar në Shqipëri ishin realiste, madje A. Temperli rekomandonte njohjen e Qeverisë shqiptare. Në të njëjtën linjë bënë punën e tyre pranë Forin Ofisit miqtë e Shqipërisë, Obri Herbert etj. Por kthesa e dukshme në qëndrimin britanik do të merrej në nëntor. Shqiptarët ndërkohë kishin bërë luftën e Vlorës, Italia që dërguar matanë Otrantos dhe Jugosllavia e Greqia, pa të nuk mund të realizonin synimet e tyre në Shqipëri. Britania ishte tani në situatë komode të konfirmonte interesin e saj për Shqipërinë, çka u duk qartë në dhjetor, kur inicoi dhe mbështeti pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Shqipëria kishte mobilizuar të gjitha forcat e saj për të ruajtur pavarësinë dhe territorin e saj por i kishte ndihur edhe fati.

Pakësimi i interesimit të SHBA-së për Evropën për shkak të problemeve politike të brendshme, dhe në kuadër edhe për Shqipërinë u pasua kështu nga rritja e interesimit të Britanisë së Madhe për këtë vend. Por, vakumin në muajt prill-nëntor 1920 e mbushën vetë shqiptarët me mobilizimin e madh për të shpëtuar vendin e tyre që fatmirësisht rezultoi i efektshëm.

Shqipëria kishte shpëtuar nga rreziku që i qëndroi mbi kokë gjatë gjithë zhvillimit të Konferencës së Paqes së Parisit. Mbetej të mbroheshin rezultatet e arritura në vitin 1920 dhe të konsolidohej e demokratizohej shteti i brishtë, që i kishte shpëtuar asgjësimit.

---

Marenglen Verli, *Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: Botimpex, 2007, f. 90.

\* Njëpunës i Legatës britanike në Beograd.

Marenglen VERLI

## SUMMARY

### **THE GREAT POWERS DIPLOMACY AND THE CHALLENGE OF ALBANIANS IN JANUARY 1920**

It's generally known the progress of the Albanian question approach at the Peace Conference. Nonetheless neutral in the world conflict, Albania risked to be annihilated.

The accord or the compromise of the 13-14 January 1920, was the peak of the worst. In absence of the USA representative, France, Great Britain and Italy approved a solution variant that was opposed not only by the USA but even from Yugoslavia. Exactly from this moment the developments in the Albanian soil of diplomacy and popular movement took an interesting path, which historiography should deepen the view. This paper aims to shed light in the weekly days after the January 14 compromise who visibly influenced the growing of the Albanian factor in taking the decisions for the future of Albania.

Was lucky for Albanians that Yugoslav delegation as a cause of internal contradictions between the Croatian Ante Trumbić (foreign minister) and the Serb Nikola Pasic (premier), wouldn't accept to renounce from Fiume to accept compensations in Albania. This slack of the process introduced the USA, that had not signed the January 13-14 compromise, but were forced to accept, if the Yugoslavs and the Italians would agree for the solution offered from the Franco-British diplomacy.

Meantime in Albania, there was a general conscience about the catastrophic decisions of the Conference for Albania and was overwhelmed the view that it should be radicalized the stands against the further dismemberment of the country after 1913. Also, on January 21 had started the works the Lushnja Congress that on January 28-31, in the conditions when the diplomatic efforts for the reassert of the Albanian state independence and its integrity wouldn't give any result, undertook the organizing of the internal popular resistance.

The decrease of the USA concern for Europe as a cause of internal political problems, and in the framework even for Albania, was followed from the growing of interest of the Great Britain for this

country. The vacuum of the April-November 1920 was filled by Albanians themselves in the huge mobilization to save their country that luckily resulted efficacious.

**Armend MEHMETI**

## **AKSIONI I ARMATOSUR I ZOGUT NË SHQIPËRI - ASPEKTE TË MBËSHTETJES JUGOSLLAVE E BRITANIKE**

Ballafaqimet politike pozitë-opozitë që kulmuan me ngjarjet e qershorit të vitit 1924 e detyruan Ahmet Zogun dhe suitën e tij të iknin në Mbretërinë Serbe-Kroate-Slllovene (më tej: Jugosllavi). Ai u prit nga Ministria e Punëve të Jashtme e Jugosllavisë dhe u vendos përkohësisht në hotelin Bristol në Beograd. Një pjesë e suitës, përfshirë këtu ushtarakë, xhandarë e nëpunës administrativë u shpërndanë në Gjakovë, Dibër, Strugë, Shkup etj., derisa lidhjet e tyre me hotelin Bristol mbaheshin nga korrierë të veçantë.<sup>1</sup>

Pas akomodimit nga Qeveria jugosllave, diku nga fundi i qershorit Ahmet Zogu dha një intervistë për gazetarët në Beograd. Ai e falënderoi Qeverinë jugosllave për mikpritjen dhe njëkohësisht shprehu dyshimet e tij mbi qëndrueshmërinë e Qeverisë Noli, duke vënë theksin në problemet ekonomike-financiare dhe në përbërjen e saj nga disa grupime të paqëndrueshme politike.<sup>2</sup>

Deklarata e Zogut ishte një sinjal për ambiciet e tij për rikthim në skenën politike shqiptare. Këto ambicie përputheshin me interesat e përgjithshme jugosllave, prandaj qysh në fillim të korrikut filluan bisedimet midis Zogut dhe politikanëve e diplomatëve të lartë jugosllavë, sikurse Momçillo Ninçiq, e më pas edhe Vojislav Marinković, respektivisht i pari ish-ministër e i dyti ministër i Ministrisë së Punëve të

---

<sup>1</sup> Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e Mbretit Zog I (1912-1939)*, Tiranë: Shtëpia Botuese Emiri, 1997, f. 50.

<sup>2</sup> *Srbija i Albanci*, “Pregled Politike Srbije prema albancima od 1913 do 1945 godine”, Knjiga Druga, Ljubljana, maj 1989, f. 29.

Jashtme të Jugosllavisë në periudhën kur Zogu ndodhej në Beograd. Një tjetër dëshmi e ambicieve të Zogut ishte se, në kohën që po negocionte me jugosllavët, ai në mënyrë sekrete kishte vendosur kontakte edhe me italianët. Në gusht të vitit 1924, ai e kishte dërguar sekretarin e tij, Jak Koçin, në Romë për të siguruar përkrahje financiare nga Italia. Zogu i kishte ofruar Musolinit një bazë detare dhe koncesione të shumta në këmbim të akordimit të një ndihme prej 2 milionë lireta.<sup>3</sup>

Duke qenë se aktivitetet e Zogut kishin rënë në sy të autoriteteve jugosllave, këto erdhën në përfundim se Zogu ishte i vendosur të rikthehej në Shqipëri dhe nëse nuk e ndihmonte Jugosllavia atëherë atë do ta ndihmonte Italia. Pasi “ndihma” në këtë rast përcillej me vendosjen e ndikimit politik e ekonomik në Shqipëri apo në marrjen e koncesioneve të ndryshme të natyrës ekonomike e financiare, Jugosllavia vendosi të ndërmernte një hap të tillë. Në këtë drejtim ndikuan edhe një varg faktorësh: rreziku sovjetik - Noli kishte propozuar vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik, ndërsa Qeveria jugosllave ndiqte një politikë konsekuente antisovjetike,<sup>4</sup> njëjtë sikurse edhe fuqitë perëndimore; afërsia e Nolit me kosovarët, sidomos roli i Bajram Currit në ngjarjet e qershorit, si dhe afërsia e tij (Nolit) me Hasan Prishtinën, prijës i kosovarëve dhe kundërshtar i Jugosllavisë, i cili po punonte aktivisht në transformimin e Komitetit të Kosovës sipas shembullit të Komitetit maqedonas të Bullgarisë dhe të një organizate me qëllime irredentiste nga emigracioni i Kosovës dhe çetat kaçake që vepronin në Kosovë e në rrafshin e Dukagjinit. Shërbimet jugosllave të sigurisë kishin informacione se Hasan Prishtina ishte në kontakt me VMRO dhe po përgatiste një akt të përbashkët midis kosovarëve e maqedonasve;<sup>5</sup> një faktor tjetër ishte fakti se Beogradi tradicionalisht kishte pasur një njeri të vetin me ndikim politik në Shqipëri, që shërbente për realizimin e objektivave të tij sikurse Esat Pasha, Marka Gjoni etj., dhe nuk shihte një person të tillë tek Noli, prandaj shpresa e vetme bazohej tek Zogu. Por, një ndër faktorët kryesorë që pushteti jugosllav ishte kundër Nolit qe edhe Lëvizja Kaçake në Kosovë. Viti 1924 shënonte ballafaqime të ashpra luftarake midis ushtrisë mbretërore jugosllave dhe forcave kaçake. Po të njëjtin vit ishte miratuar edhe “Ligji

<sup>3</sup> Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekjet për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 2004, f. 80.

<sup>4</sup> Arben Puto, *Shqipëria politike*, Tiranë: Toena, 2009, f. 377.

<sup>5</sup> Zhivko Avramovski, “Kontribut studimit të historisë së Shqipërisë në periodën midis dy luftërave botërore”, *Gjurmime albanologjike*, nr. 2-1969, Instituti Albanologjik, Prishtinë: 1969, f. 128.

mbi zhdukjen e Lëvizjes Kaçake në Serbinë Jugore”, si dhe qe thyer rezistenca e Azem Bejtës në korrik të vitit 1924.<sup>6</sup> Prandaj, për t’i shkuar deri në fund luftës kundër kaçake dhe për të rivendosur administratën dhe kontrollin e plotë shtetëror në gjithë Kosovën pushteti i Beogradit ishte i orientuar në zhdukjen e bazës mbështetëse e strehuese të kaçakëve, e cila gjendej në Shqipëri.

Edhe Zogu nuk e kishte zgjedhur rastësisht Beogradin. Raportet e mira që kishte me Ceno Beun\* ndikuan që Zogu të pranohej ngrohtë në Beograd. Në vështrimet e Pashiqit, Ahmet Zogu me aftësitë e tij dhe ambicien për pushtet, ishte shumë i përshtatshëm për përmbushjen e planit minimal serb për Shqipërinë. Ky plan nënkuptonte “*një Shqipëri të pavarur, por të dobët e të pakonsoliduar*”, me një regjim nën ndikimin e Beogradit. Një Shqipëri e tillë vite me radhë do të bënte përshtypje të mjerë në opinionin dhe rrethet qeveritare evropiane dhe në momentin kur do të krijoheshin kushte të përshtatshme për realizimin e planit maksimal (ndarja e Shqipërisë me Greqinë) të Jugosllavisë lidhur me të, askush nuk do të kundërshtonte.<sup>7</sup>

Pra, gjithë faktorët e cekur më lartë, pa anashkaluar edhe interesat ekonomike-financiare, çuan në arritjen e një marrëveshjeje të fshehtë midis dy palëve. Kjo marrëveshje duhet të jetë arritur në gusht të vitit 1924.<sup>8</sup>

Ekzistojnë teori të ndryshme rreth kësaj marrëveshjeje në aspektin e ekzistencës së saj kur kihet parasysh se në kohën e nënshkrimit Pashiqi ishte në opozitë. Po ashtu, ekzistojnë edhe dy

<sup>6</sup> Liman Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1918-1941*, Instituti i Historisë, Prishtinë: 2004, f. 173-174.

\* Hysen bej Kryeziu ose Ceno Beu ishte i biri i Riza bej Kryeziut dhe dhëndër i Ahmet Zogut, i martuar më 1922 me motrën e këtij të fundit, Nafijen. Ai kishte lidhje të forta me qarqet politike jugosllave, kishte ndihmuar madje edhe në vendosjen e pushtetit serb në disa krahina të Shqipërisë Veriore gjatë vitit 1919. Kishte ndikim të madh në këto krahina ku aktiviteti i tij gjatë pjesës së parë të vitit 1924 u fokusua në shkatërrimin e bazave të nacionalistëve kosovarë që gjenin mbështetje në këto treva. Ai ishte besnik i Beogradit dhe ishte i përfshirë edhe në veprimtaritë agenturore jugosllave në Shqipëri... Për më tepër shih: *Arkivi Qendror i Shtetit*, Fondi Komiteti i Kosovës, Dosja 50/2, nr. dok. 708, 290; Ž. Avramovski, *Britanci o Kraljevini Jugoslaviji*, Knjiga Prva (1921-1930), Arhiv Jugoslavije, Zagreb: Globus, 1986, f. 436; Robert Clegg Austin, *From Crisis to Crisis: The Rise and Fall of Fan Noli's vision for Albania 1920-1924*, Toronto: 1998, f. 143-148.

<sup>7</sup> Emine Bakalli Arifi, *Përballje historiografike*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2015, f. 283.

<sup>8</sup> Zh. Avramovski, “Kontribut studimit të historisë...”, f. 131.

versione të kësaj marrëveshjeje, ajo me shkrim dhe ajo verbale. Sidoqoftë, në dyja rastet, në korniza të përgjithshme marrëveshja parashihte ndihmën politike, financiare e ushtarake të Mbretërisë së Jugosllavisë për përmbysjen e regjimit të Nolit në Shqipëri, kurse në këmbim të kësaj ndihme Zogu duhej të plotësonte kërkesat jugosllave. Kërkesat jugosllave në versionin e shkruar konsistojnë në 16 pika dhe një dokument i tillë ruhet në Arkivin Qendror të Republikës së Shqipërisë. Ndër pikat më të rëndësishme janë: (1) Shqipëria angazhohet t'i bashkohej Jugosllavisë me bashkim personal; (2) kryetari i shtetit shqiptar do të jetë Ahmet Zogu dhe ai do ta njohë dinastinë e Karagjeorgjeviqëve; (3) Shqipëria do të heqë dorë nga ushtria e saj; (4) do të bëhet bashkimi doganor dhe kalimi kufitar do të jetë i lirë, etj.<sup>9</sup> Ndërsa, në anën tjetër studiuesi jugosllav Zhivko Avramovski, i cili ka bërë hulumtime të shumta në arkivat jugosllavë, mohon ekzistencën e një dokumenti të tillë duke theksuar se ka ekzistuar vetëm një marrëveshje verbale midis Zogut e Pashiqit, të përmbledhur në disa pika: aneksimin e Shën Naumit nga Jugosllavia, shpërndarjen e Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, vendosjen e ndikimit serb mbi kishën ortodokse shqiptare, marrëveshjet tregtare me Jugosllavinë, etj.<sup>10</sup>

Sidoqoftë, nëse versionin e marrëveshjes me shkrim merret si fakt, akti i nënshkruar midis Zogut e Pashiqit nuk ishte marrëveshje e lidhur midis dy shteteve, i cili kërkonte medoemos t'i nënshtrohej ratifikimit parlamentar dhe regjistrimit në Lidhje të Kombeve, sepse në periudhën kur u arrit kjo marrëveshje, as Zogu e as Pashiqi nuk ishin në pushtet. Zogu kishte ikur nga ngjarjet e qershorit, kurse në Jugosllavi gjatë muajve korrik-nëntor në pushtet ndodhej qeveria liberale e Lubomir Davidoviçit.<sup>11</sup>

Por, kjo nuk do të thotë se marrëveshja mund të mos ketë ekzistuar, sepse me ardhjen e Pashiqit në pushtet, nëntor 1924, intensifikohet fushata jugosllave kundër Qeverisë Noli, respektivisht finalizohen përgatitjet për ndërhyrje të armatosur në Shqipëri, që kishin filluar qysh në ditët e para të shtatorit kur Qeveria jugosllave tanimë ishte bindur se Franca dhe Britania kishin hequr dorë nga njohja e Qeverisë Noli. Derisa Franca për hir të interesave të saj ndiqte një politikë tradicionale pro-jugosllave, Britania e Madhe

<sup>9</sup> Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi: 251, V. 1924, D. 105, F. 4-5.

<sup>10</sup> Zh. Avramovski, “Kontribut studimit të historisë...”, f. 131-132.

<sup>11</sup> Arkivi i Kosovës (më tej: AK), Fondi i ish Ushtrisë së Jugosllavisë, Popisnik 17, vitet 1920-1941, f. 354-362.



vendimin për mosnjohjen e Qeverisë Noli e bëri kah fundi i muajit korrik 1924 pas një analizë të hollësishme të situatës dhe duke u bazuar në disa faktorë: rekomandimet e Hari Ejresit\* për mosnjohjen e Qeverisë shqiptare, i cili raportonte në Foreign Office (më tej: FO) se: “...qysh prej vitit 1921 gjitha qeveritë kishin ardhur në pushtet duke respektuar ligjshmërinë. Ato kishin shumicën në parlament apo i kishin mbledhur votat për besimin e parlamentit. Qeveria e Fan Nolit nuk e ka shumicën në parlament e as që e ka ndërmend ta thërrasë parlamentin. Programi i tyre është i dobët, madje parashohin edhe ndjekjen e personave përgjegjës për ngjarjet. Me fjalë të tjera, qeveria e Nolit është formuar nga një akt kryengritës dhe synon të sundojë me forcë pa kontroll parlamentar, duke i eliminuar kundërshtarët e saj”;<sup>12</sup> FO konsultoi edhe bibliotekën diplomatike britanike rreth njohjes së qeverive që kishin dalë nga kryengritjet, e cila rekomandonte mosnjohjen derisa këto qeveri demonstironin qartë se kishin mbështetjen e popullatës;<sup>13</sup> por çështja më e rëndësishme për Qeverinë britanike ishte ajo e interesave ekonomike britanike në Shqipëri, konkretisht nëse Qeveria e Nolit do t’i miratonte koncesionet e naftës për kompaninë britanike Anglo-Persian. Se kjo ishte një çështje tepër e rëndësishme për Britaninë dëshmohet edhe nga politikani i kohës, Sejfi Vllamasi. Gjatë një takimi që ai kishte pasur me Morton Edenin, ish-konsull britanik dhe përfaqësues i Intelligent Service, që i kishte bërë shërbime të mëdha Shqipërisë në kohën e Kongresit të Lushnjës, në bisedë e sipër Eden i kishte thënë: “...vajguri, që ia ç’këputi Turqisë vilajetin e Mosulit për shkak të burimeve vajguore për t’ia dhënë Irakut, po ai vajgur ju përzuri juve nga Shqipëria dhe e pruri Zogun në fuqi”.<sup>14</sup>

Nuk duhet anashkaluar as rëndësinë që kishte faktori italian për Britaninë. Në një raport nga Shqipëria konsulli britanik, Robert Parr, e kishte informuar FO se ministrat francezë e jugosllavë në Shqipëri flisnin hapur se Italia qëndronte prapa konflikteve në Shqipëri, madje se

---

\* Harry Eyres kishte qenë emisar special britanik që kishte ndërmjetësuar çështjen e pranimit të Shqipërisë në Lidhje të Kombeve në këmbim të koncesioneve të naftës për Kompaninë Anglo-Persian gjatë marsit të vitit 1920. Më vonë ai emërohet si ministër britanik në Durrës...Për më tepër shih: A. Puto, *Shqipëria politike ...*, f. 291; Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë: Botimet Vllamasi, 2012, f. 316.

<sup>12</sup> *The National Archive* (më tej: TNA), FO 371/9640 C11443/28/90, Raporti Foreign Office, 21 korrik 1924, f. 190.

<sup>13</sup> *Po aty*, f. 191.

<sup>14</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 321.

përfaqësia italiane në Shkodër ishte mbrojtur gjatë trazirave.<sup>15</sup> Këto të dhëna përforcuan hezitimet britanike ndaj Qeverisë Noli, sepse ndikimi italian në Shqipëri nënkuptonte kthimin e Adriatikut në një liqen italian, ku si rezultat do të ishte edhe bllokimi i rrugës britanike për në Mesdhe dhe një konflikt i mundshëm italo-jugosllav rreth Shqipërisë.

Në këtë mënyrë Zogut iu hap drita jeshile për të filluar aktivitetet e organizimit të intervencionit, kuptohet në mënyrë diskrete. Në këtë *“dritë jeshile”* kontribuuan edhe tre faktorë të tjerë. Ato ishin: fjalimi i Nolit në Lidhjen e Kombeve dhe tallja me të, që zbehu reputacionin e Qeverisë shqiptare dhe la përshtypje të keqe tek qarqet anglo-franceze, pas së cilës ministri i Jashtëm jugosllav e uron Zogun duke i thënë se i *“ishte hapur rruga për në Shqipëri”*;<sup>16</sup> vizita që Fan Noli i bëri Konsullatës sovjetike në Romë gjatë kthimit të tij nga Gjeneva, e cila u pasua me një propagandë të ashpër jugosllave, e cila e vinte theksin në përpjekjet sovjetike për ta vendosur bolshevizmin në disa vende të Ballkanit, në veçanti në Shqipëri; dhe situata e vështirësuar ekonomike dhe anarkia që mbizotëronte në Shqipëri, në veçanti nuk ishin realizuar pritjet e masave të gjera për lehtësimin e jetës së përditshme. Kjo bëri që në të njëjtën kohë në Shqipëri të aktivizoheshin forca tjera të pakënaqura me regjimin e Nolit, sidomos të fiseve të Dukagjinit për mospërmbushjen e premtimeve lidhur me disa reforma që do t’ua lehtësonin jetën këtyre malësorëve.<sup>17</sup> Pakënaqësia ekzistonte edhe tek rajonet e tjera shqiptare. Për t’i dhënë fund vështirësive dhe grindjeve politike Elez Isufi, njëri nga krerët e njohur shqiptar që kishte edhe mbështetje të armatosur nga ithtarët e tij, ishte i mendimit për një qeveri të Ahmet Zogut dhe në vazhden e këtij qëllimi ai zhvilloi aktivitete të shumta në veri të Shqipërisë, ku Zogu kishte shumë përkrahës, për të arritur një besë të përgjithshme për rikthimin e tij në pushtet.<sup>18</sup>

Në rrethanat e krijuara Ahmet Zogu veç kishte filluar organizimin e aksionit të armatosur me synimin final për t’u rikthyer në pushtet. Gjatë shtatorit ministri britanik në Shqipëri, Ejres, ishte në posedim të informacioneve se Ahmet Zogu ishte duke punuar për rekrutimin e ithtarëve të tij në Podgoricë, Dibër, Strugë dhe Ohër, dhe se

<sup>15</sup> TNA, FO 371/9639 C9890/28/90, R. Parr për Foreign Office, 20 qershor 1924, f. 121.

<sup>16</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*..., f. 386.

<sup>17</sup> *Po aty*, f. 269.

<sup>18</sup> TNA, FO 371/9640 C14472/28/90, H. Eyres për Foreign Office, 5 shtator 1924, f. 291-220.

ai posedonte mjete të mjaftueshme financiare për t'i joshur të gjithë shqiptarët e mërguar në pjesën jugosllave të kufirit.<sup>19</sup>

Po ashtu, Zogu tentoi ta fitonte edhe neutralitetin e qarqeve fetare katolike. Në një letër sekrete drejtuar klerit katolik françeskan Zogu i njoftonte ata për mbështetjen e fuqive evropiane dhe të fqinjëve për ta sulmuar Shqipërinë duke kërkuar të mos bëjnë asnjë kundërshtim, sepse ai përsëri do të jetë në favor të tyre.<sup>20</sup>

Për të rekrutuar njerëz në krahinat këndeje e andej kufirit po punonin edhe krerë si Ceno bej Kryeziu, Muharrem Bajraktari, Murat Kaloshi, Abdurrahman Krosi, Tafë Kaziu etj. Për t'i paguar të rekrutuarit dhe për shpenzimet e tjera Ahmet Zogu kishte siguruar edhe mjete financiare. Qeveria e Beogradit i lëvroi atij shuma të mëdha të hollash, ku sipas një historiani, 105 milionë dinarë,<sup>21</sup> kurse sipas një tjetri 30 mijë napolona floriri. Atë e financoi edhe Kompania Anglo-Persian Oil, që pranoi t'i lëvronte 50 milionë dinarë (50 mijë sterlina), gjysma e të cilave do të jepej menjëherë kurse gjysma tjetër pasi të kthehej në pushtet dhe të ratifikohet koncesioni i vajgurit.<sup>22</sup>

Për ndihmën financiare jugosllave dëshmon edhe konsulli britanik në Shkup: *“një tregtar nga Dibra më informoi se Ahmet Zogu në fillim të këtij muaji (dhjetor) iu drejtua gjithë tregtarëve kryesorë të Dibrës duke kërkuar kredi. Përgjigjja e tregtarëve ishte e zbehtë, por pas pak një makinë e Ahmet Zogut erdhi nga Ohri dhe solli 5 milionë dinarë. Nuk dihet se kush tjetër në Ohër përveç Drejtorisë Financiare (Financiska Uprava) do të mund të ishte në gjendje t'ia ofronte atij shumën në fjalë”*.<sup>23</sup>

Përpjekjet për rrëzimin e Qeverisë së Nolit ishin intensifikuar sidomos pas ardhjes së Pashiqit në krye të Qeverisë jugosllave. Në këtë mënyrë, gjatë vjeshtës, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Jugosllave, ndoshta duke punuar nëpërmjet organizatës “Dora e Bardhë”, që të mund të mohonte çdo përgjegjësi po të dilte nevoja, nisi të përqendronte në kufi forcat e mëposhtme, që do ta mbështesnin Zogun në mënyrë të

<sup>19</sup> TNA, FO 371/9640 C15834/28/90 H. Eyres për Foreign Office, 18 shtator 1924, f. 263.

<sup>20</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*..., f. 387.

<sup>21</sup> Vladimir Dedijer, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1939-1948*, Beograd: Prosveta, 1949, f. 124.

<sup>22</sup> *Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi III*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 241.

<sup>23</sup> TNA, FO 371/10654 C196/52/90, Sir. A. Young për Foreign Office, 31 dhjetor 1924, f. 14.

drejtpërdrejtë kur të arrinte çasti i duhur. Burime të sigurta britanike japin edhe shifrat e këtyre forcave: *“Njëmijë vullnetarë nga ushtria e rregullt jugosllave, shumica rekrutë malazezë dhe shqiptarë; njëmijë rezervistë nga Kërçova, Tetova, Gostivari dhe Dibra, të veshur me rroba të vendit të cilët besonin se sukcesi i lëvizjes në të cilën po merrnin pjesë do të çonte në bashkimin me atdheun e tyre dhe flamuri do të valëvitej lirisht. Pesëqind malësorë nga Mati, që kishin ikur me Ahmet Zogun; tetëqind ushtarë dhe dyzet oficerë të ushtrisë së refugjatëve të gjeneralit Vrangeli, që kishin gjetur strehim në Jugosllavi; 16 oficerë (me uniformë) të ushtrisë së rregullt jugosllave. Gjithashtu qenë vënë në dispozicion të Zogut njësitë e ushtrisë së rregullt jugosllave: 2 bateri të artilerisë malore, 10 mitraloza të rëndë dhe 20 mitraloza të lehtë, municione dhe njësi të motorizuara të transportit”*.<sup>24</sup>

Përballë fakteve të shumta, Qeveria e Nolit, vendosi, ndonëse me vonesë, të ngrejë zërin pranë Fuqive të Mëdha përmes një memorandumit në fillim të nëntorit. Aty tërhiqej vëmendja se *“ditët e fundit lëvizja antishqiptare e organizuar nga autoritetet ushtarake e civile serbe ka marrë përmasa të tilla kaq të mëdha, sa që besohet se Shqipëria ndodhet në pragun e një agresioni të huaj, vihej në dukje se i gjithë aksioni është i drejtuar nga shtabi i ushtrisë serbe”*.<sup>25</sup>

Derisa Zogu i bënte përgatitjet në territorin jugosllav, Ejres raportonte se në fund të nëntorit lëvizjet për të rrëzuar Qeverinë e Nolit u panë edhe në radhët e ushtrisë shqiptare. Oficerët e batalionit të stacionuar në Përmet, të udhëhequr nga major Radovica, u deklaruan kundër Qeverisë. Ejres po ashtu transmetonte informacione, të cilat i quante të siguruar prej burimeve private, se emisarët e Ahmet Zogut kishin qenë shumë aktivë dhe shumica e bajraktarëve të vegjël kishin punuar që ta përkrahin atë, duke aluduar në rolin e parasë. Ejresi i transmetonte Londrës edhe një bisedë që ai kishte pasur me të ngarkuarin jugosllav me Punë në Tiranë rreth financimit të Zogut. Derisa Ejres kishte shprehur mendimin se Zogu nuk kishte pasur shuma të mëdha parash kur kishte ikur nga Shqipëria dhe duke pyetur për burimet e financimit të tij, i ngarkuari jugosllav me punë në Tiranë kishte deklaruar

<sup>24</sup> Joseph Swire, *Shqipëria - ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 350-351.

<sup>25</sup> Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike, 1992, f. 305-306.

se “...kjo ishte një çështje e raportit të përbashkët që Britania e Madhe i kishte akorduar atij furnizime”.<sup>26</sup>

Një deklaram i tillë jep të kuptohet se Britania e Madhe e kishte miratuar në mënyrë të heshtur intervencionin kundër Qeverisë Noli. Ky qëndrim mund të vërtetohet përmes faktit që na sjellin studiuesit William Bland dhe Ian Price, të cilët citojnë bisedën midis përfaqësuesit italian në Londër dhe të ngarkuarit amerikan me punë në Londër, kur i pari i thotë të dytit: “...Kompania Anglo-Persiane, me miratimin e heshtur të Qeverisë britanike kishte kurdisur rikthimin në pushtet të Zogut dhe grupit të tij”.<sup>27</sup>

Ky qëndrim përforcohet edhe më tej kur Ejres i raportonte Qeverisë britanike nga Durrësi: “Është jashtëzakonisht e qartë se Jugosllavia e ka ndihmuar sulmin e Ahmet Zogut. Ahmeti është lejuar që t’i drejtojë operacionet nga Dibra”. Këshilltari politik në FO, Lampson, u përgjigj se: “...këtë ndihmë do ta paguajë me Shën Naumin”, kurse Sekretari Nikolson deklaroi: “Serbët e kishin projektuar dhe përgatitur këtë operacion me paramendim. Nëse ky projekt ka sukses, mendoj se ne nuk duhet të shqetësohemi tepër. Kjo do të thotë se si kompensim për ndihmën e ofruar serbët marrin vetëm Shën Naumin””.<sup>28</sup>

Por, pavarësisht deklarimeve të tilla, nga veprimet e mëvonshme të FO dalin indikacione se FO nuk kishte njohuri të plota rreth vendimit për ta mbështetur intervencionin, apo njohuri të tilla mund të ketë pasur vetëm një rreth shumë i ngushtë i qarqeve vendimmarrëse britanike. Kjo mund të shpjegohet me faktin që na sjellë studiuesi Alan Sharp, i cili transmeton brengat e ish-ministrit të Jashtëm britanik, lordit Kurzon, për anashkalimin e FO nga kryeministria në raste të caktuara, apo veprimin e shërbimeve të tjera britanike jashtë dijes së Foreign Office, apo siç shprehet më mirë një diplomat tjetër britanik: “Është një prirje e qartë në Londër që marrëdhëniet me jashtë të udhëhiqen veçmas nga Foreign Office...”.<sup>29</sup>

Në fillim të dhjetorit 1924, Zogu dhe Beogradi u bindën se kishte ardhur koha e ndërhyrjes, sidomos kur në nëntor Noli kishte shpallur

<sup>26</sup> TNA, FO 371/9640 C17661/28/90, H. Eyres për Foreign Office, 22 nëntor 1924, f. 290.

<sup>27</sup> William Bland & Ian Price, *A tangled web: A History of Anglo-American Relations with Albania (1912-1955)*, London: 1986, f. 25.

<sup>28</sup> Po aty, f. 25.

<sup>29</sup> Alan J. Sharp, *The Foreign Office in Eclipse 1919-1922*, London: 1976, f. 198.

mbajtjen e zgjedhjeve të reja për Asamblenë Kushtetuese.<sup>30</sup> Zogu nuk mund të lejonte që Noli ta kthente regjimin deri tani jo kushtetues në një regjim juridikisht kushtetues, i cili më pas do të njihej në rrafshin ndërkombëtar.

Për të miratuar ndërhyrjen, Beogradi, kërkonte të dinte edhe qëndrimin zyrtar të Londrës. Për ta lehtësuar përpjekjen e saj diplomacia jugosllave në fund të nëntorit ua tërhoqi edhe njëherë vërejtjen fuqive lidhur me rrezikun bolshevik që vinte nga Shqipëria, respektivisht se një përfaqësues sovjetik po dërgohej në Tiranë.<sup>31</sup> Më 2 dhjetor 1924, Lampsoni i deklaroi ministrit jugosllav në Londër se nuk duhej bërë asgjë për të provokuar situatën pasi: “...*Ballkani është një kuti eshke dhe sapo një kuti të bjerë mund të kemi një flakë të vërtetë e serioze*”, duke aluduar në reagimin italian. Lampson i pohonte përfaqësuesit jugosllav se shqetësimi kryesor për Britaninë mbeteshin ndërlikimet që do të vinin në qoftë se një fuqi do të vinte dorë në Shqipëri, të cilën Britania dëshironte ta shihte vetëm si vend të pavarur.<sup>32</sup>

Në anën tjetër, Qeveria shqiptare, përmes Ejresit, njoftonte Britaninë se ajo priste një sulm ndërmjet datës 10-15 dhjetor nga pika të ndryshme të kufirit lindor të projektuar nga Ahmet Zogu dhe përkrahësit e tij, ushtarakët e lartë serbë e rusë. Duke njoftuar se Qeveria jugosllave e kishte furnizuar atë me pushkë, armë dhe municione, Qeveria shqiptare kërkonte nga Britania që të intervenonte në Beograd për ta parandaluar këtë sulm.<sup>33</sup>

Kërkesa shqiptare kishte ngjallur diskutime në FO. Sekretari i parë në FO, Hovard Smith, duke analizuar gjitha rrethanat theksonte se ekzistojnë dyshime se serbët janë duke nxitur një kryengritje nga territori i tyre kundër një qeverie tjetër, që në fakt paraqet një rast për Lidhjen e Kombeve. Ai vazhdonte më tej, se Qeveria shqiptare ka frikë se, nëse çështja adresohet në Lidhje të Kombeve, atëherë kjo e fundit do t’ia delegojë Italisë mandatin\* mbi zgjidhjen e problemit, edhe pse ministri

<sup>30</sup> TNA, FO 371/9640 C17663/28/90, H. Eyres për Foreign Office, 16 nëntor 1924, f. 294.

<sup>31</sup> TNA, FO 371/9644 C18464, H. Eyres për Foreign Office, 27 nëntor 1924, f. 210-212; *Shqipëria - ngritja e një mbretërie*, f. 351-352.

<sup>32</sup> Pranvera Teli Dibra, *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927*, Tiranë: Neraida, 2005, f. 250.

<sup>33</sup> TNA, FO 371/9640 C18425/28/90 H. Eyres për Foreign Office, 7 dhjetor 1924, f. 300-301.

\* Konferenca e Ambasadorëve, më 9 nëntor 1921, i komunikoi vendimet e saj lidhur me Shqipërinë që konsistonin në njohjen e kufijve të Shqipërisë së vitit 1913, njohjen e

italian kishte theksuar më herët se Italia nuk e dëshironte një mandat të tillë. Duke dyshuar në thëniet e ministrit italian, Smith theksonte se në teori mund të ekzistojë një marrëveshje jugosllave-italiane, të parët të lejohen të marrin Selanikun për t'i lejuar të dytëve dorë të lirë në Kroaci, dhe sigurisht që në rrethana të tilla Italia nuk do të mund të zbatonte vendimin e Lidhjes së Kombeve. Në fund, Smith këshillonte që Britania nuk duhej të bënte kërkesë në Lidhje të Kombeve, por këtë duhej ta bënte vetë Shqipëria.<sup>34</sup>

Por ndryshe mendonte Nikolson, i cili theksonte se nuk duheshin këshilluar shqiptarët që të ankoheshin në Lidhje të Kombeve, sepse nëse çështja është e një rëndësie të veçantë atëherë Pashiqi duhej t'i ketë bërë përgatitjet e nevojshme me Francën e Italinë, e kjo do ta vinte Lidhjen e Kombeve në pozita të vështira. Nikolson shprehej se ky problem nuk duhej zmadhuar, por duhej trajtuar si pjesë e politikës lokale ballkanike.<sup>35</sup>

Derisa mendohej për opsione të ndryshme rreth Shqipërisë, sulmet në Shqipërinë Veriore tërhoqën vëmendjen e FO-së. Në FO ishin më tepër të brengosur rreth reagimit italian prandaj, më 8 dhjetor 1924, ajo i dërgonte një telegram ministrit britanik në Beograd, ku shprehej: *“Duhet ta informoni Qeverinë jugosllave se Qeveria britanike i ka pranuar me shqetësim këto raporte dhe me vullnet të plotë beson se autoritetet lokale jugosllave do të udhëzohen që t'i shmangin të gjitha veprimet me karakter provokues të cilat mund ta rrezikojnë paqen e përgjithshme në Ballkan. Gjithashtu do të vlerësonim një deklaratë të sinqertë të Qeverisë jugosllave për opinionin lidhur me situatën aktuale”*.<sup>36</sup>

Por, si përgjigje Beogradi përdori kartën e rrezikut sovjetik. Ministri jugosllav në Londër deklaroi se Qeveria shqiptare dhe ajo bullgare po toleronin dhe inkurajonin bandat bolshevike në kufi me Jugosllavinë. Kjo bëri që FO të kërkojë nga diplomatët e saj në Shqipëri e Bullgari që të merrnin të gjitha masat e nevojshme kundër rrezikut

---

interesave strategjike italiane në Shqipëri duke i njohur mandatin Italisë për të mbrojtur tërësinë territoriale të Shqipërisë... Për më tepër shih: AK, Fondi P-Millovanoviq-Beograd, nr. inv. 132, kutia 3, Revista e Lidhjes së Kombeve, f. 1195; P. Dibra, “Diplomacia angleze dhe vendimi i 9 nëntorit të vitit 1921 për Shqipërinë”, *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2002, f. 56. 373 TNA, FO 371/5733 C21578/580/90, Telegram i Lord Hardinge për FO, 11 nëntor 1921.

<sup>34</sup> *Po aty*, f. 301.

<sup>35</sup> *Po aty*.

<sup>36</sup> TNA, FO 371/9640 C18425/28/90, Foreign Office për Sir. A. Young, 8 dhjetor 1924, f. 366.

bolshevik “... së shpejti do të t’ju dërgohen udhëzime për t’i inkurajuar qeveritë në vendet ku jeni të akredituar për t’i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për t’u ballafaquar me këtë kërcënim, nëse me të vërtetë ekziston, dhe në këtë mënyrë t’i parandaloni zhvillimet me pasoja të një shkalle të gjerë”.<sup>37</sup>

Propaganda për rrezikun bolshevik e kishte burimin nga kancelaria e Branko Lazareviqit, shef i Sektorit për Shqipërinë në MPJ të Jugosllavisë. Lazareviq u kishte dërguar një notë qarkore qeverive të Francës, Britanisë, Italisë dhe SHBA-së mbi aktivitetin e sovjetikëve në Shqipëri. Përveç të tjerash, ai kishte theksuar se sovjetikët po e shfrytëzonin situatën në Shqipëri kundër Jugosllavisë të ndihmuar nga Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” dhe Organizata Revolucionare Maqedonase-VMRO. Lazareviq pohonte se pjesëtarëve të këtyre organizatave u ishin gjetur materiale dhe letra që vërtetonin mbështetjen e plotë morale e financiare të sovjetikëve dhënë këtyre organizatave.<sup>38</sup>

Propaganda jugosllave mbi aktivitetet e sovjetikëve në Shqipëri ishte pasqyruar edhe në shtypin ditor britanik. Nga burimet gazetareske jugosllave, mediat britanike transmetonin deklaratimet e Qeverisë jugosllave se aktivitetet e sovjetikëve në Shqipëri po koordinoheshin nga zyra e tyre në Vjenë, Qeveria kishte njohuri për sasinë e armëve të kontrabanduara në Shqipëri e që lidheshin me organizimin e bandave për të sulmuar Jugosllavinë.<sup>39</sup>

Sipas ish-diplomatit Morton Eden, që njihte mirë rrethanat në Shqipëri e Ballkan, Pashiqi e kishte shfrytëzuar frikën e burokracisë britanike për të zmadhuar rrezikun bolshevik, dhe në fakt Pashiqi shqetësohej nga frika se mos shqiptarët (së bashku me ata të Kosovës) mund të shërbenin si një hallkë për bashkërenditjen e veprimtarisë së lëvizjes së maqedonasve me atë të boshnjakëve e kroatëve.<sup>40</sup>

Njëkohësisht Pashiqi i jepte garanci ministrit britanik në Beograd se “Qeveria jugosllave nuk ishte e interesuar të përzihej në betejën midis partive politike në Shqipëri, ajo do të ndiqte një linjë të ashpër

<sup>37</sup> Po aty, f. 304.

<sup>38</sup> Haris Silajxhiç, *Shqipëria dhe SHBA-ja në arkivat e Uashingtonit*, Tiranë: Dituria, 1999, f. 162-163.

<sup>39</sup> *Gazeta The Nottingham Evening Post*, 23 dhjetor 1924, f. 6.

<sup>40</sup> Mentar Belegu, “Revolucioni i Qershorit 1924 - një ngjarje e shënuar shqiptare dhe ballkanike”, *Studime historike*, nr. 3, Instituti i Historisë, Tiranë: 1966, f. 110.



*neutraliteti dhe se autoritetet kufitare do të paralajmërohen edhe njëherë që të shmangen nga përkrahja për ndonjë invazion”.*<sup>41</sup>

Sigurisht që Beogradi e mbulonte veprimtarinë e tij për të mos bartur përgjegjësi në rast të dështimit të moskontrollimit të situatës. Jugosllavët me të vërtetë kishin arritur të bindnin ministrin britanik në Beograd se Jugosllavia nuk ishte e përfshirë në ngjarjet që po zhvilloheshin në Shqipëri dhe se kishte arsye për të besuar se ajo ishte e interesuar për një neutralitet të rreptë rreth ngjarjeve në Shqipëri. Ai i raportonte FO-së: *“...e vizitova Seksionin për Shqipërinë në MPJ të Jugosllavisë të cilët më lexuan një varg telegramesh se një lëvizje kryengritëse kishte filluar në Shqipërinë e Veriut, të Mesme dhe atë Jugore. Oficerët që e kishin shoqëruar Ahmet Zogun gjatë ikjes ishin vendosur në Shkup dhe nën kontroll ushtarak, prandaj nuk ka arsye për të besuar se ata gjenden në kufi. Këtu duket se ka një panjohuri të vërtetë mbi vendndodhjen e Ahmet Zogut i cili për herë të fundit u lajmërua nga Zvicra”.*<sup>42</sup>

Raportimi i mësipërm dëshmon se Qeveria jugosllave e kishte organizuar aq mirë komplotin sa që detajet e plota të organizimeve i dinin vetëm një numër i vogël zyrtarësh jugosllavë. Pra, ekzistonte mundësia që MPJ jugosllave me të vërtetë mos të kishte njohuri për vendndodhjen e Zogut, sepse për këtë punë kujdeseshin seksionet e forcave të sigurisë së Jugosllavisë. Sidoqoftë, ministri britanik vazhdonte të shprehte mendimin e vet lidhur me bisedat që kishte pasur në MPJ jugosllave: *“...nga dy bisedat e zhvilluara del se Qeveria jugosllave nuk konsideron se Qeveria e Ahmet Zogut ishte më proserbe sesa kjo e tanishmja sa për t'i dhënë atyre motive për inkurajimin e trazirave aktuale në Shqipëri, pavarësinë dhe integritetin e së cilës këta dëshirojnë ta ruajnë... sidomos kur fushata elektorale e shoqëruar me probleme të brendshme ishte duke e preokupuar Qeverinë jugosllave ...”.*<sup>43</sup>

Por në ditët në vijim, Beogradi e kishte ndryshuar prononcimin. Tani Jugosllavia, për të përgatitur opinionin ndërkombëtar mbi nevojën për ndryshime në Shqipëri dhe për rolin e Jugosllavisë në këto ndryshime, kishte filluar të shprehej, por jo shumë haptas në fillim, në favor të një qeverie të udhëhequr nga Ahmet Zogu. Ministri i Jashtëm jugosllav, Ninçiq, para ambasadorit britanik në Romë shprehej i

<sup>41</sup> TNA, FO 371/9640 C18627/28/90, Sir. A. Young për Foreign Office, 10 dhjetor 1924, f. 322-323.

<sup>42</sup> Po aty, f. 332-334.

<sup>43</sup> Po aty.

brengosur për situatën në Shqipëri dhe dëshirën për një Shqipëri të lirë e të pavarur, me një qeveri të aftë për të ruajtur stabilitetin. Për të dhënë të kuptohej se Beogradi nuk kishte qëllime të tjera përveç ndryshimit të qeverisë, Ninçiq deklaroi para ambasadorit britanik: *“...nëse nesër na ofrohet gjysma e Shqipërisë, ne do ta refuzojmë një ofertë të tillë... qeveria aktuale nuk jep shpresë për ndonjë qëndrueshmëri, në fakt e vetmja qeveri që mund të ofrojë stabilitet politik është ajo e udhëhequr nga Ahmet Zogu”*. Për më tepër ai u shpreh se: *“...i vetmi ndryshim është se nëse gjer tani Qeveria jugosllave e ka kufizuar Ahmet Zogun, duke e parandaluar atë që të marr nisma politike lidhur me Shqipërinë, tani Qeveria jugosllave nuk është e predispozuar ta mbajë edhe më tutje një qëndrim të tillë dhe priret që atij t’i japë liri veprimi”*. Ninçiq u shpreh për një marrëveshje italo-jugosllave përmes së cilës as Italia e as Jugosllavia nuk do të kërkonin avantazhe ekonomike e politike në Shqipëri.<sup>44</sup>

Sikurse shihet, Ninçiqi kishte paralajmëruar veprimin jugosllav, por kishte shprehur edhe garanci për çështjet në të cilat Londra ishte e ndjeshme: pavarësia e Shqipërisë, mosndryshimi i kufijve dhe pajtimi i Italisë për veprimet rreth Shqipërisë. Prandaj, një deklaratë e tillë u vlerësua pozitive nga FO me faktin se nuk paraqiteshin pretendimet territoriale serbe që do ta ndërlikonin edhe më tej situatën, edhe pse tani FO e kishte të qartë se Beogradi po mbështeste të preferuarin e vet për përmbysjen e Qeverisë ekzistuese në Shqipëri.<sup>45</sup>

Sigurisht që vizita e Ninçiqit kishte për qëllim sigurimin e pajtimit të Italisë për aksionin jugosllav. Prandaj, duke fituar përkrahjen e Musolinit, u lëshua një deklaratë e përbashkët, e cila përsëriste angazhimin e mëparshëm të 9 qershorit që të dy qeveritë të mos ndërhyjnë në punët e brendshme të një shteti tjetër. Për Beogradin, ky lloj formulimi ishte i favorshëm. Kur zhvilloheshin bisedimet aksioni jugosllav kundër Qeverisë së Nolit kishte nisur dhe deklarata shërbente si kapak për të mbuluar atë. Me këtë marrëveshje Qeveria jugosllave mori sigurime se nuk do të kishte ndërhyrje italiane në përputhje me deklaratën e 9 nëntorit 1921 dhe as ndonjë aksion tjetër në mbështetje të Qeverisë shqiptare.<sup>46</sup>

<sup>44</sup> TNA, FO 371/9640 C18785/28/90, R. Graham për Foreign Office, 11 dhjetor 1924, f. 337-338.

<sup>45</sup> Po aty, f. 337-338.

<sup>46</sup> P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927...*, f. 251.

Në fakt, pas të gjitha përgatitjeve, më 13 dhjetor 1924, kishte filluar operacioni ushtarak për rrëzimin e Qeverisë Noli. Operacioni kishte qenë i njëkohshëm nga tri drejtime. Njësinë që u nis nga Dibra në drejtim të Tiranës e komandonte vetë Ahmet Zogu. Pothuaj pa ndonjë rezistencë të fortë Zogu arriti në Tiranë. Njësitë e dytë nga Mali i Zi hyri në Shkodër pa asnjë rezistencë. Kurse vështirësitë lindën vetëm në drejtimin e tretë, i cili shkonte nga Prizreni për në Lumë. Rezistenca e Bajram Currit detyroi ndërhyrjen e ushtrisë së rregullt jugosllave, e cila i theu forcat e Bajram Currit.<sup>47</sup> Forcat jugosllave që e kishin ndihmuar Zogun u tërhoqën menjëherë nga territori shqiptar, në mënyrë që intervenimi mos të kishte ngjyrimë të një agresioni të jashtëm. Me Zogun mbetën vetëm mercenarët e Vrangelit. Por as Fuqitë e Mëdha sikurse Italia dhe Britania nuk do ta mirëpritnin qëndrimin e forcave jugosllave në Shqipëri, që nënkuptonte edhe forcimin e prestigjit të Francës në Evropë për shkak të aleancës që ajo kishte me Antantën e Vogël.

Rezistenca e dobët ndaj ndërhyrjes së Ahmet Zogut mund të shpjegohet përmes disa argumenteve: parashikimet e popullsisë për përmirësimin e gjendjes ekonomike ishin zbehur, Qeveria e Nolit nuk kishte bërë asgjë në këtë drejtim; në Shqipëri vazhdonte anarkia e vërtetë; Zogu përmes njerëzve me ndikim kishte lobuar tek paria dhe qarqe me ndikim në Shqipëri; sipas burimeve shqiptare agjentët e Zogut kishin rekrutuar civilë të cilët i paguanin sipas marrëveshjes. Rekrutimet ishin bërë kryesisht në zonat kufitare, si: Lumë, Dibër, Prizren, Pogradec etj.;<sup>48</sup> nuk duhet anashkaluar as kontributi i ministrit britanik Ejresit. Sipas politikanit të kohës, Ali Këlcyra, gjatë kohës së intervencionit Ejresi takohej me shumë patriotë, ushtarakë e civilë të cilëve u predikonte: “... është e kotë të luftoni e rezistoni. Fati i Fan Nolit dhe përkrahësve të tij është i caktuar, ata janë të dënuar nga qeveritë e larta ndërkombëtare si vegla të Rusisë. Nëse Zogu nuk mund të triumfojë, atëherë divizionet jugosllave e greke do të marrin urdhër për të marshuar në tokat shqiptare për t'i bërë spastrimet e duhura”.<sup>49</sup>

Në kushtet e përparimit të shpejtë nga veriu e jugu të trupave intervencioniste, diplomacia shqiptare, më 18 dhjetor 1924, iu drejtua

<sup>47</sup> Zh. Avramovski, “Kontribut studimit të historisë...”, f. 130-131.

<sup>48</sup> *Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941*, Botim i Drejtorisë së Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë: 1959, Dok. 175 dhe Dok. 176, f. 164-165.

<sup>49</sup> Ali Këlcyra, *Shkrime për historinë e Shqipërisë: kujtime politike, si dhe shkrime të tjera e letërkëmbime, të hulumtuara ndër arkiva të hulumtuara prej Tanush Frashërit*, Tiranë: Onufri, 2012, f. 119.

sërish tri Fuqive të Mëdha evropiane, Britanisë së Madhe, Francës e Italisë, që të dënonin ndërhyrjen ushtarake dhe të ndikonin në Beograd për të ndërprerë agresionin. Po atë ditë, Qeveria shqiptare i kërkoi Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve ndaljen e agresionit.<sup>50</sup> Me shpresën se do të ndikonte pozitivisht tek fuqitë, Qeveria e Nolit më 18 dhjetor u komunikoi përfaqësuesve sovjetikë, që kishin mbërritur në Shqipëri dy ditë më parë, se prania e tyre ishte jashtëzakonisht e papërshtatshme për momentin. Po të njëjtën ditë, sovjetikët u larguan nga Shqipëria.<sup>51</sup> Për më tepër, një notë proteste iu dorëzua edhe Qeverisë së SKS-së nga ministri shqiptar në Beograd. Nota akuzonte Qeverinë jugosllave për organizimin e bandave që po kryejnë agresion ndaj territorit shqiptar dhe njëkohësisht njoftonte se Qeveria shqiptare ka shpallur mobilizimin e përgjithshëm për t'u mbrojtur nga agresioni i jashtëm. Por diplomati jugosllav u përgjigj se nota përmbante akuza të tilla sa të mos diskutoheshin fare nga Qeveria jugosllave.<sup>52</sup>

Sidoqoftë, qëndrimi britanik ishte përcaktuar qysh më herët kur Nikolsoni intervencionin e cilësoi si një trazirë të brendshme duke u pajtuar me këshillën e ministrit të saj në Beograd, Alban Jung: *"Dyshoj që nëse i hetojmë faktet, ato mund të na japin një ngjyrë të intervencionit të jashtëm, prandaj do të ishte më e dëshirueshme që kjo të trajtohet si një trazirë e brendshme"*.<sup>53</sup>

Miratimi britanik për intervencion në Shqipëri dëshmohej edhe nga vetë kryeministri Çamberlen në një mbledhje të kabinetit qeveritar të mbajtur në fillim të vitit 1925, ku ai deklaroi: *"...politika e Qeverisë britanike ishte të parandalonte që kjo çështje lokale shqiptare të shndërrohej në një çështje ndërkombëtare. Ai tha se kishte marrë garanci nga ministrat e jashtëm jugosllavë e italianë gjatë konferencës së fundit të Lidhjes së Kombeve, se edhe ata e kishin parasysh këtë fakt"*.<sup>54</sup> Ky prononcim jep të kuptohet se Qeveria britanike nuk e shihte stabilitetin e Shqipërisë, rrjedhimisht edhe të rajonit, nën udhëheqjen e Nolit, dhe se një stabilitet i tillë mund të arrihej vetëm me Zogun, sidomos kur fqinjët si Jugosllavia dhe Italia kishin miratuar në parim rikthimin e tij në pushtet.

<sup>50</sup> Gazeta *The Western Daily Press Bristol*, 20 dhjetor 1924, f. 3.

<sup>51</sup> TNA, FO 371/9643 C19060/3585/90, H. Eyres për Foreign Office, 18 dhjetor 1924, f. 127.

<sup>52</sup> *Po aty*, f. 3.

<sup>53</sup> W. Bland & I. Price, *A tangled web...*, f. 26.

<sup>54</sup> TNA, CAB Referenca: /23/49, Mbledhje e kabinetit qeveritar, 5 janar 1925, f. 147.

Suksesi i intervencionit bëri që Noli i shoqëruar nga të gjithë ministrat e qeverisë së tij me familjet e tyre të largoheshin për në Itali. Përveç stafit politik me Nolin iku edhe një pjesë e ushtrisë.<sup>55</sup>

Faktori i jashtëm ishte vendimtar për rënien e Nolit dhe kthimin e Zogut, por nuk duhet anashkaluar as faktorin e brendshëm. Qëndrimi tradicional i Qeverisë britanike ndaj një vendi ku pushteti merrej me dhunë ishte mosnjohja e asaj qeverie derisa ajo të mos legjitimohej me zgjedhje të lira. Perceptimin e saj për një Evropë të qetë Londra e shihte përmes pushteteve të qëndrueshme, e këtë stabilitet sipas saj, mund ta kthente vetëm Zogu.<sup>56</sup>

Përkundër ndërhyrjes flagrante Qeveria jugosllave mohonte çdo përgjegjësi lidhur me intervencionin. Vetëm tri vite më vonë, në prill 1927, Ninçiq do të pranojë hapur ndërhyrjen në një intervistë dhënë për shtypin francez, ku theksonte: “...ishte e vetmja situatë që lejonte intervencionin përballë rrezikut të bolshevizmit”.<sup>57</sup>

---

<sup>55</sup> Gazeta *The Courier*, Monday, 29 dhjetor 1924, f. 5.

<sup>56</sup> Lush Culaj, “Qeveritë e Zogut ndaj problemit kombëtar”, *Gjurmime albanologjike*, nr. 33-34, Instituti Albanologjik, Prishtinë: 2005, f. 87.

<sup>57</sup> A. Puto, *Shqipëria politike...*, f. 382.

Armend MEHMETI

## SUMMARY

### **ZOGU'S INTERVENTION OF ALBANIA - IN THE LIGHT OF YUGOSLAV AND BRITISH SUPPORT**

The political struggle in Albania culminated in the events of June 1924, which marked the forceful overthrow of Albanian government led by Ahmet Zogu and rising on power of a government lead by oppositional leader Fan Noli. The overthrow of the government was carefully observed in Yugoslavia, particularly due to the fact that the Albanian minority living in Yugoslavia did not fully obey to Yugoslavian state. The Yugoslavian government analysed overall circumstances and decided that Noli's government should not be recognized for several reasons: its pro-Soviet disposition; its familiarity to the Kosovo Albanian nationalist leaders and their ties to Macedonian insurgent organization; the need of Belgrade to have a loyal man in Albania in order to carry out the Yugoslavian projects in the future; and economic-financial issues. Therefore, the Yugoslavian government decided to support Zog's claims to return in power. On the other hand, Great Britain perceived Noli as a danger to the peace in the Balkans and British interests which involved oil concessions in Albania for Anglo-Persian Oil Company. Thus, Great Britain tacitly supported the Yugoslavian project to support Zogu's return on power. By the end of 1924 Zogu's troops, organized in Yugoslavia, armed and supported by regular and camouflaged Yugoslav military forces marched towards Albania. Fan Noli's government complained to League of Nations, but the Great Powers decided to remain deaf. Noli was not supported even by Albanian people who were dissatisfied with anarchy, hopes for a better life and hopeless promises. Noli and his followers escaped to Italy. Zog restored his power in Albania. As a result Albania enjoyed a political tranquillity that enabled Zog to carry out reforms in Albania.

Sabit SYLA

## KOSOVA NDËRMJET FUQIVE TË BOSHTIT DHE ALEATËVE TË MËDHENJ PERËNDIMORË

Lufta e Dytë Botërore prishi ekuilibrat gjeopolitikë dhe kufijtë e shumë shteteve, realitet me të cilin nuk u pajtuan shtetet e koalicionit antifashist. Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore përfaqësuesit e Aleatëve të Mëdhenj dhe të kombeve të tjera antifashiste, hartuan plane dhe ndërmorën iniciativa për të arritur fitoren mbi Fuqitë e Boshtit dhe për të rindërtuar të ardhmen e tyre pas mbarimit të Luftës. Periudha e viteve 1944-1945, kur Aleatët kishin vendosur mbizotërimin në terren dhe kur fitorja e tyre ishte në horizont, ka qenë koha më intensive, gjatë së cilës u mbajtën takime të shumta midis tyre. Vendimet e ndërmarra në takimet dypalëshe apo shumëpalëshe, në konferenca e protokolle, patën ndikim në zhvillimin e luftës dhe të ardhmen e popujve pas përfundimit të saj. Nga ana tjetër, qysh në fillim të luftës edhe Fuqitë e Boshtit u munduan të aktivizonin dhe të siguronin mbështetjen e popujve të ndryshëm të pakënaqur nga Lufta e Parë Botërore, si dhe të atyre të ndarë nga kombet e tyre dhe gjithashtu të pakënaqur nga shtetet në të cilat ata ishin të detyruar të bashkëjetonin. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, popujt ballkanikë bënë në njëfarë mase zgjidhje të detyruara, duke u rreshtuar përkrah njërit apo tjetrit koalicion. Bullgaria dhe Rumania iu bashkëngjitën Fuqive të Boshtit, Turqia qëndroi neutrale ndërsa Jugosllavia, Shqipëria dhe Greqia kombeve antifashiste të kryesuar nga tre Aleatët e Mëdhenj. Por, edhe brenda grupimit të tri shteteve ballkanike shkalla e rezistencës nuk qe e njëjtë dhe jo të gjitha forcat iu kundërvunë pushtimit. Brenda tyre pati bashkëpunëtorë të pushtuesve, por edhe luftë civile brenda luftës çlirimtare.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Prishtinë: “Instituti i Historisë”, 2012, f. 27.

Objekt studimi i këtij punimi është Kosova, një vend në juglindje të Ballkanit i banuar me shumicën dërmuese shqiptare, tek të cilët gjithmonë ka ekzistuar pretendimi për t'u çliruar nga zgjedha serbe dhe për t'u bashkuar me pjesën tjetër të kombit, të ndarë padrejtësisht nga Konferenca e Londrës e vitit 1913. Zhvillimet politike e ushtarake që buruan nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore pashmangshëm përfshinin edhe Kosovën, e me këtë edhe përpjekjet për realizimin e aspiratave të cekura më lart në krah të Boshtit apo Aleatëve, varësisht nga zhvillimet apo rrethanat e krijuara.

### **Qëndrimi i forcave të Boshtit**

Pushtimi dhe aneksimi i Shqipërisë ishte vetëm një hallkë lidhëse në zinxhirin e projekteve ekspansioniste të Italisë. E nxitur nga invadimi gjerman në Evropë, qysh në verë të vitit 1939 Italia filloi të hartojë plane për zgjerim të mëtutjeshëm në Ballkan. Në planet e saj hyri edhe Jugosllavia, e si rrjedhojë edhe Kosova e trevat tjera shqiptare. Duke njohur pozitën e rëndë të popullit shqiptar në Jugosllavi dhe dëshirën e përgjithshme për bashkim kombëtar, Italia filloi ta promovojë nacionalizmin shqiptar, bashkimin e tyre në një shtet dhe hartimin e një strategjie konkrete, që sipas Cianos, duhej të shtrihej në tri faza pasuese: (1) propagandë e përgjithshme duke vënë theksin mbi kulturën e religjionin; (2) menaxhimi i mirëqenies publike; (3) një organizatë klandestine ushtarake të jetë e gatshme për momentin kur do të shfaqet kriza e pashmangshme jugosllave.<sup>2</sup>

Planet e Cianos dhe Musolinit fillojnë të shohin dritën tek në pjesën e parë të vitit 1941, kur Gjermania, e acaruar nga zhvillimet në Jugosllavi, pasi që Qeveria jugosllave u rrëzua nga një grusht shtet, qysh të nesërmen pas nënshkrimit të aderimit në Paktin Trepalësh, më 25 mars 1941, ndërmori një fushatë bombardimesh ajrore ndaj Jugosllavisë në mëngjesin e 6 prillit 1941. Forcat ajrore gjermane pastruan terrenin për depërtimin e njërive të motorizuara të ushtrisë gjermane nga veriu dhe jugu i Jugosllavisë, krahas forcave italiane që mbështeten aksionin e Hitlerit dhe që depërtuan në viset tjera të Jugosllavisë.<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup>*The Ciano Diaries 1939-1943*, edited by Hugh Gibson, Simon Publications, 2001, f. 93-112.

<sup>3</sup>L. S. Stavrianos, *The Balkans since 1453, with a new introduction by Traian Stoianovich*, Hurst&Company, London, 2000, f. 757.



Aksioni i forcave të Boshtit përfundoi me copëtimin e Jugosllavisë, e fat të njëjtë pësuan edhe trevat shqiptare nën sundimin e këtij shteti, që sipas marrëveshjes së 21 prillit 1941, midis Ribentropit e Cianos, u ndanë midis Gjermanisë, Italisë e Bullgarisë.<sup>4</sup> Copëtimi u bë sipas një plani gjerman të hartuar në prag të bombardimit të Jugosllavisë. Në korniza të përgjithshme, ky plan njihte Kroacinë si një shtet autonom, Italisë i njihej Dalmacia, Jugosllavia Veriperëndimore dhe Mali i Zi, pjesa më e madhe e Maqedonisë i jepej Bullgarisë, një pjesë e Danubit i jepej Hungarisë, kurse Serbia e Vjetër\* u vu nën administrimin ushtarak gjerman.<sup>5</sup>

Paralelisht me bisedimet, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë italiane kishte projektuar pushtimin e territoreve jugosllave, kurse në rastin e trevave shqiptare ishte paraparë që divizionet italiane t'i merrnin nën kontroll zonat: Gjakovë-Pejë-Prishtinë-Prizren dhe Gostivar-Ferizaj-Kërçovë.<sup>6</sup>

Më saktësisht, trevat e Plavës, Gucisë, Rozhajës, Tutinit dhe qendrat me rrethinat e Ulqinit (Ulqini me rrethinë, zona rreth liqenit të Shkodrës dhe një pjesë e fushës së Podgoricës), Tetovës, Gostivarit, Dibrës, Strugës dhe Kërçovës, u gjendën në zonën e okupimit italian dhe iu bashkëngjitën Shqipërisë, Dekretligji mbretëror nr. 264, i datës 12 gusht 1941<sup>7</sup>, respektivisht vënien nën kontrollin italian të pjesës më madhe të trevave të banuara me shqiptarë. Ky akt u konsiderua si arritje e një aspirote kombëtare ngaqë me trugun amë u bashkua një sipërfaqe jo më e vogël se 12 645 km<sup>2</sup> me një popullsi prej afro 1 milion banorësh.<sup>8</sup> Ndërkaq, rrethet e Mitrovicës, Vushtrrisë, Podujevës etj., mbetën nën zonën gjermane të pushtimit, kurse një pjesë e rrethit të

<sup>4</sup>*Documents on the German Foreign Policy 1918-1945* (më tej: *DGFP*), Series D (1937-1945), Volume XII, The War Years, Febr. 1-June 22 1941, United States Government Printing Office, Washington, 1962. Dok. 378, f. 595.

\*Me termin "Serbi e Vjetër" gjermanët e konceptonin një rajon nga Danubi në veri deri në Mitrovicë në jug..., të cilin e vunë nën administrim ushtarak...

<sup>5</sup>*DGFP*, Series D (1937-1945), Volume XII..., Dok. 291, f. 487.

<sup>6</sup>*Zbornik Dokumentata i Podataka o Narodnooslobodilačkom ratu naroda Jugoslavije* (më tej: *ZDPN*). Tom XIII, Knjiga 1, Dokumenti Kraljevine Italije 1941, Vojno istorijski Institut, Beograd, 1969, Dok. 2, f. 13.

<sup>7</sup>*Fletorja zyrtare* 19 qershor 1943-XXI, Nr. 70, f. 4. Dekret Mëkambësuer Nr. 189, Krijim i Këshillave Administrative në Viset e Lirue, Tiranë, 28 maj 1943. Alberto Pariani, Ekrem Libohova & Kolë Bib Mirakaj.

<sup>8</sup>TNA, WO 204/9558, HS-AFHQ144/5, Viti 1944, Memorandum: Politika gjermane në Shqipëri, viti 1944.

Gjilanit, Ferizajt, Kaçanikut, rrethi i Shkupit, Kumanovës, Luginës së Preshevës, etj., mbetën nën pushtimin bullgar.<sup>9</sup>

Duhet cekur se zonat që mbetën nën kontrollin gjerman u konsideruan si territor i Serbisë nën administrimin ushtarak gjerman. Por, marrëveshja midis Cianos e Ribentropit, për ndarjen e zonave pësoi një ndryshim të vogël dhe më 6 maj 1941, u vendos një lloj demarkacioni midis tri fuqive. Linja e demarkacionit të zonës së okupuar nga trupat italiane, që përfshiu territoret e cekura më lart dhe ato gjermane e bullgare, ishte si në vijim: Sienicë-Novii Pazar-Mitrovicë dhe një pjesë e hekurudhës Mitrovicë-Prishtinë-Ferizaj (gjitha këto iu ndanë Gjermanisë); Kaçanik i vjetër-Shtërpçë (i u ndanë Bullgarisë).<sup>10</sup>

Një ndarje e tillë ishte bërë në bazë të interesave ekonomike, politike (strategjike) dhe etnike. Që të dyja, si Italia ashtu edhe Gjermania, synonin resurset minerale të Kosovës, ato kishin njohuri për pasuritë e plumbit dhe zinkut në rajonin e Mitrovicës dhe për minierat e kromit në një rajon jo larg Prizrenit, që kishin një kapacitet deri 15 000 tonë.<sup>11</sup>

Në një raport të hollësishëm nga një ekspert i xeheve që ia dërgoi Musolinit, më 20 prill 1941, theksohej se në qoftë se Italia do ta kishte në dorë xeheroren e Trepçës, ajo do të bëhej eksportuesja më e madhe e plumbit dhe zinkut në Evropë. Por, natyrisht edhe gjermanët ishin po aq të interesuar ta merrnin Trepçën e ta kontrollonin linjën hekurudhore Mitrovicë-Kaçanik.<sup>12</sup>

Kështu, gjatë bisedave midis Ribentropit e Cianos për copëtimin e Jugosllavisë, i pari kishte qenë shumë i qartë në shprehjen e interesave ekonomike gjermane, që konsistonin në minierat e kromit dhe të plumbit në Luboten të Maqedonisë dhe depozitat e plumbit në Mitrovicë.<sup>13</sup> Mu për këtë arsye, komandanti i Ushtrisë gjermane për sektorin juglindor, kishte parashtruar një kërkesë për zhvendosjen e linjës së demarkacionit 10km përtej hekurudhës, duke potencuar se zona në fjalë posedonte pasuri të

<sup>9</sup>Fatmira Rama, *Dukuri arsimore gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri*, Argeta-LMG, Tiranë, 2005, f. 49-50.

<sup>10</sup>ZDPN, Tom XIII, Knjiga I, Dokumenti Kraljevine Italije 1941, Dok. 14, f. 43.

<sup>11</sup>TNA, WO 204/9558, HS-AFHQ144/5, Viti 1944, Memorandum: Politika gjermane në Shqipëri, Viti 1944.

<sup>12</sup>Noel Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2011, f. 372.

<sup>13</sup>DGFP, Series D (1937-1945), Volume XII..., Dok. 385, f. 607.

shumta të mineraleve të azbestit e kromit, të cilat kurrësi nuk duhej të binin në duar të italianëve.<sup>14</sup>

Interesimi gjerman për burimet minerale bazohej në nevojat e industrisë gjermane të luftës. Trepça kishte depozita të mëdha të plumbit e zinkut. Kompania angleze që gjatë viteve 1930 e menaxhonte Trepçën, raportonte se në ditë nxirreshin rreth 8 000 tonë koncentrate të plumbit e zinkut.<sup>15</sup> Në fakt, Trepça dërgonte çdo ditë 500 tonë koncentrat plumbi e zinku në fabrikat e municionit të Gjermanisë, duke furnizuar kështu përafërsisht 40% të plumbit që e përpunonte Gjermania.<sup>16</sup>

Por, ishin po të njëjtat depozita minerale faktorë që shkaktuan kontradikta gjermano-italiane në trevat shqiptare, apo indikacione që hodhën në dritë mosbesimin reciprok midis forcave të Boshtit. Në fund të tetorit 1941, forcat e sigurisë gjermane raportonin për një aktivitetet të emisarëve italianë në rajonin e Mitrovicës, që ishte nën kontrollin e gjermanëve. Sipas tyre, togeri shqiptar Hilmi Leka, që cilësohej si italoofil dhe Shtila\*, që ishte administrator në Shqipërinë e Jugut, po punonin me krerët shqiptarë të zonës në fjalë, për t'i bindur ata që të shkojnë në Tiranë e Romë, për të bërë kërkesë që zona e Mitrovicës t'i bashkohej Shqipërisë.<sup>17</sup>

Përpjekje të tilla sigurisht që u parandaluan nga gjermanët, të cilët ishin të bindur se prapa tendencave italiane për fuqizimin shqiptar në zonat nën kontrollin gjerman dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë, qëndronte qëllimi për marrjen e Trepçës.<sup>18</sup>

Por, nuk ishin vetëm xehet e Kosovës në optikën e interesave italiane e gjermane. Rëndësi primare kishte edhe pozita gjeografike e Kosovës që karakterizohej nga dalja natyrale në malet e larta të Shqipërisë Verilindore dhe qasja në luginën Shkup-Mitrovicë, e rëndësishme nga aspekti strategjik sidomos kur në të kalonte linja rrugore

<sup>14</sup>ZDPN, Tom XII, Knjiga I, Dokumenti Nemačkoga Rajha 1941, Vojnoistorijski Institut, Beograd, 1973, dok. 224, f. 586.

<sup>15</sup>Živko Avramovski, *Britanci o Kraljevini Jugoslaviji*, Knjiga Druga (1921-1930), Arhiv Jugoslavije, Globus, Zagreb, f. 58-124.

<sup>16</sup>N. Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër...*, f. 383.

\*Tahir Shtylla, ish-ministër i Shqipërisë në Beograd dhe anëtar i Komisionit për Rivendikimet Shqiptare të formuar në Tiranë në vitin 1940.

<sup>17</sup>ZDPN, Tom XII, Knjiga I, Dokumenti Nemačkoga Rajha 1941, Dok. 216, f. 553.

<sup>18</sup>ZDPN, Tom XII, Knjiga II, Dokumenti Nemačkoga Rajha 1942, Vojnoistorijski Institut, Beograd, 1976, Dok. 81, f. 442-443.

dhe degëzimi hekurudhor që e lidhte Beogradin me Shkupin e Selanikun, si dhe qasja në hekurudhën Ohër-Tetovë.<sup>19</sup>

Si Italia ashtu edhe Gjermania e panë të nevojshëm bashkëpunimin me popullatën lokale, respektivisht përvetësimin e tyre përmes disa masave në aspekte etnike sikurse njohja e të drejtave elementare për shkollim dhe krijimi i një administrate lokale. Nuk ka dyshim, që një nga synimet e masave të tilla ishte edhe parandalimi i veprimtarisë së rezistencës në zonat përkatëse. Kështu, në viset që mbetën nën okupimin italian nga gjysma e vitit 1941 deri në shtator të vitit 1943, u vendos një administratë civile nën drejtimin e “Ministrit për trojet e çliruara”.<sup>20</sup> Në krye të kësaj ministrie qëndruan rreth shqiptare të cilët shfrytëzuan mundësitë e ofruara dhe organizuan sistemin arsimor në Kosovë, që gjatë viteve 1941-1944 punoi sipas ligjeve arsimore të Ministrit të Arsimit të shtetit shqiptar; gjatë viteve në fjalë në Kosovë vepruan rreth 180 shkolla fillore.<sup>21</sup> Ishte kjo një arritje e madhe në kohën kur në Kosovë dhe trevat tjera shqiptare mbizotëronte një shkallë e lartë e analfabetizmit dhe e dëshirës së flaktë për arsim.

Ndryshe nga italianët, gjermanët që kishin nën kontroll zonën e Mitrovicës bashkëpunuan ngushtë me popullsinë shqiptare e serbe. Menjëherë pas pushtimit të zonës së Mitrovicës, komandanti i Divizionit 60 të Këmbëorisë së Ushtrisë gjermane mbledhi, më 21 prill 1941, krerët shqiptarë të Mitrovicës, Vushtrisë, Novi Pazarit, Drenicës, Llapit etj., të cilët i ftoi në organizimin e një administrate lokale, respektivisht në krijimin e mekanizmave të cilat do ta ruanin ligjin dhe rendin publik. Në kudër të kësaj hynte krijimi i një policie, gjyqësie dhe të një sistemi lokal financiar.<sup>22</sup> Po ashtu, u lejua edhe organizimi i një sistemi arsimor në gjuhën shqipe. Shkollat shqipe në këtë zonë funksionuan me plane të Shqipërisë, por me miratimin e Qeverisë së Serbisë.<sup>23</sup>

Një situatë e tillë kishte vazhduar deri nga shtatori i vitit 1943. Kapitullimi dhe tërheqja e ushtrisë italiane u reflektua në shumë dimensione kur kemi të bëjmë me Kosovën dhe shqiptarët në përgjithësi. Së pari, trevat shqiptare tani u vunë nën kontrollin gjerman, kurse në aspektin ndërkombëtar forcat Aleate në Ballkan duhej ta luftonin vetëm

<sup>19</sup> TNA, WO 2049558, HS-AFHQ144/5, Memorandum për rëndësinë ekonomike të Kosovës, 18 korrik 1944.

<sup>20</sup> N. Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtër...*, f. 373.

<sup>21</sup> Hysni Myzyri, *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Prizren, 2001, f. 293-294.

<sup>22</sup> ZDPN, Tom XII, Knjiga I, Dokumenti Nemačkoga Rajha 1941, Dok. 18, f. 53-55.

<sup>23</sup> Hakif Bajrami, *Dokumente të institucioneve gjermane për historinë shqiptare 1941-1944*, Vatra, Prishtinë, 1998, f. 290-294.

Gjermaninë, derisa kjo e fundit shpresat për realizimin e planeve të saj i shihte në bashkëpunimin me popullsitë shqiptare, kroate, gjermanëve të Vojvodinës dhe ndoshta të një pjesë e sllovenëve. Nga viti 1944 kishin filluar të vëreheshin shenjat e dobësimit të Gjermanisë dhe konsolidimi dhe përparimi i forcave aleate. Zhvillimet politike dhe ushtarake i vunë shqiptarët para një dileme të madhe. Si të veprohej më tej? Nën pushtimin italian e më pas gjerman, ishte realizuar pjesërisht ëndrra e bashkimit kombëtar, por ndryshimet e kufijve nuk do të njiheshin nga Aleatët, aq më tepër kur ato tani njihnin Jugosllavinë. Megjithatë, Komiteti i Lidhjes II të Prizrenit, ende shpresonte në fitoren e Gjermanisë dhe realizimin e kësaj asperate e shihte tek gjermanët. Tashmë, në skenë ishin paraqitur grupimet me këndvështrime dhe ide politike antifashiste. Në këto forca bënë pjesë dy grupime të kundërta ideologjike: partizanët komunistë dhe nacionalistët. Në këto rrethana, çështja e Kosovës mori një dimension të ri në aspekt të jashtëm dhe të brendshëm. Në planin e jashtëm, ndonëse Aleatët nuk njihnin ndryshimin e kufijve, ata megjithatë njihnin të drejtën e vetëvendosjes, dhe kjo u jepte shpresë forcave nacionaliste se bashkëpunimi me Aleatët mund të çonte në të drejtën e Kosovës për vetëvendosje. Ndryshe nga nacionalistët, komunistët i jepnin më tepër rëndësi çlirimit dhe vëllazërimit midis popujve të Ballkanit, e që si rrjedhojë do ta kishte edhe zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Situata rreth Kosovës do të komplikohet edhe më tej, kur komunistët jugosllavë do të punojnë heshtazi ashtu si nga fillimi i luftës, për rikthimin e saj në kuadër të Jugosllavisë. Në këtë mënyrë, vitet 1944-1945 paraqesin zhvillime dramatike lidhur me çështjen e Kosovës që ishte rezultat i përplasjes së qëllimeve të grupimeve të mësipërme.

Nga fundi i marsit 1944, Komiteti Qendror i Lidhjes II të Prizrenit, përmes një letre të nënshkruar nga kryetari i saj, Bedri Pejani, i shprehu Hitlerit gatishmërinë për të bashkëpunuar me Gjermaninë, respektivisht kërkoi militarizimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare që më 1941 i ishin bashkuar Shqipërisë. Një militarizim i tillë do të bëhej nën drejtimin gjerman dhe premtuhej një forcë prej 120 000-150 000 njerëz, të cilët duhej të armatoseshin me armë moderne dhe të organizoheshin e mbikëqyreshin nga oficerë gjermanë. Komiteti në fjalë shpresonte se përmes këtij militarizimi do të arrihej çlirimi përfundimtar i popullit shqiptar në krah të Rajhut gjerman.<sup>24</sup>

<sup>24</sup>ZDPN, TomXII, Knjiga IV, Dokumenti Nemačkoga Rajha 1944-45, Vojnoistorijski Institut, Beograd, 1979, Dok. 49, f. 218-219.

Por siç duket, një ofertë e tillë hasi në skepticizmin e gjermanëve pasi në përgjigje thuhej se gjatë periudhës në fjalë në formim e sipër ishte Divizioni 1 shqiptar, e më pas do të vazhdohej me formimin e Divizionit 2 dhe të një korpusi, ndonëse këto dy të fundit nuk u formuan.<sup>25</sup>

Në fakt, Gjermania e cila njohu kufijtë e Shqipërisë, nga prilli 1944 formoi Divizionin “SS Skënderbeg” që kryesisht përbëhej nga banorët e Kosovës dhe të Sanxhakut me detyrën kryesore të sigurimit të Kosovës, të linjës kufitare Tetovë-Bicaj-Kukës-Guci-Pejë, si dhe të mbrojtjes së hekurudhave dhe të infrastrukturës ushtarake gjermane nga partizanët.<sup>26</sup>

Lidhja II e Prizrenit kishte synim t’i luftonte komunistët ngaqë mendohej se ata kërkonin kthimin e sundimit jugosllav. Me fjalë tjera, kishte një gërshetim interesash me gjermanët. Në një raport të inteligjencës amerikane të marsit 1944, lidhur me grupimet e rezistencës në Shqipëri, Balli Kombëtar konsiderohej kryesisht si i orientuar kundër Gjermanisë dhe LNÇ-së, ndonëse nuk mund të përjashtoheshin edhe veprimet individuale në favor të gjermanëve.<sup>27</sup>

Se të gjithë pjesëtarët e formacioneve policore dhe ushtarake shqiptare nuk ishin kolaboracionist të pushtuesve gjermanë, e dëshmon edhe oficeri britanik, Piter Kemp, i cili kishte qëndruar shkurtazi në Kosovë dy herë, në dhjetor 1943 dhe janar 1944, në përpjekje për organizimin e rezistencës në Kosovë. Atij i kishte ofruar ndihmë shefi i Policisë në Pejë, si dhe komandanti shqiptar i garnizonit të Ushtrisë, i cili u pajtua që ushtarët t’ia linte në dispozicion Kempit, në rast të invadimit të Aleatëve.<sup>28</sup>

Nuk ka asnjë dyshim se e gjithë vëmendja nacionaliste shqiptare në Kosovë ishte drejtuar nga shmangia e rënies së serishme nën sundimin jugosllav, dhe në fund të fundit për ta ishte i pranueshëm çdo regjim i huaj përveç atij serb apo jugosllav, si dhe në ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë. Pra, nuk kishte mishërime emocionale me njërin apo palën tjetër ndërluftuese, Aleatët apo Boshtin. Kjo dëshmohet edhe nga qëndrimi i Mehdi Frashërit, në kohën derisa ushtronte detyrën e kryesuesit të Regjencës së gjermanëve. Ai e kishte dërguar të birin në Turqi për të tentuar të vendoste kontakte me Aleatët, dhe për t’i premtuar këtyre çdo lloj mbështetje kundër gjermanëve në rast se këta të fundit

---

<sup>25</sup>Po aty, Dok. 49, f. 221.

<sup>26</sup>Po aty, Dok. 50, f. 223.

<sup>27</sup>USA, Raport i Inteligjencës amerikane, 4 mars 1944, Ref. 65812-65815.

<sup>28</sup>N. Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtër...*, f. 389.

shkojnë drejt disfatës. Për më tepër, Mehdi Frashëri njihej për aktivitete kundërgjermane gjatë kohës derisa kishte qenë i internuar në Itali dhe se ai e kishte pranuar këtë pozitë, sipas një raporti, vetëm atëherë kur gjermanët kishin kërcënuar me pushtimin e plotë ushtarak të Shqipërisë si çmim i refuzimit.<sup>29</sup> Një fakt i tillë mbështetet edhe nga Herman Neubacher, përfaqësues i plotfuqishëm i Gjermanisë për Ballkanin. Në kujtimet e tij, që i sjell studiuesi Robert Elsie, Frashëri kishte kërkuar njohjen e neutralitetit të Shqipërisë, që do të ishte një “neutralitet relativ”. Qeveria shqiptare do t’i luftonte gjitha veprimtaritë spiunuese që rrezikojnë paqen e brendshme në Shqipëri. Nëse trupat gjermane sulmohen nga ushtritë tjera, Shqipëria do të qëndronte neutrale. Në këtë mënyrë, Neubacher e definoi sovranitetin e Shqipërisë si një sovranitet relativ.<sup>30</sup>

### Qëndrimi i Aleatëve

Sikurse rajonet tjera në Evropë dhe botë, edhe rajoni i Ballkanit paraqiti një pikë konfrontimi ushtarak midis forcave të Boshtit dhe atyre Aleate. Interesimi i forcave Aleate për ta sfiduar Italinë në Ballkan daton që nga pjesa e parë e vitit 1940, kur në kuadër të qarqeve ushtarake britanike filluan të krijohen mekanizma për veprimtari sabotuese apo subversive kundër shteteve që konsideroheshin armike të Britanisë. Në këtë mënyrë, në korrik 1940, formohet Special Operations Executive (SOE), dega e së cilës në Beograd përfshinte organizimin e aktiviteteve për Shqipërinë e Veriut, në krye të së cilës u vu Dayrell Oakley Hill, ish-instruktor në xhandarmërinë e Shqipërisë së Zogut. Kjo degë rekrutoi një numër shqiptarësh, si: Gani Kryeziu (me vëllezërit Seitin dhe Hasanin), Xhemal Herrin, Abaz Kupin, Muharrem Bajraktarin, Mustafa Gjinishin etj. Dega në fjalë përgatiti dhe më 17 dhjetor 1940, i parashtrori autoriteteve britanike planin për një kryengritje në Shqipërinë e Veriut, pa përfshirjen e Zogut. Plani ishte që Gani Kryeziu të veprojë me një forcë ushtarake nga Kosova që do të pajisen dhe financohen nga autoritetet ushtarake britanike. Kjo forcë parashihej që ta pushtonte Kukësin ku do ta formonte një “*qeveri kombëtare mbretërore*”, e cila më pas do të ndihmohej zyrtarisht nga Qeveria britanike si lëvizjes për çlirimin e Shqipërisë. Por, një plan i tillë u hodh poshtë pasi u refuzua

<sup>29</sup>USA, Raport i Office for Strategic Services, Ref. 65840, 3 prill 1944, f. 4.

<sup>30</sup>Robert Elsie, Hermann Neubacher - A Nazi Diplomat on Mission in Albania, [http://www.albanianhistory.net/1956\\_Neubacher/index.html](http://www.albanianhistory.net/1956_Neubacher/index.html) qasja 10 shkurt 2020.

nga Qeveria greke, e cila ishte kundër një qeverie të përkohshme shqiptare.<sup>31</sup>

Në këtë periudhë, Britania i kushtonte rëndësi të veçantë rolit të Greqisë në rajon dhe tentonte që përmes një politike progreke ta parandalonte rënien e saj nën orbitën gjermane. Sigurisht, qasja progreke ndikohej nga pozita e saj strategjike. Për britanikët ishte tepër me rëndësi të mbahej kontrolli i Mesdheut. Në anën tjetër, objektivat britanike lidhur me planin e mësipërm ishin të paqarta në rastin e Kosovës. Flitej për një “*lëvizje çlirimtare shqiptare*” dhe një “*qeveri kombëtare*”, por nuk jepeshin të dhëna se çka do të përfshihej në këtë projekt, aq më parë kur kryengritja duhej të zhvillohej nga shqiptarët e Kosovës.

Britania si një fuqi e kohës zhvillonte politika të jashtme të nivelit global dhe nuk mund të lejonte projekte të mekanizmave të saj ushtarakë që mund të sillnin probleme përcjellëse. Kjo mund të dëshmohet nga deklarata e sekretarit të Jashtëm britanik, Antony Eden, kur deklaronte se “*SOE nuk mund ta bëjë politikën e jashtme. Ata janë instrumenti ynë, e ne nuk jemi instrumenti i tyre*”.<sup>32</sup>

Politika britanike filloi të bëhet më dinamike në verë të vitit 1943. Rënia e Musolinit nga pushteti në korrik 1943, dhe më pas kapitullimi i Italisë në shtator 1943, dhe pushtimi që Gjermania i bëri rajoneve nën kontrollin italian në Ballkan,<sup>33</sup> bëri që vëmendja e forcave Aleate të kthehej nga Ballkani, e rrjedhimisht edhe nga shqiptarët ndonëse jo për nga rëndësia që ata i jepnin kombeve tjera. Me të dëgjuar për rënien e Musolinit, kryeministri britanik urdhëroi dërgimin e një misioni ndërlidhës ushtarak në Jugosllavi, për të vënë kontakte me Josip Broz Titon, komandant i përgjithshëm i Ushtrisë partizane dhe kryetar i Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Vendimi i Çerçillit për të dërguar një mision ushtarak ndërlidhës nënkuptonte se Britania tanimë njohu partizanët si faktorë lufte në Jugosllavi dhe gradualisht hoqi dorë nga bashkëpunimi me Lëvizjen Çetnike të Drazha Mihailoviqit.<sup>34</sup>

Një qasje e re vuri nën hije planet britanike të vitit 1942 për krijimin e një konfederate ballkanike midis Greqisë e Jugosllavisë, të diskutuara me qeveritë mbretërore në ekzil të këtyre dy vendeve, që

<sup>31</sup>William Bland and Ian Price, *A Tangled Web, A History of Anglo-American Relations with Albania (1812-1955)*, London, 1986, f. 43-48.

<sup>32</sup>*Po aty*, f. 54.

<sup>33</sup>ZDPN, Tom XII, Knjiga III, Dokumenti Nemačkoga Rajha 1943, Vojnoistorijski Institut, Beograd, 1978, Dok. 134, f. 540-543.

<sup>34</sup>Fitzroy Maclean, *The Heretic Tito - The life and time of Josip Broz Tito*, New York, 1957, f. 192-193.



mundësisht do ta përfshinte në të edhe Shqipërinë, e që do të zgjerohej më vonë edhe me shtetet tjera ballkanike.<sup>35</sup> Fokusi britanik pas kapitullimit të Italisë vihej vetëm në sigurimin e fitores në luftë, dhe përkohësisht hoqi dorë nga kalkulimet politike. Prandaj, misionet britanike pranë Titos kishin vetëm qëllime ushtarake. Politika britanike ishte që të dëmtohej armiku sa më shumë, e nisur nga ky qëllim ajo do ta ndihmonte çdokë që i luftonte gjermanët. Politika ishte çështje sekondare. Forma qeverisëse e Jugosllavisë, sikurse theksohej vazhdimisht, duhej të vendosej nga vetë jugosllavët pas lufte.<sup>36</sup>

Një qëndrimi i tillë politik i Britanisë konsistonte në respektimin e parimeve të Kartës së Atlantikut, një deklaratë e përbashkët e presidentit të SHBA-së dhe kryeministrit britanik, e transmetuar në gusht 1941, që ndër të tjera nuk njihte kufijtë e ndryshuar gjatë luftës dhe njihte parimin e vetëvendosjes së popujve.<sup>37</sup>

Në të njëjtën kohë, po i njëjti qëndrim u shpreh edhe nga Këshilli Ekzekutiv i Kominternit, i cili deklaronte se nuk e njihte ndryshimin e kufijve të bërë nga pushtuesit fashistë, dhe se do të respektoheshin kufijtë e paraluftës. Madje edhe porosiste, që të shmangeshin çështjet të tilla delikate e të diskutueshme, si çështja e kufijve, pasi kjo çështje ishte lënë për t'u gjykuar e për t'u zgjidhur pas mbarimit të luftës, në bazë të vetëvendosjes së lirë.<sup>38</sup> Internacionalja Komuniste përveç se nuk njihte asnjë ndryshim kufijsh të bërë prej Gjermanisë, do të deklaronte se, “*tanësia jugosllave duhet të mbesi siç qe*”.<sup>39</sup> Edhe Deklarata e Kombeve të Bashkuara, e 1 janarit 1942, e firmosur nga 26 shtete, ndër të cilët SHBA, BRSS, Britania e Madhe dhe Kina, e cila hodhi themelet e aleancës antifashiste, rikonfirmoi edhe njëherë Kartën e Atlantikut dhe parimet e saj.<sup>40</sup>

Në bazë të parimeve të mësipërme aleatët e Britanisë, SHBA e BRSS, gjatë dhjetorit 1942, ishin shprehur për pavarësinë dhe restaurimin e pavarësisë së Shqipërisë.<sup>41</sup> Një formulim i tillë jep të kuptohet se ata

<sup>35</sup>W. Bland and I. Price, *A Tangled Web...*, f. 57-58.

<sup>36</sup>F. Maclean, *The Heretic Tito...*, f. 201.

<sup>37</sup>Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë, 1999, f. 390-391.

<sup>38</sup>Xhelal Gjeçovi, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës*, Botimpex, Tiranë, 1998, f. 31.

<sup>39</sup>*Arkivi Qendror i Shtetit*, Fondi: 14, viti 1942, dos. 15, f. 1. Përgjigje e M. Popoviqit për letrën e Koço Tashkos, tetor 1942.

<sup>40</sup>*Declaration by the United Nations*, January 1, 1942, [https://avalon.law.yale.edu/20th\\_century/decade03.asp](https://avalon.law.yale.edu/20th_century/decade03.asp), qasja11 qershor 2019.

<sup>41</sup>*Foreign Relations of the United States Diplomatic Papers* (më tej: *FRUS*), Europe, Volume II, Washington, D.C.: U.S Government Printing Office, 1943, f. 1.

fjalën e kanë tek kufijtë e Shqipërisë së vitit 1913, rrjedhimisht Kosova dhe trevat shqiptare që kanë qenë në ish-Jugosllavi, do të mbesin në Jugosllavinë e re të pasluftës. Por, ngjashëm nuk ishte shprehur edhe Britania. Hezitimi për t'u shprehur jep të kuptohet se Britania ende nuk kishte vendosur se çfarë do të ndodhte me Shqipërinë pas lufte. Opsionet mbi të ardhmen e Shqipërisë, shkonin nga copëtimi midis Jugosllavisë e Greqisë si aleate të Britanisë e deri tek vendosja e një qeverie probritanike. Për më tepër, qëndrimi britanik në raport ndaj zhvillimeve në Shqipëri gjatë vitit 1943 ishte i ndryshëm nga ai me Jugosllavinë. Në rastin e Shqipërisë ajo inkurajonte forcat e rezistencës shqiptare të qëndronin pasive dhe të prisnin rastin kur do të piqen kushtet për dërgimin e forcave aleate tokësore dhe detare në Shqipëri. Duke miratuar një strategji të tillë, Britania ishte e prirë pafavorshëm ndaj zhvillimeve të shkallës së gjerë të betejës nacionalçlirimtare para zbarkimit të forcave anglo-amerikane në këtë vend. Por, planet britanike për një zbarkim të mundshëm në Ballkan dhe Shqipëri në pranverë-verë 1943, nuk u realizuan. Para Qeverisë britanike dhe komandës së Aleatëve u shfaqën dy probleme: *së pari*, a do ta trajtonin Shqipërinë si “territor mik” apo si “territor armik”, dhe *së dyti*, çfarë do të bënin me territoret shqiptare të Kosovës dhe viseve të tjera, a do të vazhdonin t'i ruanin ato siç ishin, apo do t'ia rikthenin Jugosllavisë e cila si edhe Shqipëria do të ishte nën administrimin ushtarak britanik. Planibritanik për zbarkim në Greqi, Shqipëri dhe Jugosllavi nuk gjeti miratimin e amerikanëve, të cilët e kundërshtuan atë veçanërisht në Konferencën e Ministrave të Jashtëm në Moskë, në tetor 1943. Pas kësaj periudhe, britanikët hoqën dorë nga plani i tyre për zbarkim në Ballkan. Operacionet e Aleatëve në këtë rajon do të ishin të kufizuara. Ato do të përqendroheshin në dhënien e furnizimeve për gueriljet ballkanike nëpërmjet transportit ajror e detar, dërgimit të forcave komando dhe bombardimit të objekteve strategjike.<sup>42</sup>

Misionet ushtarake britanike e vazhduan veprimtarinë e tyre në Kosovë dhe Shqipëri. Burimet ushtarake gjermane japin të dhëna se në janar 1944 në rajonin e Gjakovës, nën ndikimin e oficerëve anglezë, po organizoheshin forcat komuniste. Sipas këtyre burimeve, pesë oficerë anglezë zbarkuan me parashuta afër Kalimashit, kurse tre të tjerë ishin duke punuar me grupin e Fadil Hoxhës në Tropojë. Po ashtu, thuhet se misionet britanike janë duke punuar në linjën Tropojë-Krasniqe-Degë,

---

<sup>42</sup> Elisabeth Barker, *British Policy in South-East Europe in Second World War*, London: Macmillan Press LTD, 1976.

përfshirë këtu grupin e Adem Hoxhës, Fadil Hoxhës e Muharrem Bajraktarit, gjithë së bashku me rreth 800 njerëz.<sup>43</sup>

Por, Piter Kemp, njëri nga oficerët më të njohur britanik që veproi në Kosovë, konstatonte se përkrahja më e fuqishme nga radhët e parisë së Kosovës vinte nga familja e Kryezinjve të Gjakovës, dy prej të cilëve (Ganiu dhe Seiti) kishin qenë të internuar nga italianët me dyshimin se po merreshin me veprimtari probritanike. Pas kapitullimit të Italisë, ata nga gjysma e janarit 1944 arritën në Kosovë dhe i deklaruan Kempit se ishin të gatshëm të fillonin aksionin kundër gjermanëve. Ata kishin 100 ushtarë të armatosur dhe ishin të bindur që për një kohë të shkurtër mund t'i siguronin edhe 1000 të tjerë. Pas tre ditësh, pasi u pajtuan rreth një plani për organizimin e një kryengritjeje të përgjithshme në Kosovë, Kempit i erdhi urdhri nga eprorët e tij nga SOE, për t'i ndërprerë të gjitha kontaktet me ta, me arsyetimin se partizanët komunistë po protestonin kundër marrëveshjes së Kempit me krerët e rezistencës jokomuniste. *"Marrëdhëniet tona me partizanët jugosllavë"*, - thuhej në mesazhin e SOE, *"kanë një rëndësi vendimtare"*.<sup>44</sup>

Në vendimin e mësipërm shihen qartë dy tendenca: Britania njihte fuqinë e ushtrisë partizane jugosllave dhe ishte në gjendje të plotësonte edhe kërkesat e saj politike vetëm që ta ketë pranë në realizimin e qëllimeve të luftës, dhe e dyta, partizanët apo komunistët jugosllavë veçse kishin filluar të punonin tashmë haptas që Kosova dhe trevat shqiptare, të cilat kishin qenë nën ish-Mbretërinë e Jugosllavisë, të binin përsëri nën Jugosllavinë e re që do të krijohet pas lufte.

Në vazhden e tendencës së parë pozicionimi i Britanisë në krah të Titos u manifestua edhe në vendimet e Konferencës së Teheranit, të shpallura më 1 dhjetor 1943, pas bisedave midis përfaqësuesve më të lartë të SHBA-së, BRSS-së dhe Britanisë së Madhe. Pika 1 e konkluzioneve ushtarake shpreh vendimin që partizanët e Jugosllavisë të ndihmohen në shkallën më të lartë të mundshme me materiale dhe pajisje ushtarake, përfshirë edhe operacionet komando.<sup>45</sup>

Në këtë periudhë, kur Aleatët kishin filluar ta kalkulonin fitoren, në skenë të diskutimeve dolën edhe kufijtë midis Jugosllavisë e Shqipërisë. Koloneli Palmer, që kishte për mision të bisedonte me Enver

<sup>43</sup>ZDPN, Tom XII, Knjiga IV, Dokumenti Nemačkoga Rajha 1944-45, Dok. 19, f. 112-113.

<sup>44</sup>N. Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtër...*, f. 390.

<sup>45</sup>*The Tehran Conference, Declaration of the Three Powers*, December 1, 1943, <https://avalon.law.yale.edu/wwii/tehran.asp>, qasja 3 nëntor 2019.

Hoxhën rreth njohjes së Qeverisë shqiptare, i kishte thënë këtij të fundit se varej nga FNÇ e Shqipërisë nëse do t'i ndihmojë partizanët jugosllavë për dëbimin e gjermanëve nga Jugosllavia dhe se një gjë e tillë mund të zgjidhej midis Enverit e Titos, por se ai nuk ishte i autorizuar të ofrojë asnjë ndihmë jashtë kufijve të Shqipërisë së vitit 1939.<sup>46</sup>

Një deklaram i tillë kishte prapavijën tek njohuritë që oficerët anglezë i kishin për pretendimet jugosllave ndaj Kosovës. Philip Brod deklaronte: *“Kufijtë për të përfutur Shqipëria nuk duhet njohur, por duhet njohur kufijtë e vendosur në Konferencën e fundit të Paqes”*.<sup>47</sup> Ndërsa, diplomati D. S. Laskaj, më 1 nëntor 1944, do të shkruante: *“Qeveria jugosllave, përderisa mbetet kryesisht partizane, mund ta lejonte Shqipërinë të mbante Kosovën. Por, siç është sugjeruar në Athinë, ata mund të kërkojnë si shpërblim që Shqipëria të hyjë në ndonjë formë të Federatës jugosllave. Për sa i përket Shqipërisë unë mendoj senjë çmim i tillë ja vlen të paguhet”*.<sup>48</sup> Por, sa ishte real një vlerësim i tillë? Komanda Supreme e Aleatëve, duke mbështetur Mareshalin Tito dhe Lëvizjen Nacionalçlirimtare jugosllave në luftë ndaj gjermanëve, u premtonte atyre përfshirjen e Kosovës në të ashtuquajturën Serbi e Madhe. *“Serbë! Kur së bashku do të kemi fituar luftën, atëherë SHBA dhe Anglia do t'ju ndihmojnë ju të krijoni Serbinë e Madhe, të re e të fortë, të tillë që ju të bëheni populli më i fortë i Ballkanit, më i fuqishëm se kurdoherë”*.<sup>49</sup>

Ndryshe nga diplomati Laskaj, duket se Enver Hoxha e kishte konsideruar të rrezikshëm eksperimentin e mbetjes në një federatë të cekur më lart, ku gjasat për humbjen e përhershme të pavarësisë e më pas edhe copëtimin e trevave shqiptare ishin reale.

Vendimi i Aleatëve për të ndihmuar ushtrinë partizane jugosllave sigurisht që do të kishte pasoja negative për shqiptarët e Kosovës, të cilët tek Jugosllavia i shihnin përvojat e së kaluarës sikurse dhuna e terrori, shpërnguljet, kolonizimi e konfiskimi i pronave dhe mohimi i të drejtave elementare të njeriut. Prandaj, ata me skepticizëm të thellë shihnin edhe alternativën partizane, ndonëse kjo e fundit trumbetonte barazinë e kombeve.

<sup>46</sup>FRUS, The British Commonwealth and Europe, Volume III, 1944, f. 292.

<sup>47</sup>Arkivi i Institutit të Historisë-Tiranë, (më tej: AIH), Fondi: FO, viti 1944, dos. A. V. 158, Telegram i ministrit të Jashtëm, që i referohej Athinës për në Bari, f. 29.

<sup>48</sup>Po aty, f. 30.

<sup>49</sup>Uran Butka, *Gjeniu i Kombit*, vëll. II, Drier, Tiranë, 2006, f. 407.

Derisa tanimë ishte e qartë se Kosova do të mbetej sërish nën Jugosllavi, është me rëndësi të cekën edhe dy rekomandime lidhur me Kosovën dhe kufijtë shqiptaro-jugosllavë, të përgatitura nga Misioni Ushtarak britanik pranë Titos dhe Misioni Civil amerikan në Shqipëri. Në rastin e parë, nga Misioni Ushtarak britanik pranë Titos, në prill 1944 u raportua që *“e ardhmja e Kosovës do të vendosej me plebishit. Kufiri i saj, po të jetë e nevojshme, mund të caktohej në favor të Shqipërisë”*.<sup>50</sup> Duke u bazuar në dokumentet paraprake të Departamentit të Kërkimeve mbi kufirin shqiptaro-jugosllav dhe shqiptaro-grek, më 30 qershor 1944, Foreign Office përpunoi një raport mbi kufirin shqiptaro-jugosllav. Sipas këtij raporti, kufiri shqiptaro-jugosllav duhej ta ndiqte këtë linjë: *“Kurrizin malor midis sistemit krahor të Adriatikut e sistemeve të Detit të Zi dhe Egjeut, d.m.th. kështu ai do të mund të ndryshohej në mënyrë që të shkojë nga Veriu gjatë maleve të larta midis Plavës dhe Pejës, të rrotullohet në drejtim të Lindjes gjatë kurrizit malor midis Drinit të Bardhë dhe Sitnicës (do të thotë gjatë lartësive midis Metohisë dhe rrafshinave të Kosovës, duke ndarë kështu midis dy shteteve krahinën të marrë nga Jugosllavia dhe dhënë Shqipërisë në këtë lokalitet, më 1941), të futet në drejtim të Jugut gjatë kreshtës së maleve të larta, në lindje të Prizrenit dhe të Dibrës, të arrijë Liqenin e Ohrit midis Ohrit dhe Strugës. Kufiri veriperëndimor i Shqipërisë relativisht nuk kishte rëndësi. Kufiri i vendosur më 1941, etnikisht është më i mirë se ai që ekzistonte më parë. Nga ana tjetër, Gucia dhe Plava janë në anën e Jugosllavisë me male shumë të larta. Në afërsitë e Liqenit të Shkodrës pranimi nga ana e Jugosllavisë i linjës së vitit 1941 i kënaqshëm, por me një vlerë shumë të ngutshme, duke marrë parasysh popullsitë e vogla që ka aty. Pretendimet jugosllave në territorin shqiptar, nuk mbështeten në baza etnike. Ato do të mund të justifikoheshin nga konsiderata strategjike ose ekonomike (nevoja e Serbisë për të dalë në det). Por një nevojë e tillë mund të plotësohej me daljen e Serbisë në det në Dalmacinë e Jugut ose me anën e një skeme ndërkombëtare për zhvillim ekonomik të Shqipërisë dhe të Maqedonisë”*.<sup>51</sup>

Por, Qeveria britanike nuk ishte dakord me idenë e mbajtjes së një plebishiti që do të përcaktonte të ardhmen e shqiptarëve të këtyre territoreve, pavarësisht nga dëshira e tyre për t’u bashkuar me Shqipërinë dhe parimet e vendosura nga Karta e Atlantikut. Sidoqoftë, studiuesit

<sup>50</sup> AIH, Fondi: FO, viti 1944, dos. A. V. 159, f. 2. Mbi çështjet e kufijve shqiptaro-jugosllavë dhe shqiptaro-grekë.

<sup>51</sup> Po aty, f. 3.

seriozë dhe metodikë britanikë, brenda apo jashtë Ministrisë së Jashtme, nuk e kanë lënë pa e trajtuar edhe alternativën e bashkimit të plotë apo të pjesshëm të shqiptarëve në një shtet të vetëm, duke ndryshuar e korrigjuar kufijtë. Vëmendjes së tyre nuk i kanë kaluar as problemet ekonomike të shtetit të bashkuar shqiptar dhe rolit komplementar që solli bashkimi i territoreve shqiptare.<sup>52</sup>

Rekomandimi i dytë lidhur me kufijtë e Shqipërisë buron nga një raport i hartuar nën kujdesin e Misionit Civil amerikan në Shqipëri, me titull: *“Përmbledhje mbi të gjeturat dhe rekomandimet lidhur me njohjen e Qeverisë Demokratike të Shqipërisë”*, e cila i transmetohet Sekretarit amerikan të Shtetit, më 15 gusht 1945. Lidhur me çështjet kufitare shqiptaro-jugosllave, në rastin e Kosovës, raporti thekson: *“Autoritetet shqiptare me sa duket e kanë pranuar në heshtje qëndrimin jugosllav se nuk duhet të ketë ndryshime të këtij kufiri, por është e qartë se kjo heshtje është rezultat i ndikimit të Titos mbi regjimin aktual në Shqipëri... mundësisht komisioni që do ta studiojë problemin me kufirin greko-shqiptar, ta studiojë edhe këtë problem në aspekt të ofrimit të rekomandimeve përgjatë kornizave të një marrëveshjeje të ngjashme me ato të kufirit shqiptaro-grek, në përjashtim të asaj që një pjesë e madhe e territorit të Kosovës t’i bashkohet Shqipërisë dhe në bazë të kësaj të bëhet edhe transferimi i popullsisë. Po ashtu, nuk ka dyshim se bashkëpunimi i autoriteteve jugosllave në këtë drejtim është i domosdoshëm”*.<sup>53</sup>

Por, nuk ka asnjë reagim ndaj një oferte të tillë, apo së paku nuk ekzistojnë të dhëna për diçka të tillë nga qarqet diplomatike amerikane, ngaqë thuhej se një raport i tillë nuk është shtypur në letër, por i është transmetuar drejtpërdrejt Departamentit të Shtetit.<sup>54</sup> Në mungesë të burimeve dokumentare ne vetëm mund të supozojmë se ekziston mundësia që diçka e tillë të jetë hedhur poshtë si një ide e pabazë dhe e perealizueshme në rrethanat e kohës, apo ndoshta edhe Aleatët kanë menduar se çështja e transferimit të popullsisë në Kosovë mund të ishte një precedent për vendet tjera.

Siç duket, Enver Hoxha e kishte kuptuar mesazhin e Aleatëve, por edhe të jugosllavëve. Në Plenumin e KQ të PKSH-së, mbajtur në Berat nga 23 deri 27 nëntor 1944, çështja e Kosovës nuk u zu fare në

<sup>52</sup>Hamit Kaba&Sabit Syla, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Arkivat Kombëtare britanike, Prishtinë: “Instituti i Historisë”, 2018, f. 6.

<sup>53</sup>FRUS, Europe, Volume III, 1945, f. 46-51.

<sup>54</sup>Po aty, f. 46.

gojë. Po ashtu, për Kosovën nuk u diskutua zgjidhje e as nuk u fol për të në mbledhjen e dytë të KANÇ e as në ditën e 28 Nëntorit, kur qeveria e Enver Hoxhës, hyri në Tiranë dhe mbajti një fjalim të gjatë aty, para masës.<sup>55</sup> Po ashtu, në një artikull të gazetës “Bashkimi”, organ i Frontit Nacionalçlirimtar të Shqipërisë, botuar më 4 janar 1945, e që burimet amerikane e transmetonin më 9 janar 1945, ajo që binte në sy ishte se Enver Hoxha nuk e ngriti fare çështjen e Kosovës.<sup>56</sup>

Por, mund të ketë ndodhur që një qëndrim i tillë i LNÇ-së të Shqipërisë të ketë qenë rezultat i garancive të fuqishme jugosllave për të drejtën e vetëvendosjes së popujve, që mund të dëshmohej përmes dy akteve të mëhershme: (1) Udhëzimet që emisari Tempo ia adresonte Komitetit të Qarkut të PKJ-së për Kosovë, 2 tetor 1943, se: *“Sa i përket kufijve të ardhshëm midis Jugosllavisë e Shqipërisë, këto do të rregullohen përmes harmonisë vëllazërore midis UNÇ-së së Jugosllavisë dhe UNÇ-së së Shqipërisë, në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve”*<sup>57</sup>, dhe (2) Letra që Komiteti Qendror i PKJ i drejtonte Komitetit Qendror të PKSH, datë 2 dhjetor 1943, ku ndër të tjera thuhej: *“Secili popull ka të drejtë për vetëvendosje, përfshirë edhe shkëputjen; dhe se shqiptarët e Kosovës dhe të Metohisë kanë të drejtë të përcaktohen se ku dhe si dëshirojnë të jetojnë”*. Por një pikë të kësaj letre theksonte se *“ne nuk i përkrahim gjitha lëvizjet nacionale, por ato që veprojnë kundër imperializmit...”*<sup>58</sup> Letra e mësipërme argumenton strategjinë jugosllave në Kosovë, ushtritë partizane jugosllave shtypnin pa mëshirë çdo lëvizje të rezistencës kombëtare jo komuniste, duke i cilësuar ato si kundërrevolucionare.<sup>59</sup>

Një argument që shkon në drejtim të faktit se partizanët komunistë të Shqipërisë u kanë besuar deklaratave të partizanëve jugosllavë rreth vetëvendosjes së popujve gjendet në burimet amerikane të kohës. Në letrën që Këshilltari politik pranë Shtabit të Forcave Aleate, Aleksander C. Kirk, ia adresonte Sekretarit amerikan të Shtetit, 23 tetor

<sup>55</sup>S. Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës...*, f. 27.

<sup>56</sup>FRUS, Europe, Volume III, 1945, f. 4

<sup>57</sup>ZDPN, Tom IX, Knjiga VII, Partijsko-Politička Dokumenta 1944, Vojnoistorijski Institut, Beograd, 1970, f. 339.

<sup>58</sup>B. Petranović, M. Zečević, *Jugoslovenski Federalizam, Ideje i Stvarnosti...*, Tematska Zbirka Dokumenta, f. 809.

<sup>59</sup>N. Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtër...*, f. 390.

1944, thuhej se OSS\* raportonte se Enver Hoxha u shpreh në favor të kufijve jugorë të Shqipërisë, të caktuara nga Konferenca e Londrës, më 1913. Ai u shpreh se grekët duhet të kthehen në Shqipëri dhe nuk shih ndonjë arsye për plebishit në Shqipërinë Jugore, dhe se do ta kundërshtonte një iniciativë të tillë, pasi e konsideronte rajonin në fjalë si pjesë të Shqipërisë, për të cilin edhe do të luftonte. Në anën tjetër, Hoxha e konsideronte Kosovën si një problem që mund të zgjidhet me plebishit.<sup>60</sup> Megjithatë, propaganda jugosllave për vetëvendosje të popujve ishte vënë në sprovë nga Konferenca Nacionalçlirimtare, e mbajtur në Bujan më 31 dhjetor 1943 dhe 1, 2 janar 1944. Rezoluta që doli nga kjo konferencë, pika kryesore e së cilës ishte shprehja e së drejtës për vetëvendosje, respektivisht dëshirës së popullit shqiptar të Kosovës për bashkim me Shqipërinë hasi në reagimin negativ të qarqeve komuniste jugosllave, të cilat filluan një fushatë për dënimin dhe distancimin nga ky akt “separatist”.<sup>61</sup>

Pavarësisht të gjithave, fillimi i vitit 1945 shënon konkretizimin e ambicieve të partizanëve jugosllavë për vendosjen e Kosovës nën Jugosllavi. Më 8 shkurt 1945, komandanti suprem i UNÇ-së së Jugosllavisë jep urdhër për vendosjen e administratës ushtarake në Kosovë, kurse si komandant emëron një serbo-malazez, Sava Derljeviqi.<sup>62</sup> Qëllimi i kësaj administrate ishte shtypja e çdo lloji rezistence nga ana e shqiptarëve të Kosovës dhe përgatitja e kushteve faktike që Kosova të përfshihet në rregullimin e ardhshëm të Jugosllavisë, kuptohet jo si njësi konstituive federale, por vetëm si rajon territorial. Vendosja e administratës ushtarake u shoqërua me dhunë brutale kundër popullsisë shqiptare të ushtruar nga ushtritë partizane.

Ndonëse fati i Kosovës u vendos përmes përdorimit të forcës ushtarake nga ana e partizanëve jugosllavë, pati edhe atribute ligjore nga fuqitë aleate përmes dy akteve. E para, në Konferencën e Jaltës, shkurt 1945, tre të Mëdhenjtë njohën kufijtë e Jugosllavisë të parapushtimit, por duke e lënë të hapur problemin e pretendimeve jugosllave për kufijtë e saj me Italinë e Austrinë. Si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e këtyre vendimeve

---

\*OSS - Office of Strategic Services - Zyra për Shërbime Strategjike ishte një organizatë e inteligjencës amerikane gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe një paraardhëse e Agjencisë Amerikane të Inteligjencës - CIA.

<sup>60</sup>FRUS, The British Commonwealth and Europe, Volume III, 1944, f. 282.

<sup>61</sup>Branko Horvat, *Kosovsko Pitanje*, Globus, Zagreb, 1989, f. 225.

<sup>62</sup>ZDPN, Tom II, Knjiga XV, Dokumenta Centralnog Komiteta KP Jugoslavije i Vrhovnog Štaba NOV i PO Jugoslavije i Generalštaba JA, 1 janar - 15 maj 1945, Vojnoistorijski Institut, Beograd, 1982, Dok. 96, f. 169



Kosova *de jure* e *de facto* do të ishte në kuadër të Jugosllavisë. Ndërkaq, duke folur për Shqipërinë, Stalini e cilësoi atë që nuk meritonte status e respekt të duhur për t'u radhitur në krah të kombeve tjera.<sup>63</sup> Për më tepër, Konferenca e Jaltës kishte miratuar edhe një *"Deklaratë mbi Evropën e çliruar"*. Ndër të tjera në paragrafët e saj thuhej: *"Një nga parimet e Kartës së Atlantikut është që të gjithë popujt të zgjedhin formën e qeverisë nën të cilën mendojnë të jetojnë dhe që të drejtat sovrane të autonomisë nga të cilat u zhveshën me forcë prej vendeve agresore, duhet t'u kthehen"*.<sup>64</sup> Jo vetëm vendimi i Jaltës, por edhe kjo deklaratë binte në kundërshtim, për Kosovën për të drejtën e saj për vetëvendosje, përderisa theksohen të drejtat autonome.

E dyta, Sekretari britanik i Shtetit, paraqiti më 5 korrik 1945, një plan mbi kornizat e marrëveshjes paqësore me Italinë. Lidhur me Shqipërinë thuhej se Italia duhet ta njohë pavarësinë e Shqipërisë dhe të heq dorë nga pozitat e veçanta në këtë shtet në të kaluarën. Në memorandumin e përgatitur për paqe me Italinë shkruhej qartë se: (1) Italia ta njohë Shqipërinë si një shtet i lirë dhe i pavarur; (2) Italia t'ia njohë Shqipërisë ishullin e Sazanit; (3) gjitha traktatet midis Qeverisë italiane dhe të ashtuquajturës Qeveri shqiptare, që nga prilli 1938 të shpallen të pavlefshme dhe të anuluar.<sup>65</sup>

### Konkluzione

Duke analizuar të dhënat e mësipërme mund të vihet në përfundim se: Aleatët nuk patën qëndrim real ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve në përgjithësi. Ata jo vetëm se nuk njohën të drejtën e Kosovës për vetëvendosje, por edhe rrezikuan pavarësinë e Shqipërisë në favor të përkrahjes për interesat e tyre strategjike apo edhe favorizimit të shteteve tjera ballkanike. Konferencat paqësore të Aleatëve nuk favorizonin ndryshimin e kufijve, e njëkohësisht trumbetonin për të drejtën e vetëvendosjes së popujve, gjë që nuk u morr parasysh në rastin e Kosovës. Nga ana tjetër, realizimi i bashkimit kombëtar që u arrit nën okupimin e forcave të Boshtit ishte një realitet i përkohshëm që u venit me humbjen e këtij blloku. Në këto zhvillime, rol me rëndësi luajtën edhe forcat e rezistencës që u rreshtuan në njërin apo tjetrin bllok. LNÇ e cila në fund të luftës doli si fuqi mbizotëruese në Shqipëri, besoi te politika e

<sup>63</sup> Artur Conte, *Jalta dhe ndarja e botës*, Albinforum, Tiranë, 1994, f. 123.

<sup>64</sup> *Po aty*, f. 197.

<sup>65</sup> *The National Archives*, Cabinet Papers, No. 66/67, 1945, f. 54-56.

jugosllavëve, se çështja e Kosovës do të zgjidhej me vetëvendosje të popullsisë pas lufte, por këta të fundi zbatuan planet e tyre të kamufluara për pushtimin dhe rivendosjen e Kosovës nën pushtimin e serishëm jugosllav.

Sabit SYLA

## SUMMARY

### **KOSOVO BETWEEN THE AXIS POWERS AND THE ALLIES GREAT WESTERN**

Analysing the data mentioned above we may reach following conclusion: the Allies didn't hold a real stand towards Albania and Albanians in general during the World War II. The Allied Conferences did not support the change of borders, but at the same time they declared the compliance for the right of people for self-determination, which was not taken into account in regards to the Kosovo.

On the other hand, the accomplishment of the national union aim, achieved under the occupation of Axis forces, was a temporal realism that faded through the collapse of this Block. The resistance forces, lining up at one or at the other side, played an important role in these developments. The National Liberation Movement, emerging as a governing force in Albania at the end of the war, believed to Yugoslav politics that the issue of Kosovo would be resolved through a self-determination; but Yugoslavia implemented its secret plans to restore Kosovo under Yugoslavian rule again.



**Avni REXHA**

**PËRPPJEKJET PËR RIMËKËMBJEN DHE AFIRMIMIN  
NDËRKOMBËTAR TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS  
GJATË VITEVE 1991-1998**

Dekada e fundit e shekullit njëzetë u karakterizua me zhvillime dramatike në gjitha aspektet e jetës ekonomike-shoqërore e politike në Kosovë. Suprimimi i autonomisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në mars të vitit 1989 dhe rrjedhimisht uzurpimi i gjitha kompetencave legjislativë-ekzekutive nga Republika e Serbisë krijoi një realitet të ri politik në Kosovë. Ligjet diskriminuese të miratuara nga Kuvendi i Serbisë që për synim kishin shuarjen e vetëqeverisjes, cenimin e të drejtave kombëtare shqiptare dhe integrimin e Kosovës në sistemin legjislativ të Serbisë, ishin të papranueshme për popullsinë shqiptare në Kosovë. Në përpjekje për të mbrojtur të arriturat politike dhe për të mbajtur të hapur rrugën e përcaktimit politik në kohën kur Jugosllavia po shkonte drejt shpërbërjes së sigurt, shqiptarët e Kosovës vendosën të mos i pranonin e të mos i zbatonin ligjet diskriminuese e jo kushtetuese të Serbisë. Në këtë mënyrë filloi organizimi paralel i institucioneve politike, arsimore, shëndetësore, kulturore, informative etj., baza e së cilës qëndronte në Deklaratën e 2 korrikut 1990 dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të shpallur më 7 shtator 1990.<sup>1</sup>

Organizimi i sistemit paralel nënkuptonte një hap para drejt sendërtimit të ambicieve të popullit shqiptar në Kosovë për liri e pavarësi, kurse arsimi ishte një nga shtyllat kryesore që këtë ide e mbështeti dhe e mbajti gjallë gjatë gjithë kohës. Refuzimi për pranimin e plan-programeve mësimore të Serbisë apo të integritetit në sistemin arsimor të Serbisë rezultoi me dëbimin e nxënësve, studentëve dhe

---

<sup>1</sup> Noel Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001, f. 361.

mësimdhënësve shqiptarë nga objektet shkollore e universitare, në përjashtimin e mësimdhënësve shqiptarë nga puna si dhe në përjashtimin e gjithë punonjësve arsimorë që refuzonin t'i bindeshin ligjeve të Serbisë. Kështu, duke filluar nga 1 tetori i vitit 1991 nuk u lejua mbajtja e mësimi universitar në gjuhën shqipe. Rreth 1 000 mësimdhënës dhe 25 000 studentë shqiptarë mbetën jashtë fakulteteve, shkollave të larta, qendrave studentore, bibliotekave, konvikteve e laboratorëve, të cilat u përvetësuan nga regjimi serb.<sup>2</sup>

Në pajtim me frymën e cekur më lartë që nga viti 1992 filloi organizimi i mësimi në objekte private, të cilat u quajtën “shtëpi-shkolla”. Në këtë mënyrë filloi funksionimi i një sistemi paralel arsimor që bazën e kishte në ligjet e Kosovës që ishin në fuqi para shfuqizimit arbitrar të tyre nga Kuvendi i Serbisë. Organizimi i mësimi nëpër shtëpi-shkolla u bë nën ombrellën e Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës (MARK), e cila për shkak të rrethanave të njohura vepronte jashtë Kosovës. Mësimi nëpër shtëpi-shkolla në mënyrë institucionale ishte organizuar nga 20 janari 1992 deri më 22 mars 1999, kur është ndërprerë në tërësi për shkak të gjenocidit të forcave policore e ushtarake serbe kundër popullatës civile të Kosovës.<sup>3</sup> Sigurisht, datat e mësipërme konsiderohen si zyrtare ngaqë dihet që në një pjesë të madhe të Kosovës mësimi është ndërprerë qysh gjatë vitit 1998, për shkak të rrethanave të cekura më lartë.

Procesi arsimor universitar u organizua në kushte të rënda, kryesisht nëpër shtëpi private, bodrume, garazhe, dhoma të papërshtatshme. Mungonin bibliotekat, laboratorët e kabinetet e nevojshme, e pa bursa studimore. Në pamundësi për t'u strehuar në konvikte studentëve u dolën në ndihmë qytetarët e Prishtinës të cilët i pranuan ata në shtëpitë e tyre. Për më tepër, studentët dhe mësimdhënësit u ballafaquan edhe me kërcënimin e përhershëm nga policia serbe e cila i torturonte shpeshherë në rrugë apo gjatë procesit mësimor, prandaj edhe objektet ku mbahej mësimi ishin zakonisht në pjesët periferike të qytetit ku frekuentimi i policisë serbe ishte më i rrallë. Edhe në këto kushte të rënda policore, ekonomike, pedagogjike e psikologjike, studentët jo

<sup>2</sup> *Universiteti i Prishtinës, 1970-2000*, Prishtinë, 2000, f. 15.

<sup>3</sup> Zijadin Gashi, 25-vjetori i organizimit të mësimi në shtëpi-shkolla, Google Internet, <http://www.botasot.info/historia-lajme/643147/25-vjetori-i-organizimit-te-mesimi-ne-shtepi-shkolla/>, qasja 10 shkurt 2017.

vetëm që nuk e braktisën Universitetin, por ata dhanë ndihmën e shumëfishtë për rimëkëmbjen dhe mbijetesën e pavarur të tij.<sup>4</sup>

Pavarësisht gjitha sfidave, mësimdhënësit dhe studentët e Universitetit të Prishtinës (UP) ia kishin dalë që ta vendosnin në binarë të funksionimit të rregullt procesin e mësimi universitar. Tani kur mësimi kishte filluar të mbahej në objektet private, kur organizimi dhe mbarëvajtja e procesit mësimor ishte konsoliduar, para drejtuesve të Universitetit të Prishtinës doli çështja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndëruniversitar që shtrihej në dy objektiva: (1) ndihma në rimëkëmbjen e Universitetit ose në plotësimin e nevojave akademike, si dhe; (2) afirmimi dhe njohja e UP nga institucione akademike apo qeveri të vendeve të ndryshme. Derisa objektivi i parë kishte të bënte kryesisht me sigurimin e përvojave të reja, të mjeteve dhe teksteve mësimore dhe mbulimin e profileve studimore që mungonin, objektivi i dytë kishte edhe rëndësinë e veçantë, sepse do të shoqërohej edhe me sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar për të vërtetën e zhvillimeve politike e arsimore në Kosovë. Për t'i arritur objektivat e përshkruara më lart drejtuesit e UP-së iu drejtuan fillimisht universiteteve dhe shtetit shqiptar e më pas edhe universiteteve apo asociacioneve ndërkombëtare.

### ***Mbështetja nga Shqipëria***

Tentativat e para për bashkëpunim me institucionet arsimore të Shqipërisë ishin zhvilluar qysh në mars 1991 kur Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës kishte kërkuar rivazhdimin e marrëveshjes së vitit 1979 me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Por, në këtë periudhë Shqipëria ende respektonte dispozitat në fuqi me Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, kështu që përgjigjja zyrtare ishte: *“...përfundimi i marrëveshjes tekniko-shkencore midis Akademisë sonë dhe ASHA të Kosovës, mund të bëhet pasi të jetë nënshkruar marrëveshja midis Akademisë sonë të Shkencave dhe asaj të Jugosllavisë”*.<sup>5</sup>

Një përgjigje e tillë tregon se nuk ishin vendosur ende kontaktet zyrtare midis autoriteteve të Shqipërisë me përfaqësues të shqiptarëve të Kosovës lidhur me çështjen e organizimit të sistemit të jetës e veprimit. Si rezultat mungonte edhe ndonjë lloj marrëveshjeje për mundësinë që studentët shqiptarë të Kosovës të studionin në universitetet e Shqipërisë.

<sup>4</sup> Hajrullah Koliqi, *Mbijetesa e Universitetit të Prishtinës 1991-1994*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1995, f. 52-53; *Gazeta Shkëndija*, Prishtinë, mars 1994, f. 8.

<sup>5</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej: AMPJ)*, Fondi: Kosova, Dosja: B-VII/2, nr.: 1591, viti: 1991.

Prandaj, kërkesat e studentëve kosovarë/shqiptarë për t'u regjistruar në universitetet shqiptare ishin individuale dhe trajtoheshin përmes kanaleve diplomatike, njëjtë sikurse edhe kërkesat e studentëve nga vendet e ndryshme të botës. Sipas të dhënave të diplomacisë shqiptare, gjatë muajve qershor-shtator 1991, nëpër ambasadat shqiptare në vende të ndryshme të botës ishin dorëzuar kërkesa nga shqiptarë që jetonin në Jugosllavi për t'i vazhduar studimet në degë të ndryshme të Universitetit të Tiranës. Nga 419 kërkesa, 383 ishin nga Kosova, 24 nga viset tjera të Jugosllavisë, kurse pjesa e mbetur ishin të huaj.<sup>6</sup>

Sidoqoftë, nëntori i vitit 1991 shënoi themelet e vendosjes së bashkëpunimit institucional midis Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Vizita e Bujar Bukoshit në Tiranë, atëherë kryeministër i Kosovës, dhe takimi me autoritetet më të larta të Shqipërisë, shënoi edhe fillimin e një bashkëpunimi të koordinuar midis këtyre dy vendeve.<sup>7</sup>

Hapat e parë të bashkëpunimit në sferën e arsimit u vunë në korrik të vitit 1992 kur një delegacion i UP-së, i udhëhequr nga rektori, prof. Ejup Statovci, zhvilloi bisedime me drejtuesit e universiteteve të Tiranës, në të cilat tema qendrore ishte rimëkëmbja e Universitetit të Prishtinës. Vizita u konkretizua me nënshkrimin e disa marrëveshjeve të bashkëpunimi midis UP-së dhe Universitetit të Tiranës, Universitetit Politeknik të Tiranës, Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Universitetit të Shkodrës.<sup>8</sup>

Frytet e këtij bashkëpunimi u manifestuan qysh në gusht të vitit 1992 kur rektori i UP-së, prof. Ejup Statovci, e informonte ambasadën shqiptare në Beograd mbi grupin e parë të studentëve që duhej të arrinin në Tiranë më 23 gusht 1992.<sup>9</sup>

Regjistrimi këtij grupi studentësh ishte rezultat i marrëveshjes së arritur më 12 gusht 1992 midis ministrave të Arsimit të Shqipërisë e të Kosovës, dhe përfshinte një numër të kufizuar të tyre në fushat që nuk funksiononin në Universitetin e Prishtinës, sikurse: Farmaci - 10, Veterinari - 15, Pylltari - 7, Regji - 3, Gazetari - 2, Arkeologji - 3, Punim druri - 2.<sup>10</sup>

Rrethanat e reja në fushën e arsimit në Kosovë u manifestuan edhe me pamundësinë e punës në hartimin dhe botimin e teksteve

<sup>6</sup> AMPJ, Fondi: Kosova, Dosja: B-VII/2, nr.: 1591, viti: 1991, f. 24-25.

<sup>7</sup> AMPJ, Fondi: Kosova, Dosja: nr. 879, viti: 1993, f. 10.

<sup>8</sup> H. Koliqi, *Mbijetesa e Universitetit...*, f. 62.

<sup>9</sup> AMPJ, Fondi: Kosova, Dosja: B-VII, nr. 1103, viti 1992, f. 4.

<sup>10</sup> *Po aty*, f. 6.



shkollore, sidomos tash kur shqiptarët e Kosovës ishin përcaktuar për rrugën e lirisë dhe pavarësisë kombëtare. Një përcaktim i tillë sigurisht që hidhte në dritë nevojën e ndryshimit të teksteve shkollore, sidomos nevojën që në këto tekste të përfshiheshin elemente të karakterit kombëtar. Prandaj, në gusht 1992 përfaqësuesit e MARK dhe homologët e tyre të Shqipërisë lidhën një marrëveshje bashkëpunimi afatgjatë në sferën e arsimit e kulturës. Esenca e marrëveshjes qëndronte në bashkërendimin e veprimeve në hartimin e programeve të teksteve shkollore, për realizimin e studimeve të përbashkëta në fushën e arsimit duke krijuar grupe të përbashkëta pune me synimet që në të ardhmen të arrihet në njësimin e teksteve dhe programeve shkollore. Në terme konkrete, pala kosovare mori përsipër shtypjen apo fotokopjimin e një pjese të teksteve shkollore nga Shqipëria, që do të shërbejnë për mësim nga nxënësit dhe studentët shqiptarë, kurse pala shqiptare merrte përsipër që të pranojë në shkollat e larta në Shqipëri një numër të kufizuar studentësh nga Kosova, sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë (MASH).<sup>11</sup>

Nga termet e kësaj marrëveshjeje theks më të veçantë mori interesimi për të studiuar në Shqipëri. Kërkesat e studentëve kosovarë për të studiuar në universitetet e Shqipërisë ishin të mëdha. Arsytet e një interesimi kaq të madh qëndrojnë në disa faktorë ndër të cilat duhet veçantë kushtet e studimit, që ishin më të mira sesa në Kosovë, dhe në ikjen nga persekutimi serb, konkretisht shmangia nga rekrutimi i detyruar i kosovarëve në ushtrinë serbe, sidomos në periudhën kur në viset tjera të ish-Jugosllavisë kishin shpërthyer konflikte të armatosura midis agresorëve serbë dhe popujve sllovenë, kroatë e boshnjakë. Sipas disa të dhënave që dispononte MARK, rreth 42 kosovarë kishin ikur në Shqipëri vetëm që t'i shmangeshin shërbimit ushtarak serb, e të njëjtët tani shprehnin vullnetin të regjistroheshin në universitetet shqiptare.<sup>12</sup> Nuk duhet harruar faktin se ikjet e kosovarëve të rinj nga shërbimi ushtarak serb nuk e kishin adresë vetëm Shqipërinë, por edhe Evropën Perëndimore, Turqinë, e madje edhe vendet më të largëta.

Por, kërkesat e kosovarëve ishin të shumta kurse kuotat në dispozicion nuk mjaftonin për t'i plotësuar ato. Prandaj, MASH në shtator të vitit 1992 i kishte bllokuar kërkesat individuale të studentëve

<sup>11</sup> Gazeta *Bujku*, Prishtinë, 15 gusht 1992.

<sup>12</sup> Arkivi Privat Muhamet Bicaj (më tej: APMB), Dokumente të ndryshme si ministër gjatë viteve 1990-1999...

kosovarë dhe kishte kërkuar nga Universiteti i Prishtinës hartimin e një liste me studentët që duhej të pranoreshin në universitetet shqiptare.<sup>13</sup>

Ky akt ishte rezultat i një kërkesë që vinte nga Qeveria e Kosovës dhe nga Shoqata e Arsimitarëve Universitarë të cilët kishin shprehur brengën tek organet drejtuese të Universitetit të Tiranës (UT) se pranimi i studentëve kosovarë në këtë universitet do t'i mbyllte përfundimisht rrugët e presionit mbi serbomëdhenjtë për të çelur Universitetin e Prishtinës. Prandaj, gjatë vitit 1992 u pranuan vetëm 50 studentë kosovarë në UT.<sup>14</sup>

Ky veprim, po ashtu, i vendoste marrëveshjet mes dy vendeve në binarë institucionalë duke ofruar kuota për ato drejtime që ishin të nevojshme apo që nuk i kishte UP, dhe në këtë mënyrë kontribuonte në mos zbrazjen e UP-së dhe të Kosovës në përgjithësi.

Në përgjithësi, gjatë viteve 1991-1994 u vërejt një bashkëpunim i mirë midis UP-së dhe universiteteve të Tiranës. Rektori Statovci shprehte kënaqësinë e një bashkëpunimi të tillë sidomos në fakultetet, degët dhe seksionet që nuk ekzistonin në UP, pra në profilet që i mungonin asaj.<sup>15</sup> E rëndësishme ishte sidomos praktika profesionale dyjavëshe për studentët e Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Shkencave Matematikore Natyrore të UP-së. Gjatë vitit akademik 1992/93 në universitetet shqiptare studionin 33 studentë nga Kosova, kjo shifër u rrit për 50 në vitin akademik 1993/94 për të arritur në 110 studentë gjatë vitit akademik 1994/95.<sup>16</sup>

Gjatë vitit akademik 1996/97 bashkëpunimi midis UP-së dhe universiteteve të Shqipërisë kishte hyrë në binarë të komunikimit institucional në aspektin e regjistrimit të studentëve kosovarë në universitetet shqiptare. UP-ja ishte konsoliduar pothuaj plotësisht dhe autoritetet shqiptare, mundësonin regjistrimin e studentëve kosovarë vetëm në fushat deficitare në Kosovë.<sup>17</sup>

Lidhur me studimet deficitare, në shkresën drejtuar MARK-ut, rektori Statovci deklaroi: *“Këtë vit janë bërë përgatitje për të hapur studimet në Farmaci dhe Veterinari në Universitetin e Prishtinës, prandaj nuk kemi nevojë të kërkojmë vende të lira nga Shqipëria. Për*

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Gazeta Shkëndija, Prishtinë, mars 1992, f. 5.

<sup>15</sup> Drita Halimi Statovci, *Një jetë për një universitet*, Vëllimi I, Prishtinë, 2000, f. 85; Gazeta Bujku, 30 shtator 1992.

<sup>16</sup> H. Koliqi, *Mbijetesa e Universitetit*..., f. 65.

<sup>17</sup> Arkivi Privat Bajram Shatri (më tej: APBSH), Ministria e Arsimit dhe Shkencës për rektorin e UP-së, datë 21 mars 1996.

*vitin e ri shkollor UP kërkon një numër të vogël vendesh për studentët kosovarë në fushat: Pylltari - 5 kuota, Gazetari - 2 kuota, Infermieri - 10 kuota, Teknologji ushqimore - 5 kuota, Tekstil - 3 kuota, pra gjithsej 25 kuota. Regjistrimet jashtë listës së UP-së janë të karakterit personal”.*<sup>18</sup>

Në këto rrethana, kur UP kishte krijuar kuadro për mbulimin e fushave deficitare, vëmendje më e theksuar iu kushtua ushtrimeve laboratorike, sidomos në fushën e mjekësisë dhe të shkencave natyrore. Studentë kosovarë shkonin kohë pas kohe në Tiranë për t’i kryer ushtrimet laboratorike, të shoqëruar nga profesorët e tyre përkatës. Komunikimi i drejtpërdrejtë i kuadrove/studentëve kosovarë me ata shqiptarë ishte mjaft i vështirësuar për shkak të masave të dhunshme serbe në Kosovë. Kuadrot nga universitetet shqiptare nuk mund të vinin në Kosovë, prandaj takimi i delegacioneve reciproke zhvilloheshin në Tetovë. Por, këto vajtje-ardhje kishin edhe koston e rrezikut fizik, sepse autoritetet serbe kishin mbyllur kufirin me Shqipërinë, respektivisht shqiptarët e Kosovës nuk lejoheshin të shkonin në Shqipëri, dhe kalimi bëhej përmes kufirit maqedonas. Në rrethana të tilla çdo vulosje e pasaportës me vulë kufitare maqedonase apo shqiptare shoqërohej automatikisht me gjobitje nga autoritetet serbe, të cilat shkonin deri në masën e dënimit me burg. Këto masa do të bëheshin edhe më rigorozë pas vitit 1997 me paraqitjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjë që bëri pothuaj të pamundur kalimin kufitar të shqiptarëve të Kosovës.<sup>19</sup>

Situata e rënduar në Kosovë, ku lufta e armatosur ishte bërë i vetmi opsion për t’iu kundërvënë dhunës së shfrenuar serbe bëri që gjatë vitit akademik 1997/98 të vihet në pah nevoja për specializimin e kuadrove mjekësore kosovare. Nuk kishte asnjë dilemë, Kosovës i nevojitej më shumë se kurrë një kuadër i specializuar mjekësor. Në tetor 1997 ministri shqiptar i Arsimit u zotua publikisht që Qeveria shqiptare do të ndërmarr nisma të reja për një mbështetje sa më të gjerë për Kosovën, sidomos në lehtësimin e kushteve për studentët kosovarë.<sup>20</sup>

Deklarata e tillë u pasua me vendimin e datës 3 dhjetor 1997 përmes së cilës MASH vendosi për hapjen e 25 kuotave në Fakultetin e Mjekësisë për studentët nga trojet jashtë Shqipërisë. Kuotat për specializim u hapën në fushat: Kirurgji, Shëndet publik, Pediatri,

<sup>18</sup> APBSH, Rektori i UP për Ministrinë e Arsimit e Shkencës, datë 25 mars 1995.

<sup>19</sup> Intervistë me Salih Maqedocin, Bashkëpunëtor profesional për bashkëpunim ndërkombëtar dhe protokoll në UP në vitet 1970-1999. Intervistuar nga Avni Rexha, datë 27 qershor 2018.

<sup>20</sup> Gazeta *Zëri i popullit*, Tiranë, 8 tetor 1997.

Kardiologji, Neurologji, Sëmundje infektive, etj. Këto kuota u hapën në degët për të cilat kishte nevojë Fakulteti i Mjekësisë në Prishtinë.<sup>21</sup>

### ***Bashkëpunimi ndërkombëtar i Universitetit të Prishtinës***

Përveç Shqipërisë, institucionet arsimore të Republikës së Kosovës iu drejtuan edhe qeverive dhe institucioneve të Evropës Perëndimore. Në ditën kur duhej të fillonte mësimi në Kosovë, 01.09.1992, ministri kosovar i Arsimit kërkoi nga homologu i tij austriak në Vjenë, ndihmë e përkrahje në gjitha fushat e arsimit, sidomos në mundësinë e shkëmbimit të kuadrove dhe studentëve universitarë. Gatishmëria e palës austriake për ta ndihmuar arsimin në Kosovë u shpreh përmes ofrimit të dërgimit në Kosovë të një kontingjenti të materialit shkollor, derisa u la hapur mundësia e organizimit të një konference ndërkombëtare në Prishtinë në fushën e arsimit.<sup>22</sup>

Duket se bisedimet me autoritetet austriake kishin qenë të suksesshme. Ky konstatim bazohet në faktin se përmes një shkrese të datës 7 shtator 1992, MARK kërkoi nga kompetentët e arsimit fillor, të mesëm e universitar shqyrtimin e mundësive për një bashkëpunim konkret me organet e arsimit dhe të kulturës të Republikës së Austrisë. Për më tepër, shkresa kërkonte që të studioheshin format dhe metodat konkrete për një bashkëpunim të tillë.<sup>23</sup>

Përpjekjet për të siguruar bashkëpunim në Evropën Perëndimore morën një hov më të theksuar gjatë vizitave dhe takimeve me rektorë, akademikë e politikanë që rektori Statovci i bëri në Austri, Gjermani e Slloveni në fund të vitit 1992.<sup>24</sup>

Rezultat i këtyre vizitave dhe takimeve ishte nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim midis Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit “Friderih Schiller” të Jenës, më 4 dhjetor 1992, pastaj i marrëveshjes me Universitetin Teknik të Dresdenit, me Universitetin e Lirë të Berlinit, dhe një marrëveshje përtëritëse me Universitetin e Lubjanës.<sup>25</sup>

Nga këto marrëveshje, më e vlerësuar kishte qenë ajo e Jenës. Në fakt kjo marrëveshje shprehte legjitimitetin dhe pranimin e

<sup>21</sup> APMB, Dokumente të ndryshme si ministër gjatë viteve 1990-1999...

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> D. H. Statovci, *Një jetë për një universitet*, f. 89.

<sup>25</sup> H. Koliqi, *Mbijetesa e Universitetit....*, f. 62; Bujku, 27 dhjetor 1992, f. 4.

Universitetit të Prishtinës në qarqet akademike euro perëndimore përmes bashkëpunimit dhe këmbimit të studentëve. Gjatë një prononcimi rektori Statovci kishte theksuar rolin e Universitetit të Jenës, si *“universiteti i parë që çeli rrugë që Universiteti i Prishtinës të hyjë në universitete tjera, dhe jo vetëm gjermane”*.<sup>26</sup>

Një tipar tjetër i këtyre vizitave ishte kërkesa e rektorit të Universitetit të Prishtinës që universitetet e cekura më lart, si ato gjermane, austriake e sllovene, të pranenin për studime studentë të Universitetit të Prishtinës që ishin në vitin e fundit të studimeve, si dhe kandidatë për specializime.<sup>27</sup>

Suksesi i vizitave të përshkruara më lart nuk ndali hovin e rektorit dhe delegacionit të UP-së në kërkim të partnerëve tjerë për bashkëpunim ndërkombëtar në Evropën Perëndimore. Vullneti për ngritjen dhe legjitimimin e Universitetit të Prishtinës tejkalonte edhe sfidat e natyrës personale. Derisa ndodhej për një vizitë mjekësore në klinikat e Ulmit, rektori Statovci arriti të realizojë një takim zyrtar me rektorin e Universitetit të Ulmit, dr. W. Pechbold, ku u bisedua për mundësitë dhe interesat që do t'i sillte bashkëpunimi i ndërsjellë midis Universitetit të Ulmit dhe atij të Prishtinës. Dy rektorët më 30 gusht 1993 u pajtuan të nënshkruajnë dokumentin për bashkëpunim të gjithanshëm profesional e shkencor.<sup>28</sup>

Por, drejtuesit e UP-së nuk ishin aktorë të vetëm në përpjekjet për afirmimin ndërkombëtar të Universitetit të Prishtinës në skenën ndërkombëtare. Një rol me rëndësi luajtën edhe organizatat studentore të Universitetit të Prishtinës, sikurse Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës (UPSUP). UPSUP, në bashkëpunim me Forumin e Rinisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, më 14 shtator 1993 organizoi në Prishtinë tryezën e rinisë, ku morën pjesë përfaqësues të organizatave rinore shqiptare nga trevat e ish-Jugosllavisë. Për më tepër, një delegacion i Unionit të Pavarur të UP-së mori pjesë në Konferencën II Ballkanike të Studentëve që u mbajt në Strugë në maj të vitit 1993.<sup>29</sup>

Nuk munguan përpjekjet e UPSUP-it për të krijuar lidhje e kontakte me organizatat homologe në Evropë. UPSUP vuri kontakte dhe realizoi marrëveshje bashkëpunimi me Unionin e Studentëve të

<sup>26</sup> D. H. Statovci, *Një jetë për një universitet*, f. 89; Bujku, 27 dhjetor 1992, f. 5.

<sup>27</sup> H. Koliqi, *Mbijetesa e Universitetit....*, f. 63.

<sup>28</sup> Gazeta Bujku, Prishtinë, 2 shtator 1993, f. 1.

<sup>29</sup> H. Koliqi, *Mbijetesa e Universitetit....*, f. 54; Gazeta Bujku, Prishtinë, 5 maj 1994, f. 1.

Universitetit të Tromsit (Norvegji), pastaj me Unionin Ndërkombëtar të Studentëve të Evropës, Amerikës Veriore dhe të vendeve të zhvilluara. Një delegacion i këtij unioni mori pjesë në mbledhjen e parë ndëruniversitare të studentëve nga ish-Jugosllavia, të mbajtur në Strasburg (Francë) më 14-18 prill 1994. Në Strasburg delegacioni i studentëve kosovarë organizoi edhe një ekspozitë fotografike me temën *“Dhuna mbi shkollën shqipe”*.<sup>30</sup>

Përpyjekjet e drejtuesve të Universitetit të Prishtinës për afirmimin dhe bashkëpunim ndërkombëtar nuk pushuan edhe në vitet pasuese, sidomos pas vitit 1994 kur tanimë mësimi nëpër shkolla-shtëpi pothuaj ishte ngritur në një shkallë më të lartë të organizimit. Tani vihej në pah nevoja e ngritjes akademike të kuadrit arsimor, prandaj u zhvilluan bisedime me krerët e Universitetit të Zagrebit lidhur me perfeksionimin e kuadrit arsimor të UP-së. Nuk munguan as marrëveshjet me universitetet tjera, në radhë të parë me Universitetin e Firencës, derisa e arritura më e madhe e Universitetit të Prishtinës në drejtim të afirmimit dhe legjitimitimit ndërkombëtar ishte ftesa që iu bë rektorit të UP-së për të marr pjesë në Konferencën e 43-të bienale të Rektorëve të Universiteteve të Evropës (CRE), me seli në Gjenevë, e cila u mbajt në Selanik, prej 20-23 prill 1994. Ky ishte një rast i përkryer për afirmimin e Universitetit të Prishtinës, të cilin rektori Statovci e shfrytëzoi duke biseduar me mjaft delegacione të universiteteve evropiane të cilat shprehën admirimin për qëndresën e Universitetit të Prishtinës dhe gatishmërinë për ta ndihmuar atë.<sup>31</sup>

Vendosja e kontakteve dhe marrëveshjeve me universitetet shqiptare e evropiane ishte vlerësuar nga rektori Statovci si një sukses i madh për Universitetin e Prishtinës. Në një prononcim për mediat kosovare ai ishte shprehur: *“...komunikimi me jashtë është një arritur e madhe për Universitetin e Prishtinës. Më duhet të pranoj se duke pasur parasysh rrethanat e kushtet si punojmë, si dhe rrethimet e brendshme e të jashtme si jetojmë, nuk kam pritur që dalja e Universitetit të jetë kaq e suksesshme si dhe të bëhet kaq shumë brenda kësaj kohe. Kontaktet dhe bashkëpunimi ka marr rrugë në disa nivele: me institucionet shtetërore, universitetet veç e veç, me Konferencën e Rektorëve të Universiteteve të Evropës, me konferencat nacionale të rektorëve, dhe me asociacionet tjera”*.<sup>32</sup>

<sup>30</sup> H. Koliqi, *Mbijetesa e Universitetit....*, f. 54.

<sup>31</sup> Gazeta Bujku, Prishtinë, 19 prill 1994, f. 1.

<sup>32</sup> Gazeta Bujku, Prishtinë, 5 korrik 1994, f. 3.

Pavarësisht kushteve shumë të vështira për shkak të kufizimeve të lirisë së lëvizjes për pedagogët dhe studentët, Universiteti i Prishtinës shënoi dhe realizoi disa marrëveshje të rëndësishme me universitetet e rajonit e më gjerë. Në vitin 1994 themelohet Konferenca e Universiteteve Shqiptare, në të cilën Universiteti i Prishtinës ishte një nga themeluesit.<sup>33</sup> Qëllim i këtij asociacioni ishte promovimi i bashkëpunimit universitar e ndëruniversitar me universitetet e Shqipërisë, por edhe me atë të Zagrebit e të Evropës.

Afirmimi i Universitetit të Prishtinës vazhdoi edhe gjatë vitit 1995/96. Rektori i UP-së, Ejup Statovci mori ftesë nga Universiteti Oulu nga Finlanda që të merr pjesë në Konferencën e shtatë vjetore të Asociacionit Evropian për Edukim, që do të mbahej në pranverë të vitit 1996. Në këtë Konferencë do të shqyrtohej modernizimi i programit të edukimit permanent teknik universitar; kontributi për inovacione arsimore dhe kërkimore në universitete; avancimin e mirëkuptimit arsimor praktik nëpërmjet Bashkësisë Evropiane, etj.<sup>34</sup>

Ishte e qartë se afirmimi ndërkombëtar ishte një proces mjaft i ndërlikuar në rrethanat nëpër të cilat kalonte Kosova. Institucionet e Republikës së Kosovës nuk njiheshin zyrtarisht nga vendet evropiane apo botërore, përveç Shqipërisë, prandaj komunikimi me qeveritë evropiane ishte në korniza të komunikimit jozyrtar. Ky fakt vështirësonte punën e UP-së në drejtim të lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, sidomos kur ato fillimisht bëheshin përmes kanaleve diplomatike shtetërore. Ky fakt u potencua nga rektori Statovci, i cili gjatë një prononcimi deklaroi se *“...universiteti arriti me shumë vështirësi e shkallë-shkallë të afirmojë e krijojë marrëdhënie me botën e jashtme universitare, me organizata e shoqata universitare, me diplomatë e institucione shtetërore, të cilët shprehën mirëkuptim e gjetën rrugë për ta ndihmuar universitetin tonë përkundër bllokadave të brendshme e të jashtme. Kontaktet nuk janë vënë në bazë të protokolleve ndërshtetërore e ndëruniversitare, por këto i bëri universiteti si organ autonom”*.<sup>35</sup>

Tendencat e Universitetit të Prishtinës për bashkëpunim ndërkombëtar vazhduan edhe gjatë vitit 1998, pavarësisht se situata politike në Kosovë e kishte arritur kulmin e tensionimit si rezultat i dhunës policore e ushtarake serbe. Në një shkresë që i drejtohej MARK-ut, datë 23 nëntor 1998, Universiteti i Prishtinës njoftonte mbi lidhjen e

<sup>33</sup>Tempulli i dijes 1970-2012, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2012, f. 59.

<sup>34</sup> Gazeta Bota e Re, Prishtinë, 31 dhjetor 1995, f. 3.

<sup>35</sup> Gazeta Rilindja, Prishtinë, 15 shkurt 1995.

bashkëpunimit me Universitetin e Milanos, Firences dhe Padovës. Në tekstin e marrëveshjes shkruhej se Universiteti i Prishtinës dhe ai i Milanos u pajtuan që:

- të organizonin seminare, kurse, takime pune, shkolla verore, dhe iniciativa tjera të ngjashme;
- të zhvillonin studime dhe bashkëpunim në projekte kërkuese;
- të organizonin kongrese e ligjërata;
- të këmbenin materiale mbi punën, revistat dhe dokumentacionin pedagogjik.<sup>36</sup>

Kushtet e marrëveshjes me Universitetin e Firences parashihnin:

- vizita të ndërsjella të kuadrit arsimor dhe shkencor, promovimin e seminareve, kurseve, organizimin e projekteve shkencore;
- këmbimin e informacioneve dhe publikimeve nga fusha të caktuara shkencore;
- këmbimin e studentëve për studime postdiplomike për periudha të caktuara kohore;
- këmbimin e studentëve me qëllim të ndjekjes së kurseve, seminareve, etj.<sup>37</sup>

Ndërsa marrëveshja midis Universitetit të Prishtinës dhe atij të Padovës parashihte:

- angazhimin për bashkëpunim reciprok në fushën e didaktikës dhe të hulumtimit;
- këmbimin e informacioneve, dokumentacioneve apo publikimeve shkencore;
- organizimin e takimeve, seminareve, konferencave, kurseve etj.<sup>38</sup>

Në vigjilje të Luftës në Kosovë, në mars 1999, u bë edhe një përpjekje për lidhjen e një bashkëpunimi ndërkombëtar midis Universitetit të Prishtinës dhe atij italian La Sapienza, e cila kishte shprehur vullnetin e bashkëpunimit me Universitetin e Prishtinës.<sup>39</sup>

Fillimi i luftës në Kosovë ndali veprimtarinë arsimore në Kosovë, kurse vullneti për bashkëpunim ndërkombëtar dhe afirmim të Universitetit të Prishtinës do të vazhdojë në Kosovën e lirë me kthimin e studentëve dhe pedagogëve në objektet e tyre universitare.

Gjatë viteve 1991-1999 Universiteti i Prishtinës me ndihmën e institucioneve dhe universiteteve të Shqipërisë me sukses tejkaloi sfidat

<sup>36</sup> APBSH, Universiteti i Prishtinës për Qeverinë e Kosovës, datë 23 nëntor 1998.

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> Po aty.

<sup>39</sup> APBSH, Ministria e Arsimit për rektorin e Universitetit të Prishtinës, 10 mars 1999.



në rimëkëmbjen e tij, sigurimin e mjeteve dhe teksteve mësimore, të përvojave akademike dhe arriti që t'i ngritë edhe plotësojë edhe fushat deficitare që i mungonin në fillim. Në aspektin ndërkombëtar, Universiteti i Prishtinës u njoh nga shtetet dhe universitetet e Evropës Perëndimore. Diplomat e saj u pranuan dhe studentët kosovarë u dëshmuar të suksesshëm gjatë studimeve të tyre në Evropë. Universiteti i Prishtinës dhe sistemi arsimor në Kosovë gjatë viteve 1991-1999 u dëshmuar si shtyllë e aspiratave të popullit shqiptar të Kosovës për liri e pavarësi.

Avni REXHA

## SUMMARY

### **THE EFFORTS TO REACTIVATE THE UNIVERSITY OF PRISHTINA AND ITS INTERNATIONAL RECOGNITION DURING THE YEARS 1991-1998**

The disintegration of Yugoslavia was characterized by the rise of Serbian hegemonic tendencies which resulted in the revocation of Kosovo's autonomy and in the efforts to integrate the province of Kosovo in Serbia. Since the Albanians refused to obey to the Serbian laws, they were expelled from all public sectors. The same happened with the education system. Pupils and students were expelled from schools, universities, libraries, laboratories, dormitories, etc. In order to oppose the Serbian hegemonic goals, the Albanians started the organization of parallel life, respectively created parallel institutions. Thus, they began to organize the education system in the so-called "home-schools". These were private premises such as: house rooms, garages, basements, etc., which did not have suitable conditions for teaching. The main concern was the Serbian police violence against the Albanian school, against students and lecturers. But, Albanians decided not to subjugate to the Serbian laws that aimed to denationalize them. In this way, starting from February 1992, the University of Prishtina organized its work.

But the main challenges met by the University were: (1) reactivation, and (2) international recognition. While the first objective included recruitment of staff, experiences, textbooks, etc., the second objective included recognition of University of Prishtina by Western European institutions or universities. In the accomplishment of the first objective a considerable support came from Albania. Educational/university institutions in Albania provided extraordinary assistance with textbooks, academic experiences and registration of students from Kosovo in Albania, assistance in covering deficit areas, etc. So, there was an institutional cooperation from 1992 to 1998, and the most significant

help was the practices and training of medical staff at Albanian universities at a time when an armed movement had begun in Kosovo that opposed the unbridled Serbian violence. The second objective, in addition to recognition of the University of Prishtina in the international arena, raised the international awareness of the political and social truth in Kosovo. The efforts of the leaders of the University of Prishtina resulted in its recognition by famous international universities such as that of Jenna, Dresden, Berlin, etc. Numerous European universities accepted students from the University of Prishtina, especially in advanced studies and specializations. The students who participated in various European symposia and associations also played a role in the international affirmation of the University of Prishtina.

It can be said that during the years 1992-1998 the University of Prishtina successfully accomplished the challenge of reactivation and international recognition. Studies continued uninterrupted until the beginning of the war. Student diplomas were recognized in many countries around the world. The University of Prishtina and the Kosovo education system during 1991-1999 became the backbone of Kosovo Albanians' struggle for freedom and independence.



**KUMTESA**



**Paskal MILO**

## **THELBI EVROPIAN I RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE**

Lidhja Shqiptare e Prizrenit është një moment kulmor i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ky vlerësim i gjithëpranuar e ka bërë këtë ngjarje një gurthemel të historisë tonë kombëtare. Si e tillë, Lidhja ka qenë e mbetet një objekt i vazhdueshëm studimi dhe analizë siç është edhe rasti në Konferencën tonë të sotme. Gati si sot, 40 vjet më parë, unë kam marrë pjesë me një referim në Konferencën kombëtare me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes, të zhvilluar në Tiranë në rrethanat e një solemniteti të madh e me pjesëmarrjen edhe të studiuesve të shumtë shqiptarë nga Kosova e trojet e tjera shqiptare në ish-Jugosllavinë.

Duke shqyrtuar agjendën e asaj Konference, por edhe të të tjerave më vonë, pa përjashtuar edhe studimet e posaçme rreth Lidhjes, më ra në sy mungesa e një trajtese që shpesh e ka penalizuar Lëvizjen Kombëtare Shqiptare pa të drejtë dhe po kështu edhe Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Ato janë akuzuar jo në pak raste si lëvizje jokombëtare, por në shërbim të Perandorisë Osmane, si revolta të popullsisë së prapambetur myslimane në Ballkan, etj.

Karakterin e një lëvizjeje kombëtare apo të një ngjarjeje madhore të saj e përcaktojnë dokumentet programore, idetë dhe veprimtaritë politike e diplomatike të udhëheqësve të tyre. Historiografia shqiptare e të gjitha trevave shqipfolëse e ka përcaktuar karakterin kombëtar, autonomist e më vonë e çlirimtar të tyre. Por, thuajse ka munguar trajtimi i profilit evropian të Rilindjes Kombëtare i shprehur në ide e veprime nga ana e ideologëve dhe veprimtarëve të shquar të saj. Kumbimi im synon një kontribut modest në këtë aspekt.

Rilindja Kombëtare Shqiptare në misionin e saj historik të ngjizjes së kombit zbuloi dhe i rizbuloi vlerat dhe figurat më të shquara të botës së qëmotshme arbërore. Procesi i kalimit të shqiptarëve nga millet

osman në komb modern, do të ishte jashtëzakonisht i vështirë për disa arsye të brendshme e të jashtme, politike dhe ekonomike, kulturore, fetare, gjuhësore, të traditës etj. Me fjalë të tjera duhej ndërtuar ose rindërtuar një identitet ndryshe nga ai osman dhe që nuk mund të ishte tjetër veç evropian.

Platforma e Rilindjes Kombëtare nëse do ta quajmë si të tillë tërësinë e ideve e të pikëpamjeve të shprehura nga ideologët e veprimtarët kryesorë të saj, synonte pikërisht këtë. Dhe është për këtë arsye që plejada e rilindësve i ktheu sytë nga historia, ndërtoi disa mite, por në veçanti kryemitin rreth figurës së Skënderbeut dhe luftës së arbërorëve nën udhëheqjen e tij kundër pushtimit osman. Evokimi i kësaj epopeje historike synonte dy objektiva kryesore: zgjimin kombëtar të shqiptarëve, ndërgjegjësimin dhe ngjizjen e identitetit kombëtar për të krijuar shtetin e tyre të pavarur; *e dyta*, përmes Skënderbeut dhe epokës së lavdishme të tij të “rizbulonin” rrënjët evropiane të identitetit shqiptar, të hiqnin ato mbishtresa osmane që ishin vendosur mbi të me qëllim që shqiptarët të pranoheshin nga Fuqitë e Mëdha evropiane si bartës të qytetërimit evropian dhe jo osman.

Jo pa arsye dhe për përgjegjësi historike edhe të vetë shqiptarëve në botën politike të krishterë evropiane ishin krijuar dyshime e perceptime të gabuara për ta. Kjo për faktin se shqiptarët ndryshe nga të gjithë popujt që ranë nën sundimin osman, në masën 70 për qind të tyre u konvertuan në fenë islame dhe humbën një tipar të qenësishëm, në mos kryesorin, për qytetërimin evropian siç ishte krishterimi. Për më tepër, ata u integruan aq thellë në Perandorinë Osmane saqë në shumë raste nuk bëhej dallim midis një shqiptari mysliman e me ndërgjegje të osmanizuar e një turku etnik. Aq e vërtetë është kjo sa që vezirët e shumtë me origjinë shqiptare, deputetët, gjeneralët, guvernatorët e ministrat shqiptarë, ishin një dukuri normale e mjedisit perandorak osman.

Rilindësit shqiptarë në strategjinë e tyre të bërjes së kombit duke i njohur dobësitë identitare shqiptare, nuk u përqendruan tek forca e krishterimit si një nga boshtet identitare evropiane për të ndërtuar identitetin modern kombëtar shqiptar. Realiteti mes shqiptarëve ishte tjetër, nuk kishte besim unik fetar dhe ai nuk mund të zhbëhej. Ndaj edhe ata në përputhje me rrethanat specifike shqiptare e zëvendësuan fenë unike si shtyllë e nacionalizmit me metaforën afetare nacionaliste “*Feja e shqiptarit është shqiptaria*”.

Zgjimi i vonuar kombëtar shqiptar nuk u përcaktua vetëm nga statusi i privilegjuar historik i elitave shqiptare të osmanizuara dhe nga ekzistenca e shumicës myslimane shqiptare. Kanë ndikuar edhe rrethanat



historike në të cilat u zhvillua nacionalizmi shqiptar si sistemi i prapambetur osman, por edhe mungesa e mbështetjes së tij nga të paktën një fuqi e madhe kujdestare evropiane. Me të drejtë është konstatuar se nacionalizmit shqiptar *“iu desh të zhvillohej pa një mbështetje të jashtme, kundrejt dhe kundër të gjithëve dhe me një karakter mbrojtës”*.<sup>1</sup> Atij iu desh të lind e të veprojë në rrethanat kur sistemi ndërkombëtar, “koncerti evropian” refuzonte të njihte një komb si mjaftueshëm të dallueshëm nga një tjetër ose mjaftueshëm të qëndrueshëm për të ruajtur një ekzistencë të veçantë.

Fuqitë e Mëdha evropiane të kohës e dëshmuuan këtë qëndrim më së miri në Kongresin e Berlinit, në qershor 1878, kur e injoruan çështjen shqiptare. Ato jo vetëm refuzuan çdo mbështetje për krijimin e shtetit kombëtar shqiptar, por edhe refuzuan kërkesën e Lidhjes së Prizrenit për organizimin e të gjithë shqiptarëve nën Perandorinë Osmane në një vilajet të vetëm që Jusuf Buxhovi e quan Shqipëria Osmane.<sup>2</sup> Në këtë mënyrë, duke refuzuar shqiptarët dhe duke ushqyer pretendimet territoriale të monarkive fqinje ndaj territoreve të banuara me shumicë kompakte shqiptare, u godit rëndë një nga elementët kryesorë të formimit të kombit shqiptar siç ishte uniteti i tij territorial. Për kryeministrin britanik e ministrin e tij të Jashtëm, Shqipëria nuk ishte në kohën e Krizës Lindore e panjohur, ashtu sikurse edhe për të gjitha Fuqitë e tjera të Mëdha. Historianë plot autoritet, si Giboni, e kishin “vendosur Shqipërinë në hartën historike perëndimore” dhe i kishin dhënë “asaj kreditë në Ballkan”. Por, përsëri ishte shumë pak sepse përbri Italisë, ajo “ishte më pak e njohur se brendësia e Amerikës”.<sup>3</sup>

Rilindësit shqiptarë në misionin e tyre historik për të nxitur e zhvilluar ndërgjegjen kombëtare si kusht paraprak për krijimin e shtetit kombëtar, iu drejtuan lëvrimit të gjuhës shqipe, krijimit të një alfabeti unik e shkrimit të saj. Studiuesit që janë marrë me nacionalizmin ballkanik e veçanërisht atë shqiptar kanë nënvizuar rolin specifik të gjuhës së folur të përbashkët shqiptare si një nga faktorët e fuqishëm të identitetit kombëtar shqiptar. Por, ata në mënyrë të veçantë iu drejtuan historisë, racës shqiptare dhe origjinës së saj, heronjve mitologjikë apo realë si dhe identitetit evropian të shqiptarëve para sundimit osman. Rilindësit me të drejtë e mitizuan historinë iliro-arbërore dhe ky nuk ishte fenomen vetëm shqiptar.

Rilindja Kombëtare përpos nevojave të brendshme objektive për ndryshim e zhvillim, u nxitë edhe nga penetrimi i vonuar e sipërfaqësor në grupe të vogla elitare të shqiptarëve, kryesisht jashtë Shqipërisë të ideve të iluminizmit evropian e të Revolucionit Francez të fundit të

shekullit XVIII. Filloi të lëviz diçka që sigurisht ishte ende larg atij procesi të “evropianizimit”, të “oksidentalizimit” apo të “modernizimit” të Ballkanit që u shfaq në vendet e tjera të rajonit që *“po bëhej evropian, duke flakur tej mbeturinën e fundit të trashëgimisë perandorake...”* osmane.<sup>4</sup>

Rilindja Kombëtare Shqiptare ka filluar si një lëvizje kryesisht kulturore edhe jashtë Shqipërisë, te arbëreshët e Italisë, në kolonitë shqiptare në Rumani, Egjipt e në mjediset atdhetare shqiptare në Stamboll, në qendër të Perandorisë. Ishte koha e krijimit të shteteve-kombe, e lëvizjeve të fuqishme revolucionare nacionale që po i jepnin formën përfundimtare konturave gjeografike të shteteve evropiane. Vetëm kombet me identitet të qartë kombëtar kishin shansin të zinin vend në hartën politike që po formohej me shpejtësi në Evropë. Tradita dhe gjuha e përbashkët, uniteti i njësisë territoriale të kombit dhe krishterimi, ishin vlerat dhe kriteret për të përcaktuar përkatësinë në qytetërimin evropian.

Rilindësit ishin të ndërgjegjshëm se këto vlera te shqiptarët ose ishin të mbuluara nga pluhuri i harresës historike, ose ishin tjetërsuar apo edhe mungonin. Ndaj edhe ata e filluan punën për zgjimin kombëtar nga ringjallja e traditës historike që i bashkonte me Evropën.

Skënderbeu shumë shpejt u bë *“pasuri e përbashkët për çdo evropian të kultivuar”*.<sup>5</sup> Rilindësit e rimorën mitin e tij në një formë të re, jo vetëm fetare, por si një figurë të *“mirëfilltë simbolike të një identiteti të ri etnokombëtar e të mëtimt për një shtet më vete”*. Ata e bënë këtë për t’u vënë në dukje *“elitave evropiane vijimësinë kulturore e sidomos orientimin politik për kah Perëndimit të shqiptarëve me shumicë myslimane: Skënderbeu mishëronte edhe pretendimin për të rilidhur përkatësinë në Evropë, e cila ishte ndërprerë nga sundimi osman e në këtë mënyrë të bënte legjitimitimin historik të dëshirës politike për autonomi ose pavarësi”*.<sup>6</sup>

Evokimi i traditës historike dhe i lashtësisë së popullit shqiptar në truallin e tij evropian, paçka se në mjaft raste arrinte në kufijtë e fantazisë historike, mbolli farën e zgjimit e të krenarisë kombëtare për identitetin evropian të shqiptarëve. Por, kjo nuk ishte e mjaftueshme. Shqiptarët nuk mund të rronin por as edhe mund të ndërtonin të ardhmen e tyre mbi bazën e të shkuarës, sado e lavdishme që të kishte qenë ajo. Ata duhej t’i dëshmonin Evropës së *“koncertit të Vjenës”* se ishin evropianë edhe nga kultura e gjuha, se një komb i zhvilluar që meritonte të jetonte më vete, duhej të kishte gjuhën e tij të shkruar, shkolla dhe institucione që

lëvronin gjuhën amtare. E në këtë drejtim shqiptarët linin shumë për të dëshiruar.

Lëvrimi dhe shkrimi i gjuhës shqipe u bë detyrë parësore e rilindësve shqiptarë. Studiues të ndryshëm evropianë kishin provuar origjinën indoevropiane të gjuhës shqipe. Rilindësve, sikurse e ka përcaktuar lëvruesi i madh i gjuhës tonë Eqrem Çabej, u ra përsipër një mision i shumëfishtë, *“të dalin përpara si poetë dhe si patriotë, të shpallnin idenë e lirisë nacionale dhe të bëhen me shkrimet e tyre edukatorët e kombit”*.<sup>7</sup>

Lëvrimi dhe shkrimi i gjuhës shqipe ishte i pamundur pa një alfabet unik e të gjithëpranuar. Çështja se çfarë alfabeti do të përdorej për shkrimin e gjuhës shqipe nuk ishte thjeshtë teknike dhe punë e një rrethi të ngushtë atdhetarësh. Alfabeti ngërthente një çështje të rëndësishme sa kulturore e arsimore aq edhe politike e kombëtare. Përcaktimi i tij do të dëshmonte tendencat e orientimit politik dhe influencën e kulturës e të qytetërimit të cilit do t'i përkiste alfabeti i huazuar. Tre ishin modelet kryesore të alfabeteve që mund të huazoheshin e që kishin gjurmë në disa përpjekje modeste për ta shkruar gjuhën shqipe përmes tyre: arabë, grek e latin. Përzgjedhja e alfabetit të gjuhës shqipe ishte një proces që shoqëroi Lëvizjen politike Kombëtare për autonomi e pavarësi dhe që reflektoi të gjitha vështirësitë, pjekurinë e dilemat e orientimit të kësaj të fundit. Puna për hartimin e alfabetit ka qenë një fushëbetejë midis rrymës konservatore me ndikime të forta osmane dhe rrymës progresiste që përmes përdorimit të alfabetit latin e shihte Shqipërinë të orientuar nga Evropa.

Kostandin Kristoforidhi, një nga lëvruesit më të shquar të gjuhës shqipe dhe hartuesi i Abetares së saj në vitin 1867, shkrimin e gjuhës shqipe dhe mësimin e saj në shkollat e Shqipërisë e shihte si kusht për të njohur shqiptarët si komb e për të hyrë në shoqërinë e kombeve të tjerë që gjenden në Evropë.

Përdorimi i alfabetit të Shoqërisë së Stambollit në librat shkollorë të shkruara nga rilindësit, gradualisht fitoi epërsi ndaj tendencave në minorancë për përdorimin e alfabetit arab apo grek. Hapja e të parës shkollë shqipe në Korçë, më 7 mars 1887, shënoi një ritëm tjetër e të pandalshëm në orientimin e arsimit e të gjuhës shqipe drejt traditës evropiane. Në Shkodër në fund të shekullit XIX u përdorën dy alfabete të tjera për shkrimin e gjuhës shqipe me germa latine, ku iniciues e lëvrues ishin edhe Gjergj Fishta e Ndre Mjeda.

Kongresi i Manastirit ishte një mesazh pjekurie i Lëvizjes Kombëtare që dëshmonte fillimin e procesit përfundimtar të shkëputjes e

të orientimit të natyrshëm të shqiptarëve në kahen e qytetërimit që i përkiste historikisht. Ishte sikurse ka thënë edhe Ismail Kadare: *“një kumt i qartë i evropianizimit shqiptar”*.<sup>8</sup>

Lëvrimi i gjuhës shqipe dhe alfabeti latin i saj, ishte një nga komponentët e identitetit kombëtar shqiptar që po dilte nga errësira e harresës historike. Nacionalizmit shqiptar i nevojitej një platformë politike e qartë e vizionare që mund të shërbente si udhëheqje e aksionit për krijimin e shtetit kombëtar. Ky program i mungoi Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, ishte shenjë e dobësisë së saj, i dualizmit dhe i dilemës, i ndrojtjes që kishte vetë elita e saj. Rilindësit ishin njerëz të kulturuar e me njohje të thella të qytetërimit evropian si dhe të historisë paraosmane të atdheut të tyre. Por, brenda tyre kishte gjithashtu një kulturë osmane për të mos e quajtur një ndërgjegje osmane që i frenonte që ta shihnin përfundimisht të ardhmen e Shqipërisë jashtë Perandorisë Osmane. Argumenti kryesor i tyre ishte se në rrethanat që u krijuan gjatë dhe pas Krizës Lindore, 1875-1878, në plan të parë doli çështja e ruajtjes së territoreve shqiptare të katër vilajeteve nga kërcënimet e vendeve fqinje për aneksimin e tyre, sesa shpëputja nga Perandoria Osmane. Kishte gjithashtu edhe interesa direkte personale të elitës rilindëse të lidhura me pozitat dhe ofiqet në administratën e lartë e në jetën publike osmane. Një pengesë objektive në ambiguitetin e qëndrimeve të kësaj elite ishin dhe prapambetja e thellë e shoqërisë shqiptare, niveli i ulët kulturor i shqiptarëve, por edhe i një klase konservatore feudale shqiptare e islamizuar dhe osmanizuar që nuk e konceptonte veten dhe vendin jashtë autoritetit të gjysmëhënës.

Në këto rrethana, duke shtuar edhe njëherë tjetër edhe mungesën e mbështetjes të një Fuqie të Madhe evropiane për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, platforma e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e vitit 1878 del e gjetur dhe e justifikuar si programi i parë i organizuar politik i nacionalizmit shqiptar. Mbi 20 vjet më vonë, në 1899, Sami Frashëri në traktatin e tij politik shumë të njohur *“Shqipëria çka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”*, në vijim edhe të Kuvendit të Lidhjes Kombëtare të Pejës, përpunoi edhe më qartë platformën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për të ardhmen e Shqipërisë si shtet i pavarur. Por, edhe ai për momentin mbeti përsëri në kërkesën taktike të bashkimit të katër vilajeteve shqiptare në një njësi të vetme autonome nën Perandorinë Osmane. Veç e la të hapur projektin e një shteti të pavarur kombëtar, sepse ishte i bindur se *“shqiptarëve me hir Turqia s’u ka për të dhënë gjë. Shqiptarët duhet t’i marrin ato që duan me pahir; t’i kërkojnë me fjalë por të ken edhe pushkënë plot”*.<sup>9</sup>

Rilindësit patën kufizimet e tyre programore të diktuar edhe nga përulja e shtyllës vertebrore të shumicës së shqiptarëve para islamit e osmanizmit, fenomen për të cilin Fallmerayer në mënyrë figurative shkruante se “që prej 400 vjetësh ata gjenden të humbur nën barrën e maleve, si trupat e gjigandëve”. Por, një pjesë e mirë e tyre ishin tepër të qartë për përkatësinë dhe orientimin që duhej të kishin shqiptarët në agimin e shekullit XX. Udhëheqësi politik i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashëri, në fund të viteve ‘80-të shekullit XIX, shprehte bindjen se Shqipëria “do të tregohet më e denja për përkrahjen e Evropës” dhe se “çështja e Lindjes nuk do të mund të zgjidhet kurrë në qoftë se Evropa nuk merr parasysh fatin e Shqipërisë...”.<sup>10</sup>

Vokacionin evropian të rilindësve e shprehu në mënyrën më të mundshme për kohën edhe Sami Frashëri. Duke evokuar historinë si kombi më i vjetër në Evropë, ai nënvizonte të drejtën e shqiptarëve më tepër se të çdo kombi tjetër në tokën e Evropës. Samiu bënte thirrje “të njihet vendi ynë për Shqipëri, ta njohë edhe Evropa Shqipëri”. Ideologu kombëtar u drejtohej shqiptarëve që të përpiqeshin, se vetëm kështu “do të jemi një nga më të mirët e më të ndriturit e kombeve të Evropës”.<sup>11</sup>

Përfaqësuesi më elokuent i përkatësisë dhe i orientimit evropian të Shqipërisë mes rilindësve, në kapërcyell të shekullit të XX, ka qenë Ismail Qemali. Kultura e tij evropiane, pikëpamjet e tij liberale dhe përvoja e kontaktet e tij të vazhdueshme me përfaqësues të lartë të diplomacisë evropiane, e çuan atë në një konflikt të hapur me Sulltanin, aq sa për t’i shpëtuar dënimit në vitin 1900, ku u arratis nga Stambolli e për disa vite qëndroi në Evropë. Që andej, ai u kujtonte shqiptarëve se ata “në gjak kanë mbetur gjithnjë evropianë” dhe se e ardhmja e tyre do të ishte e sigurt po të futeshin në rrugën e qytetërimit evropian.<sup>12</sup>

Shqiptarët, qoftë edhe për përgjegjësinë e tyre nuk e patën luksin si popujt e tjerë të Ballkanit të mund të kishin mbështetjen e disa apo edhe një Fuqie të Madhe evropiane, deri në fundin e shekullit të XIX. Koniunktura evropiane filloi të ndryshojë në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XX dhe dy fuqi evropiane, Austro-Hungaria dhe Italia për shkak të interesave gjeopolitike të tyre në Ballkan shfaqën interes për shqiptarët dhe në mënyrë graduale mbështetën aspiratat e tyre kombëtare deri në shpalljen dhe njohjen e shtetit të pavarur shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, në vitin 1913.

Me të mirat dhe të këqijat e saj, Shqipëria e 1913 është një krijesë evropiane. Nuk ishte rastësi gjithashtu që projektuesi dhe themeluesi i shtetit të pavarur shqiptar, Ismail Qemali, ishte një burrë shteti që në fazën finale u mbështet nga dy fuqitë evropiane: Austro-Hungaria dhe

Italia. Shqipëria me këtë akt u rikthye në Evropë duke u shkëputur pas gati pesë shekujsh nga Perandoria Osmane. U rivendos ura lidhëse e historisë shqiptare midis epokës së Skënderbeut dhe kohës moderne që ishte njëkohësisht edhe një urë lidhëse midis shqiptarëve me Evropën e qytetërimit evropian. Me Skënderbeun në mëndje e flamurin e tij në dorë, Ismail Qemali siç edhe dëshmon përmes kujtimeve të tij, donte t’u provonte *“Fuqive të Mëdha, se Shqipëria ishte e zonja të qeveriste veten dhe e meritonte besimin e Evropës”*, dhe se *“vetëm një sovran nga Evropa mund të na udhëhiqte drejt familjes së madhe evropiane, ku po hynim”*.<sup>13</sup>

1.Nathalie Clayer, Në fillimet e nacionalizmit shqiptar. Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë. Botimet Përpjekja, Tiranë 2009, f. 11.

2. Jusuf Buxhovi, Nga Shqipëria osmane te Shqipëria evropiane, Shtëpia Botuese “Faik Konica”, Prishtinë 2010, f. 7-9.

3.Rosamond McKitterick, Roland Quinault.Edward Gibbon and Empire.Cambridge University Press 2002, p. 113.

4.Maria Todorova, Ballkani imagjinar si alter ego e Evropës, Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, 2006, f. 27.

5.Oliver Jens Schmitt. Skënderbeu K & B Tiranë 2008, f. 425.

6.Po aty, f. 430-434.

7.Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit e Lindjes, MCM. Tiranë, 1994, f. 97.

8.Ismail Kadare. Identiteti evropian i shqiptarëve, Sprovë, Onufri 2006, f. 22.

9.Sami Frashëri, Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e çdo të bëhet, Reklama, Tiranë, 2010, f. 54.

10.Historia e popullit shqiptar II, Rilindja Kombëtare, Vitet ‘30-të të shek. XIX - 1912. Botimet Toena, f. 236.

11. Sami Frashëri, Shqipëria çka qenë, ç’është e çdo të bëhet, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor. Prishtinë, 2001, f. 76.

12. Historia e popullit shqiptar II..., f. 296.

13.Ismail Qemali. Kujtime. Botimet Toena, Tiranë, 2009, f. 419.

**Gjon BERISHA**

## **ARGJIPESHK VIA E TIVARIT DHE ÇËSHTJA “PRIMAS SERBIAE” SI PASOJË E VENDIMEVE TË KONGRESIT TË BERLINIT**

### ***1. Pasojat e vendimeve të Kongresit të Berlinit për Argjipeshkvinë e Tivarit***

Kongresi i Berlinit i thirrur më 13 qershor të vitit 1878, nga Fuqitë e Mëdha, për të rishikuar Traktatin e Shën Stefanit, kishte marrë përsipër të hartonte një hartë të re politike të Gadishullit të Ballkanit të robëruar nga Perandoria Osmane.

Kongresi për shkak të gjendjes faktike në terren nuk pranoi ta përpilojë hartën politike të Evropës Juglindore në bazë të parimit të kombësisë, por vendimet u morën sipas interesave të njëres apo tjetrës fuqi të madhe. Në Kongresin e Berlinit edhe përkundër peticioneve protestuese për moscopëtimin e trojeve shqiptare, të dërguara nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Fuqitë e Mëdha, pa ndonjë hezitim, vendosën që tokat shqiptare të bëhen plaçkë tregu ndërmjet Perandorisë Osmane, Greqisë, Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi.<sup>1</sup>

Si pasojë e zgjerimit territorial që përfitoi nga Kongresi i Berlinit, Mali i Zi pushoi së qeni, në kuptim etnik dhe religjioz, një shtet homogjen, sepse tani, përveç besimit ortodoks, ai mori nën krahët e tij shqiptarët e të dy besimeve, dhe komunitete tjera. Zgjerimi territorial i Malit të Zi në Adriatik me marrjen e Tivarin kishte futur në shtetin e ri një komponent katolikë, kryesisht shqiptarë etnikë. Ky fakt i organizimit

---

<sup>1</sup> Për vendimet e Kongresit të Berlinit dhe luftën për mbrojtjen e Ulqinit, Plavës, Gucisë, Tivarit etj., shiko: *Historia e popullit shqiptar II (Rilindja Kombëtare, vitet '30 të shek. XIX-1912)*, Tiranë: Akademi e Shkencave e Shqipërisë - Instituti I Historisë, 2002, 161-188.

të një bashkëjetese të re shkaktonte probleme, sepse identiteti malazez për shekuj me radhë ishte bazuar në luftën kundër të dy besimeve që i bartnin shqiptarët: kundër shqiptarëve mysliman që i identifikonte me “*turqit*” dhe mosbesimin ndaj shqiptarëve të besimit katolikë që i identifikonte si “*skismatikë*” latinë.<sup>2</sup> Kështu për çështje e katolikëve në Mal të Zi u bë e mundur të flitej vetëm nga Kongresi i Berlinit. Nga Kodi ligjor i Pjetrit I, i cili u rishikua në vitin 1855, mund të shihet qartë se në vitet gjashtëdhjetë të shek. XIX, vetëm riti ortodoks ishte besim vendës në Principatën e Malit të Zi. Si pasojë e nenit 28 të vendimeve të Kongresit të Berlinit, ku një pjesë e madhe e trevave shqiptare i kaluan Malit të Zi, bëri të mundur që çështja e katolikëve - ku shumica e tyre ishin shqiptarë,<sup>3</sup> të bëhej temë për diskutim në mes të autoriteteve malazeze dhe qendrave të vendosjes evropiane.

Në këto kushte, rregullimi i pozitës dhe raporteve me komunitetet e reja kombëtare dhe fetare që, deri me vendimet e Kongresit të Berlinit, nuk ishin pjesë e Malit të Zi, ishte një nga detyrat më të rënda të Qeverisë në Cetinës dhe knjaz Nikollës I. Principata e Malit të Zi, pos tjerash, kishte përfituar trevat me etni shqiptare, si: Podgoricën, Tivarin, Kollashinin, Plavën, Gucinë, Rugovën, kurse në vitin 1880 edhe Ulqinin. Copëtimi i trojeve shqiptare pati pasoja jo vetëm politike, por edhe pasoja të rënda edhe sa i përket organizimit fetar.

Problemi kryesor ishte krijimi i një situatë të paqartë, pasi popullata shqiptare katolike, e cila sipas dispozitave të Kongresit të Berlinit i përkiste Malit të Zi, fillimisht, ishte nën juridiksionin e Argjipeshkvisë me seli në Shkodër, domethënë në territorin sunduar nga Perandoria Osmane. Në anën tjetër, Austria si një “*shtet ekskluzivisht katolik*”, tregojë e shqetësuar për mbrojtjen e popullatës katolike në Mal të Zi, dhe me austriakët malazezët kishin një histori marrëdhëniesh jo të mira dhe të dhimbshme. Prandaj, shqetësimet e autoriteteve malazeze ishin të lidhura me një *veto* të mundshme nga ana e Austro-Hungarisë, e cila si mbrojtëse e popullsisë katolike në Ballkan, ishte e interesuar të ruante ndikimin e saj të paprekur mbi popullatën shqiptare.<sup>4</sup>

<sup>2</sup> Ž. Karaula, “Pisma crnogorskog pjesnika, svećenika i diplomate Jovana Sundečića bosansko-đakovačkom i srijemskom biskupu Josipu Jurju Strossmayeru (1881-1887)”, *Diacovensia: teološki prilozi*, Đakovo vol.XVII, no.1 (2009), 103.

<sup>3</sup> A. Hudal, *Die serbisch-orthodoxe Nationalkirche*, Graz et Leipzig: Moser 1922, 106.

<sup>4</sup> R. Tolomeo, “L’unione delle Chiese nei rapporti tra J. J. Strossmayer e il barnabita Cesare Tondini de’ Quarenghi”, *Josip Juraj Strossmayer 1815-2015*, (Wien, 21. Mai 2015 - Roma, 9 dicembre 2015), Đakovo, 2017, 246.



Argjipeshkvia e Tivarit, me vendimet e Kongresit të Berlinit, vërtet nuk gjendej brenda një shtetit të sunduar nga osmanët, por të një shteti të krishterë sllavo-ortodoks, dhe për të nga kjo kohë fillon momenti i ri i ballafaqimit të drejtpërdrejtë me sllavo-ortodoksizmin. Në lidhje me marrjen nën kontroll të Argjipeshkvisë së Tivarit, e cila tashmë gjendej në trevën e Malit të Zi, knjaz Nikolla që në vitin 1878 i ishte drejtuar për ndihmë ideologut të “*unionit sllav*”, ipeshkvit të Djakovos (Đakovo në Kroaci) Josip Juraj Strossmajerit (1815-1905), duke kërkuar prej tij që të ndërmjetësojë tek Selia e Shenjtë (Vatikan) për kinse ripërtëritjen e Dioqezës së Tivarit. Me atë rast, knjaz Nikolla i Malit të Zi, Strossmajerit i shkroi edhe këtë, “*Mali i Zi si shtet i pavarur, i pranuar, nuk mund të pranojë që një pjesë e shtetaseve të tij, qoftë edhe vetëm nga spektri fetar, të varet nga një pushtet në kufijtë e tij, aq më tepër, kur ai gjendet në Perandorinë turke*”,<sup>5</sup> duke aluduar kështu në faktin se Argjipeshkvia e Tivarit në vitin 1876, i ishte bashkuar asaj të Shkodrës, e cila aso kohe gjendej brenda kufijve të Perandorisë Osmane. Lutjen e knjazit të Malit të Zi, e bërë që në vitin 1878, Strossmajeri e pranoi krahëhapur, pasi ideja e tij për nënshkrimin e konkordatit në mes të Selisë së Shenjtë dhe Unionit të Sllavëve të Jugut, gjegjësisht Rosisë dhe Serbisë, nuk ishte treguar produktive.<sup>6</sup>

## **2. Përpjekjet për nënshkrimin e konkordatit në mes të Malit Zi dhe Vatikanit**

Nga ana tjetër, konkordati në mes Vatikanit dhe Malit të Zi i menduar si pjesë e “*politikës lindore*” për të nxitur dialogun me botën ortodokse, shikuar në perspektivë, sipas studiuesit Francesco Kakamo “*bëri të mundur bashkimin e dy kishave*”. Kjo padyshim konfirmon faktin se një nga protagonistët kryesor të negociatave ndërmjet Selisë së Shenjtë dhe Cetinës, është misionari italian, At Cesare Tondini, i cili në atë kohë u konsiderua si figura qendrore e ekumenizmit katolik dhe që mendonin se “*konkordati me Malin e Zi për ortodoksët, do të*

<sup>5</sup> K. Nikola, *Politički spisi*, Cetinje-Titograd 1989, 187-190; N. Ukgjini, *Kisha Katolike në trevat shqiptare (nga shek. XI deri sot)*, QB Shoqata e Jezuitëve: Tiranë 2016, 158.

<sup>6</sup> M. Zöllner, “O odnosima J.J.Štrosmajera prema Crnoj Gori”, *Istorijski zapisi*, god.XXXI (LI), knj.XXXV, br.1-2 (Titograd,1978), 180; Š. Rastoder, “Konkordat između Crne Gore i Vatikana 1886.godine s posebnim osvrtom na položaj Albanaca katolika”, *Krishterimi ndër shqiptarë. Simpozium ndërkombëtar (Tiranë, 16-19 nëntor 1999)*, Shkodër: Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë 2000, 253.

*nënkuptonte një konkordat me Rusinë, dhe përfaqëson shprehjen e simpatisë së Rusisë ndaj bashkimit të Kishës”.*<sup>7</sup>

Përmes korrespondencës së knjaz Nikollës, Strossmajerit, dhe ministrit të Jashtëm të Malit të Zi, mund të bëhet rindërtimi i shumicës së negociatave që i paraprinë nënshkrimit të konkordatit.<sup>8</sup> Megjithatë, Selia e Shenjtë nuk llogariste se në këtë çështje mund të mbështetej vetëm në pikëpamjet pansllaviste të argjipeshkvit Strossmajer dhe të mikut të tij Cesare Tondinit, meqë ata nuk i njihnin mirë rrethanat lokale dhe kishte dyshime në qëllimet e ndershme të knjazit Nikolla për këtë çështje. Në mënyrë që të merrnin informata adekuate, Selia e Shenjtë angazhoi një prift shqiptar nga Argjipeshkvia e Shkodrës, abatin Imzot Prend Doçin (Primo Dochi), që t’u përgatiste një raport të hollësishëm mbi statusin e Kishës Katolike në Malin e Zi. Në relacionin e tij dërguar, nga Tivari, Kongregatës për përhapjen e fesë, më 4 qershor 1883, kryesisht, prezanton një pamje objektive të gjendjes së Kishës Katolike në Malin e Zi. Ai shpjegoi në mënyrë eksplicite në raport se autoritetet malazeze nuk lejonin ndonjë ndërhyrje në çështjet laike apo kisha brenda kufijve të tyre. Sipas tij, të gjitha ato trysni, dyshime dhe kundërshtime që bëheshin herë pas here kundër shqiptarëve katolikë nga Cetina, ndodhnin me qëllim që të mos lejohej që drejtpërdrejt administrata e argjipeshkvit të Shkodrës të ushtronte presion ndaj Romës, për të emëruar një ipeshkëv për këto vende. Gjithnjë, sipas Doçit *“Princi është shumë i sjellshëm dhe i arsimuar mirë. Megjithatë, është e dukshme se ai nuk i mban premtimet e tij, veçanërisht nëse nuk është zotuar për diçka me shkrim. Ai gjithashtu, din se si ta ndryshojë mendjen....”*. Në mënyrë indirekte shpreh pikëpamjen se *status quo*-ja nuk është e dobishme për katolikët në Mal të Zi. Sipas pikëpamjes së Doçit, autoritetet malazeze duan që territori i tyre të bashkohet edhe në pikëpamje të Kishës, meqë në Mal të Zi, administrata e kishës së Shkodrës dhe Kotorit *de facto* ka pushuar.<sup>9</sup>

Një nga problemet që u diskutuan në mes të dy delegacioneve ishte çështja se kush ka të drejtë të emërojë argjipeshkvin e Tivarit. Sipas

<sup>7</sup> F. Caccamo, “La politica orientale della Santa Sede e il concordato con il Montenegro del 1886”, *U bi nequ e aerugo nequ e tinea demolitur, Studi in onore di Luigi Pellegrini per i suoi settanta anni*, a cura di Maria Grazia. del Fuoco, Liguori editore, Napoli, 2006, 53-80.

<sup>8</sup> Për më gjerësisht për këto bisedime, krh: Ž. Karaula, “Pisma Jovana Sundečića biskupu Josipu Štrosmjeru”, 91-155.

<sup>9</sup> Dochi P. *Archivio storico della Congregazione “de Propaganda Fide” (ASPF), Scritture riferite nei Congressi (SC)* - Albania, Macedonia, Montenegro., tom.42, f. 991-994.

përfaqësuesve të papës, këtë të drejtë do të kishte vetëm një papë, megjithatë princi do të informohej paraprakisht dhe do të merrte një mendim për kandidatin që do të emërohej në atë funksion, në mënyrë që të bënte të mundur marrjen në konsideratë vërejtjet e natyrës politike. Në këtë mënyrë, në vazhden e bisedimeve disamujsh, lëvizja para e knjaz Nikollës lidhur me mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje me Selinë e Shenjtë, mori formën e negociatave të ndërlikuara. Opsioni i sundimitarit të Malit të Zi për një ipeshkëv të zgjedhur sipas dëshirës së autoriteteve malazeze - “*dëshirë e justifikuar*” në kushtet e situatës vendore, nënkuptonte zgjedhjen një sllavi, në kurriz të komponentëve shqiptarëve katolikë - Selia e Shenjtë ishte kundër një kërkesë të tillë që çonte në legalizimin e pabarazisë në mes pakicës katolike dhe shumicës ortodokse.<sup>10</sup>

Ndërkohë, rrethanat në skenën politike ndërkombëtare kishin ndikuar te Selia e Shenjtë që të jetë më vigjilente në lidhje me kërkesat e Malit të Zi. Para së gjithash, Roma ishte e njoftuar që tashmë një ditë pas Kongresit të Berlinit, shqiptarët refuzuan t’i binden vendimeve të Fuqive të Mëdha. Të bashkuar përmes Lidhjes së Prizrenit, ata po organizoheshin për një rezistencë ndaj synimeve malazeze për të marrë zyrtarisht posedimin e territorit, që u kishte dhënë Kongresi i Berlinit. Ajo që i shqetësonte veçanërisht ishte gatishmëria e shqiptarëve katolikë për të mbrojtur trevat e tyre dhe përkrahja e parezervë nga ana e bashkëqytetarëve të tyre të besimit mysliman, për të luftuar kundër malazezëve. Në fakt, ata edhe inkurajoheshin nga disa përfaqësues të klerit vendas. Pa marrë parasysh se diplomacia e Vatikanit në çdo mënyrë u përpoq t’u bëjë thirrje kryengritësve që të parandalojë përhapjen e krizës, këto nisma i bëjnë gjithnjë e më të qartë vështirësitë e vendosjes së pushtetit malazez mbi shqiptarët.<sup>11</sup>

Rezistenca e shqiptarëve ndaj vendimeve të Kongresit të Berlinit, mund të mësohet edhe nga raporti i zëvendëskonsullit austro-hungarez të Tivarit, Depolo, dërguar më 28 qershor 1880, ministrit Fuqiplotë në Cetinë, kolonelit Thoemel, mbi mobilizimin e forcave ushtarake malazeze në Tivar, për urrejtjen e madhe që kishte popullsia shqiptare e këtij qyteti kundër sundimit malazez si dhe për gatishmërinë e saj për të marrë pjesë në luftën kundër Malit të Zi. Në këtë raport, përveç tjerash thuhej: “*Në qoftë se popullsia e Shqipërisë, e nxitur nga dëshira që ta*

<sup>10</sup> Caccamo, “La politica orientale della Santa Sede e il concordato con il Montenegro del 1886”, 73-74.

<sup>11</sup> Ibid, 75.

*ruajë autonominë dhe pavarësinë e saj, është krejtësisht kundër çdo lëshimi tokësor bërë në favorin e Malit të Zi, ajo e distriktit të Tivarit, megjithëse në pamundësi që t'i bashkojë armët e saj me ato të Lidhjes Shqiptare, ndjen po këtë urrejtje dhe ka të njëjtat ndjenja si të gjithë shqiptarët e tjerë, dhe kështu, në vend që të dëshirojë që të kryhet lëshimi i Ulqinit Malit të Zi, do të donte, sipas dëshirës së shumicës, që edhe distrikti i Tivarit, të shkëputej nga sundimi malazez dhe të kthehej përsëri në kushtet e qeverisjes së parë. Urrejtja që ndjejnë tivarasit për Malin e Zi është shumë e madhe. Ndoshta përjashtim bën një pjesë shumë e vogël e elementit greko-ortodoks, i cili, meqë është pjesa më e mjeruar e popullsisë, nuk ka se ç'të fitojë ose të humbasë as nën Malin e Zi, as nën ndonjë qeveri tjetër".<sup>12</sup> Përkundër tentimeve për të manipuluar mbi baza fetare, kundër copëtimit të vendit ishte ngritur edhe banorët e Hotit dhe Grudës më në krye bajraktarin e Hotit, Dedë Gjonin. Sipas raportit të Konsullatës së Përgjithshme austro-hungareze në Shkodër, dërguar ministrit të Jashtëm, baronit Haymerle, kuptohej se banorët e Hotit dhe të Grudës kishin vendosur njëzëri që më mirë të luftojnë dhe të sakrifikojnë deri tek ai më i fundit, se sa të pranojnë shkëputjen e tokave të tyre dhe dhënien e këtyre tokave Malit të Zi. Bajraktari Dedë Gjoni, në bisedime me konsullin austro-hungarez, ia bënte me dije atij se nuk ka ekzistuar dëshira që ata, të cilët thuajse të gjithë i përkasin besimit katolik, të shkëputen me forcë nga tërësia e tyre kombëtare dhe t'i dorëzohen Malit të Zi, armikut të tyre të trashëguar prej kohësh.<sup>13</sup>*

Në këtë situatë, ndërmjet viteve 1880-1881, Selia e Shenjtë mbajti një qëndrim jashtëzakonisht të kujdesshëm: do të presë të stabilizohej çështja në kufirin shqiptaro-malazez para se të bëhej ndonjë ndryshim në kuadër të juridiksioneve kishtarë në veri të Shqipërisë. Divergjencat në marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Selisë së Shenjtë dhe Mali i Zi, implikimet e kohëpaskohshme të Austro-Hungarisë, së bashku me komplikimet që ndodhnin në ndërkohë në teren nga rezistenca e kryengritësve shqiptarë, sjellja jo e mirë e malazezëve ndaj besimtarëve dhe klerit katolik, krijuan një gjendje ngecje të zgjatur në negociatat në mes Romës dhe Cetinës. Kjo gjendje jo e mirë në negociata, u reflektua edhe në teren. Në verën e 1882, Qeveria e Cetinës nuk e lejoi argjipeshkvin e Shkodrës që të vizitonte dioqezën e Tivarit, duke u

<sup>12</sup> *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (dhjetor 1879 - qershor 1880)*, vëll. III, përg. Beqir Meta, Instituti i Historisë "Ali Hadri": Prishtinë, 2018, dok. 637.

<sup>13</sup> *Ibid.*, dok.411.

justifikuar se, gjoja negociatat ishin ende të papërfunduara në lidhje me një marrëveshje me Selinë e Shenjtë. Që atëherë ata filluan të shkaktojnë pengesa në rrugën e misionarëve françeskanë nga Shqipëria e Veriut, të cilët kishin qëllim të vizitonin disa nga famullitë e tyre të mëparshme që gjendeshin në Mal të Zi, dhe që kishin mbetur pa përkujdesje baritore.<sup>14</sup>

Gjatë bisedimeve me Vatikanin, Strossmayer, vazhdonte në insistimin e tij për sllavizmin e trevave shqiptare të Argjipeshkvisë së Tivarit, me pretendimin se në krye të Kishës nuk mund të ishte tjetër përveçse një person me *“origjinë nga sllavët e Jugut”*, i cili duhet të ishte *“i pastër si loti, i kujdesshëm si gjarpri, dhe gjithashtu thellësisht besnik ndaj Kishës Katolike dhe Selisë së Shenjtë”*. Sipas tij: *“Të gjitha këto cilësi mund të gjendet vetëm në një njeri, nga sllavët e Jugut, që e njeh historinë e popullit të tij dhe i cili është në dijeni të qëllimit të shenjtë, të një vendi hyjnor i destinuar për sllavët e Jugut”*.<sup>15</sup>

Mospranimi i propozimit të knjaz Nikollës nga ana e Selisë së Shenjtë, çoi në rifillimin e negociatave midis këtyre dy vendeve. Ky prolongim i bisedimeve, u shfrytëzua nga autoritetet në Cetinë për t’iu revanshuar shqiptarëve duke përdorur të gjitha mjetet e mundshme të ushtrimit të presionit. Në fillim të vitit 1884, përsëri knjaz Nikolla i ndaloi në mënyrë eksplicite misionarët françeskanë nga Shqipëria e Veriut që të vizitojnë katolikët e Malit të Zi. Sipas deklaratave kërcënuese dërguar përmes vikarit gjeneral të argjipeshkvit të Tivarit, Josip Koloviq, thuhej se: *“tani për tani, absolutisht nuk mund të lejojë as të tolerojë këtë mision, dhe kështu do të veprojë derisa të jetë lidhur një konkordat ndërmjet Selisë së Shenjtë dhe qeveria e tij”*.<sup>16</sup> Të ballafaquar me këtë situatë, autoritetet katolike në Shkodër dhe Tivar, të gjithë, iu drejtuan Selisë së Shenjtë, me kërkesën që sa më shpejt të arrihej një marrëveshje me Malin e Zi. Në dhjetor 1884, argjipeshkvi i Shkodrës, Imzot Pashk Guerini, udhëtoi në Romë që të bisedonte personalisht me Papa Leonin XIII. Në muajin pasues, Guerini u paraqit përsëri para Papës me një propozim, që derisa pritej një marrëveshje përfundimtare, të emërojë një kryesues të ri në Tivar, në mënyrë që popullata katolike vendase të mund t’i plotësonte nevojat më urgjente.<sup>17</sup>

### 3. Nënshkrimi i Konkordatit dhe pasojat për shqiptarët

<sup>14</sup> Caccamo, “La politica orientale della Santa Sede e il concordato con il Montenegro del 1886”, 76.

<sup>15</sup> Ibid, 78.

<sup>16</sup> Ibid., 78-79.

<sup>17</sup> Ibid., 80.

Kështu, bisedimet në mes të Malit të Zi dhe Selisë së Shenjtë, të filluara me parë, të cilat Rusia i shikonte si dinakëri politike, përfunduan më 18 gusht të vitit 1886, me nënshkrimin e Konkordatit me 14 nene,<sup>18</sup> i cili u ratifikua më 7 tetor të të njëjtit vit. Konkordati në mes të Malit të Zi dhe Selisë së Shenjtë u nënshkrua në emër të Vatikanit nga kardinali Jakobini, ndërsa në emër të Malit të Zi e nënshkroi Jovan Sundeçiq (sekretar personal i knjaz Nikollës). Kjo marrëveshje ndërshtetërore nënkuptonte lirinë e fesë për qytetarët e besimit katolik, kryesisht shqiptarët dhe në numër më të pakët kroatët në Mal të Zi, me Papën e atëhershëm Leonin XIII, i cili në mënyrë indirekte, në të ardhmen, para se të emëronte argjipeshkvin e Tivarit do të konsultohet me sovranin malazez. Kështu, argjipeshkvi, edhe pse ishte drejtpërdrejt vartës i Selisë së Shenjtë në punët e kishës, në të njëjtën kohë ishte nën kontrollin e plotë të autoriteteve të Principatës së Malit të Zi. Kjo formë e zgjedhjes së argjipeshkvit dhe juridiksionit të Tivarit, është e precizuar në disa prej neneve të Konkordatit, si: **neni 2.:** *“Shenjtëria e Tij, para se të emërojë përfundimisht argjipeshkvin e Tivarit, do të njoftojë qeverinë mbi personalitetin e kandidatit, për të shikuar a ka ndonjë shkak me natyrë politike apo civile që kishte për të kundërshtuar emërimin e tij”*; **neni 4.:** *“Para se të fillojë kryerjen e shërbimit të vet, argjipeshkvi i Tivarit do të bëjë betimin e besnikërisë para Madhërisë së Tij, knjazit të Malit të Zi me këto fjalë: “betohem dhe premtoj përpara Hyjit dhe në Ungjillin e Shenjtë, se do të jem i dëgjueshëm dhe i besueshëm ndaj Madhërisë së Tij, knjazit të Malit të Zi, unë premtoj të mos bëjë ndonjë marrëveshje, as nuk do të marrë pjesë në ndonjë këshill, e as nuk do të inkurajoj dhe as nuk do të lejoj klerikët e mi vendorë, të marrin pjesë në çfarëdo aktiviteti, i cili do të shqetësojë qetësinë publike të shtetit”*. Qeveria e Malit të Zi, pranon titullin e Shkëlqesisë së Tij të Lartë dhe i jep një shumë të të ardhurave vjetore prej pesë mijë frangash”; **neni 6.:** *“Ngritja e famullive është në kompetencë të Argjipeshkvit të Tivarit në marrëveshje me Qeverinë e Malit të Zi. Ai gjithashtu ka kompetencë të emërojë famullitarët, por kur ata nuk janë shtetas të Mali të Zi, do të veprojnë në marrëveshje me qeverinë malazeze; ndërsa kur ata janë shtetas malazezë, do të dërgojë emrat Qeverisë së lartpërmendur për*

<sup>18</sup> *Raccolta di concordati su materie ecclesiastiche tra la Santa Sede e le autorità civili.* A cura di Angelo Mercati. Vol.1, 1098-1914. Nuova ed. anastatica con supplement, Roma: Tipografia Poliglotta Vaticana 1954, 1048.

*miratim*”;<sup>19</sup> **neni 11.:** “*Formula e lutjes për sunduesin: Zot shpëtoje Knjazin*” do të këndohet në celebrimin e meshës në gjuhën e sllavëve; **neni 12.:** “*Për formimin [përgatitjen, shkollimin, Gj. B.] e malazezëve të rinj të aftë të shërbejnë si priftërinj katolikë, Qeveria malazeze, me marrëveshje të ndërsjellë me argjipeshkvin e Tivarit, do të zgjedhë më të merituarit që do të dërgohen në Romë për të bërë studimet e tyre, e për këtë qëllim, Qeveria do t’u lidhë një ndihmë vjetore të përshtatshme. Në pesë vitet e para, që nga data e kësaj kontrate, do të dërgohen nga dy të rinj për çdo vit, pas së cilës do të jetë vetëm nga një për çdo vit. Të rinjtë do të jenë të detyruar në Romë të mësojnë edhe gjuhën serbe*”.<sup>20</sup> Siç shihet, me kërkesë të Qeverisë, për kandidatët, gjuha serbe u përcaktua si gjuhë studimi dhe predikimi. Qëllimi kryesor i këtyre dispozitave (neni 11 dhe 12) ishte që kandidatët të mësonin vetëm në gjuhën serbe, meqë autoritete malazeze e dinin se kandidatët për priftërinj vinin kryesisht nga familjet shqiptare të territorit të sapo pushtuar nga Mali i Zi.<sup>21</sup>

<sup>19</sup> **Art.2.:** “*Sua Santità, prima di nominare definitivamente l'Arcivescovo di Antivari, parteciperà al Governo la persona del candidato per conoscere se vi siano fatti o ragioni di ordine politico o civile in contrario*”; **Art.4.:** “*Prima di entrare in funzione l'Arcivescovo di Antivari presterà nelle mani di Sua Altezza il Principe del Montenegro il giuramento di fedeltà nella formola seguente: «Io giuro e prometto dinanzi a Dio e sopra i Santi Evangelii obbedienza e fedeltà a Sua Altezza il Principe del Montenegro ; prometto di non avere accord qualsiasi, né di assistere ad alcun Consiglio, né d'incoraggiare, o lasciar partecipare dal Clero a me subordinato a qualsiasi impresa che tenda a turbare la pubblica tranquillità dello Stato».* Il Governo Montenegrino gli riconosce il titolo di Illustrissimo Monsignore e gli assegna un emolumento annuo di franchi cinquemila”; **Art.6.:** “*All'Arcivescovo di Antivari spetta, d'intelligenza col Governo Montenegrino, l'erezione delle parrocchie. A lui spetta pure la nomina dei Parrochi, e se trattasi di persone estranee al Principato, procederà d'intelligenza col Governo Montenegrino; se poi trattasi di sudditi montenegrini darà notizia della nomina al detto Governo.*”<sup>19</sup> Ibid., 1048.

<sup>20</sup> **Art.11.:** “*La formola di preghiera pel Sovrano: Domine safrvutn fac Principini, sarà cantata negli ufficii divini in lingua slava*”; **Art.12.:** “*Per la formazione di giovani montenegrini idonei al sacerdozio cattolico, il Governo montenegrino, di comune accordo coll'Arcivescovo di Antivari, ne sceglierà alcuni dei più meritevoli che saranno inviati a Roma per farvi i loro studii, ai quali passerà pel medesimo scopo un conveniente annuo sussidio.*

*Nei primi cinque anni dalla data della presente convenzione, questi giovani saranno in numero di due per ogni anno, in seguito sarà uno solo per ciascun anno. Gli stessi giovani saranno obbligati di studiare in Roma anche la lingua Serba.*”<sup>19</sup> Ibid, 1049. Krahaso, po ashtu edhe te I. Marković, *Dukljansko-barska Metropolija*, Zagreb 1902, 157-159.

<sup>21</sup> Hudal, *Die serbisch-orthodoxe Nationalkirche*, 107.

Në të vërtetë, Konkordati, për katolicizmin e Malit të Zi nuk solli avantazhet që u shpresuan në Romë me nënshkrimin e saj. Konkordati, të nesërmen më 8 tetor të vitit 1886, me dekretin e Papës Leonit XIII, i dha pasojat e para (për shkak të situatës imponuese të krijuar në terren) të shkëputjes së menjëhershme të Argjipeshkvisë së Tivarit nga Argjipeshkvia e Shkodrës. Kjo erdhi si pasojë e politikës së knjaz Nikollës, i cili për asnjë çmim nuk e donte juridiksionin shpirtëror të Shkodrës në Mal të Zi.<sup>22</sup>

Përveç marrëveshjes me Vatikanin, Strossmayer ishte shumë i interesuar edhe për të përcaktuar kandidatin e preferuar për postin e argjipeshkvit të Tivarit. Ky momentum u krijua pas vdekjes së argjipeshkvit Karl Pootenit, më 15 janar të vitit 1886. Duke e shfrytëzuar këtë rast, në fillim Strossmayer ishte përcaktuar për një prift nga Gjiri i Kotorrit, mirëpo ishte sekretari i knjaz Nikollës, Jovan Sundeçiq, ai i cili e bindi për të ndryshuar mendjen e tij në favor të një françeskani dalmat, drejtor i gjimnazit në Sinj dhe profesor i historisë në Universitetin e Vjenës, Shimun (Simeon) Milinović. Kështu, me sugjerimin e ipeshkvit dhe sipas vullnetit të knjaz Nikollës, Selia e Shenjtë më 8 tetor të vitit 1886, emëroi për argjipeshkëv të ri të Argjipeshkvisë së Tivarit, françeskanin Shimun Milinović, nga Dalmacia (1886 -1910), të cilit njëherësh iu vërtetua titulli i trashëguar nga shek. XV "*Primas Serbiae*".<sup>23</sup>

Argjipeshkvi Milinović, tashmë si *Primas tutius Serbiae*, së bashku me princin Nikolla dhe Strossmayerin, të prirë nga ideja për bashkimin e sllavëve të Jugut, bënë projekte për asimilimin e shqiptarëve katolikë të vendit. Në vazhden e këtij projekti, pos të tjerash, ishte edhe futja e liturgjisë kishtare në gjuhën e "*vjetër sllave*" (starosllavene), alfabeti glakolik, në Argjipeshkvinë e Tivarit (në vitin 1895) si dhe angazhimi i klerit kroat, për të vepruar ndër famullit shqiptare. Me këtë rast, duhet theksuar se argjipeshkvi Strossmayer ishte edhe një ndër pishtarët e flaktë që në Kishë të përdorej gjuha e vjetër sllave, që më parë

<sup>22</sup> Për arsye se dioqeza e Shkodrës, gjithmonë kishte numër të shumtë të shqiptarëve katolikë në krahasim me dioqezat tjera shqiptare, me kërkesën e argjipeshkvit të Tivarit dhe Shkodrës, Karl Pooten, me letërvendimin e Papa Piut IX, të datës 15 mars të viti 1867, bëhet bashkimi i Tivarit me dioqezën e Shkodrës. Argjipeshkvi, Pooten e kaloi Selinë nga Tivari për në Shkodër, duke e marrë titullin: Argjipeshkëv Metropolitan i Tivarit dhe i Shkodrës dhe "primat i Serbisë". Ukgjini, *Kisha Katolike në trevat shqiptare*, 157.

<sup>23</sup> Marković, *Dukljansko-barska Metropolija*, 175-177; Karaula, "Pisma Jovana Sundečića biskupu Josipu Štrosmjeru", 111.



përdorej vetëm në disa vende të Dalmacisë. Lidhur me problemin e gjuhës së “vjetër sllave” në liturgji në Kishën Katolike në Mal të Zi, duhet të cekim se kjo ide vinte nga Strossmajer, i cili ishte i dërguari apostolik për Serbi dhe idetë e tija nuk mund edhe aq lehtë të pengoheshin, ngaqë ishte njëri zyrtar si i dërguar apostolik për Serbi, kështu që kjo gjë, jo vetëm që mund të ndikonte në Mal të Zi, por shkaktonte probleme edhe për disa vende në Kosovë (siç ishte Janjeva).<sup>24</sup>

Argjipeshkvi Milinović, si një përfaqësues i denjë i politikës sllave të pushtetit politik në Mal të Zi, orvatej që me politikën e tij dhe aspiratat e knjaz Nikollës, i cili dëshironte që Mali i Zi të luante rolin e piemontit serb, të përfshinte edhe kishën e vet dhe t’i jepte asaj rol edhe më të rëndësishëm që sa kishte në të vërtetë.<sup>25</sup> Synimi kryesor i tij ishte futja e gjuhës së “vjetër sllave” në liturgji dhe botimi i Mesharit në këtë gjuhë.<sup>26</sup> Sipas studiuesit Zöllner, duke u bazuar në reagimin e një diplomati austro-hungarez, pohon se argjipeshkvi i sapo emëruar Shimun, sipas kërkesës së knjaz Nikollës, përmes liturgjisë sllave, në një argjipeshkvi ku shumica absolute e katolikëve ishin shqiptarë, dëshironte të sllavizojë gradualisht shqiptarët, të cilët, sipas tij, në tërësi në këtë argjipeshkvi janë rreth 4 000 frymë, kurse sllavë ka 1 500.<sup>27</sup>

Pushteti austro-hungarez, i cili në vitin 1873 kujdesej për shqiptarët katolikë në Ballkan, ndaj kësaj çmendurie dhe shumë fenomeneve të tjera diskriminuese, shprehej si kundërshtar i përbetuar. Rasti i Malit të Zi, nga Vjena zyrtare u cilësua si një gabim elementar i Vatikanit. Ambasadori austro-hungarez në Selinë e Shenjtë, kontin Luigi Paar, në raportin e tij, shkruan se ky hap i Vatikanit ishte i shpejtuar dhe jo i menduar mirë. Sipas tij, Vatikani kishte lejuar që Strossmajer t’i mashtronte. Si rrjedhojë e kundërshtimit të rreptë të Austro-Hungarisë, arriti të ndalohej përdorimi i mesharit romak në gjuhën e “vjetër sllave”.<sup>28</sup>

Më 29 mars të vitin 1887, një dispozitë plotësues e Konkordatit (sipas një rregullimi liturgjikë të Papa Benediktit XIV “*ex pastoralis*

<sup>24</sup> A. Ramaj, “Lazër Mjeda në Argjipeshkvinë Shkup-Prizren mes 1909-1921”, *Imzot Lazër Mjeda mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar*, Albanisches Institut, St. Gallen 2011, 133.

<sup>25</sup> *Ministarstvo inostranih djela 1879-1915, zbornik dokumenata*, priredio Slavko Burzanović, Podgorica, 2007, 197-198; N. Ukgjini, *Kisha Katolike në trevat shqiptare*, 160.

<sup>26</sup> Zöllner, “O odnosima J.J. Štrosmajera prema Crnoj Gori”, 179.

<sup>27</sup> Ibid, 191-192, not.86.

<sup>28</sup> Ibid., 189, 192.

*munere*”, të 26 gushtit 1754), përdorimi i liturgjisë në gjuhën sllave shtrihej mbi katolikët e Malit të Zi. Megjithatë, zbatimi i saj rezultoi me probleme të mëdha, sepse nga shqiptarët katolikë u pa si tendencë e sllavizimit të tyre. Prandaj, edhe shtypja e librave liturgjikë, gjithashtu nuk kaloi pa vështirësi. Shkrimi cirilik sikurse edhe ai glakolik nuk ishin të përshtatshme për libra liturgjikë. Ashtu siç kishte vërejtur studiuesi dhe vizitori i atyre viteve, Hudal, gjuha latine në tekstet liturgjike vazhdonte të përdorej pa u prekur në disa famulli katolike.<sup>29</sup>

Me kalimin e kohës, dispozitat e konkordatit u ndryshuan në mënyrë të konsiderueshme nga aprovimi i ligjit shtetëror të Malit të Zi, i 31 gushtit 1909, mbi organizimin e klerit të famullisë (neni 34-40). Kështu, derisa, sipas nenit 6 të Konkordatit, argjipeshkvi kishte të drejtë në plotësimin e posteve baritore, dhe vetëm krijimi i famullive të reja dhe angazhimi i klerit të huaj në kujdesin baritor ishin subjekt i kufizimeve, tani, sipas ligjit të vitit 1909 (neni 34-40) vetëm shtetasit malazezë mund të punonin si famullitarë katolikë. Kushdo që kishte studiuar jashtë vendit duhej t’i nënshtrohej një testi para një komisioni mbi temat, si: gjuha serbe dhe ajo sllave kishtare, historia serbe dhe gjeografia e “vendeve serbe”. Madhësia e famullive të veçanta përcaktohej nga Ministria e Kulturës me propozim të argjipeshkvit. Zgjedhja e famullitarëve bëhej nga një komision i përbërë nga një zyrtar i Ministrisë së Kulturës dhe një klerik katolik. Nga fondi zyrtar i pensioneve, të administruara nga Ministria e Financave, paguheshin edhe klerikët katolikë. Autoriteti i apelimit në çështjet disiplinore ishte Ministria e Kulturës. Pra, në përgjithësi, organizimi i jetës fetare kishte një sfond të rëndësishëm politik, përmes së cilës, autoritetet malazeze, synonin ta kontrollonin çdo gjë që kishte të bënte me shqiptarët katolikë.<sup>30</sup>

Propaganda katolike në mesin e ortodoksëve ndalohej, për shkak se edhe pse Kushtetuta malazeze e vitit 1905, i njihte zyrtarisht besimet fetare (neni 128), ajo ndalonte çdo proselitizëm (ndërrimi i fesë) kundër fesë shtetërore ortodokse (neni 136).<sup>31</sup>

Por, meqenëse marrëveshjet e Konkordatit nga Qeveria nuk u respektuan në të gjitha pjesët, gjithnjë u shoqërua me vështirësi në

<sup>29</sup> Hudal, *Die serbisch-orthodoxe Nationalkirche*, 107.

<sup>30</sup> *Ibid.*, 109.

<sup>31</sup> *Ustav za Knjaževinu Crnu Goru iz 1905*, str.25-26, član 128: “Slobodno i javno izvršivanje vjerozakonskih obreda imaju u Crnoj Gori sve priznate vjeroispovijesti”, član 136: “Zabranjuje se svaka radnja, upravljena protiv istočno-pravoslavne crkve u Crnoj Gori (prozelitizam)”.

zbatimin e tyre në praktikë. Kjo ishte, gjithashtu, një nga arsyet pse katolicizmi në Malin e Zi nuk bëri pothuajse asnjë përparim.

Politikën e diskriminimit dhe asimilimit të shqiptarëve katolikë e vazhdoi edhe më vonë pasardhësi i argjipeshkvit të Tivarit, Nikolla Dobriçiq (1912-1955). Një fushatë tepër detyruese për përcaktimin e identitetit të shqiptarëve katolikë si “serbë” dhe atyre myslimanë si “turq”, ishte linçuar edhe në periudhën e dy dekadave të fillimit të shek. XX, e cila nuk kaloi pa pasoja për shqiptarët. Jo vetëm kaq, por Dobriçiq është i njohur si përkrahës i aspiratave të Malit të Zi për okupimin e Shkodrës, me pretekstin se ky qytet ka qenë “*Selia e Balshajve*”, dhe si i tillë, ai kërkonte përkrahjen e Vatikanit për zgjerimin e ndikimit malazez edhe në Shkodër.<sup>32</sup> Dobriçiq, i cili e mbante vetën për serb, e jo për kroat që ishte, postin e vet si argjipeshkëv e instrumentalizonte për ta informuar Qeverinë malazeze për realizimin e qëllimeve ekspansioniste në dëm të shqiptarëve. Në sajë të kësaj politike, në bashkëpunim me politikën malazeze, ai arriti që të ndajë famullitë e Tuzit, Traboinit, Grudës dhe Klleznes në vitin 1912 nga Argjipeshkvia e Shkodrës, për t’iu bashkëngjitur asaj të Tivarit. Lufta e tij për të shkëputur territore në dëm të shqiptarëve nuk u kufizua vetëm me Shkodrën, por argjipeshkvi Dobriçiq, kërkonte që famullitë e rajonit të Pejës dhe Gjakovës (të cilat ishin në kuadër të Argjipeshkvisë së Shkupit) t’i bashkëngjiteshin Argjipeshkvisë së Tivarit.<sup>33</sup>

Çështje tjetër, që u aktualizua si rezultat i ndryshimeve territoriale që solli Kongresi i Berlinit, ishte edhe problemi i titullit “*Primas Serbiae*”,<sup>34</sup> e cila fillet e saja i ka që nga mesjeta.<sup>35</sup>

<sup>32</sup> Rastoder, “Konkordat između Crne Gore i Vatikana 1886”, 260.

<sup>33</sup> Ibid., 263.

<sup>34</sup> Më gjerësisht për këtë titullar, shiko: M. Faber, “Das Recht des Erzbischofs von Antivari auf den Titel Primas von Serbien”, *Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und der Herzegowina*, Bd.11 (1909), 342-368.

<sup>35</sup> Me këtë rast, duhet shtuar se titulli i argjipeshkvit të Tivarit “*archiepiscopus Sclavinensis*”, i shfaqur në vitin 1256, nga i cili në shek. XV doli titulli “*Primas Serviae*”, tregonte qartë detyrën që i besohej nga Roma, sikurse ipeshkvit të Kotorrit, për t’u kujdesur për ipeshkvitë katolike në zonën, ku ortodoksizmi serbo-sllav kishte filluar që në shek. XIII, të gërryente murin katolik në Adriatik dhe më gjerë në viset arbërore. Ndryshimi i gjendjes politike, forcimi dhe zgjerimi i shtetit mesjetar serb në zonat fqinje, bëri që titulli i mësipërm të riformulohet në “*Primas Serbie*”. Selia e Shenjtë ia kishte shtuar këtë titull argjipeshkvit të Tivarit në shek. XV, në mënyrë që të krijojë një rezistencë të organizuar kundër islamizmit në Ballkan. Me këtë, Roma besonte se përmes dhënies së këtij titulli do t’i bashkonte katolikët dhe subjektet e tjera të krishtera në territoret që dikur ishin nën pushtimin e Mbretërisë së Rashës. Me

Një ndër arsytet se pse Tivari, i cili e mori vazhdimësinë e Dioklës antike e kishte këtë titull kishtar, ishte pikërisht fakti së kjo Argjipeshkvi kishte në gjirin e saj edhe popullsi sllave. Me këtë rast, Primati kishte përgjithësi para papatit që sllavët, shpirtërisht të posarilindur, të mos kalojnë në ndonjë herezi. Një arsye tjetër ishin rrethanat e ndërlikuara politike në Ballkan, që shfrytëzoheshin nga Kisha Ortodokse si kundërshtare e përbetuar e Romës, për zgjerimin e hapësirës në favor të saj në Gadishullin e Ballkanit. Primati mbeti aktual edhe gjatë pushtimeve osmane, kur Kisha Ortodokse dhe Perandoria Osmane të lidhura në koalicion, në vitin 1453 kishin qëllim zvogëlimin e hapësirës kishtarë të Kishës Romake, ndër popujt e Ballkanit.

Shënime të dokumentuara për *Primatin* e Tivarit kemi nga koha e argjipeshkvit Filip Gaj, (1485-1509), i cili është quajtur “*Totius Serviae Primas*” (Primat i gjithë Serbisë). Këtë shënim e gjejmë te të gjithë ipeshkvijtë e mëvonshëm të Tivarit me radhë, si: Gjon Bruno Harapi (1551- 1571), Toma Ursini (1579-1598), Marin Bici (1608-1624), Pjetër Mazreku (1624-1634), Gjergj Bardhi (1635- 1644), te Andrea (1671-1694) dhe Vinçenc Zmajeviqi (1701-1712), Lazër Vlladanji (1749-1786), Gjergj Radovani (1787-1790), Karl Pooten (1855-1886), Shimun Milinoviç (1886-1910) etj. Imzot Vinçenc Zmajeviqi, në saje të primatit që gëzonte, në vitin 1703, mbledhi *Kuvendin e Arbënit*, në Merqi të Lezhës. Po kështu ndodhi edhe me argjipeshkvin Karl Pooten, i cili mbledhi Kuvendin II të Arbrit, në vitin 1871, në Shkodër etj.<sup>36</sup>

Me ardhjen në krye të Selisë së Argjipeshkvisë së Tivarit të Nikolla Dobreçiqit, i cili e kreu këtë detyrë nga viti 1912-1955, çështja e *Primatit* edhe pse për Selinë e Shenjtë tashmë ishte më tepër honorik, u gjallërua duke marrë madje edhe përmasa politike. Më Konkordatin e lidhur në vitin 1914, në mes Selisë së Shenjtë dhe Mbretërisë serbe, ishte paraparë që Beogradi të ngrihet në rangun e Argjipeshkvisë dhe Shkupi të shndërrohej në dioqezë/ipeshkvi.<sup>37</sup> Por, për shkak të kundërshtimit të

---

kalimin e kohës, autorizimet e Primatit filluan të mos respektohen, “kështu që me kalimin e kohës, ka mbetur vetëm si një titull nderi. Krh.: Gj.Berisha, *Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI-XV*, Botimi i dytë i plotësuar, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri” 2017, 301-302.

<sup>36</sup> Faber, “Das Recht des Erzbischofs von Antivari auf den Titel Primas von Serbien”, 343-344; Marković, *Dukljansko-barska Metropolija*, 166-167.

<sup>37</sup> **Art.2.:** “Si costituisce nel Regno di Serbia una Provincia Ecclesiastica, composta dell'archidiocesi di Belgrado, con sede nella capitale del Regno - avente come territorio quello compreso nei confini della Serbia prima dei trattati di Londra e Bucarest dell'anno 1913 - e della diocesi di Scopia, suffraganea, con sede in detta città -

argjipeshkvit Lazër Mjeda, kjo gjë u arrit vetëm në vitin 1924, kur në krye të kësaj selie ishte ipeshkvi slloven, Janez Franjo Gnidovec.<sup>38</sup>

Beogradi nuk do ndalonte me kaq. Me rastin e përgatitjes së projekt-konkordatit mes Selisë së Shenjte dhe Mbretërisë SKS, politika e Beogradit, në vitin 1924 u përpoq që me çdo kusht, nëpërmjet ligjeve të projekt-konkordatit, ta marrë titullin shumëshekullor të Primatit nga Argjipeshkvia e Tivarit, për t’ia dhënë kryedioqezës së Beogradit. Me këtë rast, Beogradi do t’i ofronte Selisë së Shenjtë edhe riorganizimin e dioqezave të tjera brenda territorit të Mbretërisë SKS. Beogradi në këmbim të marrjes së primatit, i ofronte Selisë së Shenjtë edhe formulimin e emërimit të ri për kryedioqezën e Beogradit, me emrin Argjipeshkvia Katolike Serbe me qendër në Beograd.

Nikolla Dobreçiq, meqenëse ishte ndër protagonistët e ngjarjes, kushtëzonte kalimin e Primatit nga Tivari në Beograd, me kusht që edhe ai vetë personalisht të kalonte në selinë e Beogradit.<sup>39</sup> Pas bisedimeve të stërzgjatura e të vështira, kundërshtimit të Kishës kroate dhe kundërshtimeve të popullit në Mal të Zi, pa dallime nacionaliteti dhe besimi, nuk erdhi deri te finalizimi i kësaj ideje e as konkordatit në këtë formë, i cili me siguri do të krijonte kokëçarje të reja për Selinë e Shenjtë në këtë pjesë të Ballkanit. Si rezultat, Dobreçiq u tërhoq nga kjo ide duke qëndruar në Tivar dhe duke gëzuar dhe shfrytëzuar titullin “*Primas totius Serbiae*”, gjerë në vdekje, për sa kohë qëndroi në krye të kësaj Argjipeshkvie. Por, e gjithë kjo nuk e ndalonte Nikolla Dobreçiqin, që si Primat të bënte vizita te ndryshme në Evropë, Azi e deri në Amerikë, duke kërkuar ndihma për Malin e Zi dhe duke iniciuar shkëmbime tregtare mes Malit të Zi dhe shteteve evropiane.<sup>40</sup>

Me qëllim të sllavizmit dhe zhdukjes së etnisë shqiptare në kuadër të Argjipeshkvisë së Tivarit, argjipeshkvi Dobreçiq, i cili vetën e prezantonte herë si malazez e herë si serb, e më vonë si jugosllav, në

---

*comprendente i nuovi territori -, passando dalla giurisdizione di Propaganda Fide al diritto commune”; Art.6: “Il titolo ufficiale dell’Arcivescovo di Belgrado e del Vescovo di Scopia sarà di Illustrissimo e Reverendissimo Monsignore”, Concordato Fra Pio X e Pietro I Re Di Serbia, 24 giugno 1914, in: Raccolta di concordati su materie ecclesiastiche tra la Santa Sede e le autorità civili. A cura di Angelo Mercati. Vol.1, 1098-1914. Nuova ed. anastatica con supplement, Roma: Tipografia Poliglotta Vaticana 1954, 1100-1101.*

<sup>38</sup> Ramaj, “Lazër Mjeda në Argjipeshkvinë Shkup-Prizren, mes 1909-1921”, 160.

<sup>39</sup> Š. Rostoder, J. Rostoder, *Nikola Dobrečić, Arcibiskup Barski i Primas Srpski (1872-1955)*, Budva: Život i djelo, 1991, 48-51.

<sup>40</sup> Ukgjini, *Kisha Katolike në trevat shqiptare*, 314.

bashkëveprim me Qeverinë malazeze, tentonte që në trevat shqiptare të përhapej sa më shumë gjuha, kultura, tradita serbe e malazeze. Me po këtë qëllim, Qeveria kërkonte të jepej mësim në gjuhën sllave, përkatësisht në gjuhën serbe në të gjitha shkollat ku zhvillohej katekizëm (mësim feje) në gjuhën shqipe. Për t'i ndihmuar kësaj fushate, argjipeshkvi në fjalë, në mungesë të klerit shqiptar, nxitë ardhjen sa më shumë të klerikëve kroatë, duke tentuar të ndalonte ardhjen e klerikëve shqiptarë apo italianë.<sup>41</sup> Në këtë mënyrë, kroatizimi i shqiptarëve, siç konstaton me të drejtë studiuesi N. Ukgjini, do të shërbejë si urë kalimi i zbutur i shqiptarëve në rrugëtim për t'u bërë më vonë serbë apo malazezë të besimit ortodoks, gjë që është provuar në vitet në vazhdim.<sup>42</sup>

Përdorimi i gjuhës shqipe dhe shërbimi i klerit shqiptar në këto treva të Malit të Zi, do të jetë objekt i diskutimeve dhe moskuptimeve të shpeshta në mes Argjipeshkvisë dhe shtetit malazez në vazhdimësi. Kjo ka ndodhë, sidomos, që nga fundi i shek. XX, kur në krye të kësaj Argjipeshkvie do të vijnë shqiptarët për ta vazhduar edhe në ditët e sotme.<sup>43</sup>

Përgjithësisht, mund të themi se konkordati mes Malit të Zi dhe Vatikanit i lidhur për t'i rregulluar marrëdhënie midis shtetit dhe kishës, si pasojë e zgjerimit të territoreve të Malit të Zi, pas Kongresit të Berlinit, shumë shpejt do të jetë tërësisht në shërbim të ideologjisë dhe politikës shtetërore kundër shqiptarëve. Gjatë fundit të shek. XIX dhe gjatë luftërave ballkanike, Argjipeshkvia e Tivarit do të bëhet një nga shtyllat e politikës shtetërore, e cila do të shërbejë si qendër fetare në përputhje me interesat shtetërore dhe kombëtare të shumicës së popullsisë sllave. Në këtë kontekst duhet shikuar edhe gjendja e shqiptarëve katolikë, për të cilët mund të thuhet se ata ishin në një pozitë të vështirë kombëtare.

<sup>41</sup> Rastoder, J. Rastoder, *Nikola Dobrečić*, 21, 453, 444; Ukgjini, *Kisha Katolike në trevat shqiptare*, 311.

<sup>42</sup> Ukgjini, *Kisha Katolike në trevat shqiptare*, 311-312.

<sup>43</sup> Në vitin 1998, në krye të Argjipeshkvisë së Tivarit do të zgjedhet argjipeshkvi, Don Zef Gashi (famullitar i dikurshëm i Prishtinës), kurse nga 05.4.2016, këtë post do të vazhdojë ta mbajë edhe sot, Don Rrok Gjonlleshaj. Shiko: *Bollettino della Sala Stampa della Santa Sede*, Rinunce e nomine, 05.04.2016, N. 0232, f.1-2.

**Eduart CAKA**

## **LIDHJA E PRIZRENIT DHE FORMËSIMI I IDENTITETIT SHQIPTAR BRENDA PERANDORISË OSMANE**

### **Abstrakt**

Shekulli XIX solli një përmbysje të madhe si në raportin e shtetit osman në arenën ndërkombëtare ashtu edhe në aspektin juridiko-administrativ të vet Perandorisë, pjesë e së cilës shqiptarët kishin qenë prej më shumë se katër shekujsh. Sistemi i milletit tashmë ia kishte lënë radhën epokës së nacionalizmit çka nënkuptonte se si ndarja shoqërore e shtetit osman, ashtu edhe elementët përbërës të atij që mund të quhej identitet osman, tashmë përballeshin me një realitet krejtësisht të ri. Në fakt, përbërja fetare me tre besime kryesore kishte bërë që shqiptarët të kapeshin më së shumti në elementin gjuhësor dhe atë kulturor se sa në aspektin fetar, duke nxjerrë në pah identitetin e tyre shqiptar qysh prej kohës kur hynë nën sundimin osman. Parë nga ky kontekst, Lidhja e Prizrenit del përpara si një moment kulminant i formësimit të këtij identiteti ku përkatësia etnike-kulturore tashmë mishërohej në një vlerë më të madhe, atë të ndërtimi të një entiteti administrativo-ushtarako-kulturor.

### **Hyrje**

Periudha e Tanzimatit solli ndryshime rrënjësore brenda shtetit osman. Privilegji i milletit mysliman si drejtues të shtetit ishte ngritur, jomyslimanët nuk do të paguanin më xhizjen, mund të bëheshin pjesë e ushtrisë, ndërsa në administratë mund të ngriheshin në të gjitha postet dhe funksionet e mundshme.<sup>1</sup> Sigurisht që këto ndryshime nuk vinin

---

<sup>1</sup> Bernard Lewis, *Modern Türkiye'nin Doğuşu*, Çev. Boğaç Babür Turna, Arkadaş Yay., Ankara 2008, f. 455; *Historia e popullit shqiptar: Rilindja Kombëtare - vitet '30 të shek.*

vetëm nga nevoja që kishte Perandoria Osmane për reformim dhe përshtatje me kohën, porse edhe si rezultat i balancave ndërkombëtare dhe influencës që shtetet e huaja nisën të kenë mbi vendimet që merrte Stambolli.

Për historianin turk, İlber Ortaylı, termi “osmanlli - shtetas osman” lindi dhe u zhvillua vetëm gjatë shek. XIX<sup>2</sup>, si rezultat i ndryshimeve rrënjësore që e karakterizuan Perandorinë Osmane në këtë periudhë. Më herët, në periudhën klasike me fjalën “osman” nënkuptohej klasa që sundonte shtetin, pra shtesa e quajtur askerie. Shkëputja prej shtetit osman dhe krijimi i shteteve kombe prej shumë vendeve të Ballkanit, do të nxirrte në pah një element të ri, i cili ishte nacionalizmi. Përkundër këtyre zhvillimeve edhe termi “osman” do të kthehej në një identitet e përkatësi.

## 1. Mbi identitetin osman

Marrja e Kostandinopojës në mesin e shek. XV bëri që osmanët tashmë nga një fuqi rajonale të ktheheshin në njërin prej fuqive më të mëdha të Mesdheut, e sipas studiuesve në të njëjtën kohë përbën edhe një periudhë kryesore në formësimin e atij që mund të quhet identitet osman.<sup>3</sup> Pikërisht kthimi në një perandori dhe të pasurit në përbërje një shumëllojshmëri etnish e besimesh, shënon një pikënisje për studiuesit të cilët mundohen të përkufizojnë atë që mund të quhet identitet osman ose njeriun osman, pra atë *Homo Ottomanicus*.<sup>4</sup> Megjithëse është e pamundur të jepet një përkufizim i plotë i identitetit osman, studiues të ndryshëm që

---

XIX-1912, vëll. II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Botimet Toena, Tiranë 2002, f. 108; Stavro Skendi, *Zgjimi kombëtar shqiptar (1878-1912)*, Përkth. Skënder Luarasi dhe Nestor Nepravishta, Phoenix & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, Tiranë 2000, f. 32.

<sup>2</sup> İlber Ortaylı, *Osmanlı Barış*, Timaş Yay., İstanbul 2007, f. 25. Ndërsa Lewis, përdorimin për herë të parë të fjalës “osmanlli” e daton pas vitit 1860. Shih: Lewis, *Modern Türkiye ...*, f. 455.

<sup>3</sup> Cristine Isom-Verhaaren, “Constructing Ottoman Identity in the Reigns of Mehmed II and Bajezid II”, *Journal of the Ottoman and Turkish Studies Association*, 1:1-2 (2014), f. 111.

<sup>4</sup> Maurits H. van den Boogert, “Resurrecting *Homo Ottomanicus*: The Constants and Variables of Ottoman Identity”, *The Journal of Ottoman Studies*, XLIV (2014), f. 9; Sipas Isom-Verhaaren tentativat e para në historiografinë perëndimore për të kuptuar atë çka quhet identitet osman, shkojnë prapa deri në shek. XVI tek debate mbi origjinën e Hajreddin pashës. Shih. Isom-Verhaaren, *Constructing Ottoman Identity...*, f. 113.



janë angazhuar në këtë fushë, janë përpjekur të evidentojnë disa elementë përbërës të këtij identiteti.

Shoqëria osmane ishte e ndarë sipas përkatësisë fetare ku, përveç myslimanëve të cilët ishin të zotët e shtetit, pjesa tjetër ndahej në miletin (komunitetin) ortodoks (rum), armen dhe atë hebre.<sup>5</sup> Këtë aspekt e ilustron më së miri komuniteti armen, i cili edhe pse etnikisht ishte i njëjtë porse brenda sistemit të mileteve do të ndaheshin në miletin gregorian, katolik dhe më vonë edhe në atë protestant. Secili lindte dhe e zhvillonte jetën e tij duke u varur prej autoritetit shpirtëror e administrativ të komunitetit të cilit i përkiste. Midis mileteve nuk kishte kalime përveç rasteve të konvertimit në besimin islam, ose ndërmjet fraksioneve të ndryshme të krishtera.<sup>6</sup> Kreu i secilit millet kishte autoritet shpirtëror, administrativ e financiar mbi pjesëtarët e komunitetit të cilët të gjitha çështjet e tyre civile i kryenin tek ky autoritet. Të gjitha miletet gëzonin liri veprimi në të gjitha aktivitetet e jetës së përditshme përveç të marrurit me politikë, të qenit pjesë e ushtrisë të cilat ishin privilegj vetëm i shtresës sunduese, pra i myslimanëve. Pikërisht këtu del në pah edhe fakti se aspekti fetar nuk ishte përcaktues në atë çka mund ta quajmë identitet osman, porse ishin të tjerë elementë ata që e formonin këtë identitet.

Studiuesit e periudhës klasike osmane kanë përcaktuar aspektin ushtarak dhe atë politik si dy përbërësit kryesorë të identitetit osman duke e ndarë këtë proces në dy periudha kryesore, të cilat si vijë ndarëse kishin gjysmën e dytë të shek. XVI ose fillimin e shek. XVII.<sup>7</sup> Në këtë këndvështrim, si elementi ushtarak ashtu edhe ai politik bashkohen në një emërues të përbashkët, i cili qe edhe simboli i atij që mund të quhet identitet osman në shek. XV-XVI: elitat. Roli i këtyre ka ardhur duke

<sup>5</sup> Pavarësisht se nuk konsideroheshin si një millet më vete edhe popullsia katolike që jetonte në Perandorinë Osmane gëzonte të njëjtat të drejta. Për më shumë shih: Kemal H. Karpat, *Osmanlı'da Değişim, Modernleşme ve Uluslaşma*, Çev. Dilek Özdemir, İmge Kitabevi, Ankara 2006, f. 112.; Gjithashtu shih: Stanford J. Shaw, *Between Old and New: The Ottoman Empire under Sultan Selim III (1789-1807)*, Harvard University Press, Massachusetts 1971, f. 76-77.; Lewis, *Modern Türkiye ...*, f. 453-454

<sup>6</sup> Ortaylı, *Osmanlı Barışı ...*, f. 31.

<sup>7</sup> Kjo vijë ndarëse nuk është rastësore, përkundrazi përkon me periudhën kur elitat osmane nuk ishin devshirme në shumicën e tyre, porse i përkisnin brezit të dytë, çka nënkupton se ishin produkt i plotë i realitetit osman. Për më shumë shih: Linda T. Darling, "The Sultan's Advisors and Their Opinions on the Identity of the Ottoman Elite, 1580-1653", *Living in the Ottoman Realm; Empire and Identity, 13<sup>th</sup> to 20<sup>th</sup> Centuries*, Ed. Christine Isom-Verhaaren and Kent F. Schull, Indiana University Press, Indianapolis 2016.

ndryshuar sipas periudhave të ndryshme. Tek klasa e elitës futen funksionarët shtetërorë, dijetarët, të pasurit dhe ata më të rëndësishmit - ushtarakët. Sipas studiueses Darling, ushtria kishte një rol qendror në formimin e identitetit osman.<sup>8</sup> Kjo, për vetë faktin se ishte ushtria ajo që mbante në këmbë shtetin, luftonte për zgjerimin gjeografik të tij, por edhe me pushtimin e vendeve të reja siguronte të ardhura ekonomike kolosale për Perandorinë. Gjithashtu, një pjesë e mirë e atyre që ngjiteshin deri në rangjet më të larta të pushtetit vinin nga radhët e ushtrisë.

Ushtria osmane e cila ishte edhe pasqyrë e pushtetit por edhe të identitetit osman në periudhën klasike të saj, përbëhej nga dy komponentë kryesorë, të cilët ishin spahinjët dhe jeniçerët. Sidomos në periudhën e ekspansionit të Perandorisë Osmane çka përkon me shek. XV, roli i këtyre është i padiskutueshëm.<sup>9</sup> Megjithëse me sistemin e timarit roli i spahinjve ishte më dominues, me kalimin e kohës dhe shthurjen e këtij sistemi në shekullin pasardhës ishin jeniçerët ata që patën një rol kyç në formësimin e identitetit osman.<sup>10</sup>

## **2. Elementë përbërës të identitetit shqiptar në Perandorisë Osmane**

Krahasuar me elementët kryesorë që përbënin atë çka mund ta quajmë “identitet osman”, lind pyetja se a mund të aplikohen të njëjtët instrumente përcaktuese edhe kur bëhet fjala për shqiptarët? Nëse jo, cilat ishin shkaqet dhe a mund të përcaktohen disa aspekte kryesore të cilët shërbyen për formësimin dhe dallimin e elementit shqiptar brenda kontekstit osman? Që në fillim duhet theksuar se përbërja fetare e shqiptarëve nuk i fuste ato plotësisht brenda sistemit të mileteve, siç ishin vendet e tjera fqinje. Megjithëse shqiptarët ishin pjesë e klasës sunduese për arsye se në shumicë përqafuan besimin islam, një pjesë e tyre ishin pjesë e miletit ortodoks dhe pjesa tjetër përbëhej prej popullsisë katolike. Të njëjtat kritere janë të vlefshme edhe për ata që mund të quhen elita politike apo ushtarake ku, në këto poste ngjiteshin vetëm ata shqiptarë të

<sup>8</sup> Darling, *The Sultan's Advisors...*, f. 172.

<sup>9</sup> Isom-Verhaaren, *Constructing Ottoman Identity...*, f. 113.

<sup>10</sup> Ka pasur vazhdimisht një debat dhe rivalitet midis jeniçerëve dhe spahinjve për protagonizëm dhe rëndësi në syrin e sulltanit. Pjesë e këtij debati janë bërë edhe mendimtarë të mëdhenj osmanë të shek. XVI, mes të cilëve përmendim edhe Koçi beun me origjinë shqiptare. Për më shumë lidhur me diskutimet në fjalë shih: Darling, *The Sultan's Advisors...*, f. 178-180.

cilët i përkisnin besimit mysliman. Kjo gjendje do të vijonte deri në periudhën e Tanzimatit.

Sipas Todorovës, feja nuk ka qenë një element motivues i përhapjes dhe zhvillimit të nacionalizmit. Sipas saj, klerikët dhe kisha ishin të fundit që iu bashkëngjiten lëvizjeve nacionaliste dhe se këtu bën përjashtim vetëm Shqipëria, ku klerikë të besimeve të ndryshme u bashkuan përreth nacionalizmit për vetë faktin se rreziku më i madh u kanosej prej qarqeve të krishtera, përkatësisht atyre greke e serbe se nga qendra myslimane, pra Stambolli.<sup>11</sup> Parë nga ky këndvështrim, teza e Todorovës merr peshë nëse do të kemi parasysh fjalinë e famshme të Pashko Vasës se “feja e shqiptarit është shqiptaria”, e cila karakterizon të gjithë frymën e rilindjes sonë kombëtare.

Nëse nga elementët që u theksuan më lart nuk përcaktohet dot pozicioni i shqiptarëve në atë që mund të quhet identitet osman, aspekte të tjera të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me strukturën shoqërore, të shkuarën historike por edhe me vetë karakterin e shqiptarëve, do të na ndihmonin për të kuptuar atë çka mund ta quajmë vetëdije të shqiptarëve brenda Perandorisë Osmane. Si figura të rëndësishme të Rilindjes ashtu edhe autorë e studiues të shumtë, e theksojnë në mënyrë të veçantë pozitën që kishin shqiptarët në këtë shtet, element që dëshmon se disa veçori të shqiptarëve si komb arritën t’i veçonin ata prej të gjithë kombeve të tjera të asaj perandorie.

Sigurisht që gjuha është elementi i parë dhe më kryesori ai që i veçonte shqiptarët si prej kombeve fqinjë ashtu edhe midis etnive të tjera pjesë përbërëse të shtetit osman. Ruajtja e saj pa një traditë shkrimi vetëm në të folur është një tregues i rëndësishëm i faktit se ky element ishte përcaktues në ruajtjen e vetëdijes apo identitetit të shqiptarit. Parë këtu edhe ndarja në kontekstin fetar të shqiptarëve, nuk ka dyshim se gjuha ishte faktori më kryesor përbashkues të cilët etërit e nacionalizmit shqiptar të shek. XIX e mbajtën kryefjalë të aksionit të tyre në ngjizjen e frymës kombëtare ndër shqiptarë.<sup>12</sup>

Sipas Ismail Qemalit, çdo shqiptar mban në zemër tre gjëra, të cilat janë: nderi, familja e atdheu. E mbi të gjitha këtu qëndrojnë dy virtyte: fjala e dhënë (besa)<sup>13</sup> dhe ndjenja e atdhedashurisë.<sup>14</sup> Pikërisht, këto

<sup>11</sup> Maria Todorova, *Imagining the Balkans*, Oxford University Press, New York 2009, f. 177.

<sup>12</sup> Eric J. Hobsbawm, *1780'den Günümüze Milletler ve Milliyetçilik: "Program, Mit, Gerçeklik"*, Çev. Osman Akınhay, Ayrıntı, İstanbul 1993, f. 72.

<sup>13</sup> Lidhur me konceptin e besës tek shqiptarët vlen të theksohet analiza që Gawrych i bën dramës *Besa Yahud Ahde Vefa* të Sami Frashërit, ku evokohen dy elementë të cilët i

elementë e habisin edhe studiuesin e njohur E. Hobsbawm, i cili i referohet Naim Frashërit që thotë se “të gjithë ne kemi vetëm një klan, një familje; ne, vijmë nga i njëjti gjak dhe e njëjta gjuhë”.<sup>15</sup>

Pikërisht dy elementët e përmendura më sipër, struktura shoqërore që bazohet në fisin apo klanin dhe gjuha, përbëjnë edhe pikën kyçe të ruajtjes së kulturës dhe të identitetit shqiptar gjatë sundimit osman, por edhe më herët.<sup>16</sup> Kjo lidhje e gjakut që ishte karakteristikë e shqiptarëve, i tejkalonte të gjitha ndryshimet që ekzistonin midis tyre duke e ruajtur kështu, sipas Sami Frashërit, kombësinë dhe gjuhën e tyre brez pas brezi.<sup>17</sup> Edhe Pashko Vasa, një figurë tjetër emblematike e rilindjes tonë kombëtare, thekson se fisi dhe tradita janë zemra e strukturës shoqërore ndër shqiptarë e sidomos mes malësorëve.<sup>18</sup>

Një element tjetër i rëndësishëm në ruajtjen e vetëdijes së shqiptarëve është edhe kujtesa historike. Në fakt, referimi i së shkuarës ishte karakteristikë e kombeve të ndryshme për të theksuar rrënjët e vjetra të tyre por edhe vlerat e traditat përkatëse veçanërisht në epokën e nacionalizmit. Këtë aspekt e vërejmë edhe tek shqiptarët e sidomos tek figurat kryesore të rilindjes të cilët i japin një vend të veçantë historisë së kombit shqiptar duke nisur që nga periudha pellazge për të ardhur deri në shek. XIX.<sup>19</sup> Porë nga ky aspekt, e shkuara e lavdishme jo vetëm që mbajti gjallë vetëdijen e shqiptarëve përgjatë shekujve por, në periudhën e krijimit të shteteve kombe u bë një gurthemel i ndërtimit të identitetit kombëtar.

vërejmë edhe tek mendimtarët e tjerë shqiptarë të shek. XIX si I. Qemali apo edhe Pashko Vasa: besnikërinë ndaj shtetit osman dhe dashurinë për atdheun. Shih: Gawrych, *Gjysmëhëna dhe Shqiponja ...*, f. 17, 53-54.

<sup>14</sup> Ismail Qemal Vlora, *Kujtimet*, Përkth. Reshad Agaj, f. 251-253.

<sup>15</sup> Hobsbawm, *1780'den Günümüze ...*, f. 73.; Gjithashtu shih: Stavro Skendi, *Zgjidhja kombëtare...*, f. 159.

<sup>16</sup> Duhet theksuar se edhe vetë osmanët nuk ndërhyjnë në strukturën shoqërore të këtyre zonave që bazoheshin në organizimin fisnor duke jua njohur atë formë përbërje që kishin trashëguar. Për më shumë, shih: Skendi, *Zgjidhja kombëtare...*, f. 24-25.

<sup>17</sup> Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e çdo të Jetë*, Botonjës Luarasi, Tiranë, f. 29; Gjithashtu shih. Skendi, *Zgjidhja kombëtare...*, f. 24.

<sup>18</sup> Vassa Effendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*, Shtypur në shtypshkronjën “Tirana”, Tiranë 1935, f. 93-95.

<sup>19</sup> Si S. Frashëri ashtu edhe P. Vasa në veprat e tyre i kushtojnë një vend të madh të shkuarës historike. I pari, në pjesën e parë të librit të tij trajton çështjen e të shkuarës së shqiptarëve, ndërsa i dyti pjesën më të madhe të veprës së tij ia ndan periudhës paraosmane të shqiptarëve.

Elementë të tjerë që e karakterizojnë shqiptarin duke e dalluar atë me njerëz të etnive të tjera që ishin pjesë e Perandorisë Osmane, kanë të bëjnë me disa aspekte që i përkasin vetë karakterit të tij. Sigurisht që në krye të këtyre veçorive qëndron fjala e dhënë ose *besa*, e cila sipas I. Qemalit, në sytë e shqiptarit qëndron më lart se çdo gjë tjetër. Si fjala e dhënë ashtu edhe ndjenja e atdhedashurisë për shpallësin e pavarësisë, janë dy virtyte të cilat shqiptarët i kanë ruajtur përgjatë gjithë historisë së tyre si komb.<sup>20</sup> Karakteri i fortë dhe marrëdhënia e ngushtë me armët ishin elementë të tjerë që e dallonin shqiptarin duke i nxjerrë në pah si njerëz besnikë e trima.

### **3. Lidhja e Prizrenit si pikë kulminante e formësimit të identitetit shqiptar brenda Perandorisë Osmane**

Lidhja e Prizrenit padyshim që nuk ishte një organizim dhe manifestim rastësor i vetëdijes shqiptare dhe ruajtjes së zakoneve, kulturës e hapësirës së tyre territoriale. Janë të shumta rastet kur elementi shqiptar dallohet në rrafshin perandorak që prej hyrjes së osmanëve në vendet e banuara prej shqiptarëve në fund të shek. XIV deri në vitin 1912, kur shqiptarët do të shkëputeshin përfundimisht prej kësaj perandorie duke formuar shtetin e tyre të pavarur.

Regjistrimet më të hershme të vendosjes së regjimit osman në hapësirën shqiptare i përkasin dhjetëvjeçarit të fundit të shek. XIV. Vetë osmanët nuk sollën emërtime të reja, por i njohën zonat dhe popujt sipas toponimeve dhe emërtimeve që ata përdornin për veten e tyre. Shqiptarët i quajtën *arnavutë* dhe në aspektin e grupit si *arnavut kavmi*, ndërsa hapësirës territoriale si *arnavudluk*. Pavarësisht faktit se shoqëria osmane ishte e ndarë sipas përkatësisë fetare, vërejmë se shqiptarët ortodoksë të cilët jetonin në zonat e Thesalisë nuk janë shënuar prej osmanëve si rum, porse për ta është shënuar fjala *arnavut*, element që i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë elementit etnik.<sup>21</sup>

Periudha e Skënderbeut padyshim që përbën njëra ndër pikat më kulminante të vetëdijes etnike ndër shqiptarë. Siç shprehet edhe Sami Frashëri, me Skënderbeun “për së pari herë Shqipëria u mbluadh në një mbretëri”.<sup>22</sup> Parë nga ky këndvështrim, rëndësia e epokës së Skënderbeut

<sup>20</sup> Qemali, *Kujtime...*, f. 251-253.

<sup>21</sup> Halil İnalcık, *Fatih devri üzerinde tetkikler ve vesikalar*, I, Türk Tarih Kurumu Basımevi, Ankara 1954, f. 146.

<sup>22</sup> Frashëri, *Shqipëria ç'ka qënë...*, f. 14.

lidhet me faktin se përveç elementit gjuhësor e zakonor që i dallonte shqiptarët prej popujve që e rrethonin, për herë të parë këto elemente ngjiten deri në nivelin më të lartë unifikues, në një entitet politiko-ushtarak. Në këtë kontekst, periudha e Skënderbeut do të shërbente si pikënisje për të nxjerrë në pah elementin etnik si përbashkues i shqiptarëve sidomos në realitetin e vështirë të shek. XIX, elementi shqiptar në Ballkan gjendej më i rrezikuar se kurrë më parë.

Menjëherë pas pushtimit osman të hapësirës shqiptare, një pjesë e klasës feudale shqiptare pranoi besimin islam duke u bërë kështu pjesë e shtresës sunduese. Kështu, një pjesë e këtyre arritën në pozita të larta brenda hierarkisë së shtetit osman qysh në kohën e Sulltan Mehmet Fatihut.<sup>23</sup> Studiuesit që merren me periudhën klasike të Perandorisë Osmane theksojnë se identiteti osman nuk kishte një karakter përjashtues, megjithatë ajo që kishte rëndësi ishte besnikëria ndaj sunduesit.<sup>24</sup> Parë nga ky kontekst, aspekti etnik apo fetar nuk përbënte ndonjë problem në atë çka mund të quhet identitet osman përderisa personi ishte besnik ndaj sulltanit. Kjo është edhe arsyeja që shumica e vezirëve dhe funksionarëve të lartë osmanë të cilët kishin origjinë shqiptare e ruanin, madje e shpalosnin me krenari identitetin e tyre etnik, pra atë shqiptar. Madje, studiuesit theksojnë se kishte raste, siç ndodh në rastin e sadrazamit Mere Husen Pasha, që ngjitej në postin më të lartë, ndërsa me njerëzit më të afërt komunikonte veç në gjuhën shqipe.<sup>25</sup> Evidentimi i aspektit etnik mes funksionarëve të lartë osmanë me origjinë shqiptare sigurisht që

---

<sup>23</sup> Në fakt, figurat me origjinë shqiptare qenë komandantë e funksionarë të lartë që në kohën e Sulltan Muratit II, porse në periudhën e Sulltan Mehmetit II ky element do të dalë më shumë në pah. Shih: Skendi, *Zgjidhje kombëtare* ..., f. 29.

<sup>24</sup> Në artikullin e saj Isom-Verhaaren trajton edhe figurën e Skënderbeut në mesin e personaliteteve të shek. XV, të cilët ishin bërë pjesë e administratës a ushtresë osmane. Duke marrë parasysh faktin se Skënderbeu ngriti krye ndaj osmanëve dhe u vu në mbrojtje të pronave të tij si dhe konvertimin në të krishterë, ajo shkruan se ky ishte një shembull i dështuar i identitetit osman të kësaj periudhe, përkundër shembujve si pasardhësit e familjes së paleologëve Has Murad Pasha, Mesih Pasha, Huseyin Bey, apo edhe të tjerë të cilët u bënë pjesë e administratës osmane duke i shërbyer me besnikëri sulltanit. Për më shumë, shih: Isom-Verhaaren, *Constructing Ottoman Identity*..., f. 117-119, 124-126.

<sup>25</sup> Lidhur me karakterin, jetën dhe aktivitetin e Mere Husen Pashës shih: Fikret Sarıcaoglu, "Hüseyin Paşa, Mere", *TDV İslam Ansiklopedisi*, v. XIX, 1999, f. 8-9.

arrin kulmin në Egjipt ku Mehmet Ali Pasha<sup>26</sup> dhe pasardhësit e tij e drejtuan këtë vend shumë të rëndësishëm për më shumë se një shekull.

Studiuesit theksojnë se në vitin 1730 në qytetin e Stambollit jetonin rreth 12 000 shqiptarë, të cilët në periudha të ndryshme kishin emigruar drejt qendrës më të rëndësishme të Perandorisë. Menjëherë pas revoltës së madhe të Halil Patronës, mësojmë se instancat shtetërore janë angazhuar në përndjekjen e këtij komuniteti.<sup>27</sup> Të njëjtën gjë thekson edhe studiuesja turke Nina Ergin, e cila ka kryer një studim të regjistrave osmanë të cilat pasqyrojnë punonjësit e hamameve të Stambollit. Në punimin e saj, përveç të dhënave mbi shqiptarët që punonin në këto institucione, ajo i referohet edhe një dekreti perandorak të vitit 1734-1735, ku theksohet se për secilin person që do të punësohej në hamame të shënohej edhe origjina e tij dhe, prej shqiptarëve të mos punësohej asnjë shqiptar, qoftë ky i ri apo i vjetër, ata të rikthehen në vendet e tyre.<sup>28</sup> Këto të dhëna janë të mjaftueshme për të evidentuar lidhjen etnike që shqiptarët ruanin me njëri-tjetrin, por edhe faktin se drejtuesit osmanë ishin të vetëdijshëm për këtë veçori të elementit shqiptar.

Një periudhë tjetër e rëndësishme si në fuqizimin dhe zhvillimin e hapësirës shqiptare ashtu edhe në formësimin e vetëdijes kombëtare, ishte harku kohor që zuri fill nga gjysma e dytë e shek. XVIII deri në dekadat e para të shek. XIX e njohur ndryshe edhe si periudha e pashallëqeve.<sup>29</sup> Bushatllinjtë në Veri me qendër Shkodrën dhe Ali Pashë Tepelena në Jug me qendër Janinën, për më shumë se gjysmë shekulli ushtruan një pushtet thuajse të pavarur në zonat përkatëse të administrimit, periudhë të cilën e kaluan në rivalitet me njëri-tjetrin dhe

<sup>26</sup> Për më shumë të dhëna mbi praninë e elementit shqiptar në Egjipt shih. Muhamed Mufaku, *Nga e shqiptarëve të Egjiptit gjatë shekujve XV-XX*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë: 2016.

<sup>27</sup> Karen Barkey, *Empire of Difference: The Ottomans in Comparative Perspective*, Cambridge University Press, New York 2008, f. 215.

<sup>28</sup> Nina Ergin, "The Albanian Tellak Connection: Labor Migration to the Hamams of 18<sup>th</sup>-Century Istanbul, Based on the 1752 Istanbul Hamamları Defteri", *Turcica*, 43, 2011, f. 240.

<sup>29</sup> Për të dhëna të detajuara mbi pashallëqet e mëdha shqiptare, shtrirjen territoriale dhe aktivitetin e tyre shih: *Historia e popullit shqiptar: ilirët, mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI-vitet '20 të shek. XIX*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Botimet Toena, Tiranë 2002, f. 615-645; Gjithashtu shih: Skendi, *Zgjidhimi kombëtar ...*, f. 29-31.

në përplasje me qendrën, pra Stambollin.<sup>30</sup> Ajo çka na intereson neve në këtë rast ka të bëjë me ekzistencën e elementit shqiptar, thuajse në mënyrë të pavarur, në të gjithë aparatin drejtues të këtyre pashallëqeve.

Nëse në shekujt e mëparshëm elementi etnik kishte një rëndësi dytësore, e kundërta ndodhi gjatë shek. XIX, ku shkëputja nga Perandoria Osmane dhe krijimi i shteteve kombe do të bëhej kryefjala e të gjitha ngjarjeve që kapluan këtë gjeografi. Në këtë periudhë të vështirë për trojet shqiptare, vërejmë se rilindësit përveç aktiviteteve të tyre diplomatiko-ushtarake në mbrojtje të çështjes shqiptare i dhanë një rëndësi shumë të madhe edhe aktivitetit të zgjimit ose evidentimit të atij që mund ta quajmë identitet shqiptar. Këtë aspekt e vërejmë në veprat e Vasës e Frashërit dhe në kujtimet e I. Qemalit, të cilët vënë theksin tek gjuha, tradita dhe e shkuara historike e shqiptarëve duke nxjerrë kështu në pah elementët kryesorë të këtij identiteti. Por, periudha e Lidhjes së Prizrenit nuk qe vetëm një proces i zgjimit kulturor për shqiptarët. Për herë të dytë pas asaj të Skënderbeut, shqiptarët arritën të krijojnë një bashkim politiko-ushtarak detyra e të cilit ishte ruajtja nga copëtimi i hapësirave të banuara prej shqiptarëve nga vendet fqinje.<sup>31</sup> Për këtë arsye, Lidhja na del përpara si një pikë kulminante e shpalosjes së identitetit shqiptar, atij politiko-ushtarak e kulturor, brenda Perandorisë Osmane. Themi brenda Perandorisë për faktin se autoritetet osmane fillimisht e lejuan, madje e mbështetën organizimin dhe mbajtjen e saj. Shtypja e Lidhjes do të ishte edhe vija ndarëse e shqiptarëve me shtetin osman, e pas kësaj ngjarje marrëdhëniet do të acaroheshin vazhdimisht deri në shkëputjen përfundimtare dhe shpalljen e Pavarësisë në vitin 1912.

---

<sup>30</sup> Shaw na jep të dhëna të detajuara të rivalitetit midis dy pashallëqeve, por edhe marrëdhëniet e tyre me Portën e Lartë. Për më shumë shih: Shaw, *Between Old and New ...*, f. 227-236; Gjithashtu shih: Vassa, *E vërteta mbi Shqipninë ...*, f. 97.

<sup>31</sup> Programi i Lidhjes, aktiviteti i saj, shtrirja dhe hapat që u morën prej rilindësve janë trajtuar gjerësisht nga historiografia shqiptare dhe e huaj. Për këtë arsye nuk e shohim të nevojshme trajtimin gjerësisht të saj këtu për arsye se do të dilte jashtë qëllimit dhe objektivit të kësaj kumtese. Ndërsa, për aktivitetin e rilindësve mbi rizgjimin kulturor e identitar të shqiptarëve shih: Skendi, *Zgjimi kombëtar ...*, f. 116-123, 144-149.



**Fehari RAMADANI & Fati ISENI**

## **ASPEKTE TË VEPRIMTARISË SË LIDHJES SHQIPTARE NË KAZANË E TETOVËS**

Traktati i Shën Stefanit, i 3 marsit të vitit 1878, që iu imponua Perandorisë Osmane nga Perandoria Ruse, jo vetëm që nuk përmendte fare shqiptarët, por për më tepër vendimet e tij cenonin rënd tërësinë tokësore të tyre. Sipas vendimeve të këtij traktati, gati gjysma e territoreve shqiptare u jepej shteteve sllave të Ballkanit. Në territoret që parashikohej të shkëputeshin nga trangu etnik bënte pjesë edhe kazaja e Tetovës, e cila sipas ndarjes së atëhershme administrative të shtetit osman, ishte pjesë e sanxhakut të Prizrenit dhe e vilajetit të Kosovës.

Shqiptarët sapo kuptuan përmbajtjen e Traktatit të Shën Stefanit filluan përgatitjet për të mbrojtur tërësinë tokësore të hapësirës së tyre. Mobilizimi i tyre filloi që para se të formohej Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare deklarorin se përpjekjet për zbatimin e vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit, do të detyronin shqiptarët që të mbronin tokat e tyre nëpërmjet luftës së armatosur. *“Nëse territoret e Dibrës dhe të Tetovës do t’i jepeshin Bullgarisë, sipas vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit, kjo do të çonte në revolucion”*, shkruante Abdyl Frashëri, në gazetën austriake, “Le Messenger de Vienne”, të datës 3 maj 1878. Nëse do të ndodhte diçka e tillë, kjo do të bëhej burim i përhershëm luftërash<sup>1</sup>. Nëpërmjet deklaratave për shtypin evropian, krerët shqiptarë përpiqeshin t’i paralajmëronin Fuqitë e Mëdha që të mos lejonin padrejtësitë, pasi në të kundërtën ato do të kontribuonin në krijimin e vatrave të përhershme të luftës në këtë pjesë të Evropës Juglindore.

Cenimi i tërësisë tokësore të territoreve shqiptare shkaktoi pakënaqësi të madhe në mesin e shqiptarëve. Rreziku i humbjes së një

---

<sup>1</sup> Frashëri, Kristo. 2013. *Abdyl Frashëri*. Tiranë: albPAPER, f. 109.

pjesë të tokave të tyre, mobilizoi atdhetarët shqiptarë, pa dallim krahine dhe besimi fetar. Këtij mobilizimi iu bashkuan edhe krerët e Lëvizjes Kombëtare nga kazaja e Tetovës. Më 22 maj të vitit 1878, banorët shqiptarë të Tetovës, myslimanë dhe të krishterë, i dërguan një telegram ambasadorit të Francës në Stamboll, Furnié, me të cilin kundërshtonin vendimin e Traktatit të Shën Stefanit për dhënien e territoreve shqiptare Bullgarisë. Telegrami ishte nënshkruar nga 459 shqiptarë, të cilët, në emër të 30 000 myslimanëve dhe rreth 7 500 të krishterëve, nga njëra anë kërkonin zbatimin e reformave nga Qeveria osmane dhe nga ana tjetër kundërshtonin përpjekjet ekspansioniste për krijimin e Bullgarisë së Madhe e cila “do të ishte shkatërrim për atdheun” e tyre<sup>2</sup>.

Për të kundërshtuar vendimet e Traktatit të Shën Stefanit, drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ndërmorën një sërë masash organizative. Krahinat e ndryshme nisën të mbanin kuvende ndërkrahinore, me qëllim që të parapërgatitnin mbajtjen e një Kuvendi të Përgjithshëm, për themelimin e një lidhjeje kombëtare. Nismës për mbajtjen e një kuvendi të tillë në Prizren, iu përgjigjën edhe përfaqësuesit e Lëvizjes Kombëtare nga kazaja e Tetovës. Delegatët e Tetovës iu bashkuan atyre të Dibrës, Kërçovës dhe Gostivarit, për të marrë pjesë në kuvendin ndërkrahinor të vilajetit të Kosovës që do të mbahej gjatë muajit maj 1878<sup>3</sup>.

Me të kuptuar se shqiptarët po përgatiteshin të themelonin një lidhje me karakter kombëtar, menjëherë kundërveproi Qeveria osmane. Aktivitetet e shqiptarëve për t’u vetorganizuar, në mënyrë të pavarur nga Porta e Lartë, për të mbrojtur tërësinë e trojeve të tyre, shkaktuan reagimin e menjëhershëm të sulltanit. Në fund të majit të vitit 1878, Porta e Lartë thirri në Stamboll disa nga personalitetet më të shquara shqiptare të kohës, si: Sheh Mustafa Tetovën, Abdyl Frashërin, Iljaz pashë Dibrën, Ali bej Gucinë, Ymer Prizreni, Ahmet Koronicën, Zija Prishtinën etj. Qëllimi i tij ishte që t’i bënte për vete këta përfaqësues shqiptarë, në mënyrë që lidhjes që pritej të themelohej, në vend të karakterit kombëtar shqiptar, t’i jepej karakter mysliman dhe pastaj atë ta përdorte si mjet të vetin për të kërcënuar Kongresin e Berlinit<sup>4</sup>. Porta e Lartë, përmes

<sup>2</sup> *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I (Dokumente arkivash franceze)*. Përgatitur nga Ligor Mile. Tiranë: ASHRPSSH, 1978, f. 153-154; Frashëri, Kristo. 1997. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*. Tiranë: Toena, f. 76.

<sup>3</sup> Frashëri, Kristo, *Abdyl Frashëri...*, f. 138.

<sup>4</sup> Krahaso: *Historia e popullit shqiptar, vëllimi i dytë, vitet ‘30 të shek. XIX-1912*. Tiranë: Toena, f. 154; Belegu, Xhefer, 1939. *Lidhja e Prizrenit*. Tiranë: Kristo Luarasi, f. 17; Frashëri, Kristo, *Abdyl Frashëri...*, f. 140.

presionesh, u përpoq t'i bindte ata që t'i jepnin besëlidhjes karakterin e një organizate islamike ballkanike. Këta personalitete takoheshin çdo ditë me përfaqësues të pushtetit osman në Sekretariatit e pallatit për të realizuar takimin me sulltanin. Kur kuptuan se audienca me sulltanin qëllimisht zvarritej, në mëngjesin e 8 qershorit, Sheh Mustafë Tetova, së bashku me Abdyl Frashërin, Iljaz Pashë Dibrën, Ali Bej Gucinë, Ahmet Koronicën dhe personalitete të tjera, pa i njoftuar fare autoritetet osmane u nisën me tren për në Kosovë<sup>5</sup>, me qëllim që të arrinin sa më shpejt në Prizren, ku do të mbahej Kuvendi Themelues i Lidhjes Shqiptare.

Në Kuvendin themelues të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit morën pjesë edhe katër përfaqësues nga kazaja e *Tetovës*, si: Rexhep Beu, Haxhi Saliu, Hasan Derralla dhe Esad Beu. Dy të fundit, për kontributin e tyre në luftën kundër Serbisë ishin emëruar pashallarë<sup>6</sup>. Ndër personalitetet më të shquara që merrnin pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm, konsulli Lippich numëronte edhe Hasan pashë Tetovën (Derrallën), Ali bej Gucinë, Iljaz pashë Dibrën, Abdullah pashë Drenin, Ahmet Koronicën etj.<sup>7</sup>

Më 15 qershor 1878, përfaqësuesit e sipërpërmendur të *Tetovës* së bashku me ata të Dibrës së Madhe, Dibrës së Vogël, Shkupit, Prishtinës, Gjilanit, Jeni Pazarit (Novi Pazarit), Mitrovicës, Pejës, Gucisë, Senicës, Tashlixhesë dhe Lumës ishin nënshkrues të një telegrami proteste që i dërgonin nga Prizreni ambasadorit francez kundër aneksimit të territoreve shqiptare nga Mali i Zi, Serbia dhe Bullgaria. Ata kërkonin nga diplomati francez që qeveria e tij, këto kërkesa t'i paraqiste në Kongresin e Berlinit, në mënyrë që të korrigjohej padrejtësia që u ishte bërë shqiptarëve në Shën Stefan<sup>8</sup>.

Ashtu si përfaqësuesit e kazave dhe krahinave të tjera edhe delegatët e *Tetovës* nuk ishin unikë në qëndrimet e tyre për të mbështetur ose jo dokumentin kryesor të miratuar më 17 korrik nga Lidhja, i njohur si *Kararname* (aktvendimi). Për shkak të pranisë së elementëve prosulltanist në Kuvendin e Lidhjes së Prizrenit, ky dokument përmbante disa formulime kontradiktore, duke mos qartësuar nëse Lidhja do të

<sup>5</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 85, 86.

<sup>6</sup> *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878), vëllimi I*. 2008. Përgatitur nga Beqir Meta, Ferit Duka, Marenglen Verli. Tiranë-Prishtinë: Albanica, f. 130. (AIH, Vj. 30-2-213. Relacion i konsullit Chiari për eprorët, me të cilin njofton përgatitjet dhe gatishmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur interesat e tyre. Selanik, më 14 qershor 1878).

<sup>7</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 88.

<sup>8</sup> *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I...*, f. 168.

kishte karakter shqiptar ose karakter mysliman. Prandaj, nga rreth 110 delegatë të pranishëm në kuvend, Kararnamenë e nënshkruan vetëm 49\*, pra rreth 44%. Nga 9 delegatët nga kazaja e Tetovës (Esad pashë Tetova, Mehmet Tetova, Sheh Mustafë Tetova, Rexhep pashë Dërralla, Hasan Masharnuredin, Haxhi Sadiku, Mehmet Efendiu, Abdyl Reufi, Riza Fuati), 5 prej tyre e nënshkruan atë, kurse 4 e refuzuan. Kararnameja u nënshkrua pa përjashtim nga të gjithë anëtarët e rrymës sulltaniste dhe u kundërshtua nga të gjithë delegatët e rrymës radikale. Përfaqësuesit e rrymës së moderuar u përçanë. Nën presionin e Portës së Lartë, disa prej tyre, si Iljaz pashë Dibra, Mehmet bej Prishtina, Hamdi Shaban Peja, Sadik pashë Tetova, Ahmet Sabri Karahasani, Jashar bej Shkupi, e nënshkruan Kararnamenë. Të tjerë pjesëtarë të rrymës së moderuar si Ali pashë Gucia, Ali pashë Draga, Jakup pashë Shkupi, Sheh Mustafa Tetova, Shaban bej Prizreni, Riza Abdurrahman Prishtina, Ali Tefik Manastiri, refuzuan ta nënshkruajnë programin e sulltanistëve. Esad Tetova, Sulejman Vokshi, Filip Doda përfaqësues të rrymës atdhetare, megjithëse i kishin të rreshtuar emrat e tyre në fund të Kararnamesë, ata nuk pranuan të vinin nënshkrimet e tyre<sup>9</sup>, në atë dokument.

Organet drejtuese të Lidhjes Shqiptare ishin *Këshilli i Përgjithshëm* (Këshilli Qendror) dhe *Komiteti Kombëtar* (Komiteti për Shpëtimin Publik). Këshilli i Përgjithshëm kishte gjithsej 56 anëtarë, 28 prej të cilëve ishin nga vilajeti i Kosovës, 18 nga ai i Janinës dhe 10 nga vilajeti i Shkodrës. Nga *kazaja e Tetovës* anëtarë të këtij organi të lartë ishin: Mustafa Tetova dhe Haxhi Sadik Tetova\*. Sheh Mustafa Tetova ishte njëkohësisht edhe nënkryetar i Këshillit të Përgjithshëm, pra i Lidhjes Shqiptare, kurse kryetar Iljaz pashë Dibra. Komiteti Kombëtar, i cili kishte funksione ekzekutive kishte gjithsej 13 anëtarë, njëri prej tyre Ymer Prizreni (Haxhi Ymeri), u zgjodh kryetar, kurse të tjerët përbënin

---

\* Sipas konsullit Lippich, Kararnameja (Aktvendimi), i Komitetit të Prizrenit për mbrojtjen e vendit ishte nënshkruar prej 47 delegatëve, të cilët përfaqësonin rajonet e Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Gucisë, Jeni Pazarit, Senicës, Tashllixhës, Mitrovicës, Vushtrisë, Prishtinës, Gjilanit, Shkupit, Tetovës, Kërçovës, Gostivarit, Dibrës së Poshtme dhe asaj të Sipërme. Sipas këtij Aktvendimi përfaqësuesit e këtyre vendeve merrnin përsipër të mbronin integritetin tokësor të vendit, pra të Perandorisë Osmane. (*Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878), vëllimi I...*, f. 200, shih dokumentin: *AIH Vj. 30-2-221*. Kopje e Kararnamesë dërguar nga Shkodra Ministrisë së Jashtme në Vjenë).

<sup>9</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 98, 99; 436, referencia 84.

\* *Haxhi Sadik Tetova* nga studiuesi Kristo Frashëri herë vendoset në grupin e të moderuarve herë në atë sulltanist.

tre komisionet (për punët jashtme, për punët brendshme dhe për çështje financiare). Secili prej tyre kishte nga 4 anëtarë. Komisioni për Punë të Brendshme, me kryetar Haxhi Shaban Prizrenin, njërin anëtar e kishte nga Tetova, Esad pashë Tetovën. Ky komision u ngarkua me detyrën e ruajtjes së rendit publik, “*mëkëmbjen e organeve kushtetore dhe me ndjekjen e çështjeve gjyqësore*”<sup>10</sup>.

Sheh Mustafa Tetova, Hasan Pasha, Esad Pasha, Rexhep Beu dhe Mehmet Efendiu, nga studiues të ndryshëm përmenden si personalitete me ndikim në Lidhje<sup>11</sup>, të cilët merrnin pjesë në takime të rëndësishme dhe në vendimmarrje. Hasan Pasha, Esad Pasha, Rexhep Beu dhe Mehmet Efendiu përmenden edhe në një letër që konsulli francez në Shkodër, Pons, i dërgonte ministrit të tij të Jashtëm, Vadington, më 1 korrik 1878. Ai theksonte se në Prizren ishin mbledhur krerët shqiptarë, të cilët do të diskutonin për rekrutimin e forcave vullnetare, për mbrojtjen e territoreve shqiptare nga pushtimi i mundshëm i tyre nga Mali i Zi, Serbia dhe Bullgaria. Në këtë takim merrnin pjesë edhe përfaqësuesit e sipërpërmendur nga Tetova<sup>12</sup>.

Idesë për formimin e komiteteve ndërkrahinore në shkallë vilajeti iu bashkëngjiti edhe kazaja e Tetovës. Më 26 qershor 1878, në Prishtinë u themelua Komiteti Ndërkrahinor i Lidhjes Shqiptare për vilajetin e Kosovës. Më pas, këtij komiteti iu bashkëngjitën edhe kazatë e tjera të Kosovës, kazatë e Ohrit, të Dibrës, të Matit, të Shkupit dhe të Manastirit, si dhe kazaja e Tetovës, e cila ishte pjesë e sanxhakut të Prizrenit. Delegatët e Këshillit të Përgjithshëm pasi ishin larguar nga Prizreni kishin arritur të formonin brenda një kohe të shkurtër komitetet krahinore të Lidhjes së Prizrenit në pjesë të ndryshme të territoreve shqiptare<sup>13</sup>.

Përfaqësuesit nga kazaja e Tetovës ishin të pranishëm në të gjitha takime e rëndësishme dhe vendimet që merrte Lidhja. *Rezolutën* (Kanunin e ri) e miratuar më 2 korrik të vitit 1878, nga Kuvendi i Përgjithshëm, me të cilën organizatën e formuar në Prizren e shpalli Lidhje Shqiptare, e nënshkroi një numër më i madh i përfaqësuesve tetovarë. Në mesin e delegatëve nënshkrues ishin edhe: Riza Fuati, Mehmet Pasha, Hasan Pashë Derralla, Sheh Mustafa, Sadiku, Mehmeti

<sup>10</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 108; Shih dhe: Belegu, Xhefer, *vep. e përm.*, f. 30; *Historia e popullit shqiptar...*, f. 160.

<sup>11</sup> *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I...*, f. 178, 207; Shih dhe: Shehu, Gjyltekin. 2010. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet franceze (1878-1881)*. Prishtinë, f. 33.

<sup>12</sup> *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I (1876-1879)...*, f. 177-178.

<sup>13</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 128, 133.

dhe delegati i Gostivarit\*, Haxhi Zulika<sup>14</sup>. Në dallim nga Kararnameja e 17 qershorit, dokumentin e ri, i cili i jepte Lidhjes së Prizrenit karakter të qartë kombëtar, e nënshkroi pjesa më e madhe e përfaqësuesve nga Tetova.

Shqiptarët e kazasë së Tetovës u bashkuan me bashkëkombësit e tyre në mbrojtje të tërësisë tokësore të trungut etnik. Ata mbetën të zhgënjyer edhe nga qëndrimi i fuqive evropiane në Kongresin e Berlinit, i cili ishte mbledhur për të rishikuar vendimet e Traktatit të Shën Stefanit. Rrjedhimisht, ata ishin të vendosur për të kundërshtuar çdo vendim, i cili do të prekte tërësinë territoriale shqiptare. Në një letër që Safet Pasha, vezir i madh i Perandorisë Osmane, në korrik 1878, u dërgonte ambasadorëve të tij në vendet e huaja i njoftonte se shqiptarët, myslimanë e të krishterë, sidomos ata të rretheve të Novi Pazarit, të Senicës, të Dibrës, të Tashlixhesë, të Prishtinës, të Mitrovicës, të Pejës, të Gjakovës, të Tetovës, të Lumës etj., me të cilët do të bashkoheshin edhe shqiptarët e rretheve fqinje, do ta kundërshtonin me armë aneksimin e tokave të tyre nga shtetet fqinje. Sipas letrës, popullata nuk i kishte përfillë fare këshillat e autoriteteve osmane për të pranuar vendimet e Kongresit të Berlinit. Premtimi i vetëm i shqiptarëve ishte se ata nuk do të sulmonin, por se me çdo kusht do të mbronin tokat e tyre, nëse do të kishte përpjekje për pushtim. Veziri i madh kërkonte nga ambasadorët e tij që t'i njoftonin qeveritë ku ata shërbenin për situatën e krijuar në tokat shqiptare dhe për përgatitjet e shqiptarëve për luftë. Sipas informatave që posedonte Safet Pasha, 240 000 gegë ishin të organizuar ushtarakisht dhe të gatshëm të luftonin në mbrojtje të tokave të tyre<sup>15</sup>.

Meqenëse Fuqitë e Mëdha nuk i morën fare parasysh të drejtat kombëtare të shqiptarëve, në Kongresin e Berlinit dhe për më tepër morën vendim që një pjesë e tokave veriore shqiptare t'i jepeshin Malit të Zi, drejtuesit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit vendosën që kërkesat e tyre t'ia drejtonin Qeverisë osmane. Për këto arsye, Lidhja zgjodhi nënkryetarin e saj që në emër të popullit shqiptar të zhvillonte bisedime me qeverinë e Stambollit. Më 3 gusht 1878, shtatëdhjetëvjeçari nga Tetova, Sheh Mustafa u dërgua në Stamboll, për të biseduar me vezirin e madh lidhur me fushatën luftarake të projektuar nga Lidhja, kundër

---

\* Në atë kohë nahija e Gostivarit ishte pjesë e kazasë së Tetovës.

<sup>14</sup> Rexha, Ilijaz. 1978. *Lidhja e Prizrenit në dokumentet osmane*. Prishtinë: Arkivi i Kosovës, f. 26, 29-30; Belegu, Xhefer, vep. e për., f. 39; *Historia e popullit shqiptar...*, f. 159-160.

<sup>15</sup> *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I...*, f. 176-177.

pretendimeve malazeze, për aneksimin e territoreve shqiptare. Konsulli austro-hungarez në Prizren, Jelinek, besonte se Komiteti i Prizrenit “*do të drejtohet sipas këshillës së këtij dinjitar shpirtëror, që gëzon një prestigj të madh në popull*”. Ai mendonte se qëndrimi i Sheh Mustafa Tetovës në kryeqytetin perandorak, lidhej me përpjekjet e tij për arritjen e autonomisë së Shqipërisë dhe se krahu ushtarak në Stamboll pengonte kthimin e tij në Prizren<sup>16</sup>.

Detyra e Sheh Mustafa Tetovës ishte që t’i kërkonte Qeverisë osmane që të mos dorëzonte asnjë pjesë të territoreve shqiptare shteteve të tjera. Sipas konsullit britanik në Shkodër, Kirby Green, Sheh Mustafa ishte njeri me ndikim dhe ndoshta kjo ishte arsyeja që pikërisht ai u ngarkua me këtë mision. Përndryshe, nënkomiteti ushtarak i Prizrenit e kishte zgjedhur atë për udhëheqës të vetin, ndërsa jepej kushtrimi që këtë shembull ta ndiqnin edhe komitetet tjera, në mënyrë që shehut t’i jepej komanda supreme. Nga ana tjetër, siç duket, në kryeqendrën e Perandorisë, Sheh Mustafa Tetova ishte takuar edhe me sulltanin, me të cilin kishte biseduar për shqetësimet e bashkëkombësve të tij. Përdërisa qëndrimi i tij në Stamboll nuk jepte rezultate, Qeveria osmane, nën presionin e jashtëm, nisi përpjekjet për të realizuar vendimet e Kongresit të Berlinit, për dorëzimin e territoreve shqiptare (Plavë, Guci) Malit të Zi. Por, meqenëse shqiptarët ishin kundër, Stambolli dërgoi një përfaqësues të vetin, Mehmet Ali pashë Maxharin për të bindur krerët e Lidhjes që të hiqnin dorë nga rezistenca e tyre. Sipas vlerësimeve të ambasadorit francez në Stamboll, Furnié, zgjedhja e Mehmet Ali pashës si përfaqësues i Portës së Lartë, ishte krejt e papërshtatshme, pasi ai urrehej në Shqipëri. Në Stamboll mendonin se ai krahas aftësive për të triumfuar mbi vështirësitë, do të shfrytëzonte edhe miqësinë që kishte me disa anëtarë me peshë të Këshillit të Përgjithshëm, si: Iljaz pashë Dibra, Ali pashë Gucia, Abdulla pashë Dreni, Hasan pashë Tetova, Shaban bej Peja të cilët sipas konsullit Jelinek dikur kishin luftuar nën urdhrat e tij dhe me ndërmjetësimin e pashait osman, ata kishin marrë tituj të lartë<sup>17</sup>.

<sup>16</sup> *Haus Hof und Staats Archives, Politisches Archives, Wien*, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, Fondi Dokumente të sjella nga Arkivi i Vjenës dhe të përkthyer në shqip. AIH, Vj. 30-1-192 dhe 30-2-263. Raport i Jelinek për kontin Andrassy mbi gjendjen në Kosovë. Prizren, më 6 gusht 1878; *Po aty*, Vj. 30-1-163. Raport i konsullit Jelinek për kontin Andrassy lidhur me qëndrimin e Lidhjes së Prizrenit dhe autoriteteve osmane ndaj okupacionit të Bosnjës dhe vendimeve të Kongresit të Berlinit. Prizren, më 15 shtator 1878. (Më tej: AIH, Vj...).

<sup>17</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 144; Shih dhe: Belegu, Xhefer, *vep. e përm.*, f. 46.

Drejtuesit e Lidhjes Shqiptare sapo kuptuan se mareshali osman, Mehmet Ali pashë Maxhari ishte nisur për në Kosovë\*, filluan përgatitjet për ta penguar atë të realizonte planin e tij. U thirrën të ktheheshin në Prizren rreth 700 luftëtarë shqiptarë të armatosur, të drejtuar nga Ali Draga, të cilët dy javë më herët kishin shkuar në Jeni Pazar, për të mbrojtur viset shqiptare nga ndonjë provokim serb. Ndërkohë, ata prisnin kthimin e nënkryetarit të tyre, Sheh Mustafa Tetova nga Stambolli, ku ishte ftuar nga sulltani. Ai pritej të kthehej në Prizren para se të mbërrinte Mehmet Ali pasha. Por, deri në fund të gushtit nënkryetari i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit vazhdonte të takohej me vezirin e madh. Sipas kujtimeve të të birit, Sabri Tetova, të cilave u referohet studiuesi Kristo Frashëri, shehu *tetovar* ishte takuar disa herë dhe me vetë sultan Abdyl Hamitin II, i cili u përpoq ta bindte që ta ndihmonte Mehmet Ali pashën në misionin e tij të vështirë. Por, nënkryetari i Lidhjes kishte refuzuar kategorikisht. Për shkak të moshës së thyer dhe respektit që gëzonte te bashkëkombësit e vet, sulltani hezitoi të merrte masa shtrënguese kundër tij, por u përpoq ta mbante sa më gjatë në Stamboll, me arsyetimin se ende nuk i kishte përfunduar bisedimet me atë. Kur mareshali osman u nis për në Prizren, Sheh Mustafa Tetova këmbënguli që edhe ai të kthehej në Kosovë. Gjatë udhëtimit me tren nga Stambolli për në Selanik, atë e shoqëroi vetë kryeministri osman, i cili vazhdoi përpjekjet për ta bindur që të pranonte propozimin e sultanit. Por, meqenëse nuk arriti ta bindte, sapo arritën në Selanik, ai e detyroi Sheh Mustafain që të kthehej përsëri në Stamboll, ku u mbajt zyrtarisht si “*mysafir*” i Pallatit, që në fakt ishte gjendje arresti, për afro dy muaj<sup>18</sup>.

Sipas një raporti të konsullit austro-hungarez në Prizren, Jelinek që i drejtohet kontit Andrassy, në lidhje me vizitën e Mehmet Ali Pashës në Prizren, të datës 27 gusht 1878, theksohet se në Komitet mbretëronte një “*tronditje e thellë dhe mosbesim i madh [...] prej lajmit se sheh Mustafë Tetova, i cili ishte dërguar në 3 të këtij muaji në Stamboll për bisedime me Vezirin e Madh, papritur për arsye të panjohura është thirrur telegrafisht në kryeqytet prej Selaniku [...]*”. Sipas konsullit të përmendur ishte e vështirë që Komiteti të shpërndahej, pa u kthyer shehu ose të paktën pa dërguar telegram ose një letër, ku do ta bënte të njohur qëndrimin e tij. Ai mendonte se ndikimi në popull i shehut plak ishte i

\* Mehmet Ali pashë Maxhari u nis nga Stambolli drejt tokave shqiptare, më 19 gusht 1878.

<sup>18</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 145-146.



madh, prandaj edhe qëndrimi i mëtejshëm i Komitetit do të varej shumë nga qëndrimi i Mustafa Tetovës<sup>19</sup>.

Duke parë se Mehmet Ali pashë Maxhari ishte i vendosur me çdo kusht ta realizonte misionin e tij, disa drejtues të Lidhjes Shqiptare, si Iljaz pashë Dibra, Ahmet efendi Koronica, Hasan pashë Tetova, Dervish bej Luma, më 28 gusht 1878, u nisën për në Gjakovë. Ata deklaruan se shkonin për ta ndihmuar mareshalin osman në misionin e tij, por, në fakt qëllimi i tyre ishte pengimi i udhëtimit të mëtejshëm i myshirit osman drejt Plavës dhe Gucisë. Më 31 gusht udhëheqësi ushtarak osman u nis për në Gjakovë<sup>20</sup>.

Ardhja e mareshalit osman, Mehmet Ali Pasha në Prizren për të bindur Lidhjen Shqiptare që të mos bënte rezistencë, por të pranonte vendimet e Kongresit të Berlinit që disa territore shqiptare t'i jepeshin Malit të Zi, shkaktoi pakënaqësi te popullsia e atjeshme. Disa drejtues të Lidhjes, si Abdullah Pasha, kadiu i Gjakovës Ahmet efendi Koronica dhe Hasan pashë Tetova u kishin shkuar në Gjakovë, që me datën 28 gusht. Ata kishin deklaruar se këtë e kishin bërë për ta bindur popullsinë e atjeshme që të mos zhvillonte rezistencë të armatosur kundër malazezëve<sup>21</sup>. Mirëpo, përkundër këtyre deklaratave, që me sa duket ishin në funksion të mosacarimit të marrëdhënieve me Portën e Lartë, në terren forcat e Lidhjes zhvilluan luftime me Mehmet Ali Pashën, më 5 dhe 6 shtator 1878, ku ai mbeti i vrarë. Sipas konsullit Jelinek, krerët e Lidhjes, si Ahmet efendi Koronica, Hasan pashë Tetova, Dervish bej Luma, si dhe krerët shqiptarë të Gjakovës dhe Pejës duhej ishin përgjegjës për këtë veprim. Gjithashtu edhe konsulli i përgjithshëm austro-hungarez, Lippich akuzonte këta personalitete për vrasjen e ushtarakut osman. Sipas këtyre dy konsujve, këta personalitete shqiptare kishin shkuar në Gjakovë para se atje të arrinte Mehmet Ali Pasha, me mision për ta përgatitur popullin që ta kundërshtonte kërkesën e komandantit osman për dorëzimin e territoreve shqiptare Malit të Zi. Lippich supozonte se ata kishin shkuar në Gjakovë me urdhër të Komitetit të Lidhjes Shqiptare, për të mobilizuar malësorët dhe për të

---

<sup>19</sup> *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878), vëllimi I...*, f. 276.

<sup>20</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 147-148.

<sup>21</sup> *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878), vëllimi I...*, f. 284. Shih dokumentin: *AIH*, Vj. 30-1-158. Raport i Jelinekut, për kontin Andrassy mbi revoltën e shqiptarëve në Prizren. Prizren, më 31 gusht 1878.

nxitur rebelimin në Gjakovë dhe në Pejë<sup>22</sup>. Sipas një telegrami që konti Andrassy\* i dërgonte Lordit Salisbury, Hasan pashë Tetova ishte njëri ndër personalitetet shqiptare që kishte nxitur vrasjen e Mehmet Ali pashës, të cilin shqiptarët e akuzonin se në Kongresin e Berlinit u kishte falë toka shqiptare\* Malit të Zi dhe Austro-Hungarisë<sup>23</sup>.

Me gjithë kundërshtimet e shqiptarëve, Fuqitë e Mëdha vazhdonin presionin e tyre mbi Perandorisë Osmane që kjo e fundit t'i dorëzonte Malit të Zi territoret, të cilat Kongresi i Berlinit ia kishte njohur shtetit të vogël ballkanik. Për realizimin e kësaj kërkesë, Porta e Lartë ishte e gatshme që të përdorte edhe forcën për ta nënshtruar Lidhjen Shqiptare. Por, para se të kalonte në luftë të hapur kundër shqiptarëve, Stambolli nisi të manovronte si zakonisht, duke u premtuar atyre se do të merrte në shqyrtim kërkesën e Lidhjes për formimin e një vilajeti shqiptar, nëse ata do t'i lëshonin Malit të Zi territoret e kërkuara. Për realizimin e kësaj ideje, Porta e Lartë e liroi nga "arresti" Sheh Mustafa Tetovën dhe e la të lirë të kthehej në Kosovë, pasi paraprakisht kishte marrë premtimin prej tij se do të angazhohej për t'i dhënë fund konfliktit me Malin e Zi<sup>24</sup>.

Pas kthimit të *Sheh Mustafa Tetovës* nga Stambolli, ai vizitoi të gjitha qytetet kryesore të vilajetit të Kosovës. Në nëntor 1878, veprimtari *tetovar*, në emër të Lidhjes, kërkonte nga degët e saj që të dërgonin

<sup>22</sup> *Po aty*, f. 298-299. Shih dokumentet: *AIH*, Vj. 30-1-160 dhe Vj. 30-1-197. Raport i konsullit Jelinek për kontin Andrassy mbi vrasjen e Mehmet Ali Pashës. Prizren, më 10 shtator 1878; *AIH*, Vj. 30-1-106. Raport i konsullit Lippich për kontin Andrassy mbi ngjarjet në Gjakovë dhe aktivitetin e Lidhjes së Prizrenit. Shkodër, më 14 shtator 1878.

\* Konti Gyula Andrassy (Xhula Andrashi), 1823-1890, shtetar hungarez. Në vitin 1847 hyri në Dietën Hungareze dhe në revolucionin e vitit 1848 luftoi kundër Austrisë. Pas disfatës së Hungarisë, ai iku në emigracion dhe u dënua me vdekje në mungesë, por u amnistua më 1857 dhe u kthye në Hungari. Mbështeti Deakun në bisedimet me Austrinë dhe u bë kryeministri i parë i Hungarisë (1867-1878). Nga ajo kohë do të luaj rol të rëndësishëm në politikën e jashtme të Austro-Hungarisë. Në vitet 1871-1879, ishte ministër i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë. (Më gjerësisht Derguti, Menduh & Gurakuqi, Romeo. 2004. *Historia e Kohës së Re (3), Qytetërimi perëndimor, 1871-1918*. Tiranë: SHBLU, f. 112-113).

\* Me vendimet e Kongresit të Berlinit parashikohej që Austro-Hungaria të mbante garnizone ushtarake në sanxhakun e Novi Pazari, i cili në atë kohë banohej në shumicë nga popullsia shqiptare.

<sup>23</sup> *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze (1878-1881)...*, f. 95-97.

<sup>24</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 166.

përfaqësuesit e tyre në Prizren, ku do të mbahej një kuvend i ri<sup>25</sup>. Nga të dhënat që ofrojnë konsujt austro-hungarezë dhe britanikë, që në atë kohë shërbenin në territoret shqiptare, shihet se Sheh Mustafa Tetova gëzonte autoritet të madh brenda Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

*Shehu tetovar* u kthye në Prizren rreth datës 20 tetor 1878, pas afro tre muaj qëndrimi në kryeqytetin perandorak. Ai ishte përkrahës i programit autonomist të Komitetit të Stambollit, por në lidhje me Plavën dhe Gucinë shprehej i gatshëm për të bërë lëshime. Sipas tij, nuk ia vlente të sakrifikohej fitimi i vilajetit shqiptar autonom për këto dy vendbanime. Sheh Mustafa theksonte se nëse Lidhja do të angazhohej në luftë kundër Malit të Zi për mbrojtjen e këtyre vendbanimeve, atëherë nuk do të mund ta realizonte kërkesën e saj kryesore, krijimin e një vilajeti të bashkuar autonom. Në dallim nga atdhetarët tjerë, *nënkryetari* i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit i besonte premtimit të qeverisë osmane, prandaj qëndrimi i tij shihej me skepticizëm nga rryma atdhetare<sup>26</sup>, e Abdyl Frashërit.

Ndërkohë, gjatë muajve shtator-tetor brenda Lidhjes Shqiptare u zhvilluan diskutime rreth programit të saj, të cilat u përhapën në të gjitha viset e Shqipërisë. Këto diskutime nga vëzhgues të huaj u paraqitën, nga disa si rivalitet, kurse nga pjesa tjetër e tyre si konflikt midis grupit të Gjakovës dhe të Prizrenit. Grupi i parë konsiderohej si rryma "*ekstremiste*", kurse i dyti krahu i moderuar. Sipas njoftimeve të konsullit Lippih, në fund të shtatorit 1878, Dibra, Tetova dhe Luma u shkëputën nga krahu "*revolucionar*" dhe u bashkuan me atë të moderuar<sup>27</sup>.

Sheh Mustafa, në cilësinë e nënkryetarit të Lidhjes, pavarësisht moshës së shtyrë, e vazhdoi aktivitetin e tij, për realizimin e autonomisë kombëtare. Ai mori pjesë në Kuvendin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të mbajtur në Dibër, më 1 nëntor 1878. Kuvendi miratoi një rezolutë, me të cilën kërkohej formimi i një vilajeti shqiptar, i cili do të kishte kryeqytet Manastirin, organet e tij ekzekutive dhe ligjvënëse, nëpunës shqiptarë, shkolla në gjuhën shqipe, buxhet të tijin etj. Këtë rezolutë duhej t'ia paraqisnin dhe argumentonin Portës së Lartë, një delegacion i Lidhjes i përbërë prej 14 vetash, ku bënte pjesë edhe Sheh Mustafa Tetova<sup>28</sup>.

<sup>25</sup> *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze (1878-1881)*. Përgatitur nga Skender Rizaj. Prishtinë-Priştina: Arkivi i Kosovës, 1878, f. 102-104; *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I...*, f. 207.

<sup>26</sup> *Po aty*.

<sup>27</sup> *Po aty*, f. 163.

<sup>28</sup> *Historia e popullit shqiptar...*, f. 172-173; 190.

Sipas njoftimeve të konsullit Green, kur Mustafa Tetova u kthye në Prizren, në fund të tetorit 1878, ai e gjeti Lidhjen të dobësuar nga *“xhelozitë krahinore”*. Realisht anëtarët e Lidhjes kishin pikëpamje të ndryshme për sa u takon çështjeve që buronin nga vendimet e Kongresit të Berlinit. Menjëherë, pasi arriti në kryeqendrën e Lidhjes, Sheh Mustafai zhvilloi një udhëtim nëpër qytete të vilajetit të Kosovës, ku realizoi takime me krerët lokalë. Përkundër faktit se nuk dihet përmbajtja e bisedimeve midis tij dhe drejtuesve krahinorë, por, sipas disa informacioneve që ofrojnë konsujt britanikë dhe austro-hungarezë, ai synonte të merrte drejtimin e Lidhjes Shqiptare dhe për këtë arsye kishte filluar punën për *“riorganizimin”* e saj. Për këtë qëllim ai u drejtoi një thirrje të gjithë krerëve të Shqipërisë Veriore, të cilët i ftonte që të dërgonin nga një përfaqësues të tyre në një kuvend të posaçëm, i cili do të mbledhej me nismën e tij në Prizren. Pasi nismëtari i tij nuk kishte publikuar programin e vet dhe pasi rrethet nuk dërguan delegatët e tyre, Kuvendi i posaçëm i Lidhjes dështoi<sup>29</sup>. Përkundër kësaj tentative të pasuksesshme, Sheh Mustafa Tetova shpejt arriti të merrte drejtimin Lidhjes Shqiptare.

Në pranverë të vitit 1879, Porta kishte nënshkruar një konventë me qeverinë vjeneze, në mbështetje të nenit 25 të Traktatit të Berlinit, për vendosjen e garnizoneve austro-hungareze në disa pika të Sanxhakut të Novi Pazarit. Kjo konventë shkaktoi reagime të ndryshme në Shqipëri. Disa e shihnin atë si hapin e dytë, pas pushtimit të Bosnjë-Hercegovinës më 1878, për depërtimin e Vjenës drejt Ballkanit Jugor, kurse pjesa tjetër e pranoi atë. Në grupin e fundit bënin pjesë shumica e anëtarëve të Lidhjes Shqiptare së bashku me kryetarin e saj, Sheh Mustafa Tetovën. Me këta u bashkuan sidomos edhe banorët e qyteteve të Prizrenit, të Tetovës, të Prishtinës dhe të Shkupit. Në një bisedë që Sheh Mustafa Tetova zhvilloi me konsullin Jelinek, më 14 maj 1879, deklaroi se ai personalisht ishte tepër i kënaqur nga konventa, sepse vendosja e trupave austro-hungareze në Sanxhak do të pengonte ekspansionin serb drejt Kosovës. Gjithashtu, kryetari i Lidhjes Shqiptare u shpreh se ishte në interesin e shqiptarëve që të kishin marrëdhënie të mira me Vjenën, pasi sipas tij sundimi osman në Evropë nuk do të zgjaste shumë. Ai mendonte se brenda 4-5 vjetëve Perandoria Osmane do të shembej dhe pas kësaj Austro-Hungaria do t'i mbronte shqiptarët nga lakmitë pushtuese serbo-bullgare<sup>30</sup>. Bazuar në këto deklarata të tij, Sheh Mustafa Tetova

<sup>29</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 167.

<sup>30</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 190-193.

mendonte se shqiptarët duhej të prisnin edhe disa vjet derisa të shembej Perandoria Osmane dhe deri atëherë të siguronin mbështetjen e njëres Fuqi të Madhe, që në këtë rast do të ishte Austro-Hungaria, e cila kur të vinte momenti do t'i ndihmonte ata që jo vetëm ta fitonin por edhe ta mbronin autonominë e tyre.

Gjatë gjysmës së dytë të qershorit 1879, Porta e Lartë dërgoi përforsime ushtarake në Kosovë. Ky veprim u kuptua nga shqiptarët si sinjal se ajo nuk kishte ndërmend t'u njihte atyre të drejta autonomiste dhe se përgatitej të ndërmerre operacion ushtarak për të shtypur lëvizjen e tyre. Kjo shkaktoi ankesa dhe protesta, të cilat u injoruan nga Qeveria osmane. Prandaj, më 23 qershor u zhvillua në Rugovë një miting, ku morën pjesë 800 burra të armatosur të ardhur nga Prizreni, Peja, Dibra, Tetova dhe Shkupi. Në miting u qortuan përfaqësuesit e Prizrenit pse kishin lejuar hyrjen e trupave qeveritare në qytetin e tyre<sup>31</sup>.

Në shtator të vitit 1879 u vendos të mblidhej Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes Shqiptare, i cili do të shqyrtonte dy çështje themelore: qëndrimi që duhej mbajtur nga provokimeve kufitare të Malit të Zi dhe zhvillimi i luftës për të drejtat autonomiste të Shqipërisë. Anëtarët që përfaqësonin viset e vilajetit të Kosovës në Këshillin e Përgjithshëm arritën, pothuajse që të gjithë, në Prizren gjatë ditëve të para të tetorit. Personalitetet që më së shumti u ranë në sy vëzhguesve të huaj ishin Sheh Mustafa Tetova, Iljaz pashë Dibra, Ali pashë Gucia, Hasan pashë Tetova, Ymer efendi Prizreni, Sulejman agë Vokshi<sup>32</sup>.

Më 3 tetor 1879, u mblodh Kuvendi i Përgjithshëm në të njëjtën ndërtesë, ku ishte themeluar Lidhja Shqiptare, në qershorin e vitit 1878. Në njërën nga seancat e para, u zgjodh edhe Këshilli i Përgjithshëm, i cili e zëvendësonte atë që ishte zgjedhur me rastin e themelimit të Lidhjes. Me zgjedhjet e reja, u rrit numri i atdhetarëve që u takonin dy rrymave (radikale dhe të moderuar) dhe u zvogëlua numri i sulltanistëve. Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm u zgjodh Haxhi Ymer efendiu, në vend të Sheh Mustafa Tetovës. Nuk dihen arsyet e largimit të *shehut tetovar* nga drejtimi i Lidhjes, nëse ishin shëndetësore ose për motive politike. Dy kryetarët e parë të Lidhjes Shqiptare, Iljaz pashë Dibra dhe Sheh Mustafa Tetova i takonin rrymës së moderuar, kurse kryetari i ri, i cili ishte myderriz i të drejtës islame dhe ishte nga Prizreni, i takonte rrymës atdhetare<sup>33</sup>. Ndoshta pikërisht kjo ishte arsyeja që Sheh Mustafa u largua

<sup>31</sup> *Po aty*, f. 194-195.

<sup>32</sup> *Po aty*, f. 200-201.

<sup>33</sup> *Po aty*, f. 202, 203; Shih dhe: *Historia e popullit shqiptar...*, f. 191.

nga drejtimi i Lidhjes për t'u zëvendësuar nga Haxhi Ymer efendiu, i cili ishte mbështetës i platformës atdhetare të Abdyl Frashërit.

Krahas Sheh Mustafa Tetovës, i cili ishte ndër figurat më të shquara të Lidhjes Shqiptare, personalitete të tjera të rëndësishme nga kjo kaza ishin edhe Esad pasha, Hasan pasha etj. Në janar të vitit 1880, Ahmet Muhtar Pasha, komandant i përgjithshëm i trupave osmane në Rumeli<sup>34</sup>, thirri në takim Esad Kalkandeli (Tetova) pashën dhe Hasan Derrallën\* dhe disa udhëheqës të tjerë shqiptarë për t'i sqaruar mbi nevojën që Gucia t'i lëshohej Malit të Zi, në përputhje me vendimet e Traktatit të Berlinit. Udhëheqësit shqiptarë, ndonëse pranuan kërkesën e komandantit osman, kërkuan nga ai që paraprakisht të informoheshin banorët e territoreve të cilat duhej t'i jepeshin Malit të Zi. Megjithëse kërkesa u pranua dhe njoftimi u bë nga autoritetet osmane, popullsia vendase e kundërshtoi kategorikisht këtë vendim. Ata deklaruan se ishin të gatshëm të vazhdonin luftën për të mos lejuar vendosjen e pushtetit malazez mbi këto territore<sup>35</sup>.

Në një njoftim të valiut të Manastirit për kryeministrinë, në gusht 1880, bëhet fjalë për zgjedhjen e delegatëve të Komitetit Qendror të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Sipas tij, anëtarë të këtij organi të lartë kombëtarë, nga kazaja e Tetovës ishin: Hasan Pasha, Esad Pasha, Mehmed Efendiu, anëtari i gjyqit të shkallës së parë\*, Hoxha Mustafa efendiu dhe Sadik Aga. Në fakt, Tetova përfaqësohej me 6 anëtarë në Komitetin Qendror, kryetar i të cilit ishte Haxhi Ymeri. Nga gjithsej 31 anëtarë, sa kishte Komiteti Qendror, rreth 20% e tyre ishin nga Tetova. Sipas të dhënave që ofron studiuesi Ilijaz Rexha, pas Prizrenit (i cili kishte 9 përfaqësues), Tetova ishte qendra më e përfaqësuar në këtë organ kombëtar. Nga qendrat tjera vetëm Gjakova përfaqësohej me 3 anëtarë, kurse qendrat tjera përfaqësoheshin me nga 2 ose 1 anëtar<sup>36</sup>.

Në Kuvendin e Dibrës (20-23 tetor 1880), ku morën pjesë rreth 300 delegatë, konsulli Lippih veçon 7 pjesëmarrës me peshë, të cilët i përmend edhe tradita popullore: Ali pashë Gucia, Sadik pashë Hoxholli

<sup>34</sup> Abdyli, Ramiz. 2004. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze*, Libri I. Prishtinë: Instituti i Historisë, f. 345, referenca 375.

\* Hasan pashë Derralla (Tetova) ishte i ati i Mehmet pashë Dërrallës (ministër i Luftës në Qeverinë e Ismail Qemalit). Ishin me origjinë nga fshati Gradec.

<sup>35</sup> Abdyli, Ramiz, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit...*, Libri I, f. 345-346; Abdyli, Ramiz, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze*, Libri II. Prishtinë: Instituti i Historisë, f. 81.

\* Nuk njihet emri i tij.

<sup>36</sup> Rexha, Ilijaz, *vep. e për.*, f. 73.

(nga Dibra), Esad pashë Tetova, Hasan pashë Tetova, Abdulla pashë Doshishti dhe Xhamal pashë Mati. Në Kuvend morën pjesë përfaqësues të tre rrymave. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve i takonin rrymës atdhetare të moderuar. Aty u diskutua krijimi i një province (vilajeti) autonome shqiptare. Nevoja për krijimin e një njësie autonome shqiptare brenda Perandorisë Osmane u përkrah nga të dy rrymat, radikalë e të moderuar, kurse u kundërshtua nga sulltanistët (rreth 8% e pjesëmarrësve). Dallimet midis këtyre dy rrymave, radikale dhe të moderuar, qëndronin në faktin se të parët kërkonin bashkimin e 4 vilajeteve me në krye një *“guvernator të aftë që fliste gjuhën shqipe”*. Organ më i lartë i vilajetit shqiptar do të ishte Këshilli i Përgjithshëm, prej 20 anëtarësh. Shqipja do të përdorej në shkolla e gjyqe. Ata kërkonin një Shqipëri të lirë nën protektoratin e Perandorisë Osmane. Të moderuarit kërkonin që të katër vilajetet të mbeteshin ashtu siç ishin, me administrata të veçanta, por të bashkoheshin në një ejalet të vetëm, me në krye një guvernator të emëruar nga sulltani. Esad pashë Tetova, përkrahu platformën radikale\*. Kuvendi i Dibrës gjithashtu diskutoi edhe për formimin e qeverisë së përkohshme shqiptare, megjithëse, në disa zona, si në Prizren, Gjakovë, Pejë, Dibër, Guci, Tetovë, Shkup, Kumanovë, Gjilan, Prishtinë, Kaçanik degët e Lidhjes kishin filluar të ushtronin funksione e tyre, si mbledhjen e taksave, ruajtjen e rendit publik, luftimin e vjedhjeve etj. Me fjalë të tjera, në këto vise kishte filluar jetën e vet qeveria e përkohshme shqiptare<sup>37</sup>.

Kazaja e Tetovës pati përfaqësuesit e saj edhe në organet e pavarura të ngritura nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në janar 1881. Pas formimit të Qeverisë së Përkohshme, u krijuan edhe komitetet e sanxhaqeve. Komiteti i sanxhakut të Prizrenit përbëhej nga gjithsej 24

---

\* Platforma e radikalëve, e cila parashikonte bashkimin e të gjitha tokave shqiptare në një vilajet të vetëm, të pajisur me një autonomi të gjerë dhe po të kundërshtohet nga Qeveria osmane atëherë shqiptarët ta realizonin nëpërmjet luftës u përkrah nga rreth 120 pjesëmarrës. Krahës Abdyl Frashërit, Ymer Prizrenit, Sulejman Vokshit etj., ajo u përkrah edhe nga personalitete të tjera të shquara, si: Ali pashë Gucia, Iljaz pashë Dibra dhe Esad pashë Tetova. Rezoluta tjetër e paraqitur nga rryma e moderuar dhe e mbështetur edhe nga sulltanistët, pati afërsisht 150 mbështetës. Sipas Lippihut, figurat më të shquara që mbështetën atë ishin: Sadik pashë Hoxholli, Hasan pashë Tetova, Abdulla pashë Dohoshishti, Xhemal pashë Zogolli etj. U hodhën propozime që kryeqytet i vilajetit autonom shqiptar të ishte Ohri, Manastiri ose Elbasani. (Shih: Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 337).

<sup>37</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 332-336; Frashëri, Kristo, *Abdyl Frashëri...*, f. 218-219.

anëtarë, në përbërjen e tij kishte edhe një përfaqësues nga *Tetova*, Haxhi Saliu, i cili krahas disa anëtarëve tjerë vlerësohej si ndër më aktivët<sup>38</sup>.

Krahas pjesëmarrjes aktive në gjithë veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare dhe organet drejtuese të saj, *tetovarët* iu bashkuan edhe forcave të armatosura vullnetare, që kishin për qëllim mbrojtjen e tokave shqiptare nëpërmjet luftës së armatosur. Në tetor 1880, vullnetarët nga *Tetova* u bashkuan me ata shkodranë dhe prizrenas në mbrojtje të Tuzit dhe të Ulqinit. Më 5 nëntor 1880, në Shkodër hynë 300 vullnetarë nga kjo kaza, ku u bashkuan me luftëtarë të tjerë shqiptarë, të ardhur nga vise të tjera, të cilët kishin për qëllim të luftonin në mbrojtje të Ulqinit. Më 15 nëntor rreth 360 vullnetarë *tetovarë* dhe dibranë u nisën për atje<sup>39</sup>.

Përfaqësues nga kazaja e *Tetovës* ishin pjesë edhe e Ushtrisë së Qeverisë së Përkohshme, të formuar në janar 1881. Sipas një njoftimi të konsullit të përgjithshëm anglez në Selanik, J. E. Blunt, në janar 1881, Lidhja Shqiptare e Prizrenit kishte shpallur rekrutimin e burrave të aftë për luftë, pasi përgatitej të luftonte kundër ushtrisë osmane. Qëllimi i Lidhjes ishte që të dërgonte trupat e saj në Shkup, për të detyruar autoritetet perandorake të kryeqendrës së vilajetit të Kosovës që të dorëzonin pushtetin. Pastaj ata planifikonin të vazhdonin drejt Kumanovës dhe Gjilanit. Sipas këtij njoftimi, forcat e armatosura të Lidhjes kishin vendosur që në çdo vend ku kalonin të rekrutonin 30 deri në 40 vetë. Më 3 janar pritej që të mbërrinin në Shkup 150 deri në 200 burra nga *Tetova* dhe Gostivari<sup>40</sup>. Në shkurt të vitit 1881, forcat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit arritën ta çlironin edhe *Tetovën*, Gostivarin, Dibren, ku u vendos autoriteti i Qeverisë së Përkohshme<sup>41</sup>.

Përkundër sukseseve të arritura, forcat e armatosura të Lidhjes shpejt u ndodhën përballë ushtrisë së fuqishme të Perandorisë Osmane. Për rrjedhojë, ushtria osmane arriti t'u shkaktonte disfata të njëpasnjëshme forcave shqiptare, ndërsa shumë drejtues të saj u dorëzuan te osmanët. Sipas një telegrami që Dervish pasha i dërgonte valiut të Shkodrës, nga Ferizaj, më 16 prill 1881, e njoftonte atë se krerët kryengritës të Dibrës, Prishtinës, *Tetovës*, Pejës, Shkupit ishin dorëzuar dhe se priste që të njëjtën gjë ta bënin edhe udhëheqësit e Prizrenit dhe të Gjakovës<sup>42</sup>. Disa nga ata për të ruajtur pasurinë ose privilegjet e tyre,

<sup>38</sup> *Po aty*, f. 376.

<sup>39</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 327, 342, 345.

<sup>40</sup> Abdyli, Ramiz, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit...*, Libri II, f. 139.

<sup>41</sup> *Historia e popullit shqiptar...*, f. 218.

<sup>42</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 405.



hoqën dorë nga platforma kombëtare. Hasan Pashë Dërralla, njëri nga drejtuesit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, nga takimi me Ahmet Muhtar pashën u vu në shërbim të Qeverisë osmane, duke tradhtuar idealet e Lidhjes Shqiptare. Ai ishte ndër të parët që iu dorëzua Dervish Pashës në Ferizaj. Në këmbim, Qeveria osmane e shpërbleu me postin e mytesarifit të Prizrenit<sup>43</sup>. Dervish Pashës gjithashtu i ishte dorëzuar edhe Sadik Pasha nga Tetova<sup>44</sup>, ashtu si edhe shumë drejtues të tjerë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Megjithëse ishte ndër të parët që iu dorëzua ushtrisë osmane, Hasan pashë Dërralla nuk qëndroi gjatë në krye të sanxhakut të Prizrenit, pasi osmanët e pensionuan. Një personalitet tjetër i shquar nga kazaja e Tetovës, Esad Pasha, pasi e nënshkroi deklaratën e pendimit që u ofruan osmanët drejtuesve të Lidhjes Shqiptare, u pendua disa ditë më vonë. Prandaj, Dervish pasha e arrestoi dhe së bashku me familjen i internoi në Anadoll<sup>45</sup>. Gjithashtu, ndër të arrestuarit bënte pjesë edhe Rauf Efendiu, ulema (dijetar) nga Tetova, i cili vuante dënimin në burgun e Prizrenit<sup>46</sup>, pasi nuk kishte pranuar të hiqte dorë nga kërkesat kombëtare.

### Përfundim

Vendimet e traktatit të Shën Stefanit, sipas të cilave copëtoheshin tokat shqiptare, u kundërshtuan me ngulm nga popullsia shqiptare e kazasë së Tetovës, e të dy besimeve fetare, myslimanë dhe ortodoksë. Po ashtu, përfaqësues nga kjo kaza morën pjesë në të gjitha aktivitetet e rëndësishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ata morën pjesë aktive në miratimin e dokumenteve kryesore të saj (Kararnamesë dhe Kanunit të ri); protestave e memorandumeve drejtuar Fuqive të Mëdha dhe Qeverisë osmane; veprimtarinë ushtarake të Lidhjes etj. Përfaqësues të saj morën pjesë në Kuvendin themelues dhe ishin pjesë e organeve drejtuese të Lidhjes Shqiptare, si Kuvendit të Përgjithshëm dhe Komitetit Qendror. Madje, Sheh Mustafa Tetova fillimisht ishte nënkryetar dhe pastaj edhe kryetar i Lidhjes, kurse Esad pashë Tetova ishte pjesë e Komitetit

---

<sup>43</sup> Abdyli, Ramiz, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit...*, Libri II, f. 81, referenca 44; Rizaj, Skender. 2008. Katër vilajetet shqiptare gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe vendi i saj në histori*. Prishtinë: Instituti i Historisë, f. 143; Shih dhe: Belegu, Xhefer, *vep. e përm.*, f. 188; Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 410-411; Shih dhe: *Historia e Popullit Shqiptar...*, f. 224.

<sup>44</sup> Rizaj, Skender, *Katër vilajetet shqiptare...*, f. 141.

<sup>45</sup> Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare...*, f. 475, 476, referencat 65, 111.

<sup>46</sup> Rizaj, Skender, *Katër vilajetet shqiptare...*, f. 144.

Qendror, si anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme. Sheh Mustafa Tetova, nga vëzhguesit e huaj vlerësohej si njëri ndër personalitetet më me ndikim të shqiptarët. Ai përfaqësoi Lidhjen Shqiptare në bisedimet me Qeverinë osmane gjatë muajve gusht-shtator 1878 dhe në vazhdimësi mbështeti kërkesën për krijimin e një vilajeti autonom shqiptar. Ai mendonte se ishte e domosdoshme që shqiptarët të siguronin një aleat të jashtëm dhe besonte se këtë rol mund ta merrte Austro-Hungaria, e cila kishte interesa të drejtpërdrejta në Gadishullin Ballkanik.

Në shkurt të vitit 1881, kazaja e Tetovës, ashtu si një pjesë e madhe e territoreve shqiptare, u çlirua nga sundimi osman dhe u vu në shërbim të Qeverisë së Përkohshme të Lidhjes Shqiptare. Por, pas shtypjes së Lidhjes nga ushtria osmane, pjesa më e madhe e përfaqësuesve tetovarë, për të shpëtuar nga ndëshkimet iu nënshtruan Qeverisë osmane, megjithëse pati edhe të tillë, si Esad pashë Tetova, Rauf Efendiu etj., që refuzuan amnistinë dhe mbështetën platformën kombëtare. Për këtë arsye, Esadi u internua në Anadoll bashkë me familjen, kurse Raufi vuajti dënimin me burg. Pjesëmarrja aktive e tetovarëve në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit është tregues i ngritjes së vetëdijes kombëtare të popullsisë shqiptare, të kësaj pjese të vilajetit të Kosovës.

**Agron ISLAMI**

## **POLITIKAT PËRAFRUESE TË ABDYLHAMITIT II KARSHI SHQIPTARËVE**

Viset shqiptare për Perandorinë Osmane kishin një rëndësi të veçantë strategjike, e aq më shumë kur populli shqiptar qysh nga fillimet e sistemit osman ishte i integruar në të, duke u bërë edhe pjesë e administratës së saj. Kështu, shqiptarët i gjejmë nga pozitat më të ulëta e deri tek pozita më të larta, siç ishte ajo e sadriazamit.<sup>1</sup> Madje sadriazamët nga familja e Kyprylinjëve të cilët udhëhoqën me Perandorinë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVII, respektivisht gjatë viteve 1656-1703, bëri që të rimëkëmbet Perandoria, dhe njëherit pjesa më e madhe e historianëve bashkëkohorë të periudhës osmane konsiderojnë se falë riorganizimit dhe reformave që bëri Mehmed Kypryliu dhe djali i tij Fazël Ahmed Kypryliu, mundi të mbijetojë.<sup>2</sup> Krahës këtyre mund të përmenden edhe Mustafa Bej Koçi nga Korça<sup>3</sup>, i cili hartoi raportin e njohur vlerësues të sistemit osman, si dhe shumë figura të tjera që dhanë kontribute në forma të ndryshme.

Koha kur Sulltan Abdulhamiti II erdhi në front ishte ndër momentet më të vështira për shtetin e tij. Rusët kishin aneksuar Krimenë dhe Kaukazin, po ashtu edhe francezët kishin aneksuar Algjerinë. Lufta ruso-osmane e vitit 1877-1878, përfundoi me marrëveshjen e Shën Stefanit (Ayastefanos) si rezultat i së cilës Rusia u zgjerua edhe më shumë, sidomos në viset e Rumelisë. Në këto kushte, Abdulhamiti II hartoi një politikë mbrojtëse ndaj sulmeve të fuqive të kohës. Gjatë kësaj kohe ai hartoi projektin e hekurudhës drejt Lindjes së Mesme, ku synonte që regjioni në fjalë të jetë më i qasshëm për kontroll dhe bashkëpunim me popujt atje.

---

<sup>1</sup> S.A. Aydemir, "Makedonya'dan Orta Asya'ya Enver Paşa" (İstanbul:1983), 362.

<sup>2</sup> Mehmet Toprak, "Sadrazam", TDV İslam Ansiklopedisi, (İstanbul: 1998), 415.

<sup>3</sup> Omer Faruk Akun, İslam Ansiklopedisi, vëll. 26 (İstanbul: 2002), 143-148.

Sulltani ishte i vetëdijshëm për gjendjen jo të favorshme të shtetit të tij dhe një gjë e tillë shihet edhe në memoaret e tij<sup>4</sup>, por edhe në dokumentacionin zyrtar osman, ku ai në vazhdimësi përpiket që të hartojë politika të veçanta të cilat shmangin luftën me shtetet armike të kohës. Ai ishte i vetëdijshëm edhe për rëndësinë e viseve të banuara me shqiptarë si dhe për vetë personalitetin e shqiptarëve, andaj hartoi politika të veçanta me qëllim të mbajtjes afër të këtij populli.

Duke qenë se Abdylhamiti II e njihte mirë historinë e shqiptarëve dhe i çmonte ata për trimërinë dhe besnikërinë që e tregonin ndaj tij, nuk ishte e rastësishme që ua kishte besuar sigurimin e sarajit të tij<sup>5</sup>, njëkohësisht ai në hapësirat e sarajit themeloi zyrën e Shqipërisë, e cila drejtohej nga Dervish Pasha.<sup>6</sup> Në të njëjtën kohë gjatë sundimit të tij, Ferid Pashës i cili ishte me prejardhje nga Vlora, ia kishte besuar pozitën e sadriazamit.

Sekretari i Sulltan Abdylhamitit II, Tahsin Pasha, në kujtimet e tij shkruan: *“Sigurimi i Sarajit Yëlldëz iu kishte besuar divizionit të përbërë nga shqiptarë, turq, arabë e boshnjakë... por, shqiptarët edhe për nga numri edhe për nga pesha e zinin vendin e parë. Abdylhamiti nuk kishte asnjë dyshim më të voglin në besnikërinë e shqiptarëve dhe ky besim i Sulltanit ndaj shqiptarëve bënte që ai aravutllukun ta shihte si bazament të politikave të tij në Rumeli. Por, edhe nga ana e shqiptarëve në Rumeli, Sulltan Abdylhamiti respektohej... shqiptarët kishin merita të larta si kuadro ushtarake, në veçanti në divizionin e pushkatarëve (Tyfekçinjëve) të cilin e udhëhiqte Tahir Pasha... këta kishin përgjegjësinë e sigurimit të sarajit nga dera hyrëse e Sarajit e deri tek shtrati i Sulltanit...”*<sup>7</sup>

Sulltan Abdylhamiti II si një udhëheqës prej pragmatisti, karshi rrezikut të humbjes së territoreve në Rumeli, në veçanti pas luftës shkatërruese me Rusinë e cila përfundoi me marrëveshjen e Shën Stefanit, në fillim ai do ta mbështes aktivitetin mbi themelimin e Lidhjes së Prizrenit, me shpresën që ajo do të funksiononte si një organizatë e cila do të do t'i mbronte tokat shqiptare-osmane nga pushtimi i huaj. Dhe, nuk ka dyshim se interesat e intelektualëve të Lidhjes dhe të Sulltanit osman në çështjen e mbrojtjes së tokave shqiptare

<sup>4</sup> Sulltan Abdylhamiti, Kujtimet e mia nga politika, (Shkup 2010).

<sup>5</sup> Pakalin M. Zeki, “Tüfekçi”, Osmanlı Tarihi Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü (İstanbul:1983), 535.

<sup>6</sup> Tahsin Paşa, “Yıldız Hatıraları” (İstanbul:1990), 26.

<sup>7</sup> Po aty, 133-134.

përputheshin.<sup>8</sup> Edhe Sami Frashëri në gazetën “Terxhumani Hakikat”, të datës 5 dhjetor 1878, në përgjigjen ndaj akuzës së Ahmet Mithatit, se “*tentativat e shqiptarëve për t’u shkëputur nga Perandoria Osmane është tradhti ndaj botës myslimane dhe njëherit një populli të vogël prej një milion e gjysmë siç janë shqiptarët, nuk do të mund t’i bëjnë ballë sulmeve të Rusisë...*”, (Samiu) shkruan: “*Shqiptarët nuk janë aq të pabesë sa të kërkojnë ndarje nga shteti osman, por qëllimi i tyre është që t’i ruajnë trojet e tyre nga copitimi i pushtimeve të huaja*”. Sipas Samiut, armiqet e Shqipërisë për copëtimin e saj përdoronin dy karta, forcën dhe edukimin, andaj Shqipëria duhet të bashkohet në një vilajet të vetëm në mënyrë që t’i shpëtojë asimilimit kulturor si dhe t’i ndërpres rrugën armiqve.<sup>9</sup>

Mbi këtë vijë edhe Sulltani ua kishte lëshuar një urdhër autoriteteve osmane lokale të Dibrës, Prizrenit, Gjakovës e gjetiu, që të tregoheshin tolerantë ndaj nismave politike të intelektualëve shqiptarë.<sup>10</sup>

Pas Kongresit të Berlinit, respektivisht më 25 gusht 1878, Mushiri Mehmet Ali Pasha, i cili njëherit kishte qenë edhe përfaqësues i Portës së Lartë në Kongresin e Berlinit, u dërgua në Prizren për të qetësuar shqiptarët e hidhëruar ndaj vendimeve të kongresit në fjalë. Por, kërkesa e tij që të kthehet ligji i vjetër në këto anë u konsiderua tradhti, dhe më 6 shtator 1878, ai do të vritet së bashku me nikoqirin e tij, Abdullah Pashë Drenin, i cili ishte edhe komandant i forcës ushtarake të Gjakovës.<sup>11</sup>

Megjithatë, Sulltani Lidhjen Shqiptare të Prizrenit do ta shtypë vetëm pas kërcënimeve të fuqive evropiane të kohës, se në rast të mosdorëzimit të Ulqinit, do ta okuponin Izmirin.<sup>12</sup> E që menjëherë pas kërcënimit në fjalë, respektivisht më datë 11 nëntor 1880, Sulltan Abdylhamiti II i dërgon një shkresë fuqive evropiane ku i njofton për formimin e një divizioni të ri ushtarak që do t’ua dorëzon Ulqinin malazezëve.<sup>13</sup>

---

<sup>8</sup> Ferid Duka, “Lidhja e Prizrenit në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane”, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881* (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 2011), 69.

<sup>9</sup> “Arnavutluk”, *Tercuman-i Hakikat*, 5 kanûn-i evvel 1878, 2.

<sup>10</sup> Süleyman Külçe, *Osmanlı Tarihinde Arnavutluk* (İzmir:1944), 249.

<sup>11</sup> Skender Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze* (Prishtinë: Arkivi I Kosovës, 1978), 222.

<sup>12</sup> Yüksel Çelik, “Kryengritjet shqiptare në periudhën e Abdylhamitit të II: Themelimi i Lidhjes së Prizrenit dhe veprimet që i ndërmerre Porta e Lartë”, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881* (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 2011), 114.

<sup>13</sup> Po aty.

Sulltan Abdylhamiti II me qëllim të përafrimit me shqiptarët, qysh në vitin 1892 themeloi komisione të veçanta për pajtimin e gjaqeve. Ky komision përmendet në salnamen (vjetarin) e Shkodrës, i cili njihet si diyet komisyonu: *“Në Shkodër dhe në rrethinë, në veçanti në zonën e Malësisë edhe në ditët e sotme është evidente tradita e ngujimeve, e cila është një sëmundje e trashëguar nga e kaluara. Traditë e cila bie ndesh me logjikën e shëndosh si dhe me vetë civilizimin islam... të vazhduarit e kësaj gjendjeje në mënyrë të prerë është e papranueshme për Sulltanin, dhe mbi këtë bazë valiu i vilajetit, zotëria Abdylkerim Pasha, kontribuoi shumë për zhdukjen e kësaj të keqeje njerëzore”*.<sup>14</sup>

Në vijën e pajtimit të shqiptarëve në gjak u dërguan urdhëresa tek ylemaja dhe paria vendore që të kontribuojnë në çrrënjosjen e këtij adeti të keq.<sup>15</sup> Një shembull nga kjo është edhe zgjedhja e një mosmarrëveshjeje në mes myslimanëve dhe të krishterëve shqiptarë në Zym të Hasit.<sup>16</sup>

Në të njëjtën kohë, ai themeloi edhe komisionin e ligjëruesve myslimanë me qëllim të shpjegimit të vlerës së halifes tek besimtarët, ku sipas një telegrafi të datës 12 prill 1901, raportohet se ylemat e Shkodrës ia kishin arritur të qetësojnë kundërshtarët e reformave të shtetit.<sup>17</sup> Ndërsa, përzgjedhja e këtyre ligjëruesve ishte bërë me shumë kujdes. Në shkresën e datës 21 qershor 1902, thuhet: *“Aprovohet kërkesa për dërgimin e 3 hatibëve në vilajetin e Kosovës. Këta me gjuhën e rrjedhshme shqipe do t’ua shpjegojnë islamin e vërtetë malësorëve të cilëve kanë njohuri të pakta. Të njëjtit do të dërgohen edhe në Mat dhe në ngushtica? si dhe në Dibrën e Poshtme”*.<sup>18</sup>

Në vijën e politikave përafruese ndaj shqiptarëve, Sulltan Abdylhamiti kishte shkolluar fëmijët e parisë shqiptare në mektebin *“Ashiret”* të cilin e kishte themeluar vetë. Në raportin e inspektorit të kufirit me Serbinë të datës 4 gusht 1902, thuhet: *pranimi i dhjetë fëmijëve shqiptarë në mektebin “Ashiret” është mirëpritur, mirëpo kërkesat e shqiptarëve që t’i shkollojnë fëmijët e tyre me bursë në këtë shkollë janë shumë më të mëdha, andaj sugjerojmë që kjo shifër të rritet, të paktën edhe për 10 fëmijë tjerë*.<sup>19</sup> Në të njëjtin vit, gjejmë një vendim të Ministrisë së Arsimit ku përmenden 20 fëmijë shqiptarë që do të shkollohen në mektebin *“Ashiret”*, ku sipas vendimit në fjalë, të gjitha

<sup>14</sup> “İşkodra Vilayet Salnamesi” (İşkodra Vilâyet Matbaası:1310) ,136-137.

<sup>15</sup> BOA, Y. S. Hususi, 390/86.

<sup>16</sup> BOA. Y.S. Hususi, 257/134.

<sup>17</sup> BOA, R, Müf. Evraki, 2/115.

<sup>18</sup> BOA. DH.MKT. 2510/130.

<sup>19</sup> BOA, İ.HUS. 98/16.

shpenzimet e nxënësve do të mbuloheshin nga fondi i mektebit, si dhe do t'u jepej bursa vjetore prej 64 000 groshëve (kurushëve).<sup>20</sup>

Sulltan Abdylhamiti II në një rën anë, hartonte politika dhe formonte komisione të veçanta për mbajtjen bashkë të shqiptarëve, në anën tjetër mendohej që përmes politikave të tij të shkaktojë përçarje në mes ortodoksëve të Ballkanit. Kjo dëshmohet në kujtimet e sekretarit të tij, Tahsin Pasha, i cili thotë: *“Synimi kryesor i politikës së jashtme të Abdylhamitit ishte që ta kontrolloj Rusinë, të qëndroj në paqe me Anglinë, të mos ketë përplasje direkte me Gjermaninë, të mos harroj që Maqedonia mund të jetë pre e Austrisë dhe aq sa është e mundur të kalojë mirë me shtetet tjera. Ndërsa, ai dëshironte që popujt ortodoksë të Ballkanit, respektivisht bullgarët, serbët dhe grekët, t'i mbajë të përçarë mes vete.*<sup>21</sup>

---

<sup>20</sup> BOA, I. Maarif, 4.

<sup>21</sup> Tahsin Pasha, po aty, 85.





**Zeqirja REXHEPI**

## **RAPORTET MIDIS FUQIVE TË MËDHA DHE LIDHJA E PRIZRENIT**

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, Kriza Lindore hynë në një fazë të re historike. Shfaqja e fuqive të reja në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare, si Gjermania dhe Italia, dhe dobësimi i vazhdueshëm i Perandorisë Osmane, e hapi sërish mundësinë e prishjes së *status quo*-së në Ballkan, e cila kishte funksionuar pas disfatës së Rusisë në luftën e Krimesë.

Në rrafshin ndërkombëtar, prishja e *status quo*-së do të thotë rrezik për territoret që administroheshin nga Perandoria Osmane, gjë që nënkuptonte copëtimin e trojeve të banuara me shqiptarë. Kjo është koha kur Rilindja Kombëtare Shqiptare përpiqej të mbjellë farën e ndërgjegjes kombëtare ndër shqiptarët dhe pikërisht në këtë kohë ajo duhej të përballej me çështjet tepër të ndërlikuara, të raporteve midis Fuqive të Mëdha.

Traktati i Shën Stefanit e alarmoi pjesën e ndërgjegjësuar kombëtare shqiptare, përfaqësuesit e së cilës u mblodhën në Kuvendin historik të Prizrenit. Epilogu i Kuvendit në Prizren ishte formimi i Lidhjes Shqiptare, e cila për një kohë të shkurtër arriti të imponohet si përfaqësuese politike e kombit shqiptar.

**Fjalët kyçe: raporte, Fuqitë e Mëdha, Lidhja Shqiptare.**

### **Hyrje**

Lidhja Shqiptare e Prizrenit padyshim se është organizimi më i rëndësishëm politik dhe ushtarak i Rilindjes Kombëtare Shqiptare në

shekullin XIX. Shfaqja e saj në skenën politike ndërkombëtare ndërlidhet me ngjarjet dramatike që janë zhvilluar në Ballkan si rrjedhojë e Krizës Lindore - Luftës Ruso-Turke (1877-1878). Epilogu i zhvillimit të Krizës Lindore ishte Traktati i Shën Stefanit, vendimet e të cilit dukshëm e rritën epërsinë e ndikimit të Rusisë në Ballkan në dëm të ndikimit të Austro-Hungarisë. Traktati i Shën Stefanit, përmes “Bullgarisë së Madhe”, në të vërtetë i hap rrugë hegjemonisë ruse, por edhe kontrollimit të ngushticave detare (Bosforit dhe Dardaneleve), me çka drejtpërdrejt rrezikohej Stambolli dhe Perandoria Osmane, sikurse dhe interesat e Fuqive të Mëdha perëndimore në Lindjen e Afërme, si: Britanisë së Madhe, Francës dhe Gjermanisë.

Krahas rrezikimit të interesave strategjike të Fuqive të Mëdha, Traktati i Shën Stefanit drejtpërdrejt i rrezikonte trojet shqiptare që ndodheshin nën administrimin osman.

Në Traktatin e Shën Stefanit, Rusia i shkëputte Perandorisë Osmane rreth 80% të zotërimeve territoriale në Ballkan, por nuk mori gjë për vete, sepse pretendimet e saj territoriale synonte t’i realizojë përmes “Bullgarisë së Madhe”, e cila do të shërbente si satelite e Rusisë.<sup>1</sup>

Në këto rrethana, synimet hegjemoniste ruse i vënë në pikëpyetje interesat e të gjitha Fuqive të Mëdha. Këta të fundit nuk u pajtuan me Marrëveshjen e Shën Stefanit dhe për disa muaj organizuan Kongresin e Berlinit, në të cilin do të rishqyrtohen të gjitha çështjet e hapura. Duhet theksuar se me këtë rast janë rishqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me interesat e Fuqive të Mëdha dhe të sferës së ndikimit të tyre (shteteve sllave), por jo edhe çështja shqiptare, e cila ishte në fazën e ndërkombëtarizimit të saj. Aq më tepër, në Kongresin e Berlinit, trojet e banuara me shqiptarë etnikë bëhen pre e pazareve, duke iu shkëputur Perandorisë Osmane, për t’ju dhuruar shteteve fqinje ballkanike: Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë.

Nga kjo periudhë historike, pra nga Traktati i Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit fillon kalvari i shkëputjes sistematike të trojeve etnike shqiptare nga shtetet e përmendura ballkanike, me pëlqimin e Fuqive të Mëdha.

Rilindësit shqiptarë të kohës, e ndjenë rrezikun që u kërcënohej tokave shqiptare, prandaj janë përpjekur të organizojnë potencialet kombëtare shqiptare, pas sundimit pesëshekullor të Perandorisë Osmane. Me nismën e tyre, më 10 qershor 1878, tre ditë para mbajtjes së

---

<sup>1</sup> *Historia e popullit shqiptar II, Rilindja Kombëtare, vitet ‘30 të shekullit XIX - 1912*, Toena, Tiranë, 2002, f. 147.

Kongresit të Berlinit, në Prizren u mbledh një Kuvend me rëndësi jetike për kombin shqiptar, në të cilin është formuar Lidhja Shqiptare, si një organizatë politike, e cila do ta drejtojë kauzën historike shqiptare.

Misioni i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte i trefishtë: të zgjojë ndërgjegjen e fjetur të shqiptarët; të imponohet si faktor politik tek Fuqitë e Mëdha, duke ia marrë të drejtën Perandorisë Osmane, si dhe t'i përfaqësojë shqiptarët dhe t'i mbrojë me armë trojet etnike, të cilat Kongresi i Berlinit ua kishte ndarë shteteve fqinje ballkanike.

### **Raportet midis Fuqive të Mëdha dhe Lidhja e Prizrenit**

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, rajoni i Ballkanit që administrohej nga Perandoria Osmane vazhdon të mbetet arenën e krizave të rënda, me karakter ndërkombëtar, në të cilat janë implikuar fuqitë më të mëdha të kohës.

Në vitet e '50-ta të shekullit XIX, gjatë kohës së krizës së Krimesë (1853-1855), Franca dhe Anglia luajtën rolin kryesor, duke e rikthyer *status quo*-në në Ballkan, parim të cilin e kishte rrezikuar Rusia me veprimet e veta ushtarake. Rreth njëzet vjet më pas, në një zonë tjetër të Ballkanit, përkatësisht në Bosnjë-Hercegovinë, shpërthen kriza e re (1875). Ndërkohë, harta politike e Evropës kishte ndryshuar, përpos fuqive ekzistuese, si Franca, Anglia, Austria dhe Rusia, shfaqen edhe dy fuqi të reja evropiane: Gjermania dhe Italia.

Përderisa gjatë kohës së krizës së Krimesë nuk është ndjerë rreziku për trojet ku jetonin shqiptarët etnikë, kriza e dytë (Kriza Lindore), e cila zhvillohet në kufijtë e Shqipërisë, i rrezikoi ndjeshëm trojet shqiptare.

Dalja në skenën evropiane e të dy fuqive të mëdha, më 1871, dhe kundërthëniet midis tyre, gradualisht shkaktojnë rirreshtimin e tyre, duke krijuar kështu aleancat politiko-ushtarake. Austro-Hungaria afrohet gjithnjë e më tepër me Gjermaninë, ndërsa Franca me Rusinë. Me këto rreshtime të reja janë formuar aleancat e mëdha ushtarake, të cilat do ta shpijnë Evropën në Luftën e Parë Botërore.<sup>2</sup>

Zhvillimet e reja politike në Evropë e inkurajojnë edhe Rusinë cariste ta përshpejtojë procesin e depërtimit në Ballkan, duke u përfshirë edhe drejtpërdrejt në luftimet kundër Perandorisë Osmane, siç ishte Lufta Ruso-Turke e vitit 1877.

Pikërisht, në kohën e ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), edhe pse në dukje Fuqitë e Mëdha kishin marrë vendime të

<sup>2</sup> Misha Glenny, *Historia e Ballkanit, 1804-1999*, Toena, 2007, f. 135.

përbashkëta, midis tyre “zienin” kundërthënie të mëdha, të cilat përpiqeshin t’i zbutin përmes pazareve të ndryshme në kurriz të popujve të shtypur dhe të pambrojtur. Në kohën kur vendimet e Kongresit të Berlinit duhej të jetësoheshin, lidhet Marrëveshja midis Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë (Marrëveshja Bismark-Andrashi).<sup>3</sup> Edhe Franca, nga ana tjetër nuk qëndronte duarkryq. Ajo, gradualisht do t’i afrohet Rusisë, duke i “mbyllur sytë” para shtrirjes së ndikimit rus në Ballkan, në rajonin ku rrezikohen drejtpërdrejt tokat e shqiptarëve etnikë, e me këtë edhe kauza e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare.

Gjashtë Fuqitë e Mëdha: Gjermania, Britania e Madhe, Franca, Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia, u mbledhën në Berlin, më 13 qershor deri më 13 korrik 1878, për të rishikuar vendimet e Traktatit të Shën Stefanit. Me këtë rast, Fuqitë e Mëdha nuk i morën parasysh fare kërkesat e delegacionit shqiptar të ngarkuar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit.<sup>4</sup> Kongresi i Berlinit nuk e njohu Shqipërinë dhe nuk e njohu as kombin shqiptar. Që situata të zhvillohet edhe më keq për shqiptarët, sipas nenit 23 të Traktatit të Berlinit, pamundësohej bashkimi i katër vilajeteve që ishte në kundërshtim me aspiratat autonomiste të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.<sup>5</sup> Perandoria Osmane obligohej të hartonte *Rregullore Organike* për administrim autonom të vilajeteve. Mbetja e trojeve shqiptare, të ndarë në katër vilajete ishte tërësisht në dëm të kauzës për të cilën angazhohej Lidhja e Prizrenit. Vendimi i Traktatit të Berlinit<sup>6</sup>, i dobësonte lidhjet ekonomike, politike dhe kulturore midis shqiptarëve dhe nga ana tjetër e favorizonte ndikimin e shteteve fqinje: të Serbisë në vilajetin e Kosovës; të Bullgarisë në vilajetin e Manastirit dhe të Greqisë në vilajetin e Janinës.

Përkundër pikëpamjeve të Fuqive të Mëdha, të cilat mbi bazën e mosnjohjes së realitetit kombëtar shqiptar, duke e shpallur Lidhjen Shqiptare të Prizrenit si krijesë të Qeverisë osmane, Lidhja Shqiptare synonte të mënjante pushtetin e kalbur osman me qëllimin themelor, mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare. Këtë e vuri re edhe vetë konsulli anglez në Shkodër, pas vrasjes së Mehmet Ali Pashës në Gjakovë, i cili thotë: “*Që në shenjat e para të përpjekjeve se po veprohet për të*

<sup>3</sup> *Историја дипломатије* (свеска прва), Архив за правне и друштвене науке, Београд, 1949, f. 55.

<sup>4</sup> *Historia e popullit shqiptar II*, (vepër e përmendur), f. 162.

<sup>5</sup> Po aty, f. 164.

<sup>6</sup> Neni 23 i Traktatit të Berlinit.

*përcaktuar kufijtë e rinj shqiptaro-malazezë, Lidhja Kombëtare ka të ngjarë të heq mënjanë autoritetet turke dhe ta marr mbrojtjen e vendit në dorë”.*<sup>7</sup>

Për sa i përket organizatës së Lidhjes së Prizrenit, përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha kishin pikëpamje diametralisht të ndryshme. Mëdyshja tek Fuqitë e Mëdha ka qenë si rezultat i propagandës së fuqishme të Rusisë dhe të vendeve sllave ballkanike, të cilat e kanë prezantuar Lidhjen Shqiptare si një krijesë turke dhe jo si një realitet politik dhe ushtarak në skenën ballkanase dhe evropiane. Në këtë kontekst, ministri rus në Cetinë, z. Jonine, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit e paraqiste si “dordolec imagjinar” të vënë përpara nga Porta si shkas për t’iu shmangur detyrimeve të veta, ndërsa agjentët austriakë e prezantojnë Lidhjen si një realitet mjaft serioz.<sup>8</sup>

Nën ndikimin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që tashmë jepte frytet e para, në ditën e fillimit të Kongresit të Berlinit, më 13 qershor 1878, Fuqive të Mëdha u dërgohet një *Memorandum*, në të cilin përpos tjerash u bëjnë me dije veçantitë kombëtare të shqiptarëve. Në këtë *Memorandum*, mes tjerash thuhet: “*Përmes gjithë vështirësive, shqiptarët kanë mundur të ruajnë pavarësinë e tyre, veçoritë, traditat dhe gjuhën kombëtare dhe qofshin katolikë, ortodoksë ose myslimanë, i urrejnë jo vetëm sunduesit e tyre turq po edhe gjithë të huajt tjerë*”.<sup>9</sup>

Nga kjo, mund të vërehet qartë se shqiptarët kishin filluar të ndërgjegjësohen kombëtarisht, duke u treguar Fuqive të Mëdha se Ballkani dhe Evropa duhet të llogaritin edhe për interesat e një kombi, tek i cili sapo ishte “trazuar” ndërgjegjia e fjetur.

Sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit, Fuqitë e Mëdha e njohin Malin e Zi si shtet të pavarur dhe i premtuan zgjerim territorial në krahinat e Tivarit, Podgoricës, Plavës e Gucisë... etj. Këtij premtimi evropian, shqiptarët iu kundërpërgjigjën. Me nismën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u ndërmorën një sërë aktivitete për të kundërshtuar

<sup>7</sup> Shkresa e Kirby Green, konsull anglez në Shkodër, për gjendjen e tensionuar midis Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Qeverisë osmane pas vrasjes së Mehmet Ali Pashës, nr. 70 Politikë, Shkodër, 15 shtator 1878. PRO FO 78 Ç2841, Ramiz Abdyli, Libri II, f. 45.

<sup>8</sup> Nga letra e sir Henri Elliot, ambasador i BM. Në Vjenë për ministrin e Punëve të Jashtme të BM, markezin Salisbury, Vjenë 14 prill 1880, nr. 167 konfidenciale. Ramiz Abdyli, Libri I, f. 75.

<sup>9</sup> Ramiz Abdyli, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze (1878-1881)*, Libri II. Përmbledhja e Memorandumit të 13 qershorit 1878, nga një zyrtar i lartë anglez, kundër copëtimit të tokave shqiptare dhe nevojës së krijimit të shtetit autonom shqiptar, f. 40.

zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, për sa i takon dorëzimit të trojeve shqiptare vendeve fqinje.

Plava e Gucia, qytete shqiptare në veri të Shqipërisë, të cilat sipas vendimit të Traktatit të Berlinit, duhej t'i dorëzohen Malit të Zi, deri kah fundi i vitit 1879. Mirëpo, Lidhja Shqiptare e Prizrenit e kundërshtoi fuqishëm vendimin e Fuqive të Mëdha. Veprimtaria e vendosur e Lidhjes Shqiptare për t'i mbrojtur krahinat e përmendura, shkaktoi divergjenca midis përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha. Kështu, Musun Pasha (Masurus Pasha), sipas ambasadorit anglez në Stamboll, Henry Layard, i paska thënë se *"Porta do të bënte çmos për të arritur dorëzimin paqësor të territorit, se ata i kishin tërhequr trupat dhe autoritetet e tyre civile (dhjetor 1879), por nëse ata nuk ia arrijnë t'i bënë banorët t'u bindeshin paqësisht dispozitave të Traktatit, ai nuk mendonte se Traktati e kërkonte ose që Fuqitë mund të prisnin që Qeveria osmane të hapte luftë kundër nënshtrësve të saj të mëparshëm për t'i detyruar t'i nënshtroheshin asaj fuqie nën autoritetin e së cilës duhej të kalonin"*.<sup>10</sup>

Ndërkohë që, zbatimi i vendimeve të Kongresit të Berlinit, për tokat që i ishin dhënë Malit të Zi, nuk realizohej për shkak të kundërshtimit nga Lidhja e Prizrenit, knjaz Nikolla i Malit të Zi, nga fillimi i nëntorit 1879, provoi të tërheq vëmendjen e Fuqive të Mëdha përmes luftës së armatosur.

Në fillim të janarit 1880, u përballën drejtpërdrejt Ushtria malazeze dhe Ushtria shqiptare e Lidhjes së Prizrenit. Më 8 janar, Ushtria malazeze pësoi disfatë dhe pjesët e mbetura të saj u tërhoqën brenda territorit të Malit të Zi.<sup>11</sup>

Rezistenca e armatosur shqiptare kundër përpjekjeve ushtarake të Malit të Zi, pati jehonë të jashtëzakonshme me ç'rast fillon ndryshimi i opinionit publik evropian për shqiptarët. Nga kjo kohë, opinionit publik evropian fillon të interesohet për historinë e popullit shqiptar, ndërsa disa publicistë e kritikuan Kongresin e Berlinit që nuk i kishte përfillur të drejtat e një kombi trim dhe liridashës, siç ishte populli shqiptar.<sup>12</sup> Me fjalë tjera, përpjekjet politike dhe përpjekjet e armatosura të organizuara nga Lidhja e Prizrenit, e shpalosën çështjen kombëtare shqiptare në Ballkan, e cila kërkonte zgjidhje politike.

<sup>10</sup> Ramiz Abdyli, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, Libri II, Prishtinë, 2004, f. 77. Nga shkresa e ambasadorit anglez në Stamboll, H. Layard dërguar lordit Beaconsfield, përfaqësues i delegacionit anglez në Kongresin e Berlinit, nr. 1495, 16 dhjetor 1879. PRO FO 78 Ç 2941.

<sup>11</sup> *Historia e popullit shqiptar*, (vepër e përmendur), f. 182.

<sup>12</sup> Po aty, f. 183.

Kryekonsulli austro-hungarez në Shkodër, Shmuker, pas fitores së forcave ushtarake të Lidhjes Shqiptare kundër ushtrive malazeze i raporton qeverisë së Vjenës, si vijon: “*Shqiptarët luftuan të shtyrë nga ideja kombëtare*”.<sup>13</sup>

Vendosmëria e shqiptarëve i detyroi Fuqitë e Mëdha ta rishqyrtojnë vendimin e mëparshëm, rreth Plavës dhe Gucisë dhe me propozimin e ambasadorit italian, kontit Corti, propozuan t’i jepeshin Malit të Zi, Hoti, Gruda dhe një pjesë e Kelmendit, me popullsi të besimit katolik. Sipas marrëveshjes, dorëzimi i këtyre viseve duhej të bëhej më 22 prill 1880.<sup>14</sup>

Se si janë zhvilluar raportet midis Fuqive të Mëdha, dhe pikëpamjet e tyre rreth Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në kohën kur zhvillohej veprimtaria e saj, dokumentet angleze hedhin dritë për rivalitetin midis dy fuqive pretendente për ndikim në Ballkan: Austro-Hungarisë dhe Italisë. Kështu, në njoftimin e konsullit anglez në Shkodër, Kirby Green, që i dërgohet ministrit të Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, markezit Salisbury (21 mars 1880), pra në kohën kur zhvillohen ngjarjet rreth kufirit me Malin e Zi, vihen re kundërthëniet ose siç i quan konsulli anglez “xhelozit” e agjentëve konsullorë italianë që kishin ndaj agjentëve austriakë në Shqipërinë e Veriut.<sup>15</sup> Dokumenti, në të vërtetë shpalos rivalitetet e dy fuqive fqinje, të cilat edhe pse kishin marrë obligime për vënien në jetë të vendimeve të Kongresit të Berlinit dhe “Protokollit të Stambollit”, më 18 prill 1880, përpiqen të krijojnë mundësi të reja ndikimi për periudhën vijuese.

Një paradoks tepër interesant mund të vihet re në dokumentet angleze të kohës. Në raportet e përfaqësuesit diplomatik, dërguar Ministrisë së Jashtme, përmenden *shqiptarët* si popull, edhe përkundër faktit se ky popull (shqiptarët) nuk njihet në Kongresin e Berlinit. Në këtë kontekst, mund të kuptohet “hipokrizia” e konsullit anglez në Shkodër, z. Kirby Green, i cili në Raportin e 18 prillit 1880, që i dërgon ministrit të Jashtëm britanik, markezit Salisbury, në të cilën mes tjerash thotë: “*Jam përpjekur në të gjitha drejtimet për të gjetur qëllimet e vërteta të shqiptarëve të Veriut lidhur me ndryshimet e bëra tashti në*

<sup>13</sup> *Historia e popullit shqiptar*, (vepër e përmendur) f. 183.

<sup>14</sup> “Protokolli i Stambollit”, 19 prill 1880, sipas të cilit Sulltani i lëshon Malit të Zi në vend të krahinave të Plavës e Gucisë, Hotin dhe Grudën. *Historia e popullit shqiptar*, (vepër e përmendur), f. 185.

<sup>15</sup> Ramiz Abdyl, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze, Libri I*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2004, f. 43.

*kufirin shqiptaro-malazet dhe jam përpjekur të zbuloj nëse po i shtyn ata për kundërshtim ndonjë ndikim i jashtëm”.*<sup>16</sup>

Sipas Marrëveshjes (Protokolli i Stambollit), 24 orë para zbrazjes, komandantët e pikave të zëna nga Ushtria osmane duhet të paralajmërojnë komandantin e Ushtrisë së princit të Malit të Zi në Podgoricë, për orën e saktë, në të cilën duhet të tërhiqen nga pikat e zëna. Mirëpo, në pasditen e 22 prillit 1880, në ditën kur Ushtria turke duhej t'i lironte pozicionet në favor të Ushtrisë malazeze, pozicionet i kapën shqiptarët që drejtoheshin nga Komiteti i Lidhjes në Shkodër. Në këto rrethana, Fuqitë e Mëdha kërkonin që Porta t'i ripushtojë pozicionet, të cilat i kishin zënë luftëtarët e Lidhjes Shqiptare dhe t'ia dorëzojë Malit të Zi.

Edhe pse Fuqitë e Mëdha përpiqen të mbeten unike dhe të vendosura në vendimin e tyre, rreth përcaktimit të kufirit me Malin e Zi, megjithatë rezistenca e shqiptarëve për mosdorëzimin e pozicioneve të braktitura turke, i fut ato (Fuqitë e Mëdha) në dilema të reja rreth hapave që mund të merreshin. Një dilemë e këtillë shfaqet tek Austro-Hungaria, gjë që nuk mbetet pa u vërejtur nga ambasadori anglez në Vjenë, sir Henri Elliot, i cili në letrën që i dërgon kontit Granville, ministër i Jashtëm i Britanisë së Madhe, shkruan: *“Lidhur me telegramin tuaj nr. 77 kam kuptuar nga gjuha e ministrit austriak të Punëve të Jashtme, se si do të parapëlqente një politikështyrje ndaj shqiptarëve, më mirë sesa zbatimin e masave që ka të ngjarë të çojë në konflikt”.*<sup>17</sup>

Se midis Fuqive të Mëdha ekzistonin kundërthënie dhe dyshime të thella në veprime, mund të vërehet edhe nga Raporti tjetër i konsullit anglez në Shkodër, Kirby Green, që i dërgon ministrit të Jashtëm të Britanisë së Madhe, markezit Salisbury, (Shkodër, 25 prill 1880), në të cilin pasi ia prezanton tërë ngjarjen rreth kufirit shqiptaro-malazet dhe aktivitetin e Lidhjes Shqiptare, rreth kësaj çështjeje. Me këtë dyshohen veprimet e francezëve dhe italianëve (fundi i raportit)... *“marr guximin ta informoj Shkëlqesinë tuaj konfidencialisht se, konsulli italian dhe francez besohet se po e mbështetin fshehurazi Lëvizjen e tanishme shqiptare, por përtej ekzistencës së kësaj përshtypjeje nuk kam ndonjë provë se po bëjnë kështu”.*<sup>18</sup>

<sup>16</sup> Po aty, f. 86.

<sup>17</sup> Ramiz Abdyli, Libri I, (vepra e përmendur) f. 146. Vjenë, 4 maj 1880.

<sup>18</sup> Ramiz Abdyli, Libri I, (vepër e përmendur) f. 119. Z. Kirby Green, konsull anglez në Shkodër për markezin Salisbury, ministër i Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe. (nr. 78 Politike), Shkodër, 25 prill 1880.



Gjatë kohës së zhvillimit të ngjarjeve rreth kufirit me Malin e Zi, krerët e Lidhjes Shqiptare, përpos aktiviteteve të rezistencës së armatosur i kanë intensifikuar edhe veprimet diplomatike, duke iu drejtuar përfaqësuesve të huaj diplomatikë. Kështu, përfaqësues të Lidhjes Shqiptare, dy anëtarë të Komitetit Shqiptar (Shkodër), i drejtohen diplomatit anglez, z. Kirby Green, më 17 maj 1880, në të cilën thuhet: *“Kemi nderin t’juja dorëzojmë bashkëngjitur një telegram drejtues Shkëlqesisë së tij, Lordit Gladstone, me lutje që nëpërmjet jush ta çojë të sigurt në destinacion. Nënshkruar nga Ibrahim Efendi Dragusha dhe Andrea Shiroka”*.<sup>19</sup>

Bashkëngjitje 2 në nr. 175

*“Komiteti shqiptar për z. Gladstone,*

*Populli shqiptar, i përfaqësuar në këtë moment nga të nënshkruarit, ka nderin t’i dërgojë Shkëlqesisë suaj urimet më të mira me rastin e zgjedhjes suaj kryeministër i Lartmadhërisë së saj britanike.*

*Ky popull njëkohësisht kërkon mbrojtjen e lartë të kombit të lavdishëm të Anglisë për çështjen e integritetit të tij territorial, të të drejtave të tij, për të cilat Shqipëria ka bërë përpjekje dhe ka dhënë jetën e saj”*. Nënshkruar dhe vulosur, për Komitetin Shqiptar: Andrea Shiroka, Jovan Musani, Simon Simoni, Daut Efendiu, Selim Efendi Çorba, Sulejman Begu, Haxhi Agë Loha.<sup>20</sup>

Rezistenca e vendosur e shqiptarëve për të mbrojtur tokat e tyre i vë në lëvizje diplomatët austro-hungarezë, të cilët propozojnë alternativa të reja territoriale, të cilat duhej t’i jepen Malit të Zi. Konti austriak Lipich, në vend të Hotit e Grudës propozon kompensimin me zonat midis liqenit të Shkodrës dhe detit (më 1 qershor 1880). Anglia përmes konsullit anglez në Shkodër, Kyrbi Green, propozimi i paraqitet princit të Malit të Zi. Këtë e mbështet edhe Austro-Hungaria. Princi malazez e ka pranuar propozimin e ri.

Divergjencat midis Fuqive të Mëdha janë vënë re edhe me rastin e dorëzimit të Ulqinit nga Turqia, më 26 nëntor 1880.

## Përfundim

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Evropën Juglindore zhvillohet akti i fundit i dramës ballkanike. Kjo është koha kur në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare evropiane shfaqen fuqi të reja, si

<sup>19</sup> Ramiz Abdyli, Libri I, (vepër e përmendur), f. 211. Shkodër, 17 maj 1880.

<sup>20</sup> Po aty, f. 211-212.

Gjermania dhe Italia, me ç'rast "çrregullohen" marrëdhëniet tradicionale evropiane.

Perandoria Osmane, një shtet që e kishte humbur hapin historik me fuqitë tjera, ishte shndërruar në një boshllëk të paqëndrueshëm, i cili do të plotësohej me ndikimet e fuqive tjera.

Rusia, duke i shfrytëzuar shtetet e vogla sllave ballkanike, përpiquej ta plotësojë këtë boshllëk në Ballkan, pra, ta zëvendësojë Perandorinë Osmane. Ambiciet e Rusisë shkaktuan të ashtuquajturën "Krizë Lindore", e cila zë fill me kryengritjen në Bosnjë-Hercegovinë për të vazhduar me luftëra, në të cilat hynë edhe vetë Rusia. E gjunjëzuar ushtarakisht, Perandoria Osmane i pranoi të gjitha kushtet e Rusisë, në Shën Stefan. Mirëpo, fuqitë tjera evropiane nuk e pranuan Marrëveshjen e Shën Stefanit, për shkak se drejtpërdrejt rrezikoheshin interesat e tyre.

Marrëveshjet politike, si ajo e Shën Stefanit, ashtu dhe e Berlinit, kësaj radhe i rrezikonin trojet shqiptare që ndodheshin nën administrimin osman.

Duke e ndjerë rrezikun e madh për tokat shqiptare, rilindësit shqiptarë të kohës, pas një sundimi të gjatë osman, përpiqen të organizojnë potencialet e ndërgjegjshme kombëtare shqiptare, duke formuar një organizatë politike dhe ushtarake për t'u dalë zot tokave, të cilat rrezikoheshin nga fqinjët. Me nismën e tyre, më 10 qershor 1878, tre ditë para mbajtjes së Kongresit të Berlinit, në Prizren u mbledh një Kuvend me rëndësi jetike për kombin shqiptar, në të cilin është formuar Lidhja Shqiptare, si një organizatë politike, e cila do ta drejtojë kauzën historike shqiptare.

Misioni i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte i trefishtë: të zgjojë ndërgjegjen e fjetur të shqiptarët; të imponohet si faktor politik tek Fuqitë e Mëdha, duke ia marrë të drejtën Perandorisë Osmane; t'i përfaqësojë shqiptarët dhe t'i mbrojë me armë trojet etnike, të cilat Kongresi i Berlinit ua kishte ndarë shteteve fqinje ballkanike.

Është për t'u theksuar se, në Kongresin e Berlinit, Fuqitë e Mëdha kanë sjellë vendime unanime, mirëpo kjo nuk do të thotë se ato ishin unike në shumë çështje. Përkundrazi, midis Fuqive të Mëdha ekzistonin mospajtime dhe kundërtënie, të cilat në rrethana tjera historike do të mund të shfrytëzohen për arritjen e qëllimeve kombëtare.

Në kohën e ngjarjeve vendimtare për të ardhmen e kombit shqiptar, Lidhja Shqiptare e Prizrenit duhej të përballlet me:

- Qeverinë osmane, e cila pas humbjes së rëndë që kishte pësuar në luftë me Rusinë, synonte ta shfrytëzojë energjinë kombëtare të Lidhjes Shqiptare për interesa të saj;

- fqinjët grabitqarë, të cilët pasi i kishin arritur objektivat e tyre në Kongresin e Berlinit (ishin njohur si shtete të pavarura), përpiqeshin t'i vënë në jetë vendimet, rreth përfitimeve territoriale, të cilat nuk ishin asgjë tjetër përpos toka shqiptare;

- propagandën e fqinjëve dhe të Rusisë cariste, për ta prezantuar Lidhjen Shqiptare si një organizatë e krijuar nga vetë Qeveria osmane;

- Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në krye me Abdyl Frashërin, si një nga figurat më të spikatura kombëtare të idesë kombëtare, akoma nuk mund t'i shfrytëzonte të gjitha kapacitetet kombëtare të shqiptarëve, për shkak të ndërgjegjes së ulët tek shqiptarët, e cila ishte në pragun e zgjimit.



**Sali KADRIA**

## **REGJISTRIMI I POPULLSISË GJATË VITIT 1918 NË TERRITORIN E SHQIPËRISË, TË OKUPUAR NGA AUTORITETET AUSTRO-HUNGAREZE**

Pas hyrjes së trupave austro-hungareze në Shqipëri, në janar të vitit 1916, ato okupuan territorin e saj deri në vijën e lumit Vjosa, liqeni i Ohrit në Jug, duke zotëruar kështu më tepër se dy të tretat e territorit të shtetit shqiptar<sup>1</sup>. Autoritetet drejtuese të Monarkisë Habsburge vendosën të merreshin me procesin e regjistrimit të popullsisë në territorin e Shqipërisë, që mbahej prej tyre. Regjistrimi i popullsisë së Shqipërisë u duhej autoriteteve austro-hungareze jo vetëm për qëllime ushtarake, por edhe për forcimin e administratës civile.

Në vitin 2001, një grup studiuesish publikoi përfundimet e projektit kërkimor: “Regjistrimi i popullsisë së Shqipërisë i vitit 1918: hedhja e të dhënave dhe analizat kryesore”<sup>2</sup>. Studiuesit e përfshirë në këtë projekt synonin që regjistrimin e popullsisë së Shqipërisë të vitit 1918, ta bënin të disponueshëm për kërkimet e mëtejshme shkencore<sup>3</sup>. Ky studim me rëndësi shkencore u fokusua më tepër në kuadrin e analizës së

---

<sup>1</sup>Peter Bartl, *Shqiptarët: nga Mesjeta deri në ditët tona*, përkthyer nga Afrim Koçi, Tiranë: “Instituti i Dialogut & Komunikimit”, 2017, f. 178.

<sup>2</sup><http://www-gewi.uni-graz.at/seiner/albanisch/index.html> (Shikuar, më 15 korrik 2020).

<sup>3</sup>Ky projekt kërkimor u subvencionua nga Fondi Austriak për Nxitjen e Kërkimeve Shkencore (Fondsur Förderung der Wissenschaftlichen Forschung). Drejtuesit e projektit ishin: Helmut Eberhart, profesor në Departamentin e Etnologjisë Evropiane dhe Antropologjisë Kulturore, në Universitetin Graz - Austri; Karl Kaser, profesor në Departamentin e Historisë së Evropës Juglindore, në Universitetin Graz - Austri; Ndihmës për kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave ishin: Siegfried Gruber, kërkues shkencor në Departamentin e Historisë së Evropës Juglindore, në Universitetin Graz - Austri; Gentiana Kera, kërkuese shkencore në Departamentin e Historisë së Evropës Juglindore, në Universitetin Graz - Austri; Enriketa Papa, kërkuese shkencore në Departamentin e Historisë së Evropës Juglindore, në Universitetin Graz - Austri.

gjendjes social-demografike, ekonomike dhe kulturore të popullsisë shqiptare të asaj periudhe. Prandaj, në këtë artikull shkencor, ne do të përqendrohemi kryesisht në rrethanat historike, problemet e ndeshura para, gjatë dhe në përfundim të procesit të regjistrimit, si dhe në analizën e disa prej rezultateve që dolën nga ky regjistrim, por që paraqesin interes për historinë e Shqipërisë të viteve 1916-1918.

Sipas të dhënave që dispononin autoritetet civile austro-hungareze, thuhej se deri në vendosjen e trupave të Monarkisë Habsburge në Shqipëri, për popullsinë e këtij vendi nuk kishte të dhëna statistikore të sakta. Deri në vitin 1912, administrata osmane u përpoq disa herë që të realizonte numërimin e popullsisë në disa qytete dhe kaza të këtij vendi, por këto përpjekje rezultuan të pasuksesshme. Që në fillim të këtij projekti, shfaqeshin probleme të ndryshme, të cilat pengonin realizimin e numërimit të popullsisë në viset shqiptare. Më vonë, administrata osmane provoi që në disa vise shqiptare të realizonte të paktën regjistrimin e shtëpive të këtij vendi, për të nxjerrë me përafërsi numrin e popullsisë së viseve të banuara nga shqiptarët. Mirëpo, edhe këto përpjekje nuk patën sukses, pasi zyrtarët osmanë nuk kishin aftësitë e duhura për realizimin e një projekti të kësaj natyre. Para fillimit të Luftës së Parë Ballkanike, shteti osman provoi që të nxirrte numrin e njerëzve të aftë për luftë e për shërbime të tjera ushtarake. Qeveria osmane u përpoq të forconte zyrat e nefuzëve [fjala nüfuz, rrjedh nga gjuhët arabo-perse, e cila do të thotë ndikim, autoritet, fuqi dhe depërtim - S. Kadria], por u pa qartë se edhe shënimet e këtyre zyrave, nuk mund të përdroreshin për qëllime statistikore<sup>3</sup>.

Konsullatat e Fuqive të Mëdha evropiane në Shkodër, Durrës, Vlorë, Manastir dhe ndonjë qytet tjetër, dispononin të dhëna statistikore fragmentare për popullsinë e viseve shqiptare, por ato mbeteshin të kufizuara vetëm brenda territorit, të cilin e mbulonin këto zyra konsullore. Edhe kleri katolik dispononte të dhëna në lidhje me popullsinë e disa krahinave shqiptare që i përkiste këtij besimi fetar. Gjithashtu, edhe disa udhëtarë evropianë kishin mbajtur shënime në lidhje me popullsinë shqiptare, por ato jo gjithmonë mbështeteshin në të dhëna të besueshme<sup>4</sup>.

Mbështetur në të dhënat e mbledhura nga burime të huaja, mendohej se në prag të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, popullsia

<sup>3</sup>Franz Seiner, *Numrim i parë i popullsis në Shqypni*, nxjerrë prej “Hyllit të Dritës” të vjetës 1922-1923, Shkodër: “Shtypshkroja Franciskane”, 1922, f. 3.

<sup>4</sup>*Po aty*.

etnike shqiptare në katër vilajetet osmane, të banuara kryesisht nga shqiptarët, përllogaritej afërsisht në 1 milion e 500 mijë deri në 1 milion e 600 mijë banorë. Numri i banorëve të vilajetit të Shkodrës arrinte afërsisht në 237 mijë banorë, ndërsa ai i vilajetit të Janinës arrinte në 552 mijë banorë. Numri i popullsisë sipas qyteteve paraqitej i tillë: qyteti më i madh shqiptar ishte Shkodra, me një popullsi që arrinte në 32 mijë banorë; qyteti i dytë më i madh shqiptar renditej Prizreni, me 30 mijë banorë; qyteti i tretë më i madh ishte Janina ose siç cilësohej “kryeqyteti i Shqipërisë së Jugut” me 22 mijë banorë. Ndërkaq, qytetet e tjera që vinin në radhë për nga numri i popullsisë ishin: Korça me 20 mijë banorë; Dibra, Peja, Berati me nga 15 mijë banorë secila. Gjakova, Tirana me nga 12 mijë banorë; Prishtina, Ohri dhe Gjirokastra me nga 11 mijë banorë; Elbasani ishte me 8 mijë banorë, Mitrovica kishte 7 mijë e 500 banorë, Preveza kishte 6 mijë e 500 banorë, Vlora kishte 6 mijë banorë, Durrësi, Parga dhe Kruja kishin nga 5 mijë banorë secila, ndërsa Butrinti [Saranda ose Delvina - S. Kadria] kishte 2 mijë banorë<sup>5</sup>.

Qeveria austro-hungareze ishte e interesuar të dispononte të dhëna të sakta në lidhje me numrin e përgjithshëm të popullsisë në Shqipëri dhe për viset e tjera etnike shqiptare. Mbështetur në statistikën osmane të vitit 1902, Alfred von Rappaport, i cili mbante detyrën e konsullit të përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, shkruante se, në të gjitha viset në lindje të shtetit shqiptar, për të cilat kishte pretendime Bullgaria, rreth 75 për qind e numrit të përgjithshëm të popullsisë së këtyre viseve, përbëhej nga shqiptarë myslimanë, ndërkohë që 3 për qind ishin shqiptarë katolikë. Nga popullsitë e tjera që banonin në këto territore thuhej se, 17 për qind ishin serbë, 5 për qind ishin turq, jevgjit, emigrantë dhe vllahë<sup>6</sup>.

Në mars të vitit 1916, autoritetet ushtarake austro-hungareze në Shqipëri, nxorën një njoftim, për lehtësimin e procesit të regjistrimit të popullsisë. Sipas këtij njoftimi, kërkohej që t’u viheshin emra shqip disa vendeve shqiptare, të cilat mbanin emërtime në gjuhën italiane, si:

<sup>5</sup>“Shënime të shkurtera mi Shqipërinë”, përkthyer prej P. V. Kolonia, në *Përparimi*, nr. 1, New York, qershor-korrik 1918, f. 19-20.

<sup>6</sup>Haus - Hof und StaatsArchiv, Wien Politisches Archiv Albanien, (më tej: *HHStA, PA, A*), në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë (më tej: *AIH*), Vj. 26-16-1668, Projektligji nr. 62, i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, Alfred von Rappaport, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vjenë, 22 janar 1916.

“Skutari - Shkodrë, Bojana - Bunë, San Giovanni di Medua - Shënjn, Alessio - Lesh, Durazzo - Durrc, Valona - Vlorë”<sup>7</sup>.

Më 19 mars 1916, autoritetet ushtarake austro-hungareze në Shqipëri, ngarkuan Zyrën e Prapavijës Ushtarake pranë Korpuskomandës XIX me qendër në Shkodër, që të nxirrte numrin e shtëpive, bagëtime dhe mjeteve të jetesës së banorëve<sup>8</sup>. Në maj të vitit 1916, u fillua me procesin e regjistrimit provizor të popullsisë, gjësë së gjallë, si dhe studimin e rezervave ushqimore në qytetin e Shkodrës. Në fund të muajit maj 1916, u realizua numërimi i planifikuar, ndërsa në muajt gusht dhe shtator të këtij viti, u krye një provë tjetër me disa shtojca në fletët e regjistrimit, për numërimin e popullsisë dhe nxjerrjen e numrit të bagëtime në Shkodër dhe rrethet e tjera të okupuara të Shqipërisë<sup>9</sup>.

Në fund të muajit tetor 1916, komisari civil austro-hungarez, August Rittervon Kral, njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë se, sapo kishte përfunduar regjistrimi i parashikuar i popullsisë në disa rrethe të Shqipërisë. Sipas këtij informacioni, rrethi i Dibrës i ishte bashkuar procesit të numërimit të popullsisë, pasi deri në këtë periudhë ai kishte mbetur i përjashtuar. Në përfundim të numërimit rezultonte se ky rreth kishte 72 618 banorë<sup>10</sup>.

Po çfarë rezultati nxori procesi i numërimit të popullsisë dhe pasurisë së shqiptarëve në vitin 1916? Përfundimi i numërimit nuk nxori shifra të sakta. Shkaqet kryesore të këtij dështimi ishin: *së pari*, mjetet logjistike për realizimin e këtij projekti ishin të pamjaftueshme; *së dyti*, përfundimi i këtij projekti dëshmoi se autoritetet austro-hungareze nuk kishin bërë përgatitjet e nevojshme për realizimin e regjistrimit të popullsisë së Shqipërisë të okupuar nga trupat e Monarkisë Dualiste; *së treti*, për realizimin e këtij procesi të vështirë, nuk ishin përzgjedhur njerëzit e duhur, të cilët duhej të zotëronin njohuritë dhe kompetencat e

<sup>7</sup>“Për Shqypëni e Shqypëtarë - Emnashqyp për vënde të Shqypënisë”, në *Vëllazënia*, nr. 6, Vjenë 27 mars 1916, f. 2.

<sup>8</sup>Eugen M. Oberhummer, “Dieerste Volkszählung in Albanien”, in: *Anzeiger der phil.-hist. Klasse der Akademie der Wissenschaften in Wien vom 19 November* (Jahrg. 1920, Nr. XXI), p. 2.

<sup>9</sup>Enriketa Pandejmoni (Papa), “Franz Seiner dhe regjistrimi i popullsisë në Shqipëri gjatë Luftës së Parë Botërore 1916-1918” në *Austro-Hungaria dhe Shqipëria 1916-1918*, përmbledhje e akteve të Konferencës shkencore: “Austro-Hungaria dhe Shqipëria në vitet 1916-1918”, mbajtur në Tiranë më 26-27 janar 2018, botim i Muzeut Historik Kombëtar - Tiranë, Tiranë: “KRISTALINA-KH”, 2019, f. 134.

<sup>10</sup>*HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-15-1596, Shkresë rezervate nr. 1064 P. e konsullit të përgjithshëm austro-hungarez A. Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 25 tetor 1916.*



nevojshme për zbatimin e detyrave të ngarkuara. Për shkak të lartpërmendura, numërimi i popullsisë dhe pasurisë në Shqipëri, në vitin 1916, u shoqërua me mungesa dhe gabime.

Pas shqyrtimit që u bëri të dhënave të mbledhura nga terreni gjatë vitit 1916, eksperti i njohur austro-hungarez në fushën topografike të regjistrimit dhe statistikës, Franz Seiner, arriti në përfundimin se lënda statistikore e mbledhur gjatë vitit 1916 ishte e pasaktë. Sipas tij, ndër problemet kryesore ishin: 1. Të dhënat e mbledhura në terren nuk ishin verifikuar dhe kontrolluar në mënyrën e duhur; 2. Statistikat e paraqitura nuk kishin pasqyrim të emrave të vendeve ose nëse disa prej tyre përmbanin emrat e vendeve, ato nuk mund të përdreshin sepse kishin gabime; 3. Për shkak të vështirësisë së shkrimit të gjuhës shqipe nga ana e nëpunësve, emrat e njerëzve dhe të vendeve ishin shënuar me gabime. Megjithë problemet e mësipërme, F. Seiner shkruante se, ky numërim dha një ndihmesë të madhe për administrimin e vendit nga autoritetet austro-hungareze në periudhën e mëvonshme. Gjithashtu, materiali i mbledhur gjatë vitit 1916, shërbeu si bazë për kërkimet e mëtejshme statistikore për popullsinë e Shqipërisë.

Në pranverë të vitit 1917, autoritetet austro-hungareze mendonin që të kryenin një proces të ri regjistrimi të popullsisë në territorin e Shqipërisë të okupuar prej tyre. Në mars të vitit 1917, në krye të kësaj detyre u ngarkua Franz Seiner, që mbante detyrën e referentit të Zyrës së Statistikës së Vendlut (Shqipërisë). F. Seiner kishte qenë për herë të parë në Shqipëri në vitin 1914, i kontraktuar nga Komisioni për Shqipërinë pranë Akademisë së Shkencave në Vjenë, në një ekspeditë kërkimore për realizimin e matjeve hartografike si dhe për të pasqyruar në harta zonën nga bregdeti i Durrësit deri në lumenjtë Drini i Zi, Mat dhe Shkumbin. Kjo ekspeditë kishte për qëllim t'i hapte rrugë kërkimeve të tjera me karakter gjeografik, botanik, zoologjik, etnografik dhe antropologjik<sup>11</sup>. Me gjithë vështirësitë e ndeshura në Shqipëri, për shkak të ngjarjeve të vitit 1914, ai e realizoi me sukses këtë detyrë.

Në muajin prill 1917, autoritetet ushtarake austro-hungareze nxorën një urdhër tjetër, sipas të cilit, vendeve shqiptare do t'u vireshin emra në gjuhën shqipe, si: "Skutari -Shkodër, Dulcigno - Ulqin, Klementi - Kelmend, Ipek - Pejë, San Giovanni di Medua - Shënjin, Alessio - Lesh,

<sup>11</sup>E. Pandejmonj (Papa), "Franz Seiner dhe regjistrimi i popullsisë në Shqipëri gjatë Luftës së Parë Botërore 1916-1918" në *Austro-Hungaria dhe Shqipëria, 1916-1918*, f. 137.

Bojana - Bunë, Durazzo -Durrc, SassoBianco - Shkami i Kavajës, Valona - Vlorë dhe Saseno - Sazan”<sup>12</sup>.

Në fund të muajit maj 1917, komisari civil A. Kral, i raportonte Vjenës lidhur me përgatitjet e bëra, për fillimin e procesit të regjistrimit të popullsisë në territorin e Shqipërisë, që ndodhej nën okupimin e trupave austro-hungareze. Sektori i Statistikës pranë Zyrës së Prapavijës i drejtuar nga Franz Seinerq vepronte nën autoritetin e Korpuskomandës XIX të Ushtrisë austro-hungareze, kishte përcaktuar kritere të qarta për realizimin e regjistrimit të popullsisë. Kjo zyrë do të konsideronte të vlefshme, kombësinë e banorëve të regjistruar, mbështetur në atë se çfarë deklaronte çdo personi pyetur nga nëpunësit e angazhuar në fushatën e regjistrimit. Specialistët austro-hungarezë mendonin se vështirësia më e madhe parashikohej për rastet kur regjistruesit do të ndesheshin me problemin e identifikimit të banorëve shqiptarë dhe banorëve sllavë myslimanë. Sipas tyre, kishte raste, kur këto dy grupe të popullsisë nuk arrinin të bënin dallimin e qartë midis kombësisë dhe besimit fetar, e për rrjedhojë e quanin veten thjesht “turq”. Në rastet e pakicave të huaja, organeve të regjistrimit u ishte ngarkuar si detyrë që të konstatojnë gjuhën e folur nga ana e banorëve dhe të mbanin shënime të sakta nëse ata flisnin gjuhën serbe, bullgare apo bullgarishten maqedonase. Regjistruesit duhej të përcaktonin kombësinë e këtyre banorëve duke u mbështetur në kriterin e gjuhës së folur prej tyre. Personat e ngarkuar me procesin e regjistrimit, ishin porositur nga organet e prokurorisë, që të tregonin një kujdes të posaçëm për regjistrimin e saktë të popullsisë vlllehe dhe asaj jevge në territorin e Shqipërisë, që ishte nën kontrollin e trupave austro-hungareze. Autoritetet e Monarkisë Dualiste theksonin se gjatë regjistrimit duhej të mbahej parasysh fakti se, popullsia vlllehe njihej nga shqiptarët edhe me emërtime të tjera, si zinzarë (xinxarë) dhe arumunë. Ndërkaq, jevgjit duhej të cilësoheshin gjithnjë si të tillë, edhe në qoftë se gjuha e tyre e folur ishte shqipja<sup>13</sup>.

Më 21 qershor 1917, Korpuskomanda XIX e trupave ushtarake austro-hungareze, përmes një shkrese zyrtare, të nënshkruar nga nënkoloneli Juha (Jucha), urdhëronte Bezirkkomandat dhe zyrat e

<sup>12</sup>“Përdorimi i emrave të përparshëm të Shqypnië”, në *Posta e Shqypniet*, nr. 34, Shkodër, 4 prill 1917, f. 2.

<sup>13</sup>*HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-6-690, Raport nr. 127/ P. 6062 i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 27 maj 1917; Po aty, Vj. 28-8-826, Raport i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez, Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 27 maj 1917.*

administratës shqiptare që vareshin prej saj, që të fillonin përgatitjet për regjistrimin e shtëpive të banorëve në të gjitha viset e Shqipërisë që ndodheshin nën juridiksionin e tyre. Sipas këtij urdhri, kërkohej që secila njësi ushtarake-administrative t'u vinte nga një numër të gjithë shtëpive të rrethit të cilin e mbulonin, si dhe të plotësonte numërimin për ato vende në të cilat regjistrimi ishte bërë më herët. Krahës procesit të numërimit të shtëpive, do të duhej të bëhej edhe regjistrimi i saktë i secilës shtëpi të banuar. Autoritetet austro-hungareze kërkonin që ky proces duhej të shtrihej edhe në kasollet, stanet dhe shatorët (çadtrat) e pakicave të popullsisë nomade siç ishin jevgjit që banonin përkohësisht në një vend të caktuar. Numërimi duhej të vijonte në të gjithë territorin, madje edhe në male, ku gjendeshin grumbuj kasollesh e stanesh të barinjve.

Një çështje që kërkonte zgjidhje ishte mënyra e vendosjes së emrave të familjeve dhe të emrave të parë të njerëzve. Deri në këtë periudhë, shumica e banorëve të viseve shqiptare përdorte vetëm emrat e parë, por për qëllime dallimi nga njëri-tjetri ata u shtonin emrave të tyre emrat e babait dhe të gjyshit në linjë atërore. Kryefamiljarët u lanë të lirë të zgjidhnin emrat e tyre. Vetëm në raste të veçanta, emri u zgjodh nga administrata austro-hungareze dhe ajo shqiptare. Udhëzimet për zbatimin e këtij procesi u përpunuan nga studiuesi i gjuhës shqipe, Maximilian Lambertz<sup>14</sup>.

Problem tjetër, ishte përcaktimi i vendbanimeve dhe rregullimi i kufijve të fshatrave, si dhe mënyra se si duhej të shkruheshin e regjistroheshin emrat e fshatrave. Për më tepër, emra mbanin vetëm lagjet (mëhallët) e fshatrave, ndërkohë që mjaft prej fshatrave nuk kishin një emërtim të veçantë. Për zgjidhjen e këtij problemi, u krijua "Komsia letrare" në Shkodër, e cila hartoi udhëzimet e duhura për mënyrën se si duhej të caktoheshin emërtimet e vendeve të Shqipërisë<sup>15</sup>.

Për këtë qëllim, u krijua një indeks i fshatrave, qyteteve dhe i qyteteve me rreth 1 800 hyrje. Në hyrje të rrugëve, regjistruarit vendosën tabela me emrat e tyre. Më 26 maj 1917, autoritetet austro-hungareze nxorën një urdhër, me qëllim që popullsia të njihej me procedurën e regjistrimit, por edhe për të bindur njerëzit të raportonin numrin e

<sup>14</sup>Franz Seiner, *Ergebnisseder Volkszählung in Albanien in dem vondenösterr-ungar. Truppen 1916-1918 besetzten Gebiete*, (Akademie der Wissenschaften in Wien, Schriftender Balkankommission, Linguistische Abteilung XIII). Wien und Leipzig: Hölder-Pichler-Tempsky A.-G., 1922, p. 4.

<sup>15</sup>F. Seiner, *Ergebnisseder Volkszählung in Albanien in dem vondenösterr-ungar. Truppen 1916-1918 besetzten Gebiete*, p. 2.

fëmijëve të tyre (zakonisht të femrave), meqë shpërndarja e furnizimeve të nevojshme ushqimore do të mbështetej në të dhënat e regjistrimit të popullsisë<sup>16</sup>.

Me të dhënat e mbledhura nga nëpunësit e ngarkuar me këtë detyrë, listat e numërimit hartoheshin në dy kopje dhe i dërgoheshin bezirskomandës përkatëse. Gjatë plotësimit të statistikave, regjistruesit ishin porositur që të shihnin me kujdes nëse një shtëpi ose pronë kishte një apo më tepër pronarë. Të gjithë pronarët dhe bashkëpronarët e një prone të caktuar, duhej të përfshiheshin në regjistrim. E njëjta procedurë ishte parashikuar të zbatohet edhe për çiftinjtë, të cilët kishin blerë ndonjë copë toke [në mënyrë fiktive - S. Kadria] nga pronarët. Me sa duket, për ndjekjen e kësaj procedure, autoritetet austro-hungareze mbanin parasysh faktin se pavarësisht “lojërave” me titullin e pronësisë që bënin pronarët, ata vazhdonin ende të ruanin “de facto” pronësinë dhe vijonin të mbeteshin në krye të pronave të tyre. Ekspertët austro-hungarezë theksonin se sipas përkufizimit që jepte shkenca e statistikës, me termin kryefamiljar do të kuptohej një person, i cili ose e cila arrinte të mbante veten dhe familjen e tij. Pjesëtarë të familjes quheshin personat, të cilët nuk arrinin të mbanin vetë veten e tyre. Autoritetet austro-hungareze kërkonin që në kolonën në të cilën mbante emërtesën “Shtëpi të rrënuara”, duhej të shënohej nëse ato ishin rrënuar nga forcat serbe, esadistët, epirotët apo të tjerë.

Në mbarim të këtij procesi, oficerët austro-hungarezë dhe nëpunësit e administratës vendore shqiptare pranë çdo bezirskomande të angazhuar në këtë proces, duhej t’i shqyrtonin të gjitha listat e regjistrimit, që u kishin ardhur nga zyrat vartëse. Ato duhej të përcaktonin nëse këto statistika ishin të sakta dhe të lexueshme. Listat e hartuara duheshin të korrigjoheshin gabimet dhe të plotësoheshin mangësitë. Sipas procedurës së hartuar paraprakisht, listat do të renditeshin sipas mydyrjeteve (komunave), të cilat do të hidheshin në një pasqyrë të nënprefekturave. Ajo përmbliidhte shumën e përgjithshme të mydyrjeteve, të cilat do t’i paraqiteshin brenda një afati të shkurtër të bezirskomandës. Kjo e fundit i shqyrtonte me kujdes statistikën dhe nëse gjente gabime dhe mangësi në lista, ajo duhej t’i korrigjonte.

<sup>16</sup>Po aty; Lef Nosi, *Dokumenta historike për t’i shërbye historiës tonë kombëtare*, botim i dytë, përgatitja për botim dhe redaktimi shkencor nga prof. dr. Marenglen Verli dhe prof. dr. Ferit Duka, botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Proklamë e Komandës Mb. e Rr. e të XIX Trup Ushtrie E. V. No. 2485, nënshkruar për komandarin nga Jucha, Obstltm.p., Shkodrë, më 21 qershier 1917, Tiranë: “Nënë Tereza”, 2007, f. 264-266.

Bezirkskomnada hartonte një pasqyrë të përkohshme përmbledhëse, mbështetur në pasqyrat e nënprefekturave, e cila përfshinte të gjithë bezirkun. Ajo ia paraqiste Korpuskomandës XIX pasqyrën në plotësi dhe një kopje të listave të hartuara<sup>17</sup>.

Me ndihmën e listave që mbaheshin pranë bezirkskomandës, mendohej që me kalimin e kohës procesi i numërimit të bëhej gjithnjë e më i saktë. Shifrat në lidhje me shtëpitë dhe tabelat e rrugëve do të mbaheshin me kujdes. Në qoftë se do të kishte ndërtime të reja, atodo të pasqyroheshin në statistika dhe në këtë mënyrë do të plotësohej dhe përmirësohej më tej numërimi. Për realizimin me sukses të kësaj detyre, komanda e trupave austro-hungareze kërkonte që të zgjidheshin njerëz të përshtatshëm dhe të ditur. Numërimi i shtëpive dhe regjistrimi i tyre do të fillonte më 15 korrik 1917, me synimin që ai të përfundonte brenda një periudhe të shkurtër<sup>18</sup>.

Franz Seiner mendonte se gjatë procesit të regjistrimit të vitit 1916 në Shqipëri, kuptimi i fjalës “vend” ishte përdorur në mënyrë të gabuar. Sipas tij, pati disa raste kur rrethi i bashkisë së një vendi që marrë gabimisht për vetë vendin. Për këtë shkak, numri i banorëve në disa vendetë Shqipërisë rezultoi shumë i madh. Gjatë regjistrimit të vitit 1917, komanda e trupave austro-hungareze në Shqipëri kërkonte që t’u shpjegohej organeve të regjistrimit se me fjalën “vend” do të kuptohej një territor i caktuar me një grup shtëpish, i cili njihej si vend me një emërtim të veçantë. Duke pasur parasysh kushtet e Shqipërisë së asaj periudhe, kishte raste kur këto vende përbëheshin nga shtëpitë dhe kasollet ose nga grumbuj shtëpish të shpërndara (lagje e vendit, mëhalla etj.), të cilat në të shumtën e rasteve mbanin emra të veçantë. Autoritetet austro-hungareze theksonin se me fjalën lagje të një vendi (mëhallë) duhej të kuptoheshin dhe shënoheshin ato grupe shtëpish apo qendra të banuara, të cilat ndodheshin në distancë prej qendrës së një vendi dhe mbanin emërtime topografike, por edhe të gjitha krahinat e mëhallët e atij vendi që me kalimin e kohës merrnin emra të veçantë<sup>19</sup>.

Në një raport studimor sekret, të përgatitur gjatë Luftës së Parë Botërore nga Shërbimi i Zbulimit i Admiraliatit të Marinës Ushtarake Angleze, jepej sqarimi i kuptimit të fjalës mëhallë. Sipas këtij studimi,

<sup>17</sup>L. Nosi, *Dokumenta historike për t'i shërbye historiës tonë kombëtare*, Proklamë e Komandës Mb. e Rr. e të XIX Trup Ushtrie E. V. No. 2485, nënshkruar për komandarin nga Jucha, Obstltm.p., Shkodrë, më 21 qershier 1917, f. 264-266.

<sup>18</sup>Po aty.

<sup>19</sup>Po aty.

thuhej se fisi ndahej në mëhalla dhe këto të fundit në shtëpi. Mëhalla ishte një grup shtëpish nganjëherë të grumbulluara me një rrethim të përbashkët, por kishte edhe raste të tjera kur ato ishin të shpërndara, por që banoheshin nga pjesëtarë të së njëjtës familje<sup>20</sup>.

Pothuajse në të gjitha vendet e mëdha, qendrat e tyre mbanin një emër të veçantë që i dallonte prej grupeve të shtëpive që gjendeshin në një rreth të caktuar. Emërtimet e pjesëve të tjera të vendit, zakonisht caktoheshin sipas besimit të banorëve, fisit që u përkisnin, zanatit kryesor për të cilin shquhej popullsia e tyre, kushteve gjeografike si dhe sipas emrave të banorëve të tyre më të njohur. Për ato vende, shtëpitë e të cilave gjendeshin të shpërndara dhe kufiri ndërmjet vendit dhe lagjes së atij vendi nuk ishte i caktuar qartë, caktimi i vijës ndarëse mes tyre lihej përkohësisht në dorën e organeve të ngarkuara me këtë punë. Ndërkohë, për rastet e dyshimta ishte vendosur që të bëheshin shqyrtime të mëtejshme. Autoritetet austro-hungareze u kërkuan organeve të regjistrimit që të mbanin parasysh faktin se kishte disa bashki shqiptare të përbëra prej disa pjesësh, të cilat në mjaft raste nuk kishin lidhje të përbashkëta dhe unike. Kjo gjendje lidhej me dy shkaqe: *së pari*, përbërja e tyre ishte zhvilluar që prej periudhave të hershme; *së dyti*, ato ishin formuar si rrjedhojë e legjislacionit dhe reformave të ndërmarra nga shteti osman në periudha të ndryshme. Listat e emërtimeve të këtyre vendeve do të mbaheshin sipas drejtshkrimit të përcaktuar nga Korpuskomanda e trupave austro-hungareze në Shqipëri dhe kjo do të mbetej në fuqi, derisa ajo të caktonte një drejtshkrim tjetër të gjuhës shqipe<sup>21</sup>. Gjatë vitit 1917, administrata ushtarake austro-hungareze në Shqipëri, arriti të përfundonte regjistrimin e një pjese të konsiderueshme të pasurisë së banorëve të Shqipërisë, por ky regjistrim nuk u konsiderua i plotë dhe i saktë.

Më 10 janar 1918, Korpuskomanda XIX e trupave austro-hungareze në Shqipëri urdhëroi që të merreshin masat e duhura, në mënyrë që më datë 1 mars 1918, të fillonte procesi i regjistrimit të popullsisë në territorin e kontrolluar prej saj<sup>22</sup>. Në krye të kësaj detyre u ngarkua drejtuesi i Zyrës së Statistikës së Vëndit (Shqipërisë), Franz

<sup>20</sup>Personazhet kryesore të Shqipërisë - vendet, fiset, populli gjatë Luftës së Parë Botërore, Raport sekret i Shërbimit të Zbulimit të Admiraliatit të Marinës Ushtarake Angleze, përkthyer nga Piro Misha, Tiranë: Botimet IDK, 2016, f. 28.

<sup>21</sup>L. Nosi, *Dokumenta historike për t'i shërbye historiës tonë kombëtare*, Proklamë e Komandës Mb. e Rr. e të XIX Trup Ushtrie E. V. No. 2485, nënshkruar për komandarin nga Jucha, Obstltm.p., Shkodrë, më 21 qershier 1917, f. 264-266.

<sup>22</sup>F. Seiner, *Numrim i parë i popullsis në Shqypni*, f. 9.

Seiner. Vendimi për fillimin e procesit të regjistrimit të saktë të popullsisë shqiptare ndikoi në faktin që pranë administratës së prapavijës të formohej një zyrë statistikore me dy degë: njëra degë e kësaj zyre kryente shërbime për qëllime ushtarake, ndërsa tjetra punonte për hartimin e statistikave për vendin. Që nga kjo periudhë, prefektët dhe nënprefektët u ngarkuan me detyrën e mbajtjes së të dhënave kryesisht për rastet e lindjeve, të vdekjeve dhe të martesave, në njësitë administrative që drejtonin. Ndërkaq, klerikët u ngarkuan me detyrën që për çdo muaj të mbanin dhe të paraqisnin te drejtuesit e komunave, të fshatrave dhe të lagjeve të qyteteve, të dhënat në lidhje me rastet e lindjeve dhe të vdekjeve për zonën që ata mbulonin. Ndërsa, kryetarët e komunave dhe drejtuesit e lagjeve duhej që për çdo muaj t'i dërgonin këto të dhëna pranë zyrës së bashkisë së qyteteve të tyre<sup>23</sup>.

Data 1 mars 1918 u zgjodh qëllimisht për fillimin e procesit të regjistrimit të popullsisë, pasi në fund të muajit mars ose në fillim të prillit, mjaft familje shqiptare largoheshin nga fshatrat e tyre për në kullotat malore verore, ku kalonin atje të paktën gjysmën e vitit. Në çdo vend u emërua nga një “komisoner regjistrimi”. Komisioneri i regjistrimit mund të ishte pjesë e trupave okupuese ose një oficer ushtarak shqiptar. Ata ishin të mbikëqyrur nga komisarë të rrethit dhe të qarkut (bezirkut). Shumica e komisonerëve u trajnuan personalisht nga F. Seiner. Formularët e regjistrimit me 24 kolonat e tyre, u hartuan në gjuhën gjermane dhe shqipe, në mënyrë që të dhënat të plotësoheshin në mënyrë sa më të lehtë. Drejtuesit e fshatrave ishin të detyruar të korrigjonin të dhënat e rreme që jepeshin nga kryefamiljarët<sup>24</sup>.

Në pranverë të vitit 1918, studiuesi dr. Eugen Oberhammer, zhvilloi një ekspeditë studimore në viset shqiptare<sup>25</sup>. Për realizimin e një numërimi të saktë të popullsisë së Shqipërisë që gjendej nën okupimin e trupave austro-hungareze, u tregua kujdes që të regjistroheshin në mënyrë të saktë jo vetëm banorët që ndodheshin në momentin e regjistrimit në vendbanime, por edhe ata që ishin larguar përkohësisht prej tyre. Gjatë zbatimit të kësaj detyre, nëpunësit e angazhuar ndeshën dy probleme kryesore: së pari, meshkujt shqiptarë nuk dëshironin t'i nënshtroheshin procesit të regjistrimit, pasi mendonin se ai kishte për

<sup>23</sup>HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-3-396, Aneks i relacionit me nr. 137/P., drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 9 qershor 1918.

<sup>24</sup>F. Seiner, *Ergebnisseder Volkszählung in Albanien in dem vondenösterr-ungar. Truppen 1916-1918 besetzten Gebiete*, p. 2-5.

<sup>25</sup>Fitim Rifati, *Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore, 1914-1918*, botim i Institutit të Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, Prishtinë: 2019, f. 221-222.

qëllim realizimin e një rekrutimi të plotë ushtarak të shqiptarëve nga autoritetet austro-hungareze; së dyti, për shkak të veçorisë së fanatizmit që vijonte të ishte ende i pranishëm në mesin e shqiptarëve, këtyre të fundit nuk u pëlqente të paraqisnin për regjistrim femrat që ishin pjesë e familjeve të tyre. Prandaj, oficerët austro-hungarezë të ngarkuar me këtë detyrë, zhvilluan një veprimtari të gjerë propagandistike me popullsinë e painformuar shqiptare<sup>26</sup>.

Autoritetet austro-hungareze arritën të realizonin regjistrimin e popullsisë së Shqipërisë edhe në zonat malore të vendit, në të cilat deri në këtë periudhë nuk ishte kryer asnjëherë një regjistrim i tillë. Kjo shënonte një përparim të rëndësishëm për Shqipërinë<sup>27</sup>. Ky projekt i rëndësishëm përfundoi në fund të muajit shtator 1918, pasi ishin rishikuar të dhënat e përfundimet. Në fund të muajit shtator 1918, Zyra e Statistikës në Shkodër, ndërpreu procesin e përpunimit të të dhënave, pasi Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë austro-hungareze urdhëroi fillimin e tërheqjes së trupave austro-hungareze në vijën Shkodër-Pejë, mbrojtja e së cilës iu ngarkua gjeneral-kolonelit, Von Pfancer Baltin. Në tekstin e këtij urdhri thuhej se, duke marrë parasysh gjendjen e përgjithshme, shtrohej nevoja e marrjes së këtyre masave: asgjësimi i dokumenteve jo shumë të rëndësishme brenda një kohe të shkurtër, shkurtimi i administratës së prapavijës ushtarake në Shqipëri, largimi i forcave ndihmëse, grave të ushtarakëve, klerikëve dhe nëpunësve austro-hungarezë, largimi i menjëhershëm nga Shqipëria i materialeve arkivore austro-hungareze<sup>28</sup>.

Me qëllim që t'i ruante divizionet austro-hungareze si njësi të organizuara, pas humbjes që pësuan në frontin e luftës në Maqedoni, gjeneral-koloneli austro-hungarez Von Pfancer-Baltin, urdhëroi tërheqjen graduale të trupave habsburge nga Shqipëria. Megjithatë transportimi i materialit të regjistrimit të popullsisë së Shqipërisë për në Vjenë, ishte mjaft i vështirë, autoritetet ushtarake austro-hungareze ranë dakord për t'ia dorëzuar të gjithë materialin Akademisë së Shkencave të Austrisë, së bashku me autorizimin për të punuar me të dhe për të publikuar rezultatet

<sup>26</sup>F. Seiner, *Numrim i parë i popullsisë në Shqipëri*, f. 10.

<sup>27</sup>HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-16-1601, Raporti i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez, Kral, drejtuar baronit Burian, ministër i Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 16 nëntor 1916.

<sup>28</sup>HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-2-223, Telegram shifër nr. 102 P. i konsullit Lejhanec, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 27 shtator 1918; *Po aty*, Vj. 28-2-222, Telegram shifër nr. 74 i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, drejtuar konsullit Lejhanec në Shkodër dhe telegrami tjetër i MPJ-së nr. 335, drejtuar kontit Trautmansdorf në Baden, Vjenë, 29 shtator 1918.



e tij. Më 5 nëntor 1918, pak kohë përpara se të nënshkruhej marrëveshja e armëpushimit, Ushtria austro-hungareze liroi Shkodrën, qytetin e fundit të Shqipërisë<sup>29</sup>.

Procesi i numërimit dhe regjistrimit të popullsisë në viset e Shqipërisë që gjendeshin nën okupimin austro-hungarez u zhvillua në mënyrë të rregullt, nëse mbahen parasysh kushtet e vështira të asaj periudhe lufte. Problemet më të mëdha gjatë procesit të regjistrimit u shfaqën në qarkun (bezirkun) e Beratit. Në përfundim të procesit të regjistrimit të popullsisë së Shqipërisë, mungonte materiali për bezirkun e Beratit, i cili përfshinte rrethin (Kreis)e Beratit, të Fierit, të Lushnjës dhe të Skraparit, të cilat kishin një popullsi prej 89 142 banorësh<sup>30</sup>. Nëatë periudhë, qarkulloi mendimi se i gjithë materiali dokumentar, nga ana e bezirkeve (qarqeve) të tjerë të vendit vetëm ai i Beratit u neglizhua. Në të vërtetë, shkaku i mos regjistrimit të popullsisë që ishin pjesë e bezirkut të Beratit me një popullsi prej 89 142 banorësh, lidhej me veprimin e papërgjegjshëm të një oficeri sllav, i cili e dogji të gjithë materialin e mbledhur statistikor për bezirkun e Beratit<sup>31</sup>.

Drejtuesit ushtarakë ishin përpjekur që t'ia hidhnin përgjegjësinë komisarit civil, Kral, për mosrealizimin e regjistrimit të popullsisë në këtë qark. Komisari civil, A. Kral, informonte komandantin e Korpusit XIX të trupave austro-hungareze me qendër në Shkodër se, këto probleme kishin ndodhur për shkak të mungesës së oficerëve austro-hungarezë në këtë bezirk. Kral bënte me dije se Zyra e Prapavijës së Ushtrisë austro-hungareze, ishte informuar më datë 10 mars 1918, për mungesën e oficerëve në bezirkun e Beratit. Ai mendonte se shkaqet e mosrealizimit të procesit të numërimit dhe regjistrimit në bezirkun e Beratit ishin: 1. Mungesa e personave të përshtatshëm të ngarkuar në detyrën si komisonerë të numërimit; 2. Zvarritja për një kohë të gjatë e emërimit të komisarit të ri civil; 3. Ngarkesa e tepërt me punë e personelit të bezirkut të Beratit gjatë periudhës së numërimit të popullsisë<sup>32</sup>.

<sup>29</sup>Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, përkthyer nga Kujtim Ymeri, Tiranë: "Dituria", 2005, f. 229; P. Bartl, *Shqiptarët: nga Mesjeta deri në ditët tona*, f. 180.

<sup>30</sup>F. Seiner, *Ergebnisse der Volkszählung in Albanien in dem vondenösterr-ungar. Truppen 1916-1918 besetzten Gebiete*, p. 5.

<sup>31</sup>F. Seiner, *Numrim i parë i popullsis në Shqypni*, f. 12.

<sup>32</sup>HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-8-828, Raporti nr. 127/ P. 6062 i komisarit civil dhe konsullit të përgjithshëm austro-hungarez, A. Kral, drejtuar komandantit të Korpusit XIX, Shkodër, 27 maj 1918.

Akademia e Shkencave i kërkoi drejtuesit të regjistrimit të popullsisë, Franz Seiner, që të përpunonte statistikën kryesore. Krahës Franz Seiner, materiali i mbledhur u përpunua edhe nga studiuesi dr. Eugen Oberhummer, i cili mbante detyrën e drejtuesit të Komisionit për Ballkanin në Akademinë e Shkencave të Austrisë, në Vjenë. Në vitin 1921, E. Oberhummer, publikoi të dhënat statistikore paraprake në lidhje me regjistrimin e kryer në vitin 1918<sup>33</sup>. Tabelat e rezultateve të procesit të regjistrimit të popullsisë së Shqipërisë u publikuan në vitin 1922, me mbështetjen financiare të Qeverisë shqiptare.

Sipas të dhënave të mbledhura gjatë vitit 1918, thuhej se regjistrimi i popullsisë së territorit të Shqipërisë që gjendej nën kontrollin e tyre përfshinte një sipërfaqe prej 20 096 km<sup>2</sup>. Pra, rreth 70 për qind e sipërfaqes së shtetit shqiptar sipas kufijve të vendosur në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës të vitit 1913. Më 9 qershor 1918, komisar civil A. Kral, i dërgoi Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë një raport të shpejtë, në të cilin thuhej se numri i popullsisë së Shqipërisë arrinte në 515 mijë e 124 banorë<sup>34</sup>. Sipas raportit të komisarit civil, A. Kral, mendohej se popullsia e Kosovës arrinte në rreth 220 000 banorë, shumica e së cilës ishte shqiptare<sup>35</sup>.

Ndryshe nga sa paraqitej në dokumentin e mësipërm të dërguar nga diplomati A. Kral, në broshurën e Franz Seiner me titull: *Numrim i parë i popullsisë në Shqipëri*, i cili u botua edhe në gjuhën shqipe në vitin 1922, ky ekspert shkruante se, sipas regjistrimit të kryer gjatë vitit 1918, në Shqipëri banonin gjithsej 524 217 banorë, me një dendësi prej 26 banorësh për kilometër katror. Nga procesi i regjistrimit të vitit 1918, rezultonte se në pjesën e Shqipërisë të kontrolluar nga austro-hungarezët ishin numëruar dhe përlllogaritur gjithsej 435 075 banorë, ndërsa kësaj shifre i ishin shtuar 89 142 banorë të bezirkut të Beratit, të cilat kishin dalë nga regjistrimet e mëparshme, pasi materialet e tij ishin dëmtuar<sup>36</sup>.

<sup>33</sup>Eugen Oberhummer, "Mitteilung über die erste Volkszählung in Albanien" in: *Anzeiger der Akademie der Wissenschaften in Wien, philosophisch-historische Klasse* 57/1920, Wien, 1921, p. 7-8.

<sup>34</sup>HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-3-397, Aneks 5 i relacionit të konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, "Mbi numrin e popullatës", 9 qershor 1918.

<sup>35</sup>Po aty, Vj. 28-3-396, Aneks i relacionit me nr. 137/P., drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 9 qershor 1918; Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, botim i Institutit të Historisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike - Tiranë, Tiranë: "Kristalina- KH", 2013, f. 45; F. Rifati, *Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore, 1914-1918*, f. 215.

<sup>36</sup>F. Seiner, *Numrim i parë i popullsisë në Shqipëri*, f. 4.

Komisari civil, A. Kral, informonte Qeverinë austro-hungareze se nga numri i përgjithshëm i popullsisë së regjistruar në Shqipërisë, rezultonte se rreth 357 mijë banorë ishin shqiptarë myslimanë, 70 mijë ishin shqiptarë katolikë, 38 mijë e 800 banorë i përkisnin ritit ortodoks grek, 760 banorë i përkisnin fesë ortodokse të ritit serb dhe bullgar. Qyteti që kishte numrin më të madh të popullsisë në pjesën e Shqipërisë që ndodhej nën okupimin austro-hungarez ishte Shkodra, me 28 mijë banorë, i ndjekur nga qyteti i Tiranës me 10 mijë e 600 banorë<sup>37</sup>. Administrimi ushtarak austro-hungarez nuk përfshinte mjaft vise shqiptare në Veri dhe në Jug të vendit. Megjithatë, sipas regjistrimit të vitit 1918, rezultonte se në Shqipërinë e Sipërme<sup>38</sup>, me një sipërfaqe prej 14 015 km<sup>2</sup>, kishte 379 078 banorë dhe një dendësi popullore prej 37 banorë për kilometër katror. Në Shqipërinë e Poshtme në një sipërfaqe prej 6 081 km<sup>2</sup>, kishte 145 139 banorë, me një dendësi popullore prej 24 banorë për kilometër katror<sup>39</sup>. Bezirku që kishte sipërfaqen më të madhe, ishte i Beratit me 4 480 km<sup>2</sup>, ndërsa numrin më të madh të popullsisë e kishte bevizirku i Tiranës, me 142 676 banorë, i cili kishte njëherësh edhe dendësinë më të madhe të popullsisë me 32 banorë për kilometër katror<sup>40</sup>. Ndërkaq, rrethi i Elbasanit kishte sipërfaqen më të madhe me 1 325 km<sup>2</sup>. Numrin më të vogël të dendësisë së popullsisë e kishin rrethet e Kirit (në Shkodër) me 12 banorë për km<sup>2</sup>, Malësia e Gjakovës me dhe Puka me 14 banorë secila për km<sup>2</sup>. Rrethet me dendësinë më të lartë të popullsisë e kishin: Shkodra me 85 banorë për km<sup>2</sup>, rrethi i Durrësit me 56 banorë për km<sup>2</sup> dhe rrethi i Kavajës me 49 banorë për kilometër katror<sup>41</sup>.

Nga publikimi i F. Seiner, duhen marrë në konsideratë disa të dhëna që paraqesin interes. Në regjistrimin e popullsisë së vitit 1918 u përfshinë 6 bevizirke, 28 rrethe (kreis) dhe 114 bashki<sup>42</sup>. Ndër rrethet e përfshira në procesin e regjistrimit, ishin: Kruja, Mati, Ohri, Oroshi (Mirdita), Puka, Kiri, Leshi (Lezha), Malësia e Madhe, Shkodra, Durrësi,

<sup>37</sup> *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-3-397, Aneks 5 i relacionit të konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, "Mbi numrin e popullatës", 9 qershor 1918.*

<sup>38</sup> Në dokumentin që A. Kral i drejtonte Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, nuk përcaktohej shtrirja dhe kufijtë e nocioneve gjeografikë "Shqipëri e Sipërme" dhe "Shqipëri e Poshtme". Në botimin e Franz Seiner përcaktohej në vija të përgjithshme që nga territoret e bevizikut (qarkut) të Elbasanit në Jug e deri në bevizikun e Zhurit (Prizren), emërtoheshin si Shqipëria e Sipërme, ndërsa bevizirku i Beratit dhe pjesa jugore e bevizikut të Tiranës konsiderohej si Shqipëria e Poshtme.

<sup>39</sup> F. Seiner, *Numrim i parë i popullsisë në Shqypni*, f. 14-15.

<sup>40</sup> *Po aty*, f. 17.

<sup>41</sup> *Po aty*, f. 18.

<sup>42</sup> *Po aty*, f. 13.

Elbasani, Kavaja, Peqini, Tirana, Dibra e Poshtme, Gora, Hasi, Luma, Malësia e Gjakovës, Berati, Fieri, Lushnja, Mallakastër, Skrapari, Elbasani i Poshtëm, Gramshi, Peqini i Poshtëm, Shënarpëndja.

Numri i popullsisë sipas bezirkeve ishte si më poshtë: Kruja kishte 51 786 banorë nga të cilët 51 311 banorë ishin shqiptarë, 40 vlllehë, 435 jevgj dhe 4 banorë të tjerë; Puka kishte 32 504 banorë nga të cilët 32 486 vetë ishin shqiptarë dhe 18 jevgj; Shkodra kishte 84 509 banorë nga të cilët 81 997 ishin shqiptarë, 2 vlllehë, 1 675 banorë serbo-kroatë, 5 bullgarë, 15 grekë, 673 jevgj, 142 të tjerë; Tirana Përdimorë kishte 111 088 banorë, nga të cilët 106 737 ishin shqiptarë, 1 vllleh, 562 serbo-kroatë, 2 bullgarë, 14 grekë, 3724 jevgj, 48 të tjerë; Zhuri kishte 99 187 banorë, nga të cilët 90 833 ishin shqiptarë, 109 vlllehë, 26 serbo-kroatë, 206 bullgarë, 1 grek, 718 jevgj, 294 të tjerë; Berati kishte 113 551 banorë, por meqenëse nuk ishin ruajtur dokumentet e regjistrimit, nuk kishte të dhëna të tjera të detajuara të sakta; Tirana Jugorë kishte 31 588 banorë, nga të cilët 31 367 vetë ishin shqiptarë, 220 jevgj dhe 1 banor i përkatësive të tjera. Popullsia sipas qyteteve kryesore të vendit paraqitej si më poshtë: qyteti me numrin më të madh të popullsisë në Shqipëri ishte Shkodra me 23 099 banorë, nga të cilët 21 493 banorë të saj ishin shqiptarë, 1049 serbo-kroatë, 5 banorë ishin bullgarë, 10 ishin grekë, 1 jevgj dhe 127 ishin të tjerë; në vendin e dytë vinte qyteti i Tiranës me 10 251 banorë, nga të cilët 9 336 ishin shqiptarë, 23 ishin serbo-kroatë, 1 bullgar, 876 jevgj dhe 15 të tjerë; në vend të tretë ishte qyteti i Elbasanit me 10 102 banorë, nga të cilët 9 231 ishin shqiptarë, 869 jevgj dhe 2 të tjerë; në vend të katërt vinte Berati me 9 006 banorë dhe më tej ishte qyteti i Kavajës me 5 453 banorë, nga të cilët 5 141 ishin shqiptarë, 1 serbo-kroat, 308 jevgj dhe 3 të tjerë; qyteti i Durrësit me 4 175 banorë, nga të cilët 3 436 banorë ishin shqiptarë, 75 vlllehë, 14 grekë, 627 jevgj dhe 23 të tjerë; qyteti i Krujës kishte 3 861 banorë, nga të cilët 3 824 banorë ishin shqiptarë dhe 37 jevgj<sup>43</sup>. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se shumica e rrethëve, krahinave në pikëpamje administrative, etnografike dhe gjeografike kishin popullsi shqiptare në shumicë absolute.

Popullsia e Shqipërisë që gjendej nën okupimin austro-hungarez, sipas besimit fetar, paraqiste këtë tablo: bezirku (qarku) i Krujës kishte 40 506 banorë të besimit mysliman, 11 105 banorë të besimit katolik dhe 179 banorë të besimit ortodoks; bezirku i Pukës kishte 6 963 banorë të besimit mysliman dhe 25 541 banorë të besimit katolik; bezirku i

<sup>43</sup>*Po aty*, f. 14-15.

Shkodrës kishte 37 706 banorë të besimit mysliman, 47 810 banorë të besimit katolik, 1 983 banorë të besimit ortodoks dhe 10 banorë të besimit jud; bezirku i Tiranës Perëndimore kishte 103 863 banorë të besimit mysliman, 514 banorë të besimit katolik, 6 699 banorë të besimit ortodoks, 10 banorë të besimit jud dhe 2 të besimeve të tjera; bezirku i Zhurit (Prizren) kishte 93 792 banorë të besimit mysliman, 4 500 banorë të besimit katolik dhe 835 banorë të besimit ortodoks; bezirku i Beratit kishte 85 052 banorë të besimit mysliman dhe 28 499 banorë të besimit ortodoks; bezirku i Tiranës Jugore kishte 27 237 banorë të besimit mysliman dhe 4 351 banorë të besimit ortodoks. Marrë në tërësi, në viset e Shqipërisë nën administrimin austro-hungarez kishte gjithsej 392119 banorë të besimit mysliman, 89470 të besimit katolik, 42546 banorë të besimit ortodoks, 20 banorë të besimit jud dhe 2 u përkisnin besimeve të tjera fetare<sup>44</sup>.

Për sa u përket qyteteve kryesore të vendit, raporti i popullsisë sipas besimeve fetare ishte: qyteti i Durrësit kishte 2 457 banorë të besimit mysliman, 175 banorë të besimit katolik, 1 539 banorë të besimit ortodoks, 2 të besimit jud dhe 2 të besimeve të tjera; qyteti i Elbasanit kishte 8 409 banorë të besimit mysliman, 5 banorë të besimit katolik dhe 1692 banorë të besimit ortodoks; qyteti i Kavajës kishte 4 342 banorë të besimit mysliman dhe 1 111 banorë të besimit ortodoks; Kruja kishte 3 855 banorë të besimit mysliman, 1 banor të besimit katolik dhe 5 banorë të besimit ortodoks; qyteti i Shkodrës kishte 15 266 banorë të besimit mysliman, 7 091 banorë të besimit katolik, 732 banorë të besimit ortodoks dhe 10 banorë të besimit jud; qyteti i Tiranës kishte 9 468 banorë të besimit mysliman, 18 banorë të besimit katolik, 757 banorë të besimit ortodoks dhe 8 banorë të besimit jud; qyteti i Beratit kishte 5 125 banorë të besimit mysliman dhe 3 881 banorë të besimit ortodoks. Në tërësi, në qytetet e Shqipërisë nën administrimin austro-hungarez kishte 48 922 banorë të besimit mysliman, 7 286 banorë të besimit katolik, 9 717 banorë të besimit ortodoks, 20 banorë të besimit jud dhe 2 banorë që u përkisnin besimeve të tjera<sup>45</sup>.

Nga numri i përgjithshëm i popullsisë së regjistruar, në bezirkun e Krujës, 48 891 banorë ishin bujq, ndërsa 1899 kishin profesione të tjera; në bezirkun e Pukës, 32 375 banorë merreshin me bujqësi, ndërsa 129 kishin profesion tjetër; në bezirkun e Shkodrës, 59 593 banorë ishin bujq, ndërsa 24 916 kishin profesione të tjera; në bezirkun e Tiranës

<sup>44</sup>Po aty.

<sup>45</sup>Po aty.

Perëndimore 82 083 banorë merreshin me bujqësi, ndërsa 29 005 merreshin me ndonjë profesion tjetër; në bezirkun e Zhurit, 96 381 banorë ishin bujq, ndërsa 2806 banorë të tjerë zotëronin një profesion tjetër; në bezirkun e Tiranës Jugore 31 455 banorë ishin bujq, ndërsa 123 banorë kishin një profesion tjetër<sup>46</sup>.

Nga të dhënat e mbledhura, rezultonte se në rrethin (Kreis) e Matit kishte 15 tregtarë vllahë, të cilët jetonin së bashku me 33 njerëz të farefisit dhe shërbëtorët që i përkisnin ritit ortodoks grek. Nga grupi i mësipërm, 13 persona kishin nënshtetësi serbe. Në rrethin e Shkodrës kishte 11 fshatra, në të cilat jetonin 463 serbo-kroatë. Nga ky grup, 278 banorë ishin të besimit mysliman, 185 ishin serbo-ortodoksë, ndër të cilët 45 ishin nënshtetas malazezë. Gjithashtu, kishte 85 jevg, një banor me origjinë turke dhe një tjetër me ngjyrë nga Sudani. Popullsisë hebraike i përkisnin 7 persona me banim në Shkodër, të cilët ishin me prejardhje hungareze. Qyteti i Shkodrës nuk kishte material të rilevuar. Rrethi i Gramshit kishte një fshat me emrin Grabovë, me popullsi të krishterë, nga e cila 415 banorë ishin vllahë, të cilët i përkisnin ritit ortodoks grek. Rrethi i Kavajës kishte 6 fshatra me 182 banorë, të cilët i përkisnin pakicave dhe flisnin gjuhë të huaj. Nga numri i mësipërm, 162 banorë ishin serbo-kroatë të besimit mysliman. Nga ky numër, 13 banorë kishin ardhur në Shqipëri nga Mali i Zi, ndërsa 27 të tjerë kishin ardhur nga Bosnja. Ndërkaq, në numrin prej 182 banorësh përfshiheshin edhe 7 turq dhe 5 bullgarë. Në rrethin e Peqinit, ndodhej fshati me emrin Hasmashaj, ku banonin 188 vllahë, të cilët ishin të gjithë qiraxhinj. Gjithashtu, raportojë se në shtatë fshatra të nënprefekturës së Peshkopisë, që ishin në përbërje të qarkut (bezirk) të Zhurit (Prizren), kishte 864 banorë të huaj. Nga ky numër, 793 banorë ishin bullgarë që praktikonin ritin ortodoks të ekzarkatit bullgar, nga të cilët vetëm 3 mbanin nënshtetësinë bullgare; 36 ishin vllahë prej të cilëve 24 mbanin nënshtetësinë bullgare, ndërsa 35 banorë ishin jevgj<sup>47</sup>.

Sipas të dhënave që dolën nga regjistrimi, në Shqipërinë e Sipërme rezultonte se numri mesatar i pjesëtarëve të familjeve shqiptare në Shqipëri lëvizte nga 5 deri në 7 persona për familje. Pra, kishte 62 226 shtëpi të banuara me 69 172 familje dhe me 379 078 banorë. Për një shtëpi i bie të kishte 1.2 familje dhe 6.1 banorë. Numri më i madh i

<sup>46</sup>*Po aty.*

<sup>47</sup>*HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-7-786, Raport nr. 154/ P. i Kral, konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shqipëri, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 22 qershor 1918.*

shtëpive rezultonte në rrethin e Dibrës së Poshtme me 6 989 shtëpi, 8 356 familje dhe 40 526 banorë. Vetëm në rrethin e Oroshit (Mirditë) paraqitej numri më i lartë i pjesëtarëve në një familje, përkatësisht me 7 vetë, ndërsa në Malësi të Madhe kishte 6.9 vetë për familje. Në Shqipërinë e Sipërme ndeshen edhe familje me 20 e më tepër banorë, të cilët jetonin në një shtëpi. Nëse krahasohet pjesa e Shqipërisë së Sipërme me pjesën e Shqipërisë së Poshtme, mund të thuhet se fenomeni i të jetuarit së bashku në një shtëpi ishte më i përhapur në Shqipërinë e Sipërme. Megjithatë, shifrat tregonin se ndryshe nga zadrugat apo “zajednakuča” (shtëpi të përbashkëta) që ishin veçori e popullsisë sllave, në malësitë shqiptare nuk ishte aq e përhapur dukuria e “komunizimit shpijak”<sup>48</sup>. Të dhënat zyrtare dëshmonin se në territorin e Shqipërisë që gjendej i okupuar nga trupat austro-hungareze, kishte 252 794 meshkuj (50.1 % e popullsisë) dhe 251 423 femra (49.9% e popullsisë). Pra, për 1 000 meshkuj kishte 994 femra, ose një shpërndarje thuajse e barabartë. Binte në sy fakti se, vetëm në krahinën e Tiranës, numri i femrave ishte shumë më i madh se i meshkujve, ndërsa në krahinat tjera kishte më shumë meshkuj<sup>49</sup>.

Gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, vihet re se Austro-Hungaria punoi me të gjitha mënyrat për realizimin e interesave të saj në viset shqiptare. Megjithatë, gjatë periudhës së shkurtër të viteve 1916-1918, ajo realizoi edhe vepra të rëndësishme në dobi të shqiptarëve, ndër të cilat ishte edhe regjistrimi i popullsisë në pjesën më të madhe të Shqipërisë. Në lidhje me kontributin e saj, përfaqësuesit e kolonisë shqiptare në Rumani shpreheshin në këtë periudhë se, Austro-Hungaria bëri “më shumë se sa pritej” në drejtim të ndihmës ndaj shqiptarëve dhe për sigurimin e shtetit të ardhshëm shqiptar<sup>50</sup>. Publicisti dhe poeti kombëtar shqiptar, Gjergj Fishta, shkruante se nëse ideali i shqiptarëve ishte organizimi i kombit shqiptar, mbështetur në parimet e kulturës së Evropës Perëndimore, Austro-Hungaria ishte ajo që punoi gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore për ta vënë në jetë këtë aspiratë të tyre. Ai

<sup>48</sup>F. Seiner, *Numrim i parë i popullsis në Shqypni*, f. 23.

<sup>49</sup>Franz Seiner, *Ergebnisseder Volkszählung in Albanien in dem vondenösterr-ungar. Truppen 1916-1918 besetzten Gebiete*, (Akademie der Wissenschaften in Wien, Schriftender Balkankommission, Linguistische Abteilung XIII). Wien und Leipzig: Hölder-Pichler-Tempsky A.-G., 1922, p. 8; F. Seiner, *Numrim i parë i popullsis në Shqypni*, f. 23-24.

<sup>50</sup>HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-4- 491, Memorandum i përfaqësuesve të kolonisë shqiptare në Rumani, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenw, Bukuresht, 26 shkurt 1918.

shtonte se “*aq ka punue, per me e çue në vend këtë ideal, sa s’kemi arsye me pritë ma tepër prej sajë*”<sup>51</sup>.

---

<sup>51</sup>Gj. Fishta, “Ushtriya austro-ungare e të mkamunt e Shqypnis”, në *Posta e Shqypniës*, nr. 13, Shkodër, 23 janar 1918, f. 1.



## **MATERIALE DHE DOKUMENTE**



**Qerim LITA**

## **SI I PËRSHKROI REMZI KOLGECI NGJARJET E NËNTORIT 1988 NË KOSOVË?**

**(Dokument)**

Marshi protestues i minatorëve të minierës “Trepça”, që filloi më 17 nëntor 1988, i cili më pas u shndërrua në protesta dhe demonstrata mbarëshqiptare në Kosovë, tronditi thellë udhëheqjen e atëhershme komuniste jugosllave në përgjithësi, e atë serbe në veçanti. Në ato demonstrata të cilat zgjatën deri më 21 nëntor, qindra mijëra shqiptarë dolën nëpër rrugët dhe sheshet e Kosovës për ta mbrojtur Kushtetutën e vitit 1974, duke brohoritur parullat: “Jetën e japim, Kosovën se japim”, “Nuk e japim Kushtetutën nga viti 1974”, “Rroftë Kushtetuta e vitit 1974”, “Tërë Kosova është çu në këmbë që Kushtetutën e vitit 1974 mos me e ndërru”, “Kosovë po se po -Metohi jo se jo”, etj. Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme njoftonte se vetëm më datë 18 nëntor, në Prishtinë kishin arritur në këmbë mbi 60 mijë demonstrues shqiptarë nga të gjitha vendbanimet e Kosovës, prej tyre 40 000 ishin vendosur në stadiumin e qytetit, ndërsa 20 000 të tjerë protestonin para Komitetit Krahinor. Ishin të kota masat e ndërmarra nga udhëheqja e atëhershme politike e Kosovës, për pengimin e tubimeve masive të popullsisë shqiptare dhe për pengimin e ardhjes së organizuar të tyre në Prishtinë. Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës njoftonte se demonstruesit shqiptarë ishin këmbëngulës ndaj “kërkesave të veta”, duke mos iu përgjigjur apeleve dhe thirrjeve për shpërndarje, nga ana e strukturave të atëhershme udhëheqëse kosovare. Ndër udhëheqësit politik kosovar, i cili gëzonte autoritet më të gjerë te popullsia shqiptare, padyshim se ishte Remzi Kolgeci, i cili asaj kohe mbante dy poste më të larta partiake e shtetërore: kryetar i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe ushtrues detyre i kryetarit të Komitetit Krahinor të Lidhjes

së Komunistëve të Kosovës, post të cilin e ushtroi përkohësisht pas dorëheqjes së imponuar të kryetares së mëparshme Kaçusha Jashari. Autoriteti i tij u pa në ditën e tretë të demonstratave, përkatësisht në mbrëmjen e datës 19 nëntor, kur dhjetëra mijëra demonstrues shqiptarë të tubuar para Komitetit Krahinor e pranuan apelin e tij që të shpërndahen, pasi paraprakisht u premtoi se të gjitha kërkesat e tyre do të shqyrtoheshin në një mbledhje të jashtëzakonshme të Komitetit Krahinor, e cila do të mbahej menjëherë posa të krijoheshin kushtet.

Si udhëheqës me përgjegjësi më të madhe politike në Kosovë, ai krahas angazhimit të drejtpërdrejtë për qetësimin e situatës në Kosovë, mori pjesë aktive edhe nëpër mbledhjet e jashtëzakonshme të përbashkëta apo të ndara të Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe Kryesisë së RSFJ-së, si dhe të Kryesisë së KQ të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe Kryesisë së RS të Serbisë. Një mbledhje e tillë u mbajt më 24 nëntor 1988 në Beograd, ku si organizatore formale e saj ishte Kryesia e KQ të LKJ-së, e në të cilën morën pjesë edhe anëtarët e Kryesisë së RSFJ-së. Në atë mbledhje, Remzi Kolgeci mbajti një fjalim më të zgjeruar për rrjedhat e protestave dhe të demonstratave shqiptare në Kosovë, si dhe për masat që ishin ndërmarrë nga ana e strukturave politike e ekzekutive kosovare për pengimin e tyre. Ai që në fillim të fjalimit u ankua për presionin e madh që kishte pasur një ditë më parë nga udhëheqësi më i lartë komunistë serb, S. Millosheviqin, por edhe nga Petar Graçanin, asaj kohe sekretar federativ për Punë të Brendshme, që me çdo kusht të udhëtojë në Beograd për një marrëveshje të re, e cila, siç shprehet ai, binte ndesh me qëndrimet, përkatësisht marrëveshjet e arritura në KQ të LKJ-së, sa i përket problemit të Kosovës. Pas përfundimit të fjalimit, atij iu parashtruan një sërë pyetjesh provokuese nga ana e pjesëmarrësve, veçanërisht nga përfaqësuesit maqedonas pjesëmarrës në atë mbledhje, si: Vasil Tupurkovski, Millan Pançevski dhe Jakov Llazarevski, por edhe nga ata serbë e malazezë, si: Borisav Joviq, Marko Orllandiq etj. Fjalimi i tij i plotë si dhe debati i zhvilluar më pas, i cili ruhet në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës në Prishtinë, fondi KK i LK i Kosovës, asaj kohe është konsideruar si një dokument shumë sekret, dhe në të kanë pasur qasje vetëm një numër i caktuar i udhëheqjes së lartë komuniste të Kosovës. Dokumenti, i cili është përkthyer nga gjuha serbo-kroate, nxjerr në pah qëndrimin e vërtetë, përkatësisht të luhatshëm të Remzi Kolgecit dhe të udhëheqjes së atëhershme politike të Kosovës ndaj revoltës së minatorëve shqiptarë, e cila më pas u shndërrua në revoltë e protestë mbarëshqiptare në Kosovë.

## **Fjalimi i autorizuar i Remzi Kolgeci në mbledhjen e Kryesisë së KQ LKJ-së, nga data 24 nëntor të vitit 1988<sup>1</sup>**

Tepër sekretet  
Kthehet pas përdorimit  
Numri i evidentimit 161

Fjalën e ka shoku Kolgeci.

Remzi Kolgeci: U thash se edhe unë, por edhe ju jeni në një situatë tejet të rëndë për arsye se konsideroj se për këto çështje qësot Kryesia i ka vendosur në rendin e ditës, ndoshta nuk jemi të përgatitur mjaftueshëm që të futemi në detaje, por unë e kam kuptuar se duhet të jap një informatë të shkurtë për ngjarjet me ato vlerësime që ne i jemi qasur punës në lidhje me zbardhjen e situatës së përgjithshme që këtyre ditëve ka ndodhur në Kosovë.

Së dyti, ndoshta do të ishte mirë që për këtë mbledhje të kemi edhe marrëveshje në Kryesinë e KK të LK të Kosovës për mbledhjen e mbajtur më 20 të dielën, ku mori pjesë edhe shoku Koroshec, me shokët Brigiç dhe Uzellac dhe shokët nga KQ LK të Serbisë. Ja përse e them këtë, për arsye se kjo bisedë e sotme përkatësisht biseda e mbrëmshme për ne në Kosovë ka qenë e pa planifikuar dhe unë nuk ua zë për të madhe që mbledhjen e keni caktuar aq shpejtë, përkundrazi. Por mendoj se është bërë pak, kjo ka qenë befasuese për arsye se ne qemë marrë vesh se si duhet të qasemi. Së bashku me Kryesinë e KQ LKJ-së dhe me Kryesinë e KQ LK të Serbisë e ndërtuam një metodë pune. Kjo e mbrëmshmja doli në mënyrë befasuese. Por, unë e kam kuptuar se kjo ka ardhur me propozim të shokëve nga Kryesia e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë. Fillimisht mund të them se rreth asaj bisede rreth thelbit të bisedës dhe rreth asaj se çfarë do të bisedohej në atë takim të mbrëmshëm, nuk kam mundur të mos marrë pjesë jo nga dëshira ime por për shkak situatës së përgjithshme. Unë jam informuar dje rreth orës 15,30 se duhet të vij në Beograd. Kjo është një çështje që fillimisht duhet t'ju informoj se në çfarë shtate kemi qenë ne. Ndërsa është një e vërtetë e madhe se parmbremë shoku Petar Graçanin (sekretar federativ për Punë të Brendshme - Q.L.) dhe shoku Millosheviq insistuan që unë të vij në Beograd me çdo kusht për shkak marrëveshjes rreth

---

<sup>1</sup>Titulli është pjesë përbërës i dokumentit.

vlerësimit të situatës. Unë kërkoj falje që këtë duhet t'ua them patjetër. Në Kryesinë e KQ LKJ-së me siguri se këto për ju nuk janë detaje me rëndësi. Me këtë unë kam dashur të them, që edhe për mua ka qenë e pamundur një mënyrë e tillë e bisedës dhe e qasjes aq të shpejtë. Për shkak asaj se drejtimin dhe marrëveshjen e aksionit ne e kemi arritur bashkërisht u thashë se, dëshiroj edhe një herë ta theksoj në mbledhjen e Kryesisë së Komitetit Krahinor në përbërje të zgjeruar, ku ishin shokët më përgjegjës nga Kryesia e KQ LKJ-së dhe Kryesia e KQ të Serbisë.

Unë e kam konsideruar por edhe sot e konsideroj se ajo marrëveshje është e harmonizuar dhe mbi bazën e asaj marrëveshjeje ne i jemi qasur realizimit të saj, ishim në rrugë që të vepronim asisoj. Mua më është plotësisht e qartë fakti se Konferenca e Lidhjes së Komunistëve të Serbisë ishte një tubim i tillë, saqë nuk mund të bisedohej asgjë për situatën në Kosovë. Mirëpo, mua personalisht gjithashtu më është e qartë se në këtë situatë nuk mund të jap vlerësime të thelluara, vlerësime politike për shkak të rrethanave dhe fakteve më të ndryshme. Unë sot nuk do të futesha në detaje për ato fakte. Por, pasi shoku Stipe<sup>2</sup> më dha detyrë që t'u informoj shkurtimisht, unë do të përpiqem që vërtetë të jem krejtësisht i shkurtë dhe në fund t'ju informoj se si ne kemi menduar të punojmë dhe se ky përcaktimi i yni a ka qenë i drejtë apo jo. Nëse nuk është, le të më thuhet këtu në Kryesi. Ne këtë do ta pranojmë. Nëse është, në atë rast të na ndihmoni që atë përcaktim ta kryejmë së bashku, sepse nëse nga kjo situatë në opinion sërish dalim me dallime unë mund të pohoj dhe pohoj se do ta vështirësojmë situatën, nuk do ta ndihmojmë situatën në Kosovë. Rrjedhimisht, nuk do ta ndihmojmë as edhe aksionin tonë politik për përshpejtimin e përkufizimit, të shprehëm ashtu, të ngjarjeve kundërrevolucionare nga 81-ishi me ato aksione që udhëhiqen e që duhet udhëhequr detyrimisht në Kosovë në luftën kundër nacionalizmit e separatizmit shqiptar. Por, edhe të dukurve tjera dhe nacionalizmave tjerë që i kemi pasur dhe për fat të keq ende i kemi, e që në situata dhe kohë të caktuar nuk kemi arritur t'i përkufizonim. Veçanërisht pas mbledhjes së XVI të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Tubimet, të them më mirë, tubimet e organizuara, kanë filluar gjatë rrjedhës së mbledhjes së Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës. A ishte para apo në mëngjes, unë them gjatë mbajtjes së mbledhjes. Mund të themi edhe në mëngjes nëse kjo paraqet një detaj të rëndësishëm. Filloi nga minatorët e Stari Tërgut për të

<sup>2</sup>Stipe Shuvar, kryetar i Kryesisë së KQ LKJ-së.

vazhduar me minatorët e Kishnicës, Novo Bërdës, Magurës, punëtorët e ndërmarrjes së ndërtimtarisë “Ramiz Sadiku” dhe disa organizatave tjera në Prishtinë. Kjo ishte më datë 17. Ndërsa më 18 gjithashtu vazhdimi i ardhjes, ardhjes së organizuar në Prishtinë, të shprehem ashtu, edhe të minatorëve edhe të qytetarëve e të tjerëve dhe të rinisë. Kjo ishte më 18, ndërsa për datën 19 duhet t’i jap disa karakteristika. Më datën 19 pati më pak punëtor sesa ditës paraprake më shumë të rinj e të strukturave tjera. Më datë 20, ditë e diel, një intensitet krejtësisht më të vogël të prezencës në Prishtinë, intensitet më të vogël të lëvizjes nga drejtimet tjera kah Prishtina që kjo datë përfundoi me bisedën në sallën “Boro e Ramizi”. Më datë 21 pati përpjekje karakteristike për lëvizje kah Prishtina, por në Prishtinë që një ditë relativisht e qetë. Më 22, kjo do të thotë dje, pati përpjekje për lëvizje kah Prishtina, por nuk pati as çfarë defilimi. Edhe sot, sipas informatave të deritanishme, ka mundësi që tash atje të ketë ndodhur diçka, por situata është përafërsisht sikur dje. Tash, çfarë është ajo që që prezent në ato tubime. Unë këtu i kam të shkruar, por nuk do t’ju ngarkoj me atë që kemi shkruar rreth atyre, nëse do të ketë nevojë unë do ta lexoj. Çfarë ishte karakteristikë, të themi në bisedën dhe lëvizjet e minatorëve dhe bisedën me minatorët më datën 17 në sallën “Boro e Ramizi”. Karakteristika thelbësore e bisedës ishte në atë se mbledhja e Komitetit Krahinor dhe paralajmërimi i mbledhjes së Komitetit Krahinor rreth ndërrimeve kadrovike në Komitetin Krahinor, u kuptua si një presion i caktuar ndaj kuadrit etj. etj. Kjo është e para.

Së dyti, informimi jo i mjaftueshëm rreth ndryshimeve kushtetuese. Prezent ishin edhe shokët tjerë, dhe shoqja Kaçushe, dhe shoku Azem, dhe udhëheqësit tjerë të Krahinës. Mund të pohoj se aty nuk pati asnjë incident derisa kam qenë prezent, por edhe më vonë. Biseda u zhvillua ashtu siç qemë dakorduar, por kur ata tash më kishin dalë në rrugë dhe insistonin të shkojnë për Prishtinë dhe ne u dakorduam, sepse nuk patëm mundësi tjetër për t’i kthyer për Mitrovicë. U thash, ashtu siç qemë dakorduar dhe sa do të zgjaste ajo bisedë. Çfarë parulla pati në atë bisedë të parë? Ne mund t’ua japim edhe regjistrin e parullave, të cilat i kemi marrë nga aktivistët si dhe nga organet e sigurimit. Nëse duhet mund t’i japim edhe sot apo nesër, kjo nuk paraqet ndonjë problem. Por, them se në atë bisedë të parë me ata minatorë që ishte një masë e madhe, rreth dy-tre mijë njerëz, mbisundonin parullat: “Tito partia”, “Rroftë Lidhja e Komunistëve”, “Rroftë Vëllazërim Bashkimi”, “Nuk duam dorëheqje”, “Rroftë Azemi”, “Nuk e duam ndërrimin e Kaçushes” etj. etj. Në bisedën e zhvilluar më datë 17 folën 5 deri 6 minatorë. Unë nuk arrita ta vërej, edhe pse isha aty deri sa folën të gjithë,

se gjatë fjalimeve të minatorëve, të cilët folën pa as çfarë koncepti apo ndonjë letre, se atje u tha diçka që do të ishte e papranueshme. Biseda të ngjashme dhe ardhje të ngjashme pati edhe në mbledhjen ndërmjet 17 dhe 18 nëntorit. Isha edhe në ato biseda, përkatësisht gjatë tërë mbledhjes deri të nesërmit në mëngjes. Edhe aty nuk kam mundur të vërej diçka që do të ishte e papranueshme. Edhe aty u theksuan parullat e njëjta që i theksova pak para. Tash, vijmë te data 18. Ne më 18 në mëngjes mbajtëm mbledhje urgjente të Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës dhe Komitetit për MPP-ë dhe VMSH-ë (Mbrotjtja e përgjithshme popullore dhe vetëmbrojtja shoqërore - Q. L.). E vlerësua situatën dhe u morëm vesh sesi të veprojmë më tej. Në mbledhje patëm lëvizje kah Prishtina, lëvizje të njerëzve punëtorë, qytetarëve kah Prishtina. Pjesa më e madhe, mund të pohoj, se shkoj në këmbë. Pati edhe transport të organizuar, për ata njerëz të cilët erdhën me autobusë, kamionë etj. Mirëpo, një masë e madhe e njerëzve udhëtoi në këmbë. Qëndrimi ynë ishte se mund të bisedojmë atje ku është e mundur të bisedohet – nëpër komuna, e jo në Prishtinë. Tash të kaloj, të kthehem sërish në datën 18 nëntor. E caktua mbledhjen dhe u dakordua, që në rast se vjen një masë më e madhe e njerëzve kah Prishtina, ne nuk kemi mundur të lejojmë që ajo masë e njerëzve të lëvizte kah Prishtina, përkatësisht brenda në Prishtinë, në qytet. Për arsye se ekzistonin, sigurisht, vlerësime të tilla sa që mund të cenohej siguri publik, rendi dhe qetësia publike etj. Marrëveshja jonë e përbashkët ishte që të gjitha ato masa që vinin, t'i orientonim kah stadiumi dhe në stadium. Nën vizoj sërish, për shkak të sigurisë së rendit dhe qetësisë publike etj. Të gjitha ata njerëz që atë ditë vinin kah Prishtina i orientonim kah stadiumi dhe nuk pati as çfarë problemi. Nëse këtu kemi gabuar, unë mund të bartë një pjesë të përgjegjësisë, jo një pjesë, por përgjegjësinë e përgjithshme, sepse kjo ishte ideja ime e cila që pranoi në Kryesi etj. Për shkak se situatën e patëm vlerësuar ashtu siç e patëm vlerësuar, ne nga Kryesia e RSFJ-së kërkuam pëlqim për vendosjen e masave të gatishmërisë. Atë e morëm nga Kryesia e RSFJ-së, dhe të njëjtën e zbatuam.

Të mos flas sesi atë ditë u organizuam me aktivistët politik dhe se si atë ditë funksiononte ai aktivitet politik. Në stadium atë ditë, flas për datën 18, patëm rreth 40.000 njerëz. Ajo çfarë pati mundësi të dëgjohej dhe të shihej, edhe atë ditë mbisunduan parullat të cilat ishin në linjën e Lidhjes së Komunistëve, ato parulla karakteristike që i nënvizova më herët. Aty folën edhe udhëheqësit e Krahinës, foli Daut Jashanica, kryetar i Kryesisë së LSPP të Kosovës, Savo Komadiniq, kryetar i Sindikatës së Kosovës, Azem Vllasi dhe Kaçusha Jashari. Pas fjalimeve që u mbajtën



në stadium, u dakorduam të shpërndahen. Një pjesë u shpërnda, një pjesë u nis kah Komiteti Krahinor. Kuptohet se atyre iu bashkëngjit edhe grupi i qytetarëve, njerëzve, rinia dhe para Komitetit Krahinor që një masë e madhe. Edhe aty u drejtuan aktivistët politik me kërkesë që ata të shkojnë nëpër shtëpitë e tyre. Kjo është karakteristikë për datën 18 nëntor.

Pra, gjatë 17 dhe 18 nëntorit, nuk vërejtëm ndonjë incident as në planin ndërnacional, e as në ndonjë incident i cili do të mund të paraqiste ndonjë rrezik më të rëndë për rendin e qetësinë publike, sigurinë etj. Data 19 paraqet një ditë më karakteristike. Unë thash se aty erdhi në shprehje rënia e numrit të punëtorëve, ndërsa u shtua numri i rinisë. Gjatë tërë ditës janë zhvilluar biseda me njerëzit dhe në Prishtinë që shtuar masa e njerëzve, ndërkohe po atë ditë në Prishtinë dhe në mbarë Kosovën binte shi i madh, shi rrebesh. Unë thuajse për çdo orë i raportoja edhe Kryesisë së RSFJ-së edhe kryesisë së KQ LKJ-së për ngjarjet. Ekzistojnë informatat dhe dokumentet. Sipas vlerësimeve tona, para Komitetit Krahinor ishte një masë prej rreth 15 e 20.000. Ndërsa nëpër rrugët e Prishtinës, nga “Grandi” deri te “Bozhuri” dhe rrugëve përreth, sipas vlerësimeve të organeve të sigurimit, pati rreth 35.000 njerëz nga të gjitha viset e Kosovës. Ky është vlerësimi për numrin e atyre që ishin tubuar para ndërtesës së Komitetit Krahinor. Ndërsa nga “Grandi” e deri te “Bozhuri” ishte një masë e madhe.

Kryesuesi:

Kjo nënkuptohet që këto 20.000 përfshihen në masën e 35.000.

Remzi Kolgeci:

Po, po. Gjatë tërë ditës, ne të gjithë, ishim në kontakt të vazhdueshëm me shokët nga Kryesia e KQ LKJ-së dhe Kryesia e RSFJ-së, me shokun Koroshec<sup>3</sup>, edhe me shokun Dizdareviq<sup>4</sup>, por edhe me shokun Stipe dhe me shokët tjerë. Ajo ka mund të shndërrohej në diçka që nuk do të ishte mirë as për Kosovën, as për Jugosllavinë dhe për askënd. Pra, as për shqiptarët, as për serbët, as për malazezët, për askënd në Kosovë e në Jugosllavi. Unë u paraqita në mbledhje rreth orës 20,30. Mora pjesë jo me iniciativën time. Gjithsesi se edhe me iniciativën time, por edhe në bazë të marrëveshjes me shokët nga Kryesia e KQ LKJ-së. Paraqitja ime ishte ashtu siç ishte, por ajo përfundoi me fjalët si vijon: se së shpejti do të thirret mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit Krahinor, mirëpo që të caktohet ajo mbledhje e jashtëzakonshme e Komitetit

<sup>3</sup>Shtjefan Koroshec, sekretar i përgjithshëm i KQ LKJ-së.

<sup>4</sup>Raif Dizdareviq, asaj kohe kryetar i Kryesisë së RSFJ-së.

Krahinor, duhet detyrimisht të krijohen kushte për punë, “ndërsa një ndër kushtet është që ju të shpërndaheni prej rrugëve dhe të shkoni nëpër shtëpitë tuaja”. Të gjitha kërkesat tuaja të cilat u dëgjuan këtyre ditëve do të analizohen në mënyrë të gjithanshme dhe për atë do të njoftohet opinionin jugosllav. Këtë ua thashë. Ua thashë për arsye se e kuptova se një ndër qëllimet, një ndër kërkesat e atyre njerëzve të cilët kishin ardhur, ishte të revidohen qëndrimet e mbledhjes së fundit të Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve në lidhje me shokun Azem dhe Kaçushen. Mund të them se pas fjalimit, jo për shkak të asaj se ndoshta isha shumë bindës, por nuk e di se për çfarë arsye, pas gjysmë ore masa filloi të shpërndahet pa asnjë incident. Aty ishte edhe shoku Sinan<sup>5</sup> dhe shokët tjerë, shoku Brigiq, shoku Uzellac dhe më falni nëse ka qenë edhe dikush tjetër, ndërsa unë nuk ia kam përmendur emrin. Rreth orës 22 u shpërnda e tërë masa, ndërsa në qytetet mbisundoi një qetësi relative. Patëm vetëm problem rreth transportit të njerëzve deri në komunat nga kishin ardhur. Kjo që të shtunën në mbrëmje.

Të dielën. Të shtunën në mbrëmje në mbledhjen e aktivitetit politik të Komitetit Krahinor ishin shoku Brigiq dhe shoku Uzellac. Kjo ishte në ora 22. Aty u dakordua se çfarë duhej punuar atë mbrëmje e çfarë të nesërmit. Prezent ishin edhe kryetarët e komiteteve komunale, të cilët dhanë informata të shkurta për situatën dhe për vlerësimin e situatës për ditën e nesërme. Mund të them se vlerësimet e kryetarit të komitetit komunal<sup>6</sup> ishin reale, veçanërisht reale ishin ato të aktivistëve politik. Edhe data 20 kaloi kryesisht mbi bazën e vlerësimeve të cilat i dëgjua nga kryetari i komitetit komunal dhe shokëve aktivistë politik të Komitetit Krahinor. Dita e diel ishte karakteristike për sa vijon: deri në ora 2 pas dite, që relativisht qetë në qytet, a ishte kështu shoku Koroshec. Për atë kohë ne e mbajtëm mbledhjen e zgjeruar të Kryesisë së Komitetit Krahinor, ku u pajtuam se çfarë duhet të punohet më tej. Në ora 4,50 pasdite, një grup prej 100-200 të rinjve u nis nëpër qytet, me parullat karakteristike: “Rroftë Lidhja e Komunistëve”, “Tito-partia” etj. Dal nga dalë shfaqeshin edhe parullat, parullat e papranueshme me përmbajtje armiqësore. Grupi i njëjtë i provokonte studentët e Qendrës studentore. Unë mund të them, ndërsa këtë e kanë edhe në informatë shokët e Kryesisë së KQ LKJ-së dhe Kryesisë së RSFJ-së, se studentët në mënyrë shumë korrekte dhe të dinjitetshme, e hodhën poshtë provokimin e atij grupi. Nuk iu bashkëngjiti asnjë student. Atëherë ata marshuan nëpër

<sup>5</sup>Sinan Hasani, anëtar i Kryesisë së RSFJ-së.

<sup>6</sup>Të Prishtinës.

qytet, defiluan etj. Mund të them, se ai grup ishte një ndër grupet më këmbëngulëse, grupi i cili u shndërrua në rreth 800, më vonë 1.000 etj. Grupi pati një ndalesë të vogël para Komitetit Krahinor dhe atëherë e orientuam në “Boro e Ramizi” që edhe me atë grup të zhvillohet bisedë. Kjo për arsye se qëndrimet i kishim të përbashkëta që aksioni politik të udhëhiqet deri në fund. Atë mbrëmje edhe ai grup u shpërnda, mirëpo ajo ditë ishte karakteristike për nga paraqitja e parullave të papranueshme. Pati edhe parulla “Kosova Republikë” etj. Thash se, e hëna ishte një ditë relativisht e qetë, në përjashtim se patëm marshim në këmbë të një grupi nga Rahoveci dhe grupe të të rinjve, ndërsa të martën ishte një qetësi e plotë dhe, ja arritëm deri në ditën e sotme.

Tash më lejoni që në pika të shkurta të them se për çfarë u pajtuam në Kryesinë e Komitetit Krahinor rreth asaj se çfarë duhet punuar rreth analizës dhe vlerësimit të atyre ngjarjeve në Kosovë. E kemi regjistrin e të gjitha parullave, të cilat qenë shfaqur gjatë ditës së parë, të dytë e të tretë etj., edhe të pranueshmet edhe të papranueshmet. Nuk do të futesha në atë, në ditën e parë, të dytë dhe të tretë qenë brohoritur parullat të cilat ishin në linjën e LK-së. Ditëve tjera, përkatësisht të fundit dhe ditën e parafundit të këtyre ngjarjeve ishte karakteristike për përpjekjen e theksimit të parullave të papranueshme. Të gjitha ato i kemi të dokumentuar, nëse do të nevojitej ndonjëherë, e me siguri se do të nevojitet për analizat tona, atyre nuk do u shmangemi.

Për çfarë u pajtuam në atë mbledhje të fundit të Kryesisë së KK të LK të Kosovës, ku mori pjesë edhe shoku Koroshec dhe shoku Sokolloviq nga KQ i LK të Serbisë? Themeltarja ishte për sa vijon: që në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme të Komitetit Krahinor të shkojmë me informatën për ngjarjet dhe se në atë informatë të përpiqemi ta japim elementin themelor për analizën e ngjarjeve në Kosovë. Ky ishte dakordimi i parë dhe thamë se në mbledhjen e jashtëzakonshme të KK-së të shkohet menjëherë pasi do të krijoheshin kushtet për të, sepse nuk e kemi ditur se çfarë do të na sillte dita e nesërme. Ne i kishim vlerësimet, mirëpo sërish i patëm rezervat edhe ndaj atyre vlerësimeve tona dhe të organeve tjera. Në këtë mënyrë edhe filluam të punonim, shokët që erdhën në ndihmë u përpoqën të punojnë, ne e patëm një letër, atë ditë grumbullonim letra etj. Kuptohet se shokët nga KQ-ë, të cilët erdhën të na ndihmonin se nuk ishin të kënaqur me atë që patëm mundësi të punonim deri në atë moment, sepse ishim në aksion të përhershëm. U dakorduam që menjëherë në terren të iniciojmë një aktivitet politik intensiv mbi bazën e Platformës së qartë për bisedime me komunistët, me njerëzit punëtorë dhe me qytetarët. Elementet e Platformës na e ofroi

Shtjefan Koroshec dhe ato elemente i pranuar të gjithë ne që ishim prezentë, mbi bazën e asaj Platforme diçka kemi zgjeruar dhe janë duke u zhvilluar biseda në të gjitha organizatat e Lidhjes së komunistëve edhe nëpër degët e LSPP-së etj. Ndërsa dëshmi për këtë është prezenca e anëtarëve të Komitetit Qendror në terren. Ata erdhën dhe e panë atë letër, panë se çfarë po punohet. Pra, atë e respektuam menjëherë dhe vepruam sipas marrëveshjes.

Së treti, u dakordua që pas mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit Krahinor do të shkonim në KK-ë me analizë të ngjarjeve. Kjo është karakteristika e tretë, përkatësisht konkluzioni i tretë. Pati edhe disa konkluzione tjera që nuk janë me rëndësi për t'i parashtruar këtu para jush. Por, ne tërë aktivitetin tonë e orientuam në atë drejtim, pa marrë parasysh se dy kryesitë, Kryesia e KK të LK të Kosovës dhe Kryesia e KSA të Kosovës, janë të cingjara sa i përket numrit. Për momentin Kryesia e KK numëron vetëm 8 anëtarë, ndërsa Kryesia e KSA të Kosovës ka vetëm pesë anëtarë. Pra, duhet ta kuptoni se në situatë të tillë ka qenë shumë rëndë të punohet materiali dhe të merrej pjesë në terren, e njëkohësisht edhe të udhëhiqet dhe të koordinohet aksioni

E re është ajo që thash në fillim, tërë ajo që u kërkua dhe u insistua nga unë që të vij urgjentisht për Beograd. Unë e respektoj edhe KQ LKJ-në dhe Kryesinë e tij, unë e vlerësoj dhe e respektoj Kryesinë e RSFJ-së, por u thashë: shokë, mos më ngarkoni, sepse dje u mbajt Kuvendi i KSA të Kosovës. Nga unë u insistua të vij parmbremë, unë i luta që të mos më fusin në atë situatë për arsye se nga Kryesia e RSFJ-së kemi një kërkesë që të sigurohet puna normale e Kuvendit të KSA të Kosovës, sepse pati frikë se do të bllokohej puna e Kuvendit të KSA të Kosovës, se nuk do i jepej pëlqimi për amendamentet e Kushtetutës së RSFJ-së. Së dyti, nuk e kam ditur se çfarë do më sjell dita e nesërme, prandaj i luta që të mos insistojnë të vij sepse e kemi një situatë të tillë. Dje morëm pjesë në Kuvendin e organizuar, kërkoj falje që po i paraqes detajet, por jam i detyruar që në fund t'i them përcaktimet tona. Morëm pjesë në Kuvendin e KSA të Kosovës edhe pse patëm informata të tilla se do të jetë kjo apo ajo. Kuvendi i KSA të Kosovës u dha pëlqim amendamenteve të Kushtetutës së RSFJ-së me duartrokitje frenetike, pa asnjë reagim të vetëm. Ndërkohë, vlerësimet si në nivelin e vendit<sup>7</sup>, si në nivelin e Serbisë, vënin në dukje për një bllokadë të mundshme etj.

Dje u insistua sërish të vij në Beograd dhe sërish duke mos i ditur saktësisht arsyet. Unë e dija se do të bisedonim rreth vlerësimeve

---

<sup>7</sup>Fjalën e ka për RSFJ-ën.

dhe siç po e shihni arrita në Beograd tërësisht i papërgatitur për të biseduar në një forum aq me rëndësi, siç është Kryesia e KQ LKJ-së. Mirë, njeriut nuk i nevojitet shumë kohë për t'u përgatitur për këtë, tërë atë që e kam elaboruar deri më tash, e kam thënë mbi bazën e asaj që e kam parë unë personalisht dhe mbi bazën e inspektimit të gjendjes që e kemi marrë nga organet e Lidhjes së Komunistëve të Kosovës dhe organeve tjera si dhe të organeve për punë të brendshme si në rangun e Krahinës, po ashtu edhe në rangun e komunave.

Mund të pohoj se në mënyrë të vazhdueshme i kemi informuar dy kryesitë së të RSFJ-së po ashtu edhe të Republikës së Serbisë. Këtyre ditëve kemi prezencë dhe aktivitet të madh nga anëtarët e Komitetit Qendror dhe të disa anëtarëve të Kryesisë së Komitetit Qendror të LKJ-së. Për ato që po i them këtu, të njëjtat ia kam thënë edhe shokut Sllobodan Millosheviq dhe shokut Pero Gračaninit, se diçka është duke ndodhur në Republikën e Serbisë, mendoj në Krahinë, ndërsa as ditën e parë, as të dytën e as të tretën nuk e pa të arsyeshme askush nga Komiteti Qendror i LK të Serbisë të jetë prezent dhe të shkojë poshtë për të biseduar me njerëzit. Këtë mos e kuptoni si akuzë, kjo është vërejtja ime personale. Pati njerëz nga Kryesia e KQ LK të Serbisë në mbledhjet e Kryesive etj. Unë flasë për mungesën e veprimtarisë politike të shokëve nga KQ të Serbisë poshtë me masat, nuk flas për mos prezencën nëpër mbledhje. Unë i shpreh mendimet e mia, e nëse gaboj do të kërkoj falje dhe do të tërhiqem, por them se kjo ka qenë kështu. Ne e kuptojmë se mbajtja e Konferencës së LK të Serbisë është qëllim i rëndësishëm sa i përket përgatitjes etj., mirëpo nuk kemi mundur ta kuptojmë se në një situatë të tillë të mos ketë një angazhim politik më të madh nga shokët e KQ të Serbisë në terren, në mesin e njerëzve dhe në mesin e komunistëve.

Mbrëmë unë, por edhe shokët nga Kryesia e KQ të Jugosllavisë, kanë marrë një dokument i cili emërtohet – Vlerësimet dhe qëndrimet rreth situatës në Kosovë. Me siguri se këtë e keni lexuar edhe ju. Ndërsa është e sigurt se një ndër elementet mund të jetë, marrëdhëniet e përgjithshme në shoqëri. Ndërsa, elementi i dytë mund të jetë marrëdhëniet e përgjithshme në shoqëri pas mbledhjes XVI të KQ LKJ-së. Elementi i tretë mund të jetë sesi ne e paramendojmë atë se kush ka ndikuar në situatën e krijuar në Kosovë. A ka mundur të ndikonte edhe jo-uniteti ynë për disa çështje në RS të Serbisë, a ka mundur të ndikoj debati kushtetues, përkatësisht situata e cila ishte prezent para zhvillimit përfundimtar, zhvillimit të organizuar të debatit kushtetues dhe një sërë elementesh tjera. Nuk do t'i theksoja të gjitha. Një ndër elementet mund

të ishte dhe ajo se a kemi zhvilluar aksion politik të mjaftueshëm në luftën kundër nacionalizmit e separatizmit shqiptar, i cili element është i rëndësishëm që mund t'i shërbente asaj analize.

Të mos zgjatëm më shumë, të mos i numërojmë edhe elementet tjera.

Ne dhe e mbajtëm mbledhjen e Kryesisë së KK të LK të Kosovës dhe Kryesisë së KSA të Kosovës, ku i kam informuar se përse duhet të shkojmë për Beograd dhe çfarë mendojmë ne, çfarë propozojmë ne dhe nuk propozojmë e mendojmë asgjë të re, përveç asaj që u pajtuam në mbledhjen e fundit të Kryesisë së KK të LK të Kosovës në prezencën e shokut Koroshec, kjo është e para.

E dyta, nëse në një situatë të tillë do të ishte e pamundur të mos thuhej diçka në Konferencën e Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, ndërsa unë gjithashtu konsideroj se nuk është e mundur të mos thuhet diçka për ngjarjet në Kosovë. Ne mendojmë se mund të jepet një informatë për ngjarjet, qoftë kësaj, siç e dhashë unë apo më të mirë.

Të jepen elemente, disa elemente të cilat do të mund t'i japim, por tash nuk i kemi ato elemente, të cilat do të mund të shërbenin për vlerësimin e situatës, dhe të mos shpejtojmë me vlerësimet politike të ngjarjeve. Ju mua mund të ma zini për të madhe për atë që them se nuk duhet shpejtuar, por këtë nuk e them për shkak oportunitetit tim personal, por për shkak asaj që vërtet mendojmë se me këtë rast duhet ta japim vlerësimin e saktë të ngjarjeve që të mund më vonë të udhëheqim aksion politik të intensifikuar për progresin e të gjithëve në Kosovë.

Për sa u tha më sipër, mendimi ynë është që kjo vlen edhe për shqiptarët, serbët, malazezët dhe për të gjithë të tjerët. Nëse në këtë moment kjo nuk respektohet, në atë rast duhet shfrytëzuar edhe autoritetin e Komitetit Qendror të LKJ-së. Për këtë le ta jep vlerësimin KQ i LKJ-së, e jo që tash nga fillimi të kemi dallime e gjithësesi se për këtë çështje do t'i kemi, jo për çështjen e ngjarjeve, por për çështjen e asaj se vlerësimet a duhet të jepen në këtë moment apo më vonë dhe kjo do të ketë ndikim shumë të papërshtatshëm në situatën e përgjithshme në Kosovë. Gjithçka që ka ndodhur këtyre ditëve, e kësaj t'i shtohet edhe elementi i jo unitetit tonë, jam i bindur se kjo do të ndikonte edhe më tej në procesin e shpërnguljes së serbëve e malazezëve, por do të ndikonte edhe në pamundësinë e mobilizimit më të thelluar të shqiptarëve në luftën kundër nacionalizmit e separatizmit shqiptar dhe të mos e zgjasë më shumë. Shokë unë e përfundova, unë edhe një herë kërkoj falje për fjalimin tim të pa sistemuar, me bindje se ju këtë do ta merrni parasysh për shkak situatës që unë u gjeta.

Kryesuesi:

Faleminderit.

Marko Orlandiq<sup>8</sup> ka pyetje.

Urdhëroni.

Marko Orllandiq:

Si e vlerësoni tash zhvillimin e mëtutjeshëm të situatës?

Remzi Kolgeci:

Sa u përket vlerësimeve politike kjo përbën një çështje, ndërsa çështje të dytë paraqesin vlerësimet e sigurisë, mirëpo si njëra po ashtu edhe e dyta, duhet të jenë si të them shtyllë për udhëheqjen e aksionit të mëtutjeshëm. Ne, p.sh., patëm vlerësime për ditën e hënë se do të ketë përfshirje, përkatësisht demonstrata masive të studentëve nëpër rrugë. Këto vlerësime ishin nga shokët e organeve të sigurimit. Ne në mbrëmjen paraprake, para atyre vlerësimeve zhvilluam aksion politik gjatë mbrëmjes nëpër qendrat studentore, i kemi zgjuar studentët, për ta parë disponimin e tyre. Mund të them se në asnjë qendër studentore ku profesorët i zgjonin studentët, nuk pati as edhe incidentit më të vogël, por se studentët patën një sjellje korrekte ndaj informatave të profesorëve. Ndërkohë, unë në ora 12 të natës isha duke biseduar me dekanët, rektorin dhe prorektorët. Këtë e tregon edhe informata e tyre. Të nesërmit isha edhe në aktivin politik të Universitetit.

Të hënë nuk patëm asnjë incident te studentët, as në mensën studentore e as në ligjërata etj., patëm vetëm një paralajmërim për grumbullimin e studentëve të nacionalitetit serb e malazias, tubim protestues në lidhje me deklaratën, përkatësisht të ndonjë deklarate të Azem Vllasit, ku paska thënë se në ato tubime të studentëve kanë qenë prezent edhe serbët dhe malazezët etj., d.m.th., të hënë nga ana e studentëve nuk patëm asnjë incident, si nëpër mensat studentore, po ashtu edhe nëpër fakultete, qendrat studentore, ndërkohë ne patëm një vlerësim krejtësisht të kundërt. Unë këtë e flas për arsye se në këto momente është vështirë dhe shumë e rrezikshme të jepen vlerësime të caktuara, ndërkohë të ndodhë diçka tjetër. Mirëpo, flas për një vlerësim që e patëm nga ana e shokëve, nga organet e sigurimit e cila për fatin e mirë të të gjithëve nuk qe realizuar në tërësi, por vetëm se ishte prezent. Vlerësim të tillë të ngjashëm patëm edhe dje.

Tash të shohim se çfarë në të vërtetë ndodhi. Mos vallë ndikoi, siç thonë disa, faktori i kohës, për arsye se atë ditë binte shi e borë, apo ka ndikuar diçka tjetër, a thua bëhet fjalë për aksionin politik etj. Deri te kjo duhet të arrihet pas një hulumtimi konkret të gjendjes. Çfarë mund të

---

<sup>8</sup>Anëtar i Kryesisë së KQ LKJ-së.

ndodhë nesër, unë personalisht mendoj se në këtë moment atje poshtë<sup>9</sup> është prezent një aksion politik shumë i fuqishëm dhe intensiv, ky është mendimi ynë. Unë personalisht mendoj se nëse vazhdohet aktiviteti intensiv politik, të bëhet përkufizimi i pozitives që ishte prezent, nuk ka asgjë pozitive kur grumbullohen njerëzit nëpër rrugë, pa marrë parasysh se për çfarë bëhet fjalë, dhe të jem më i qartë, pa marrë parasysh se për cilin nacionalitet bëhet fjalë. Ju garantoj dhe jam tërësisht i bindur se do të përzihen forcat e ndryshme armiqësore, forca armiqësore nga pozita e nacionalizmit e separatizmit shqiptarë në radhë të parë, dhe ato janë të përziera aty diku, që për këtë do ta dëshmojë analiza e sigurimit se deri ku dhe në cilat përmasa, se do të kemi sukses nëse intensifikohet aksioni politik, se në këtë mënyrë do të arrijmë ta ndërpresim shprehjen e pakënaqësisë nëse kjo është vetëm pakënaqësi dhe tërë ajo të orientohej në suazat e sistemit politik dhe të sistemit politik të institucioneve. Përndryshe, në në Kosovë kemi folur, por sa ia kemi arritur kjo përbën diçka tjetër, se shprehja e pakënaqësisë në këtë mënyrë nuk është e pranueshme. Me këtë logjikë janë duke vepruar në terren edhe aktivistët tanë politik. Se a do t'ia arrijmë, unë shpresoj se po nëse do të ketë unitet, bashkëveprim në aksion, e në rast se s'ka unitet atëherë nuk do ia arrijmë, nëse do të kemi dallime rreth kualifikimeve dhe ngjarjeve në Konferencën e Lidhjes së Komunistëve të Serbisë nuk mund të garantoj, nuk mund të pohoj, por supozoj se kjo do të shkaktoj dëm të madh, dëm politik dhe se do të kemi një situatë të kundërt nga ajo që ne e dëshirojmë sot apo nesër.

Kryesuesi:

Vasil Tuporkovski<sup>10</sup> dëshiron të parashtoj pyetje.

Vasil Tupurkovski:

....Kur isha...gjatë mbrëmjes...shokët në Kryesi të Komitetit Krahinor thanë se...janë të organizuar edhe atë të organizuar jashtëzakonisht mirë, tubimet, tubimet masive dhe kjo vetëm mbi bazën...e ditës së parë...edhe t'i në fillim theksove se mund të bëhet fjalë për një organizim... një definicion konkret rreth kësaj. Ku e shihni dhe ku qëndron ai organizim i tyre...

Remzi Kolgeci:

Shoku Tupurkovski nëse do ta dija se cilët subjekte janë, unë fare nuk do të flisja aq gjatë, por do të thosha për ato çështje që më pyete mua. Unë në pjesën time përfundimtare thash se çfarë mund të merret

<sup>9</sup>Mendon për Kosovën.

<sup>10</sup>Anëtar i Kryesisë së RSFJ-së.



nga elementet që do të shërbenin për analizën e ngjarjeve. Unë nuk mund të them se tërë ajo ka qenë spontane dhe këtë nuk mund ta pohoj askush, mirëpo se çfarë ka ndikuar që të jetë aq masive, kjo duhet të dëshmohej. Prandaj duhet të vijmë deri te ajo analizë, e cila do ta tregoj realitetin për tërë atë që ka qenë prezent në Kosovë, por edhe brenda një viti të fundit. Nëse do të ishte e mundur që në këtë situatë këtë ta shtrojmë në mënyrë reale, e ta shohim se sa ka ndikuar ajo që emërtohet, që dikur kemi thënë, nacionalisti shqiptarë po heshtë, apo që ngandonjëherë kemi thënë se nacionalisti shqiptar nuk është në aksion.

Për sa u tha më sipër, në këtë situatë, në këtë moment, unë shoku Tupurkovski nuk mund të them, se cili element ka ndikuar, ky apo ai. Unë vetëm se i përmenda disa elemente të cilat do të shërbenin si bazë për hartimin e asaj analize.

Kryesuesi:

Fjalën e ka shoku Marko Orllandiq.

Marko Orllandiq:

Unë mendoj se Remziu dha një vlerësim të situatës së tanishme për sa i përket atyre parashikimeve, dhe unë e kuptoj plotësisht për ato vlerësime të tija tërësisht të logjikshme. Unë, kërkoj falje, por a ka mundësi Remziu, të na tregoj se çfarë konkretisht propozohet për momentin për të qenë të sigurt në vlerësimet, se në ato dokumente tona çfarë ka në drejtimin e ndërmarrjes së masave e aktiviteteve për të pasur një kontroll dhe për ta normalizuar situatën, jashtë asaj që pak a shumë është e njohur.

Kryesuesi:

Fjalën e ka Millan Pançevski<sup>11</sup>.

Millan Pançevski:

Unë do ju lutesha nëse mundeni...nuk dyshoj, nuk besoj se unë do të mund të qëndroj deri në fund. Unë kam menduar se vallë Kryesia e KK ka një elaborim rreth asaj që paraqesin kërkesa themelore në këto tubime, në këto grumbullime, në këto demonstrata, siç i keni emërtuar. Mendoj se kjo është me rëndësi krahas atyre parullave të cilat t'i na i tregove. Këto, a i keni të themi, të sintetizuar, se cilët janë kërkesat bazë të atyre demonstratave?

Remzi Kolgeci:

Personalisht unë mendoj, shoku Orllandiq, se në këtë moment duhet të gjithë ta përforcojnë aksionin politik, edhe shokët nga Kryesia e KQ LKJ-së, e në radhë të parë aktivitetin tonë atje. Nuk mund të thuhet

---

<sup>11</sup>Anëtar i Kryesisë së KQ LKJ-së.

asnjëherë se është i mjaftueshëm aktiviteti politik dhe se nuk do të kishte nevojë të bëhet edhe diçka më shumë. Shokët nga KQ LK të Serbisë pas atij aksioni, aksionit politik në Lidhjen e Komunistëve dhe në strukturat tjera të vijnë deri te ato elemente, të cilat, si të them, do të mund të shërbenin për një analizë politike reale. Kjo është e para. Ky është mendimi im dhe përafërsisht drejtimi ynë, ashtu jemi pajtuar.

E dyta, të intensifikohet veprimtaria e organeve përkatëse për të ardhur deri te vlerësimet e sakta, vlerësimet e sigurisë, të argumentuara, reale, të gjithanshme. Unë nuk dëshiroj të flas këtu për atë pjesë, me siguri se për këtë do të flasim në Kryesinë e RSFJ-së, shoku Dizdareviq, unë jam në situatë që në Kryesinë e RSFJ-së të flas pak më gjerësisht për disa çështje, të cilat për mua në këto momente nuk janë të qarta, porse ka nevojë të bisedohet edhe për atë pjesë në Kryesinë e RSFJ-së.

Shokut Pançevski, se çfarë ka mbizotëruar, cilët janë kërkesa bazë. Unë flas nga ajo që ka pasur mundësi të dëgjohet dhe nga ajo që është mundur të shihet. Unë nuk flas nga ajo se çfarë ka qenë ndoshta diku nën tokë apo diku në ndonjë provincë apo të ndonjë grupacioni, apo te ndonjë individ. Brohoritjet bazë ishin parullat “Tito partia”, e them këtë me përgjegjësi, “Rroftë Lidhja e Komunistëve”. Kërkesa bazë ka qenë revidimi i Vendimit tonë të KK-së lidhur me Kaçushe Jasharin dhe Azem Vllasin, kjo ka qenë bazë. Mund të them, se bie fjala, në natën e parë pati parulla individuale “Kosova Republikë”, por mund të them se masa reagoi menjëherë dhe e identifikoi atë njeri, i cili e brohoriste atë parullë dhe dy tre individë. Menjëherë janë kapur, menjëherë ai grupacion prej dy tre vetëve u arrestua nga organet e sigurimit dhe u ndërmorën masa e nevojshme. Kjo është e para.

E dyta, mund të them, se bie fjala, minatorët e kapën një njeri për fyti dhe e dëbuan jashtë turmës, sepse e identifikuan se nuk ishte i tyre dhe se nuk ishte minator, dhe se kishte filluar të parashtroj kërkesa të cilat nuk ishin në përputhje me kërkesat e minatorëve.

Mund të them se në disa komuna pati edhe asi parulla, parulla armiqësore, por nuk mund ta them atë se ajo masë që ka qenë aty se ato parulla i ka pranuar etj. Unë thash se e kemi regjistrin e të gjitha parullave të papranueshme, përkatësisht parullave armiqësore e nëse u intereson juve, mund t’i lexoj. Ato janë mbi bazën e dokumentit që e kemi pranuar nga shokët e organeve të sigurimit. Për secilën komunë, në cilën do kohë, kush e ka bartë etj. Nëse ka nevojë, shoku kryetar, unë këtë do ta lexoj. Mendoj, se nuk ka nevojë.

Kryesuesi:

Fjalën e ka shoku Jakov Llazarevski<sup>12</sup>.

Jakov Llazarevski:

Pyetje, por unë propozoj, që pyetjet t'ia dorëzojmë shokut Koroshec e ndoshta edhe shokut Çullafiq. Mendoj se është tepër e rëndësishme, duke e pasur parasysh, atë që shoku Kolgeci e përkujtoi se ne shpesh në debatet dhe analizat tona për situatën në Kosovë, kemi folur se përse shqiptarët nuk janë aktivë? Përse heshtin? Kjo personalisht na ka befasuar të gjithëve. Ky faktor befasues si është vlerësuar në Komitetin Krahinor? Për këtë arsye se edhe në atë mbledhje të jashtëzakonshme kemi folur se janë befasuar të gjitha forcat e organizuara. Nuk është e mundur që asnjë komitet komunal të mos kishte ofruar ndonjë të dhënë se çfarë po përgatitet dhe ku është orientuar pakënaqësia e të gjithë atyre, të cilët kishin filluar të dalin në rrugë gjatë kohës së mbajtjes së mbledhjes së Kryesisë. Sepse, shikoni, ne e kemi pritur se diçka do të ndodhte, se do të zgjohet ai aktivitet, ai angazhim i shqiptarëve. Dhe më habitë se në fillim parullat “Rroftë Lidhja e Komunistëve”, mbështetje ndaj mbledhjes së XVII etj. Si nuk kemi arritur, si ka mundësi që udhëheqja zyrtare partiake dhe shteti nuk kanë arritur nëse jo 40 mijë, së paku 10 mijë t'i ngrenë dhe të protestonin për shkak krimit që ndodhi në kazermën e Paraqinit? Si është e mundur që askush nëse jo 40, së paku 5 apo dy mijë të mos çohen e ta dënojnë tërë atë që ka ndodhur në Kosovë, sa u përket të drejtave, të sigurisë pronësore e personale: Si sqarohet kjo? Ky është momenti më vendimtar për vlerësimin e situatës, por edhe për aksionin politik. Për këtë, Komiteti Krahinor e ka të domosdoshme të kryej vlerësimin, ndërsa ne këtu të debatojmë. Dhe si është e mundur që organet kompetente, organet e sigurimit që ata në një aspekt të bashkëveprojnë me komitetet komunale dhe me forcat tjera të organizuara. Mirëpo, si ka mundësi të ndodhë që organet e sigurimit të mos e informojnë askënd dhe për asgjë, të mos grumbullojnë të dhëna me rëndësi që të mund të dihet se çfarë mundet dhe në cilën mënyrë kjo mund të ndodhë, sepse gjithçka ka qenë nën vëzhgim, dhe ka pasur mundësi të parashikohet gjithçka. Ka mund të parashikohet edhe i tërë aktiviteti dhe të bëhet përforsimi, sepse pati baza dhe informata të bollshme se do të ndodhte diçka që në fakt edhe ndodhi.

Remzi Kolgeci:

Shoku Llazarevski ka plotësisht të drejtë, kur thotë se ka pasur mundësi që të ndodhte tërë kjo. Unë mund gjithashtu të them, se si ka mundësi tërë kjo të ndodh. Dhe tërë ajo që u tha personalisht nga shoku

---

<sup>12</sup>Kryetari i KQ LK të Maqedonisë dhe anëtar i Kryesisë së KQ LK të Jugosllavisë.

Llazarevski, mund të shërbejë si element për atë analizë. Si pati mundësi kjo të ndodhte. Për këtë sot të jepet përgjigje, unë nga kjo mund vetëm të them diçka. Mirëpo, kjo neve sot do na vononte pak si më gjatë, e të mos ishte vërejtur se diçka te shqiptarët, jo te shqiptarët, por te kuadri, madje edhe nga vetë kuadri. Gjithçka që ka ndodhur muajve të fundit, vitin e fundit edhe ajo çfarë është e vërtetë, edhe ajo çfarë nuk është e vërtetë se a ka ndikuar, apo nuk ka ndikuar, unë them, gjithsesi se ka ndikuar në disponimin, përkatësisht në pa disponimin. Prandaj i theksova disa elemente. Ta marrim shtypin e vitit të fundit, unë nuk them, as “Politikën”, as këtë, as atë, por shtypin në përgjithësi. Ta analizojmë shtypin gjatë këtij viti të fundit, ta analizojmë tërë atë që shkonte në atë drejtim që ishte negative ndaj kombësisë shqiptare në Kosovë. Nuk them, gjithçka, por një pjesë të saj, ndërsa kemi edhe disa elemente tjera, për çka ndoshta do të arrijmë deri te një disponim. Ndërsa unë pajtohem plotësisht me ju, në pyetjen se si ka pasur mundësi që ne të mos e organizonim një tubim të tillë, për ta shprehur pakënaqësinë tonë ndaj situatës që është në Kosovë, përkatësisht ndaj situatës në të cilën gjenden serbët dhe malazezët etj. Ky është orientimi ynë, nevoja e jonë e djeshmja, e sotmja dhe e nesërmja, edhe pse nevojitet të punohet edhe më tej, ndonjë tubim protestues të shqiptarëve, duhet të jetë tubim protestues për pozitën e serbëve, malazezëve dhe të tjerëve në Kosovë. Unë për këtë pajtohem në tërësi. Mirëpo, tash situata është e tillë, e kur prishet makina (vetura-Q.L.), është një shprehje popullore, atëherë ka mjaft rrugë. Unë jam i bindur se makinat nuk janë të prishura në tërësi, se ka mundësi ende të udhëtohet, prandaj të përpiqemi të gjejmë rrugë të përbashkëta, që ato makina të mos na prishen edhe më shumë.

Dobrosav Çullafiq:

Unë gjithashtu, do të thosha se është i saktë konstatimi se ka dështuar Shërbimi i Sigurimit Publik në Sekretariatit Krahinor për Punë të Brendshme. Ne këtë e kemi konstatuar edhe në mbledhjen e Sekretariatit Krahinor, me rastin e qëndrimit tim së bashku me sekretarin republikan për punë të brendshme të Serbisë, në mbrëmjen ndërmjet të premtës dhe të shtunës. Atëherë në atë mbledhje me atë aktiv punues konstatuam se Shërbimi është befasuar me formën e këtillë të reagimit, demonstrimit.

Pra, ky konstatim u dha edhe në Sekretariatit Krahinor edhe në Sekretariatit Federativ edhe në Sekretariatit Republikan të Serbisë. Për këtë arsye, ne kemi formuar një komision, në nivelin më të lartë profesional. Në të janë nënsekretarët e sigurimit shtetëror të SPB-së Federative dhe nënsekretarët të sigurimit shtetëror të SPB-së

Republikane, me shokët nga Shërbimi për sigurimin shtetëror të Krahinës, ata tashmë janë atje dhe iu është dhënë për detyrë ta përcaktojnë se a thua ka dështuar Shërbimi, përkatësisht si ka mundur të ndodh që Shërbimi të dështojë deri në ato përmasa, saqë dalja në rrugë të punëtorëve dhe ai shpërthim i protestave të zhvillohet në atë mënyrë në mbarë hapësirën e Krahinës, ndërsa Shërbimi të mos dijë për këtë. Shpresoj se komisioni këtë punë do ta kryej brenda pesë-gjashtë ditëve.

Borisav Joviq<sup>13</sup>:

Shoku Stipe e sqaroi në detaje se çfarë kemi punuar të gjithë në terren, ndërsa veç kësaj ne këtu merremi vazhdimisht për këto çështje. Ne që jemi në Beograd, si të thuash, nuk ka ditë e të mos ulemi e të mos e vlerësojmë situatën mbi bazën e të gjitha informatave të cilat i marrim për çdo ditë nga poshtë dhe më shumë herë brenda ditës nga shokët të cilët janë poshtë në terren, por edhe nga shokët nga Komiteti Krahinor dhe Kryesia edhe prej shokëve nga Komiteti Qendror dhe Kryesia, siç e dini, është në rrjedhë.

Sa i përket shërbimit të sigurimit, shoku Raif<sup>14</sup> foli për këtë, i kemi dërguar dy ekipe të forta, njëra do të qëndroj një kohë më të gjatë, ndërsa e dyta ka për detyrë t'u përgjigjet pyetjeve: kush i organizoi dhe përse i organizoi, ndërsa roli, përkatësisht vendi i kryerjes së detyrës së shërbimit për siguri edhe në atë situatë... Unë mendoj se do të ishte e gabuar nëse ne tash do të thoshim se gjithçka që ka marrë pjesë në ato demonstrata në ditën e parë dhe ditën e dytë e me siguri edhe ditën e tretë kanë qenë me disponim armiqësor, se aty në shumë çka ka qenë reaksioni, mirëpo se demonstratat në ditën e tretë, të dytat sipas netëve dhe të tretat për nga dita morën karakter të rrezikimit të rregullimit kushtetues, rendit dhe qetësisë dhe se kanë dalë jashtë kontrollit unë mendoj se kjo është e saktë dhe se ..duhet të nisemi. Faleminderit.

Kryesuesi:

Gjithashtu Stane<sup>15</sup> duhet të shkojë.

Remzi Kolgeci:

Shoku Stane, unë theksova se para vete i kam të gjitha parullat përfshi edhe numrin e parullave që u brohoritën e të cilat nuk janë në linjën e LK-së. Ato parulla nuk i kam shpikur unë, ato janë dokumente të cilat janë marrë nga ana e shokëve nga organet e sigurimit, prandaj thash se nëse do të ketë nevojë të bëhet krahasimi i ditës së parë, të dytë e të

---

<sup>13</sup>Anëtar i Kryesisë së RSFJ-së.

<sup>14</sup>Dizdareviq.

<sup>15</sup>Stane Dollanc, anëtar i Kryesisë së RSFJ-së.

tretë, unë nuk mund të pajtohem, për arsye se dita e parë karakterizohet vetëm me ardhjen e minatorëve, kjo është dita e parë, dita e tretë, përkatësisht nata e tretë, nata e tretë në vetvete pranon elemente si të them që mund të karakterizohen se ka më shumë shprehje, kjo është e para. Pra, sa u përket parullave dhe sa i përket tërë asaj ekzistojnë dokumentet dhe mund të bëhet krahasimi, ekzistojnë xhirime televizive.

Unë nuk dëshiroj të fsheh asgjë dhe ja përse u paraqita për fjalë. Gjithçka që ekziston le të vendoset në tavolinë dhe le të shihet dhe le të dëshmohet, unë nuk jam kundër asgjëje, e cila çon kah ajo që është reale, por edhe nëse dëshironi që për ato fjalë..le të jetë ashtu. Mirëpo, dëshiroja ta thosha këtë. Shoku Dollanc thotë se kam qenë i njëanshëm, unë nuk dëshiroja të isha i njëanshëm dhe nëse ka nevojë mund tash të flas më gjerësisht, këtë mund ta bëj, mirëpo unë u përkufizova në njërën karakteristikë dhe në tjetrën. Ja, unë e përfundova dhe do të isha më i lumturi nëse do ta dija se kush është organizatori i atyre, jo vetëm unë por të gjithë ne. Mirëpo, derisa të vijmë te ai, ka një periudhë paraprake, se çfarë ka ndikuar që erdhi te ajo. Më falni e përfundova.

Remzi Kolgeci:

Në fund unë jam i detyruar, nuk do ju lodhi shumë gjatë. Unë dëshiroj t'u falënderohem edhe shokut kryetar dhe juve që më keni dëgjuar me vëmendje. Unë në fillim theksova se me çfarë qëndrimi kam ardhur. Ky nuk është qëndrimi im, por i të dy kryesive.

Së dyti, fare nuk e kam kontestuar se nuk ka nevojë të thotë diçka Konferenca e LK të Serbisë. E as që mund ta kontestoj. Mirëpo, se sa jam kuptuar, kjo është një çështje tjetër. Unë shpresoj se jam kuptuar nga shumica e pjesëmarrësve. Atë që e kam thënë sot, mbrëmë ua kam thënë edhe shokëve nga KQ e Serbisë. Ju lutem, mos ma zini për të madhe nëse e them këtë, se për gjithçka që do të ndodhë në Konferencë, unë shpresoj se do të jetë gjithçka në rregull, unë dua të jetë gjithçka në rregull, jo vetëm unë, por ndoshta të gjithë ne këtu, por edhe në Kosovë, nëse ajo do të ndikoj negativisht në aksionin politik të mëtejshëm, unë mund t'ua them këtu se do të mendoj sinqerisht për veprimin tim të mëtejshëm.

Kryesuesi:

Për çfarë mendoni? Për dorëheqjen e imponuar?

Remzi Kolgeci:

Po, këtë e mendoj shumë seriozisht. Më lejoni të them vetëm këtë. Në këtë situatë, unë dhe të tjerët të cilët kanë ngelur në Kryesi, pas kësaj mënyre të punës, pas një marrëveshje kërkohet sërish një marrëveshje tjetër, mendoj për atë marrëveshje që e kemi arritur

bashkërisht, unë ende nuk mund ta kuptoj, ka mundësi të jem ende i dehur, i lodhur...

Kryesuesi:

Ke kujdes, ne këtu nuk kërkuam as çfarë marrëveshje tjetër.

Remzi Kolgeci:

Unë mendoj për shokët nga KQ e Serbisë. Nuk mendoj për Kryesinë e KQ LKJ-së.

Ju lutem ta përfundoj, kam të drejtë ta them. Me siguri se më nuk do të jem në këtë Kryesi, ju lutem ta them me përgjegjësi. Këtë e them me përgjegjësi<sup>16</sup>.

---

<sup>16</sup>Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHRM), F. KK i LK të Kosovës (fondi i pasistemuar), K. 390A.





## **RECENSIONE**



## **NJË VEPËR MADHORE PËR HISTORINË DHE HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE**

**(Fatmira Musaj, “*Republika shqiptare 1925-1928*”, Tiranë:  
Akademia e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë, 2018)**

Historiana shqiptare Fatmira Musaj, është e njohur për kontributin e rëndësishëm që e ka dhënë për historinë shqiptare, e të viseve të tjera shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë së sotme. Fatmira Musaj është autore e shumë artikujve me karakter shkencor, pjesëmarrëse dhe kontribuuese në veprimtari të shumta shkencore dhe shoqërore-kulturore, në tubime, tryeza, simpoziume dhe konferenca në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Ndër studimet më të njohura të saj janë ato që i kushtohen një personaliteti të shquar siç është Isë Boletini, të kurorëzuara me veprën shkencore “Isa Boletini”, botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë. Ky studim sot e kësaj dite mbetet pikë reference për të gjithë studiuesit të cilët merren me këtë personalitet dhe kohën e tij. Një studim tjetër me rëndësi të jashtëzakonshme ka të bëjë me gruan shqiptare në kohën e transformimeve të mëdha shoqërore e politike gjatë periudhës së formimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar “Gruaja në Shqipëri (1912-1939)”, botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë.

Ndërsa, monografia që tani i ofrohet botës shkencore dhe jo vetëm asaj, me titull: “*Republika shqiptare 1925-1928*”, botuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë, 2018, paraqet kulmin e angazhimit profesional të historianes Fatmira Musaj. Ta themi që në fillim që kjo monografi me diapazonin tematik dhe nivelin shkencor të trajtimit paraqet një vepër që i bënë nder historiografisë shqiptare dhe avancon të njëjtën.

Kjo vepër shkencore përmban 7 kapituj të cilët mbulojnë të gjithë lëmit e zhvillimeve qenësore të një shteti në konsolidim e sipër e që në

zhargonin historik e njohim si periudha e “regjimit të Ahmet Zogut”. Por, siç del nga ky studim, kemi të bëjmë me periudhën e ndërtimit të bazës së një shteti modern shqiptar. Apo siç e thotë edhe vetë autorja, “kjo është një etapë e veçantë e periudhës së historisë së Pavarësisë dhe konsolidimit të shtetit shqiptar (1912-1939)”.

Studiuesja Fatmira Musaj, në kapitullin e parë me titull: “Rënia e Qeverisë së Iljaz Vrionit dhe përpjekjet për t’u rikthyer në pushtet (qershor-dhjetor 1924)”, trajton ashpërsimin e krizës politike dhe largimin e Qeverisë jashtë vendit, kalimin e Zogut në Jugosllavi dhe organizimin e emigracionit politik për t’u rikthyer në pushtet, largimin e Qeverisë së Nolit dhe kthimin e Ahmet Zogut në Tiranë, mesazhet e Shoqërisë “Vatra”, për bashkëpunim dhe stabilitet politik në Shqipëri.

Në kapitullin e dytë, autorja vë theksin mbi “Ahmet Zogun në krye të Republikës shqiptare”, ku vihet në pah ringritja e institucioneve të shtetit të tronditur shqiptar dhe forcimi i karakterit kushtetues-juridik i Republikës shqiptare, rritjet dhe dobësitë. Në këtë kapitull, autorja me mjeshtri trajton zgjedhjet parlamentare dhe ato për pushtetin vendor, masat për shtrirjen e autoritetit të shtetit në vend dhe sigurimin e regjimit. Në këtë kapitull të mbushur me fakte interesante, përshkruhet aksioni për mbledhjen e armëve, vendosja e censurës ndaj shtypit dhe ndalimit të aktivitetit të shoqërive politike e kulturore, kuvendin me bajraktarët, amnistitë, synimet dhe rezultatet e saj. Nuk ka mbetur pa u përfshirë në libër edhe themelimi i Bankës Kombëtare Shqiptare dhe siguri i huas si dhe përjashtimi i Myfit Libohovës nga jeta politike e administrative e vendit.

Në kapitullin e tretë kemi të bëjmë me zhvillimet në lëmin e politikës së jashtme të shtetit shqiptar, ku tematika e marrëdhënieve me Italinë imponohet si kryesorja. Brenda këtij kapitulli trajtohen ngjarjet me rëndësi, si: animi i Ahmet Zogut drejt Italisë, kryengritja e Dukagjinit si shtysë për nënshkrimin e Paktit të Parë të Tiranës, jehona e këtij paktit, lëvizja e Beogradit për rrëzimin e Ahmet Zogut (1927), Ceno Bej Kryeziu dhe eliminimi i tij dhe pakti ushtarak italo-shqiptar apo siç njihet në zhargonin historiografik Pakti i Dytë i Tiranës, nëntor 1927.

Kapitulli i katërt hedh dritë mbi aspekte të politikës së jashtme të shtetit shqiptar që ka të bëjë me marrëdhëniet e Shqipërisë me shtetet tjera si me Jugosllavinë, Greqinë, Turqinë dhe Egjiptin. Këtu prijnë marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1925-1928, çështja e Shën Naumit dhe Vermoshit dhe impakti i kësaj çështjeje në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, marrëdhëniet me Greqinë, marrëdhëniet me Turqinë në vitet

1925-1928 dhe qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj shqiptarëve të Egjiptit 1925-1928.

Në kapitullin e pestë shtjellohet hollësisht “Administrata shtetërore dhe reformimi saj”. Kapitulli në fjalë trajton organet qendrore ekzekutive të shtetit dhe reformimin e tyre, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe reformimin e saj, riorganizimin e forcave të armatosura në Shqipëri (1925-1928), riorganizimin e xhandarmërisë shqiptare, riorganizimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, reformën në sistemin financiar të shtetit, riorganizimin e Ministrisë së Punëve Botores dhe Bujqësisë, ristrukturimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe riorganizimi i gjykatave, Dhoma e Deputetëve e Senati dhe riorganizimin e Pushtetit Lokal.

Të dhëna me interes autorja i sjellë në kapitullin e gjashtë i cili mbulon “Aspekte të zhvillimit ekonomik”. Aty jepen të dhëna për trashëgiminë në fushën ekonomike, politikat ekonomike në vitet 1925-1928, aspektet të zhvillimit të bujqësisë, komunikacionin, gjendjen dhe zhvillimin e tij, si dhe zhvillimi i tij pas nënshkrimit të Paktit të Parë të Tiranës, shërbimi i Postë-Telegraf-Telefonave (PTT) dhe tregtia e jashtme.

Kapitulli i shtatë: “Arsimi, komunitetet fetare dhe shëndetësia (1925-1928)”, është kapitulli i fundit i librit që shtjellon gjendjen arsimore në Shqipëri në vitin 1925, komunitetet fetare, pavarësimi, konsolidimi dhe qëndrimi i shtetit shqiptar (1925-1928), përpjekjet për pavarësimin e Kishës Ortodokse Shqiptare, normalizimin e marrëdhënieve me Kishën Katolike: lidhja e konkordatit me Vatikanin; shërbimi shëndetësor: trashëgimia në shërbimin shëndetësor. Po ashtu, libri ka pjesën përmbyllëse, si: bibliografinë dhe treguesin e emrave.

Pra, siç po shihet nga vetë përmbajtja e këtij studimi, kemi të bëjmë me një studim/ sintezë shkencore për një ndër periudhat më të rëndësishme të ndërtimit të shtetit modern shqiptar apo ndryshe të periudhës së Republikës shqiptare 1925-1938.

Ndër të tjera, ajo që bie në sy dhe frymëzon siç ndodhi dhe me mua gjatë analizës së këtij studimi, është sasia dhe cilësia e burimeve arkivore dhe të tjera si duke shfrytëzuar një gamë të gjerë të literaturës historiografike, bibliografi, indeksin e emrave etj. Ky fakt, pra hulumtimi fundamental shkencor është determinues në cilësinë e këtij studimi dhe pasqyron një përkushtim e kulturë profesionale rrallë të parë në historiografinë tonë. Në fakt ky aspekt i angazhimit plotëson mozaikun e portretit të Fatmira Musajt si një studiuese rigoroze e objektive.

Vepra është përpiluar me kujdes të madh, duke e shtjelluar lëndën në mënyrë sistematike, si: shfrytëzimi, interpretimi dhe analiza e saktë e burimeve, duke u mbështetur në metodologji shkencore-bashkëkohore të përmbledhura në 773 faqe, që ndahen në shtatë kapituj, sipas një renditjeje kronologjike, me sqarime dhe plotësime përcjellëse, me dokumente, duke shfrytëzuar një gamë të gjerë të literaturës historiografike, bibliografi, indeksin e emrave etj. Të gjitha këto e bëjnë studimin në fjalë sa të vlefshëm për shkencë aq edhe praktik për lexim dhe shfrytëzim, andaj ka një varg arsyes të forta që këtë monografi e bëjnë joshëse, jo vetëm për studiuesit e historisë dhe gjurmuesit, por edhe për ata që ushqejnë simpati dhe dashuri për studimin e së kaluarës.

Siç shihet, prof. Fatmira Musaj arriti t'i ofrojë lexuesit një tërësi të historisë së pasur shqiptare, duke e shtruar atë mbi baza objektive, për shkak se tematika e zhvillimeve ekonomiko-shoqërore të Shqipërisë në vitet 1925-1928, ishte mjaft komplekse dhe e gjithanshme. Andaj, autorja ka bërë kujdes që të mënjante përsëritje a mendime kontradiktore. Studimi është një përpjekje, ku veç politikës së jashtme të shtetit shqiptar, i është kushtuar vëmendje e plotë edhe zhvillimeve të brendshme, si ato politike, ekonomike, veprimtarinë e Qeverisë dhe të Ahmet Zogut për të çuar përpara reformat e nisura në vitet 1920-1924, për konsolidimin e shtetit shqiptar, deosmanizimin e jetës shtetërore, për ta orientuar atë drejt zhvillimeve me prirje perëndimore. Andaj, historiania Fatmira Musaj i ka studiuar në detaje qëllimet e reformave që u ndërmorën në fushën legjislative, në ngritjen e administratës së shtetit, të asaj qendrore e lokale, në arsimin kombëtar, të institucioneve fetare, të forcave të armatosura, në shëndetësi etj.

Qasja e historianes Fatmira Musaj ndaj problemeve shkencore të shtruara në këtë studim monografik, është origjinale. Ka stil të bukur, plot gjallëri dhe përfundime të thukëta, për zhvillimet e Shqipërisë në kohën e Republikës. Saktësisht, autorja në 481 fusnota dhe shënime nënteksti ka trajtuar paralelishtme tekstin kryesor edhe të dhënat parësore që ndjekin rrjedhën e ngjarjeve me qëllim njëjtësimin e tyre dhe të proceseve në formë unitare.

Nga studimi "Republika shqiptare 1925-1928", të autores Fatmira Musaj, fitohet një pasqyrë e qartë e zhvillimeve kryesore në Republikën shqiptare 1925-1939, shprehur me një gjuhë profesionale dhe lehtësisht të kuptueshme nga lexuesi. Edhe kjo anë e këtij studimi, flet për kulturën, pedanterinë gjuhësore dhe për një përkushtim e punë të madhe të autores së tij.

---

Ky studim si një vepër madhore për një periudhë të rëndësishme, dinamike e fundamentale në funksionalizimin e shtetit modern shqiptar brenda viteve 1925-1928, me vlerat e tij shkencore njëkohësisht paraqet kontribut të shquar në avancimin e historiografisë shqiptare.

**Alban DOBRUNA**





## **BALLAFAQIMET E NJË HISTORIANI ME ROBËRINË DHE HISTORINË**

(Jakup Krasniqi, *Ballafaqime historike për çlirim dhe bashkim kombëtar*, Instituti i Historisë-Prishtinë, 2019)

Dr. Jakup Krasniqi është emër i njohur jo vetëm në Kosovë, por në gjithë hapësirën kombëtare shqiptare. Është i njohur për veprimtarinë e tij atdhetare dhe politike, i njohur si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, por edhe si ministër, parlamentar dhe kryeparlamentar i Republikës së Kosovës. Është doktor i shkencave historike, por edhe autor i disa librave në fushën e historisë. Gjurmët e tij janë të dukshme jo vetëm në këto veprimtari, por edhe fushën profesionale dhe intelektuale. Produkt i veprimtarisë së tij profesionale dhe intelektuale është edhe libri *“Ballafaqime historike për çlirim dhe bashkim kombëtar”*.

Libri *“Ballafaqime historike për çlirim dhe bashkim kombëtar”* është goxha voluminoz. Voluminoz jo vetëm për nga numri i faqeve, por edhe për nga temat, çështjet e problemet që trajton. Libri është një përmbledhje shkrimesh të ndryshme: kumtesa, seminare, trajtesa, fjalë rasti, punime diplome, ese, recensione etj., të sistemuara në kapituj, nënkapituj dhe njësi tjera më të vogla. Ato janë shkruar në periudha, kohë dhe rrethana të ndryshme. Disa prej tyre janë të botuara më herët e disa botohen për herë të parë. Pavarësisht kur janë shkruar a botuar shkrimet, ato e plotësojnë njëra-tjetrën, nxjerrin në sipërfaqe shumësinë e temave të trajtuara, librin e bëjnë më gjithëpërfshirës, por edhe e pasurojnë atë me të dhëna të reja, me dëshmi e me referenca.

Temat e çështjet e trajtuara këtu, për arsye praktike mund t'i ndajmë në tri grupe. Në grupin e parë hyjnë ato tema që janë trajtuar e stërttrajtuar në kohë e periudha të ndryshme (Epoka dhe figura e Skënderbeut, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë etj.). Grupit të dytë i përkasin temat që nga historiografia nuk janë trajtuar sa duhet. Edhe kur janë trajtuar, nuk janë trajtuar duke u bazuar vetëm në kritere profesionale, por më shumë në kritere politike dhe ideologjike (tema e

Kosovës dhe lufta e saj për liri e bashkim kombëtar). Në grupin e tretë hyjnë temat që nuk janë trajtuar (për disa arsye) pothuajse aspak nga historiografia shqiptare dhe jo vetëm (Lufta e UÇK-së, familja Jashari dhe roli i saj në luftën për liri etj.).

Disa nga temat kryesore me të cilat autori është i lidhur më shumë, të cilat edhe kanë zënë vendin kryesor në këtë libër, janë: Epoka e Skënderbeut, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, luftërat ballkanike, Kongresi i Lushnjës, Revolucioni i Qershorit 1924, Luftërat ballkanike, Kosova mes dy luftërave botërore, gjatë Luftës së Dytë Botërore, nën administrimin ushtarak 1945, nën sundimin e Jugosllavisë së Titos e të Millosheviqit, deri te çlirimi dhe shpallja e pavarësisë së saj etj. Përveç këtyre temave, në këtë libër kanë zënë vend të konsiderueshëm edhe shkrimet për disa personalitete historike. Si personalitete historike, që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë dhe me të cilët autori është jashtëzakonisht i lidhur (prandaj disave prej tyre ua kushton nga dytri shkrime), janë: Skënderbeu, Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, Avni Rustemi, Shaban Polluzha, Adem Demaçi, Adem Jashari, Ahmet Haxhiu etj. Shumica e shkrimeve kanë karakter afirmativ, vlerësues.

Në faqet e këtij libri parakaloj në mendime, pikëpamje, ide dhe opinione të ndryshme, të shtrira në kohë dhe hapësirë, me të cilat autori është shërbyer, natyrisht duke pasur për bazë literaturën profesionale, të cilës edhe i është referuar. Literatura profesionale këtu nuk është referenca e vetme. Sepse, për shkak të natyrës së disa shkrimeve, herë pas here citon edhe vargje e strofa këngësh, por edhe thënie e proverba popullore; vargje dhe strofa nga poezi të poetëve të traditës sonë letrare dhe kombëtare; thënie, mendime dhe ide të dijetarëve botërorë. Ai nuk ka komplekse as kur e citon Marks, Engelsin a Leninin, as kur e citon Barletin, Nolin, Hasan Prishtinën e ndonjë tjetër. Ai ka guximin intelektual të pozicionohet më shumë se një herë për ndonjë ngjarje a personalitet. Të pozicionohet dhe ta shprehë mendimin e tij të ndryshëm nga të tjerët, pavarësisht literaturës, pavarësisht referencave. Disa prej personaliteteve historike i quan korifinj të lirisë, të demokracisë etj. Kështu, jo rrallë, duke përdorur edhe figura stilistike (kryesisht epitete dhe krahasime), disa nga korifenjtë i quan: *yll lirie e pavarësie, krenari të kombit e njerëzimit, trima Arbërie e legjendar lirie* etj. Mirëpo, disa që nuk i takojnë grupit të korifenjve, herë i quan "*bastard*", herë "*jurishnik*", herë "*kryemizor të Shqipërisë*" etj. Përkundër këtij diskursi, Krasniqi me profesion është historian. Është historian i kohës dhe rrethanave. Është historian i angazhuar. Historian që është ballafaquar me

ngjarje, rrethana e personalitete historike, disa prej të cilëve i ka njohur personalisht dhe ka bashkëpunuar me ta.

Në këtë libër është gërshetuar përvoja jetësore, profesionale dhe intelektuale. Mirëpo, kryefjalë e kësaj vepre është *ballafaqimi*. Ballafaqimi historik në luftën për liri dhe bashkim kombëtar. Ballafaqimi historik me historinë, me ngjarje, data, epoka e personalitete historike. Këto përbëjnë brumin, esencën e librit, fokusin kryesor. Prandaj, togfjalëshi ballafaqim historik ose “ballafaqime historike”, siç del në titull të librit, duhet kuptuar në kontekst të shtrirjes në kohë dhe hapësirë, në kontekst të kohës dhe rrethanave të kësaj lufte. Duke trajtuar tema të ndryshme, ai ballafaqohet edhe me historinë e historisë, edhe me ngjarje historike dhe histori të ngjarjeve historike, por edhe me personalitete historike dhe historinë e tyre; me politika e ideologji të ndryshme; me dije e koncepte të ndryshme për ngjarjet, për temat, për historinë. Historiani Krasniqi është ballafaquar njëkohësisht me historinë dhe me robërinë, por edhe me vetveten. Është ballafaquar qoftë si lexues i pasionuar i historisë, qoftë si dëshmitar, pjesëmarrës a protagonist në ngjarje të caktuara historike, por edhe si shkruar i historisë.

Gjatë përgatitjes të disa prej këtyre shkrimeve të përfshira në këtë libër, autori nuk ka mundur t’i shmanget ballafaqimit me vetveten. Ballafaqimi me vetveten nuk ka qenë më pak sfidues se në ballafaqimet tjera gjatë veprimtarisë së tij atdhetare, politike, por edhe profesionale. Pozita e tij ka qenë sfidues, sepse në raste të caktuara është detyruar të pozicionohet, të shprehë mendimin dhe pikëpamjen e vet për ndonjë ngjarje a personalitet. Kështu, duke u gjendur në mes të dy rivalëve (subjektivizmit dhe objektivizmit), ka bërë përpjekje që t’i përafrojë aq sa ishte e mundur në këso rastesh, megjithatë ka raste kur ai lëkundet sa në njërin anë (subjektivizëm) sa në anën tjetër (objektivizëm). Se sa ja ka arritur t’i harmonizojë, t’i pajtojë këta “dy rivalë” mbetet ta vlerësojë lexuesi.

Këto e ballafaqime të tjera, sikur ia kanë imponuar edhe gjuhën me të cilën shkruan, edhe mënyrën e ligjërimit me të cilën ligjëron, diskursin, fjalorin, shprehjet, madje edhe figurat stilistike jo shumë të zakonshme në diskursin e historianit.

Autori, disa nga shkrime të shkruara para tri-katër dekadash, qofshin ato të botuara apo të pabotuara, të cilat i ka përfshirë në këtë libër, ka pasur mundësi t’i ndryshojë, t’i redaktojë, reduktojë a plotësojë. Mirëpo, siç duket, nuk ka dashur t’i ndryshojë, qoftë edhe kur ka pasur nevojë për një gjë të tillë. Sepse, nëse këto i lexojmë në kontekstin e kohës dhe rrethanave kur janë shkruar, ato kanë kuptim, kanë

domethënien e vet, sepse janë ruajtur të pandryshuara nga koha kur janë thënë e shprehur. Këto, në njëfarë mënyre janë një dëshmi e sinqeritetit të autorit, e guximit të tij dhe gatishmërisë së tij që të sakrifikojë nga jeta e tij personale dhe profesionale. Sepse, në rrugën për çlirim e bashkim kombëtar, ai u ballafaqua me shumë sfida, me shumë të panjohura, të cilat ja cenuan edhe veprimtarinë profesionale, madje edhe lirinë. Lirin e tij dhe popullit të cilit i takon. Liria dhe bashkimi i të cilit janë alfa dhe omega e këtij libri. Natyrisht edhe ideali jetësor i veprimtarit të çështjes kombëtare, veteranit të luftës së UÇK-së, politikanit dhe historianit Jakup Krasniqi.

**Miftar KURTI**

*Prishtinë, dhjetor 2019*

## KONTRIBUTI ATDHETAR I ESAT MYFTARIT

(Esat Myftari, *Vdekja jote jeta ime*, Prishtinë, 2020, f. 287)

Esat Myftari është një qytetar pejan, i lindur më 1940, në një familje të vjetër të këtij qyteti. Veprimtaria e tij letrare u shqua qysh në bankat sa ishte gjimnazist si dhe më vonë në përvojën e tij të shkurtër në gazetën “Rilindje”. Kalvari i jetës së tij deri më 1991 ishte i kushtëzuar nga ndikimet politike të rrethanave në Shqipëri ku ai emigroi më 1963. Kurse, nga viti 1991 u bë deputet i Parlamentit të parë pluralist, e më 1992 me fitoren e Partisë Demokratike të Shqipërisë emërohet nga ministri i jashtëm Alfred Serreçi, drejtor i Drejtorisë për Diasporë. Afërsisht 2 vjet ishte edhe ambasador i Shqipërisë në Riad, pastaj përkthyes dhe pas vitit 2000 iu përkushtua tërësisht shkrimeve. Kontributi i tij është me vlerë në fushat historiko-politike pasi zbërthej tema të ndryshme duke i rumbullakuar me libra të frytshme. Po veçojmë disa nga librat e tij: “Emrush Myftari”, Pejë, 2011; “Enver Hoxha dhe Kosova”, Tiranë, 2016; “Esat Mekuli profili politik”, Prishtinë, 2018, si dhe libri i tij fundit që po e prezantojmë “Vdekja jote, jeta ime”, botuar në Prishtinë më 2020.

### I. Struktura dhe përmbajtja librit

Libri është konceptuar nga autori në kapituj dhe sythe të shumta që mbulojnë hollësisht jetën e tij të pasqyruar kronologjikisht sipas ngjarjeve. Mund të themi që ky libër është i strukturuar mjaft mirë dhe paraqet një mënyrë të veçantë të trajtimit të ngjarjeve në formën e romanit historik ose më mirë kujtimeve nga vështrimi letrar dhe historik. Filli i kujtimeve nis që nga pranimi i tij gazetar për pjesën e *Sindikatave* në “Rilindje”.

Tek Myftari shohim një vendosmëri të madhe për punë gjatë harkut kohor afërsisht 2-vjeçar. Sa jetonte në Prishtinë vërejmë një vendosmëri për mbrojtjen e interesave kombëtare shqiptare në Kosovë

me anë të retorikës dhe veprimeve me individë të kohës së Kosovës. Me interes, por edhe fatkeq na paraqitet figura e tij si gazetar në një mbledhje të maketit të Prishtinës, ku ai spikati si vrojtues i ngjarjeve dhe së këndejmi morri pjesë në diskutime të ndryshme që ndodhën aty. Në Prishtinë e para Plenumit të Brioneve, temat e ndërlikuara që lidheshin me Shqipërinë staliniste ishin tejet koshiente për kosovarët që jetonin në Kosovë, por të rrezikshme për prekje të këtyre temave. Me guximin e tij, autori në mbledhjen e lartpërmendur pasi u diskutua edhe për situatën politike në Shqipëri dhe raportet me vendet e ndryshme të këtij vendi, u konfrontua me sekretarin e Sindikatave të Kosovës, një serb shovinist i kohës.

Sa ishte gazetar me porosinë e vajzës së axhës së tij, Luljeta Myftarit (vajza e atdhetarit të shquar Emrush Myftarit) i dha porosi të interesohej për fatin e ekzekutimit të babait të saj. Në libër vërejmë kontakte të autorit me personalitete që e kishin njohur figurën e Emrushit dhe kishin dijeni mbi fatin e tij tragjik, më 1945. Zaten pas një periudhe gazetari i ri nuk e pa vetën pjesë të “Rilindjes” pas situatës së rënduar dhe trysnisë që e ndjente gjithnjë në këtë institucion, por edhe në Kosovën e sunduar nga serbët. Kështu shohim veprimet e tij të para si djalë me guxim të madh kombëtar dhe intelektual. Ai do të ndërmerr hapat si në vijim: a) do të jap dorëheqje nga “Rilindja”; b) do të organizon mbledhje të përbashkëta me interes kombëtar me grupin e tij të Pejës për bashkërendimin e veprimeve politike që shpinin në alternativat për zgjidhjen e çështjes së Kosovës përmes Shqipërisë, ku ata si grup po edhe shqiptarët e Kosovës shihnin të vetmen shpresë.

Grupi i tij ilegal i përbërë nga shokë të idealit, si: Abdylaziz Daci, Esat Myftari, Ramadan Shala, Shefqet Deçani, Adem Bajri, diskutuan gjatë në shtëpinë e këtij të fundit për veprimet e mëtejme për çështjen kombëtare. Sa shohim në libër në bisedat e gjata u vendos që të votohet mes anëtarëve dhe së këndejmi Esat Myftarit i ra hise që të shkonte në Shqipëri dhe të vë në alarm shtetin shqiptar. Anëtarë i grupit, Ramadan Shala, siç mësojmë nga përshkrimet e autorit, e morri përsipër ta bëjë dërgimin e tij për në kufi me një njeri të njohur.

Copëza interesante në libër shpalosen kur autori i librit arrin që të dal në Shqipëri në vitin 1963 përmes Junikut. Nga këtu libri merr një dimension tjetër, sepse ngjarjet rrodhën krejt me intensitet tjetër. Autori me sinqeritet të madh na tregon që në arritjen e tij në kufi pastaj bartjen në Tropojë, ai menjëherë u vu re nga autoritetet shqiptare.

Në mënyrë kronologjike dhe tematike po japim një tablo siç e paraqet autori jetën e tij në Shqipëri. Libri na njofton se që në momentin e parë

në Tropojë erdhi për vizitë i ngarkuari i Komitetit Qendror të PPSH-së për punët e Kosovës. Ndërmjet Sakip Hoxhës i ngarkuar me këto punë dhe autorit shkëmbyen biseda të ndryshme në Tropojë lidhur më ardhjen tij në Shqipëri. Djalin e ri e dërgojnë në Tiranë në një vend të sigurt që të këtë një strehim të përkohshëm.

Pjesë me rëndësi shohim edhe te mosrespektimi i rregullave të jetës nga autori, i cili thekson se doli në Tiranë që të shoh qytetin, por në fakt ishte i udhëzuar që t'i bindej urdhrit mos të dilte jashtë zonës ku jetonte. Tirana iu duk tejet e ndryshme nga çfarë e kishte përfytyruar. Koloneli Hoxha në një natë, me sa vërejmë në libër, e ftoi në një darkë me rëndësi Myftarin, ku diskutoi gjatë për jetën e tij, çështjen e Kosovës, Jugosllavinë etj. Autori thekson se me autoritetet e Shqipërisë nga organet që merreshin me Kosovën diskutoi për personalitetin e Adem Demaçit, grupin e tij, si dhe në fund të konkluzioneve të autorit vërehet një zhgënjim i theksuar mbi Shqipërinë. Organet e shtetit marrin vendim ta dërgojnë në qytetin e Përmetit për jetesë. Për djalin e ri në këtë qytet, ka mundësinë të këtë edhe një jetë tejet modeste imtime me një vajzë, të njihet me persona si Ziso Vangjeli etj.

Në libër shpalosen edhe bisedat e tij me shokun e ngushtë, Namik Lucin. Këto diskutime u bënë në Tiranë pas bisedave që ju bënë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Me sa vihet në dukje, Myftari i tregoi që brenda në Shqipëri nuk ka kurrfarë lëvizje për çështjen e Kosovës dhe se dëshira e tij ishte që të riatdhesohej në Kosovë, sepse zhgënjimi i tij ishte i madh. Emocione të mëdha paraqiten nga autori kur më 1968, në Shqipëri për vizitë i erdhi nëna e tij. Me shumë elokuencë na paraqitet një rrëfim i singertë kur pas një periudhe ata shihen edhe diskutojnë për shumë punë familjare, për shokët e grupit etj.

Jeta e tij përfundimisht do të merrte kahe tjetër pasi autorin e dërgojnë përsëri për transferim në qytetin e Lezhës. Në këtë qytet mbajti kontakte me personalitete si Bep Gargjolën, prof. Gafurrin me të cilët diskutonte çështje historike për revistën "Studime historike", për autoritetin e Fadil Paçramit etj. Me interes për lexuesin është edhe vajtja e tij në Ambasadën jugosllave ku kishte shprehur me herët dëshirën që të riatdhesohej për Kosovë. Në këtë ambasadë do të bisedonte me stafin e saj për shumë momente të jetës së tij, që nga bankat shkollore, të gjimnazit, për familje të vjetra nga Peja si Gazikolloviq, Rajoviq, jetën studentore, por edhe diçka që ai e mësoi aty - dënimin e grupit të tij ilegal në Kosovës. Këtu me sa vërejmë ndërmjet autorit dhe autoriteteve jugosllave u diskutua edhe riatdhësimi i tij për Kosovë i cili në fund mbeti pezull. Në Lezhë ai pati mundësinë të njihet edhe personalitetin

erudit Angjelin Saraçi, një shkodran që kishte njohuri të mëdha nga shkencat humanitare. Ndërmjet të dyve bisedat kryesore rrjedhin për problemin e Kosovës. Myftari në Lezhë pati mundësinë që të shoh nga larg degradimin e figurës së Todi Lubonjës. Por, nga teksti shohim se shoqëria e tij ishte tejet e ngushtë me Shefqet Kelmendin një emigrant kosovar. Autori fillon të zbërthej detaje me vlerë ku shton se kosovarët në Shqipëri kishin dosjen me emërtimin 2A dhe pothuajse të gjithë ishin tëurvejuar nga Sigurimi i Shtetit.

Një periudhë interesante për jetën e tij do të ishte edhe puna si arsimtar në qytetin e Lezhës, ku me një përkushtim do t'i qasej punës së mësimdhënësit, ku do të jepte maksimumin për nxënësit e tij lezhjanë. Siç duket, autoritet e Sigurimit të Shtetit e kishin mbushur mendjen që kosovarin e ri ta vëzhgojnë tërë kohën dhe ta shohin si të padëshirueshëm nga momenti kur ai u zhgënjye me shtetin shqiptar; nga momenti kur shprehu dëshirën që të riatdhesohej në Shqipëri; nga momenti kur shoqërohej me personalitetet e njohura të lartpërmendura; nga momenti kur Shqipëria bënte rolin e ndërmjetësuesit të çështjes së Kosovës fatkeqësisht në dëm të shqiptarëve të këtij vendi. Autori me shumë korrektësi na tregon se shoku i tij Shefqet Kelmendi pasi ishte ndjekur, vëzhguar nga bashkëpunëtorët "Shqiptari", "Sazani", "Pinoku" etj., ishte arrestuar nga autoritet shqiptare. Nga këtu jeta e tij ishte në rrezik, sepse autori nga çasti në çast priste që ta arrestonin për veprimtari "propaganduese ndaj shtetit shqiptar". Autori e kishte ditur mirë që ai do të arrestohej së shpejti dhe këtë e kishte diskutuar me të dashurën e tij Rozin, me të cilën natën e fundit e kishin paraparë që do të vinin ta merrnin jo më larg se për pak orë. Në libër mësojmë se arrestimi i tij ishte i shpejtë nga Sigurimi. Ai u morr në një xhip dhe u vendos në hetuesi. Autoritetet shqiptare kishin vendosur ta sajnin situatën vetëm e vetëm të pengonin veprimtarinë atdhetare të individëve kosovarë për zgjidhjen e Kosovës.

Nga shënimet e Myftarit shohim se në bisedat që u bënë, kryehetuesi Gjoleka në fillim zhvilloi një bisedë jo të këndshme me autorin. Aty vihet në dukje edhe kërcënimi i parë i hetuesit duke i thënë se grupi i tij në Kosovë është dënuar me 9 vjet, kurse me nenin 73 të Kodit Penal të Shqipërisë, Myftari do të dënohej me 10 vjet burg. Në bisedat e paraqitura mësojmë se nga autori u kërkua një transformim ideologjik, kurse ky i fundit e kundërshtoi këtë gjë. Biseda të tjera të hetuesve, si Gligori, që do të zhvilloheshin, do t'i ofronin edhe fotografi të ndryshme nga jeta e tij në Kosovë etj. Pjesë tejet interesante në pasazhet e autorit shohim edhe në bisedat e bëra me hetuesit mbi



nacionalizmin, Namik Lucin, mbi takimin e tij me profesorët kosovarë Menduh Begolli dhe Ahmet Kelmendi etj. Kur po shihej që çështja po shkonte drejt një bashkëpunimi që nuk po sillte rezultate, ngase autori nuk po pranonte të bëhej bashkëpunëtor i Sigurimit, atëherë nga Tirana sollën edhe hetues tjerë, si Ilia Samara I cili bashkë me fletoret e autorit të mbajtura shënime në gjuhën gjermane. Hetuesi nga Tirana bashkë me Myftarin zhvilluan biseda të gjata mbi gjuhën gjermane dhe profesorin Vangjeli, i cili ia kishte mësuar këtë gjuhë. Pastaj, biseduan për Tomas Manin, kartelën bibliotekare, takimet me Ziso Vangjelin, letërsinë e veriut, vizitat e autorit te Lidhja e Shkrimtarëve, Stefan Cvajgun etj. Pjesë po ashtu me vlerë janë edhe përjetimet e tij në birucën e Lezhës ku pati diskutime me një burrë në dhomën e tij të vogël në lidhje me temat, si religjioni, kosovarët, masakra e shkurtit 1944 e kryer nga grupet e Xhafer Devës, Lidhja e Dytë e Prizrenit etj. Autori na njofton se në këtë birucë filluan t'i shfaqen edhe probleme serioze shëndetësore të cilat nuk u trajtuan seriozisht nga autoritetet e burgut dhe hetuesisë.

Pjesa e fundit e librit i përket gjykimit të autorit në Lezhë. Siç mësojmë nga përshkrimi që i bënë me përpikëri ngjarjeve, autori thekson se për ta bërë lëndën edhe më të ngjeshur me dëshmi të rrejshme, hetuesi ftoi në sallën e gjykimit kolegë të shkollës së tij me të cilët kishte punuar, pra nga hetuesia ishte vendosur që lënda për të sajohet me dëshmi të rrejshme dhe Esat Myftari të burgosej dosido. Këtu u paraqitën shumë dëshmitarë, ku shumica prej tyre folën gjëra të paqena për autorin, si p.sh. sekretari i shkollës i cili theksoi se Myftari ishte i dëmshëm, brum i huaj etj. Kurse, ndër të paktë njerëz që i përmend autori të cilët dolën në mbrojtje të tij, ishte Pjetët Luli, një arsimtar i cili me guxim kundërshtoi hetuesinë duke theksuar të vërtetën mbi veprimtarinë e personalitetit integral të Myftarit. Në vitin 1976, pas shumë ditëve diskutime me dëshmitarë të ndryshëm, më në fund u morr vendimi nga gjyqtarja e Tiranës, Flutura Tirana, e cila e dënoi atë me 10 vjet heqje lirie dhe konfiskim. Fundi i gjyqit edhe pse ishte i padrejtë, jo njerëzor, megjithatë autorit nuk i lëvizi qerpiku për veprimtarinë dhe jetën e bërë në Shqipëri.

Rëndësia e këtij libri është shumëdimensionale si dëshmi e gjallë e një njeriu që ka vepruar me ndërgjegje për gjetjen e mënyrave të zgjedhjes së çështjes së Kosovës për t'u larguar nga robërimi serb. Autori Myftari është ndër njerëzit e rrallë kosovar të burgosur që ka lënë një libër me vlera të mëdha në fushën letrare-historike. Pos tjerash, autori me këtë libër ka dhënë një kontribut të çmuar në fushën e krijimeve letrare si një penë e hollë e rrallë, por edhe një kontribut të parëzervë për

historianët që t'i shohin edhe kujtimet si burime të frytshme dhe serioze mbi shkrimin e historisë bashkëkohore pa dallime ideologjike dhe me një objektivitet shkencor.

**Kosovar BASHA**

**IN MEMORIAM**



## In memoriam

Prof.dr. Drita Bakija-Gunga  
1943-2020



Më datën 26 gusht 2020 morëm lajmin e hidhur për shkuarjen në amshim të studiueses së Institutit të Historisë në Prishtinë dhe profesoreshës universitare, prof. dr. Drita Bakija-Gunga. E njohur në botën akademike në Kosovë për mirësinë e saj, qetësinë, buzëqeshjen tipike, aftësinë për komunikim me të gjithë, përkushtimin, harenë, kënaqësinë e ligjëratave që na dhuroi ne studentëve të saj.

Drita Bakija-Gunga u lind në Gjakovë më 31 dhjetor 1943, në një familje të angazhuar në veprimtari të devotshme në rrugën e tarikatit bektashi. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në

vendlindje. Studioi Degën e Historisë në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës, ku u diplomua më 1973. Pas diplomimit u punësua si mësimdhënëse në Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë. Po në të njëjtin fakultet, më 1975 i regjistroi studimet pasuniversitare, me tezë të magjistraturës: “Lëvizja e grave të Kosovës në mes të dy luftërave botërore”, të cilën e mbrojti me sukses në vitin 1978. Pastaj, viti 1982 do të jetë vit i përfundimit të një grade tjetër shkencore, doktoratës, me tezën: “Gratë e Kosovës në periudhën e ndërtimit socialist 1945-1978”, njëherit duke u bërë gruaja e parë në Kosovë që merr gradën doktor i shkencave të historisë.

Në vitin 1975 u pranua në Institutin e Historisë të Kosovës si punonjëse shkencore. Ajo hyri në botën e shkencës duke pasur një

kulturë historike solide dhe një fond të gjerë njohurish kulturore që do t'i përcillte në lëvrimin dhe ndriçimin e të kaluarës së popullit shqiptar, ku shpejt bëhet e mirënjohur, nëpërmjet shkrimeve, studimeve, ligjëratave, seminareve dhe simpoziumeve shkencore që organizoheshin. Prof. Drita me aftësitë intelektuale, me virtyte morale, nuk kishte si mos t'i donte kulturën dhe artin. Prof. Bakia e takoi në jetë edhe dashurinë e saj, e cila u kurorëzua me martesë me poetin e madh, Fahredin Gunga, njëri nga më të shquarit e poezisë bashkëkohore shqiptare në Kosovë.

Në vitin 1986 botoi librin "Gratë e Kosovës në periudhën e ndërtimit socialist 1945-1978", Prishtinë: Instituti i Historisë. Ky është studimi, shtjellimi dhe botimi i parë në Kosovë për problematikën e femrës në trevat tona, të cilën historiografia shqiptare deri në atë kohë thuajse nuk i kishte kushtuar fare kujdes. Profesoresha në këtë monografi ka studiuar femrën shqiptare në Kosovë në të gjitha fushat e jetës, në aktivitetet e saj në rrjedhat shoqërore-historike të zhvillimeve të pas Luftës së Dytë Botërore, si arsimimi, inkuadrimi i saj në këshillat e punëtorëve, në organet drejtuese dhe punë drejtuese, si dhe në organizatat politike-shoqërore. Andaj, prof. Drita u bë prijatë e studimeve që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe pozitën e gruas në shoqëri, si promovimi i mundësive të barabarta, angazhim i përmirësimit të pozitës së gruas në edukim, shëndetësi, arsimim, kulturë, ekonomi.

Disa nga kontributet e prof. Drita Bakija-Gunga në këtë lëmi janë: Gratë e Kosovës në Lëvizjen Revolucionare 1933-1941, Kosova, nr.6, 1977; Gratë e Mitrovicës dhe të rrethit në Lëvizjen Punëtorë Revolucionare në mes dy luftërave botërore, Mitrovica dhe rrethina (monografi), Mitrovicë 1979; Gjendja dhe pozita e grave në Kosovë në Mbretërinë e Jugosllavisë dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, Dituria, nr.3-4 1982; Lidhja e Prizrenit dhe gruaja shqiptare, Konferencë kombëtare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Tiranë 1979; PKJ dhe puna me gratë e Kosovës në mes dy luftërave botërore, Përparimi, nr.2 1979; Disa aspekte të zhvillimit të Frontit Antifashist të grave të Kosovës e Metohisë, Kosova, nr. 13-14, 1985; Shtypi i grave për emancipimin e tyre në periudhën e ndërtimit socialist të Kosovës, Përparimi, nr.3 1987; Pozita shoqërore e gruas në Kosovë nga fundi i shekullit XIX deri më 1920, Kosova, nr. 17, 1988; Arsimi i femrës shqiptare dhe mendimi i rilindësve, 100-vjetori i Shkollës Shqipe të Vashave në Prizren, Prishtinë, 1993; Shpërngulja e shqiptarëve në Turqi, 1944-1966, Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1995), QIK, Prishtinë, 1997; Arsimimi i femrës ndër shekuj (Përmbledhje punimesh nga Simpoziumi i mbajtur në Tetovë, 7 Marsi - Dita e Shkollës Shqipe), Jehona, Shkup.

Prof. Drita Bakija Gunga ishte e angazhuar edhe si pedagoge në Degën e Historisë të Fakultetit Filozofik në Universitetin e Prishtinës, ku mbajti ligjërata nga lëndët “Metodika e historisë” dhe “Historia e gruas dhe e barazisë gjinore”. E them me bindje të plotë që kemi qenë fatlumë që kemi pasur mundësinë të kemi një profesoreshë brilante, që tejkalonte dimensionin e mësimdhënësës, mikes, qytetare e dorës së parë, që na frymëzonte në çdo moment me pasion, fisnikëri, dashuri, me mendje të hapur dhe mbi të gjitha me zemër të madhe.

Ajo ishte zgjedhur në kryesinë e parë të Shoqatës së Gruas në mars 1990, që më pas u transformua në Forumin e Gruas së LDK-së dhe me iniciativën e kryetarit të atëhershëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ibrahim Rugova, u propozua për kryetare të këtij forumi, por për shkak të karakterit modest nuk e pranoi, ngaqë kurrë nuk aspiroi për lavde po për pozita të larta.

Prof. dr. Drita Bakija-Gunga në vitin 2008 u pensionua, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e Institutit, si studiuese me aftësi shkoqitëse, stil elegant e qëndrime pozitive. Profesoresha u nda nga jeta më 26 gusht 2020, e rrethuar nga familjarët e saj të dashur. U varros në vendlindjen e saj.

**Alban DOBRUNA**





## In memoriam

Prof.dr. Izber Hoti

1948-2020



Izber Hoti u lind më 15 gusht 1948 në fshatin Revuçë afër Podujevës. Shkollën fillore, Normalen, Fakultetin Filozofik, Degën e Historisë, dhe studimet pasuniversitare i kreu në Prishtinë, ku magjistroi dhe doktoroi. Gjashtë vjet ishte mësues në Prishtinë, kurse në Institutin e Historisë së Prishtinës u punësua më 1976. Magjistroi me temën: “Prishtina dhe rrethina ndërmjet dy Luftërave Botërore”, në fund të vitit 1978, ndërsa doktoroi më 1981, me temën: “Lëvizja Nacionalçlirimtare në Prishtinë dhe

rrethinë 1941-1945”. Mori pjesë në tubime të ndryshme shkencore në Kosovë dhe jashtë saj, si dhe recensoi dhe redaktoi shumë punime e vepra shkencore nga fusha e historisë. Orientimi i studimeve të prof. Hotit ishte kryesisht historia e shekujve XIX-XX, periudha historike për të cilat u bë një nga historianët e shquar shqiptarë. Nga viti 2013 edhe pse në pension, ai vijoi edhe më tej të ishte aktiv në punën shkencore. Ishte autor i Projektit “Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX” në Institutin e Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Së fundmi, ai u bë pjesë e projektit më të ri shkencor “Historia e Kosovës”, ku mban autorësinë e disa njësive.

Ndër botimet e veçanta të prof. I. Hotit duhen përmendur: *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Prishtinë dhe rrethinë (1941-1945)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 1986; *Lëvizja ilegale antifashiste në Kosovën Lindore 1941- 1944*, Prishtinë, 1990; *Zhvillimi i mendimit historik dhe i*

*historiografisë*, Prishtinë, 1994; *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve (1930- 1941)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 1997; *Forcat e armatosura në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 1998; *Të dhëna të panjohura për Luftën e Dytë Botërore në Kosovë (1941-1945)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 1999; *Prishtina dhe rrethina ndërmjet, dy Luftërave Botërore*, Prishtinë: Faik Konica 2010.

Largimi i parakohshëm nga jeta i prof. I.Hotit në tetor 2020, në moshën 72-vjeçare është një humbje e madhe për familjen por edhe për kolegët në Prishtinë, Tiranë, Shkup e më gjerë. Gjithsesi emrin e prof. Hotit do ta bëjë të paharrueshëm vepra e tij.

Marenglen VERLI  
Beqir META  
Sabit SYLA

## **AKTIVITETE**

## **AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI”- PRISHTINË GJATË VITIT 2020**

### **VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE**

#### **1. 2. Organizimi i Konferencave dhe Sesioneve shkencore**

Bazuar në Planin e punës për vitin 2020, Instituti i Historisë nuk ka organizuar ndonjë aktivitet shkencor gjatë këtij viti, për shkak të pandemisë me Covid-19.

#### **1. VEPRIMTARIA BOTUESE**

Në kuadër të veprimtarisë themelore të Institutit, një vend të rëndësishëm zënë botimet e IH, të cilat janë realizuar si me poshte:

##### **1. Revista shkencore “Kosova, nr. 45”.**

Revista *Kosova*, revistë shkencore e Institutit të Historisë është një ndër botimet më të rëndësishme shkencore në fushën e shkencave historike. Duke vazhduar traditën e botimit të saj, me dalje një herë në vit, edhe këtë vit, revista *Kosova*, nr.45, 2020, përmban 8 artikuj shkencorë, 7 kumtesa, material e dokumente, recensione, aktivitete, si dhe dy përkujtime kushtuar kolegëve të ndjerë Drita Bakija-Gunga dhe Izber Hoti.

Të redaktuara nga një redaksi profesionale, artikujt, kumtesat dhe materialet e trajtuara në këtë numër sjellin kontribute të reja në fushën e historisë së popullit shqiptar përgjithësisht, dhe asaj të Kosovës në veçanti.

Autorja Exhlale Dobruna-Salihu, përmes artikullit shkencor: “*Dy monumente nga koha romake të zbuluara rishtas në Kosovë*”, na sjellë interpretimin shkencorë të dy monumenteve nga antikiteti në Kosovë (periudhës romake), të dalura në dritë qoftë me gërmime arkeologjike, qoftë përmes gjetjeve të rastit, të cilat u takojnë dy grupeve të mëdha tematike dhe kategorive të ndryshme brenda tyre: 1. Altari votive i

zbuluar në vitin 2017 gjatë gërmimeve arkeologjike të Institutit Arkeologjik të Kosovës në Vendenisin antik (Gllamnikun e sotëm), dhe 2. Stela mbivarrore, e cila u gjet rastësisht në muajin qershor të vitit 2019 në fshatin Peqan, kushtuar bijës nga Peqani i Therandës.

Emine Kalaja-Hajdari: *“Dëshmitë epigrafike të pranisë së hyjnive të lindjes në Dardani”*. Autorja jep një përshkrim të përgjithshëm mbi dëshmitë epigrafike, të cilat pasqyrojnë prezencën e një komuniteti të ardhur nga Lindja në territorin e Dardanisë që në shekullin e parë, për të arritur fluksin më të madh gjatë shekujve II-III. Bashkë me ta depërtuan edhe kultet e ndryshme në Dardani duke e pasuruar kështu korpusin e hyjnive zyrtarë dhe jozyrtarë të cilët adhuroheshin dhe nderoheshin në këtë pjesë të Perandorisë Romake gjatë shekujve I-III.

Teuta Shala-Peli, vjen me artikullin *“Roli i klerikëve drishtianë në shërbimet laike gjatë viteve 1917-1496”*. Autorja merr në studim rastin e Drishtit, duke studiuar angazhimi i klerit drishtas në shërbime të ndryshme laike. Ky rol, është vlerësuar si një tregues se kleri në Drisht gjatë mesjetës, kishte pothuajse tërësisht ndikim në pushtetin laik: në fushën e gjyqësi, qoftë si gjykatës apo si noter; në politikë, duke marrë pjesë në nënshkrimin e marrëveshjeve politike; në ekonomi, përmes mbledhjes së taksave; si luftëtarë, në mbrojtjen e qytetit të Drishtit; si mësues, në përhapjen e arsimit si dhe në ngritjen e shkollave, etj.

Studiuesi Agron Islami përmes artikullit të titulluar: *“Aspekte të jetës socio-ekonomike dhe politike në Kosovë gjatë shekullit XVIII sipas ankesave dhe kërkesave të qytetarëve”*, na sjellë të dhëna historike mbi dimensionin social, ekonomik, financiar dhe pronësor të qytetarëve të Kosovës gjatë shekullit XVIII. Autori, ka trajtuar disa ankesa dhe kërkesa të qytetarëve të Kosovës të trajtuara në Divanin Osman gjatë shekullit XVIII.

Marenglen Verli, në këtë numër, vjen me artikullin *“Shqiptarët përballë ndërkombëtarëve në Paris në mbyllje të konferencës së paqes (14 janar - 3 mars 1920)”*. Autori trajton çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris. Ndër të tjera trajton edhe problemet e kufijve dhe të statutit të shteteve të Ballkanit dhe në kuadër të tyre edhe “çështjen shqiptare”. Akademik Verli, vjen në përfundim se Shqipëria kishte shpëtuar nga rreziku që i qëndroi mbi kokë gjatë gjithë zhvillimit të Konferencës së Paqes së Parisit. Mbetej të mbroheshin rezultatet e arritura në vitin 1920 dhe të konsolidohej e demokratizohej shteti i brishtë, që i kishte shpëtuar asgjësimit.

Armend Mehmeti sjellë artikullin: *“Aksioni i armatosur i Zogut në Shqipëri - aspekte të mbështetjes Jugosllave e Britanike”*. Ai jep të

dhëna mbi ballafaqimet politike pozitë-opozitë, të cilat kulmuan me ngjarjet e qershorit të vitit 1924 dhe që e detyruan Ahmet Zogun dhe suitën e tij të iknin në Mbretërinë SKS. Në mënyrë të veçantë, në këtë artikull, theksohet pozicioni dhe qëndrimi britanik dhe ai jugosllav në ngjarjet e brendshme në Shqipëri në mes të Zogut dhe Nolit. Sipas tij, faktori i jashtëm ishte vendimtar për rënien e Nolit dhe kthimin e Zogut, por nuk duhet anashkaluar as faktorin e brendshëm.

Sabit Syla vjen me artikullin: *“Kosova ndërmjet fuqive të boshtit dhe aleatëve të mëdhenj perëndimorë”*. Autori sjellë të dhëna mbi pozicionin e Kosovës dhe Qëndrimi i forcave të Boshtit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sipas studiuesit të artikullit, në përfundim të luftës, aleatët nuk patën qëndrim të drejtë ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve në përgjithësi. Ata jo vetëm se nuk njohën të drejtën e Kosovës për vetëvendosje, por edhe rrezikuan pavarësinë e Shqipërisë në favor të përkrahjes për interesat e tyre strategjike apo edhe favorizimit të shteteve tjera ballkanike.

Avni Rexha sjell artikullin: *“Përpyjekjet për rimëkëmbjen dhe afirmimin ndërkombëtar të universitetit të Prishtinës gjatë viteve 1991-1998”*. Autori konkludon se gjatë viteve të okupimit serb dhe mbylljes së institucioneve arsimore, procesi arsimor universitar u organizua në kushte të rënda, kryesisht nëpër shtëpi private, bodrume, garazhe, dhoma të papërshtatshme. Mungonin bibliotekat, laboratorët e kabinetet e nevojshme, e pa bursa studimore. Organizimi i mësimi nëpër shtëpi-shkolla u bë nën ombrellën e Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës, e cila për shkak të rrethanave të njohura vepronte jashtë Kosovës.

Në këtë numër të revistës kemi shtatë kumtesa të publikuara, të cilat ishin lexuar në Konferencën shkencore ndërkombëtare, kushtuar 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (Prizren, 10 qershor 2018). Kumtesat e prezantuara në këtë numër të revistës janë: Paskal Milo *“Thelbi Evropian i Rilindjes Kombëtare Shqiptare”*, Gjon Berisha *“Argjipeshkvia e Tivarit dhe çështja “Primus Serbiae” si pasojë e vendimeve të Kongresit të Berlinit”*, Eduart Caka *“Lidhja e Prizrenit dhe formësimi i identitetit shqiptar brenda Perandorisë Osmane”*, Fehari Ramadani & Fati Iseni *“Aspekte të veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare në kazanë e Tetovës”*, Agron Islami *“Politikat përafruese të Abdylhametit II karshi shqiptarëve”*, Zeqirja Rexhepi *“Raportet midis fuqive të mëdha dhe Lidhja e Prizrenit”*, Sali Kadria *“Regjistrimi i popullsisë gjatë vitit*

1918 në territorin e Shqipërisë, të okupuar nga autoritetet Austro-Hungareze”.

Në rubrikën “Materiale dhe Dokumente”, Qerim Lita, sjell disa dokumente të përpunuara me titull: “Si i përshkroi Remzi Kolgeci ngjarjet e nëntorit 1988 në Kosovë?”

Në këtë numër të revistës kemi gjithashtu, recensionet e përgatitur nga Alban Dobruna *Një vepër madhore për historinë dhe historiografinë shqiptare* për botimin me titull “Fatmira Musaj, “Republika shqiptare 1925-1928”, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë, 2018; vlerësimi i Miftar Kurtit, *Ballafaqimet e një historiani me robërinë dhe historinë*, mbi librin: “Jakup Krasniqi, Ballafaqime historike për çlirim dhe bashkim kombëtar, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2019”; dhe recensionin e studiuesit Kosovar Basha *Kontributi atdhetar i Esat Myftarit*, për librin: “Esat Myftari, *Vdekja jote jeta ime*, Prishtinë, 2020”.

Në nderim të punës dhe kontributit shkencor të studiuesve dhe kolegëve tone, profesorëve Drita Bakija-Gunga dhe Izber Hoti, të cilët u ndanë nga jeta në vitin 2020, studiuesit M. Verli, B. Meta, S. Sylja dhe A.Dobruna i kanë kushtuar një hapësirë të veçantë jetës dhe veprës së tyre.

## 2. *Kosova - rruga drejt lirisë,*

Kjo vepër është përmbledhje e kumtesave të Konferencës shkencore ndërkombëtare: “*Kosova - rruga drejt lirisë*”, e cila është mbajtur me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës dhe ndërhyrjes së forcave të Aleancës Veriatlantike (NATO). Konferenca i ka zhvilluar punimet në Prishtinë, më 11 qershor 2019, nën organizimin e Institutit të Historisë “*Ali Hadri*” - Prishtinë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë - Tiranë dhe Institutin për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Përmbledhja me punime e kësaj Konference trajton rrugëtimin historik të lirisë së Kosovës (jo në përmasa të gjera) duke e pasqyruar në dimensionet e saja politike, juridike, ekonomike, ushtarake, shoqërore, kulturo-arsimore dhe historiografike. Punimet e sjella për lexuesin në këtë botim kanë një rëndësi të veçantë për historinë më të re shqiptare, ku shtjellohen tema të ndryshme, të cilat na ofrojnë materiale të reja, mbështetur në të dhëna dhe fakte shkencore dhe në metodologjinë e trajtimit bashkëkohor, që padyshim si të tilla do t'i shpijnë përpara studimet në fushën e historiografisë shqiptare e më gjerë.

3. Alban Dobruna, *Ahmet Koronica në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*

Studimi "Ahmet Koronica në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit", është një studim monografik, për njërin nga personalitet kryesore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), për të cilin historiografia shqiptare ka shpalosur momente interesante në kuadër të makroprojekteve kushtuar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por ky personalitet nuk është trajtuar gjerësisht nga studiuesit e historisë. Në këtë kontekst, përmes këtij studimi i kushtohet vëmendje më e zgjeruar këtij personaliteti, duke realizuar kërkime të reja në arkiva dhe biblioteka, për të paraqitur të dhëna me interes, të cilat ndriçojnë segmente të caktuara të jetës e veprimtarisë së Ahmet Koronicës dhe viteve të para të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Marrë për bazë strukturën dhe përmbajtjen brenda tekstit, autori i ofron lexuesit argumente të bollshme se kemi të bëjmë me një personalitet historik, i cili është aktiv në një periudhë historike të popullit shqiptar, siç është Lidhja e Prizrenit. Ai është një ndër figurat kryesore përkrah Abdyl Frashërit, Ymer Prizrenit, Sulejman Vokshit etj., të cilat luajtën një rol të rëndësishëm dhe kontribuuan në përpjekjet politike, diplomatike dhe ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila ishte një organizatë politike-ushtarake për realizimin e të drejtave e aspiratave kombëtare, për mbrojtjen e tokave shqiptare nga copëtimi i huaj dhe për çlirimin e trevave shqiptare që ishin pushtuar nga shtetet ballkanike.

4. Selver Islamaj, *Letërkëmbimet e panjohura të Faik Bej Konicës 1901-1912, Vëll.II.*

Në këtë vëllim përfshihen dokumente të nxjerrura nga Arkivi i Shtëpisë, Oborrit dhe Shtetit me adresë në Vjenë (Haus-, Hof- und Staatsarchiv), me signaturën "ATOeStA/HHStA PA XIV 18 Liasse XII dhe HHStA PA XIV 19 Liasse XII/2 (2. Teil)", gjendet një material i rëndësishëm, jo vetëm për audiencat profesioniste, por për të gjithë historianët dhe hulumtuesit tjerë, lexuesit e zakonshëm si dhe për historiografinë shqiptare në përgjithësi. Përveç, origjinalit të transkriptuar dhe përkthimit të tyre, iu mundësohet lexuesve për herë të parë qasja në letërkëmbimin e Faik Bej Konicës me Baron von Zwiedinek.

Dokumentacioni i botuar ka vlerë të veçantë, sepse ajo ofron informacione të vlefshme për shumë çështje, ndër të cilat mund të përmendim: Së pari, përmes këtyre letërkëmbimeve, bëhen detaje të



rëndësishme të ditura, si p.sh. shqetësimi i Faik Konicës mbi zhvillimet rreth gazetës së tij “Albania”; Së dyti, letrat na japin një pasqyrë të sfidave dhe vështirësive me të cilat është përballur Faik Konica; Së treti, del në pah se në mes Faik Konicës dhe disa personalitete të kohës kishte një komunikim intensiv; Së katërti, bëhet e qartë se Konica gëzonte respekt të madh tek bashkatdhetarët në mërgim; Së pesti, Faik Konica ishte tejet i shqetësuar mbi zhvillimet në trojet shqiptare. Së gjashti, përpjekjet e tij për të bërë gazetën më të famshme në mesin e intelektualëve shqiptarë me mbështetje të drejtpërdrejt nga Ministria e Punëve të Jashtme, e cila e ndihmonte atë që të ndërtonte bazën kryesore për të shpërndarë këtë gazetë në atdhe dhe në diasporë, etj. Dokumentet në fjalë, deri më tani nuk kanë qenë në duart e lexuesve. Megjithatë disa dokumente janë përshkruar nga studiues të ndryshëm, por për herë të parë u jepet mundësia me pas origjinalin e transkriptuar dhe përkthimin e dokumentit në formë të librit.

5. Armend Mehmeti, *Diplomacia e Britanisë së Madhe mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1919-1939*, Instituti i Historisë, Tiranë.

Studimi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në periudhën midis dy luftërave botërore është një temë që ka zgjuar interesimin dhe vëmendjen jo vetëm të studiuesve të historisë, por edhe të politikanëve, gazetarëve, analistëve politikë, e të studiuesve të fushave tjera sociale. Pasi këto marrëdhënie ishin trajtuar nga historiografia e dy vendeve, të cilat kryesisht mund të anonin kah e vërteta e tyre, për të fituar një objektivitet shkencor e pasqyrim real u pa e nevojshme që ato të trajtohen nga një këndvështrim i një shteti tjetër, që nuk kishte interesa të mëdha e kufizime gjeografike me asnjërën nga shtetet në fjalë, por që interes primar e kishte paqen dhe qetësinë në Evropë, në mënyrë që të vazhdonte me eksploatimin e pasurive nga kolonitë e saj në Lindje të largët - pra fjala është për Britaninë e Madhe.

Britania e Madhe, si një nga fuqitë politike e ushtarake të kohës, ndoqi me kujdes të madh zhvillimet në rajonin e Ballkanit, ndërsa diplomatët e saj nuk hezitnin të ndërhynin në zhvillimet diplomatike në Ballkan me synim primar ruajtjen e paqes në rajon, respektivisht ruajtjen e interesave britanike. Prandaj, monografia në fjalë paraqet zhvillimin e relacioneve shqiptaro-jugosllave shikuar nga këndvështrimi britanik, duke filluar me një pasqyrim të raporteve midis dy popujve që nga shekulli nëntëmbëdhjetë, për të vazhduar me boshtin e këtij studimi, pra gjitha zhvillimet politike e ekonomike midis Shqipërisë e Jugosllavisë

gjatë periudhës midis dy luftërave botërore. Kjo monografi sjell edhe risi të reja: ndërhyrjen e diplomatëve britanikë në punët e brendshme të Shqipërisë, respektivisht përfshirjen e tyre në ballafaqimet e brendshme politike në Shqipëri, dhe Kosovën – një çështje që preokuponte dy vendet, respektivisht si shihej Kosova dhe shqiptarët nga diplomatët britanikë, lufta e tyre për liri, politika represive serbe dhe interesimi i shtetit shqiptar për bashkëkombësit e tyre në Jugosllavi.

Hartimi i këtij punimi mbështetet në analizën e burimeve të pabotuara historike të kohës të proveniencës britanike, shqiptare dhe jugosllave, pra të mbledhura në arkivat britanike, shqiptare, jugosllave, në burimet e botuara historike dhe në studimin e punimeve të botuara në revista të ndryshme shkencore në botë.

6. Sabit Syla & Qerim Lita, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1944-1948, Vëll.I.*

Në këtë vëllim të kësaj përmbledhjeje janë përfshi dokumente me rëndësi të dorës së parë, që përfshijnë harkun kohor tetor 1944 - qershor 1948. Pjesa më e madhe e dokumenteve janë të fushës diplomatike e partiake, por nuk mungojnë as ato të fushës ushtarake, kulturore dhe ekonomike. Thuhet të gjitha dokumentet botohen për herë të parë të cilat janë përzgjedhur nga koleksioni i materialeve arkivore, kryesisht nga Arkivi i Jugosllavisë në Beograd, fondi Komiteti Qendror i Partisë (Lidhjes) Komuniste të Jugosllavisë, materiale këto të hulumtuara në kuadër të projektit “Historia e Kosovës”.

Në vitet 1944-1948, ndërmjet udhëheqjes komuniste shqiptare dhe asaj jugosllave u vendosen marrëdhënie të ngushta dhe miqësore bashkëpunimi. U nënshkruan Traktate e një sërë marrëveshesh të karakterit ekonomik, politik e kulturor ndërmjet dy vendeve, si: “Traktati mbi Aleancën dhe Ndhimën Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë”, i nënshkruar më 20 shkurt 1945. Më 1 korrik 1946 “Traktati mbi bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë”. Më 9 korrik 1946, “Traktat Miqësie dhe Ndhimë Reciproke”. Më 26 nëntor 1946, “Traktati mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimit doganor e unifikimit valutor”. Edhe çështja e inkuadrimit (aneksimit) të Shqipërisë në kuadër të Federatës së atëhershme jugosllave, mori përmasa të hapura.

Në Tiranë, “miqësia” midis udhëheqjes komuniste shqiptare dhe asaj jugosllave, përbënte “një rëndësi jetësore”. Kudo ndihej fushata e popullarizimit të Jugosllavisë dhe udhëheqjes së saj. U riaktivizua Shoqata për Bashkëpunim Kulturor “Shqipëri-Jugosllavi”. Në mbarë

vendin lartësohej politika “vëllazërore” e popujve jugosllavë, si dhe personaliteti i Titos. Kësaj fushate iu bashkëngjit edhe Sektori i Agjitacionit dhe Propagandës (Agjitpropit) pranë KQ PKSH-së, si dhe shtypi. Paralelisht me këtë fushatë, Shqipëria u vërsua nga të ashtuquajtur “specialistë” jugosllavë të fushave të ndryshëm, si ushtarake e të sigurisë, ndërtimtarisë, ekonomisë, agronomisë, kulturës, arsimit etj., numri i të cilëve shkonte mbi 600. Pjesa më e madhe e tyre mbanin poste të larta qeveritare, si ndihmësministra apo këshilltarë të lartë pranë ministrive përkatëse të Qeverisë së atëhershme shqiptare.

Në Shqipëri u vendosen edhe misionet aleate. Misioni i parë ushtarak i pasluftës që u vendos në Shqipëri, ishte ai anglez, më 21 mars 1945. Atë e udhëhiqte gjenerali i brigadës Hodgson, nën udhëheqjen e të cilit ishin gjithsej 38 oficerë e nënoficerë. Gjatë muajit maj u vendos edhe ekipi diplomatik i SHBA-së, në krye me G. Jakobs, ndërsa në korrik u vendos Misioni Ushtarak Sovjetik në krye me kolonel Sokollov.

Shqipëria përkeqësoi marrëdhëniet me aleatët perëndimorë anglo-amerikanë. Ata nuk e njohën Qeverinë Shqiptare të kryesuar nga Enver Hoxha. Qeveria amerikane e tërhoqi nga Shqipëria misionin e vet diplomatik. Ndërkohë, më datë 5 mars 1946 edhe Misioni Ushtarak Britanik e lëshoi Shqipërinë.

#### 7. Shefqet Dinaj, *Statusi politik-shoqëror i shqiptarëve të Kosovës në vitet 1945-1966*

Në këtë monografi studiuesi Shefqet Dinaj (bashkëpunëtor i jashtëm), ka trajtuar trajtuar statusi politik-shoqëror i shqiptarëve të Kosovës në vitet 1945-1966, një periudhë historike relativisht e gjatë, mbi 20-vjeçare. Në këtë studim analizohet statusi politik, juridik dhe shoqëror i shqiptarëve të Kosovës pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, me të gjitha reperkusionet që ndodhen në këtë territor shqiptar. Veçohet dhe analizohet vendosja e Administratës Ushtarake, dhuna dhe terrori i shkaktuar nga ripushtimi jugosllav, revolta e shqiptarëve për të mbrojtur qenësinë e tyre kombëtare dhe mbijetesën, Masakra e Tivarit, goditjet e grupeve dhe organizatave patriotike shqiptare të kohës etj. Në studim bëhet analiza e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, e periodizuar sipas tonalitetit të tyre politik. Fillohet me vitet 1945-1948, vizitat reciproke të udhëheqësve politikë të të dy vendeve, pritshmëria dhe pasojat e tyre në statusin e Kosovës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi.

Monografia fillon me Revoltat e Shqiptarëve (dhjetor 1944-janar 1945) që shpërthyen si reagim ndaj terrorit intensiv dhe propagandës së shfrenuar antishqiptare serbe, malazeze e maqedonase, qëllimi i së cilës

ishte të njolloste popullin shqiptar në tërësi si bashkëpunëtor i pushtuesit gjerman, t'i mbyllte gojën dhe të realizonte më lehtë aneksimin e Kosovës në Jugosllavi. Studimi vazhdon me vendosjen e Administratës Ushtarake në Kosovë, e cila me veprimet gjenocidale në terren ishte vazhdim i një lufte të re, në kushtet e së cilës do të kryhej më lehtë në praktikë aneksimi i Kosovës, kolonizimi, vrasjet, shpërnguljet, veprime këto që përkonin me elaboratet e Vasa Çubrilloviqit të mbajtura në Klubin Serb të Kulturës. Për të provuar pa asnjë ekuivok vendosjen e Administratës Ushtarake në Kosovë, në monografi, autori ka ofruar të dhëna burimore dhe faksimile të dokumenteve të nënshkruar nga vetë Josip Broz Tito për zbatimin e saj. Më pas jemi ndalur në një segment sa diskriminues aq edhe denoncues të Administratës Ushtarake, që është Masakra e Tivarit.

Një vend të rëndësishëm në monografi zënë marrëdhëniet shqiptare- jugosllave pas LDB. Sipas autorit, marrëveshjet dypalëshe e shndërruan qeverinë shqiptare në një strukturë administrative të qeverisë jugosllave dhe planet ekonomike të saj në një shtojcë të planeve ekonomike jugosllave. Vetëm pas thyerjes Tito-Stalin, qershor 1948, kur marrëdhëniet sovjeto- jugosllave u ashpërsuan dhe arritën në ngrirje të plotë, udhëheqja komuniste shqiptare anoi nga BS dhe kaloi në radhën e parë të luftës ideologjike e politike kundër Jugosllavisë. Pikërisht në këtë kohë, PPSH filloi të ngrejë çështjen e Kosovës, si popullsi që i ishin shkelur të drejtat e njeriut dhe të drejtat kombëtare.

#### 8. Skender Zhitia, *Roli i Mbrojtjes Civile në Luftën Çlirimtare të Kosovës 1998 - 1999*

Monografia trajton periudhën e Luftës Çlirimtare 1998-1999 në Kosovë, të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Në këtë monografi mes tjerash shpalosen dimensionet historike, të cilat i detyruan shqiptarët e Kosovës të nisin dhe të zhvillojnë luftë të armatosur. Po kështu evidencohet dhe pozicionimi progresiv i faktorit ndërkombëtar dhe konstatohet rëndësia e kontributit të tij për perspektivën evropiane të shqiptarëve të përndjekur dhe nëpërkëmbur. Në temën bosht, shpaloset procesi i ngritjes dhe shtrirjes së UÇK-së në aspektin ushtarak, si dhe aspekte specifike që kanë të bëjnë me këtë subjekt historik. Shtjellohen strukturat e rëndësishme të Mbrojtjes Civile (MC), me theks të veçantë në Zonën Operative të Llapit (ZOLL), misioni dhe detyrat, organet drejtuese dhe organizimi i tyre funksional, fushat e bashkëpunimit me UÇK-së dhe popullatës civile, si në krijimin e infrastrukturës së banimit, ushqimit dhe trajnimit, krijimin e mundësive për evakuim të luftëtarëve

të plagosur dhe të civilëve në raste të caktuara, krijimin e rezervave ushqimore, të higjienës, veshmbathjes, naftës dhe derivateve të saj, barnave mjekësore e deri tek informimi dhe njoftimi mbi situatën në terren e më gjerë. Trajtohen aspekte përballjeje të popullsisë shqiptare të Kosovës, me format e vrazhda të përndjekjes nga ana e forcave ushtarake, policore e paraushtarake (paramilitare) serbe, siç janë masakrat ndaj popullsisë civile, dhuna seksuale, dhe spastrimi etnik i popullsisë civile si dhe shkatërrimi i ekonomive familjare e publike përmes plaçkitjes dhe shkatërrimit fizik të objekteve të banimit dhe objekteve përcjellëse. Të gjitha çështjet e ngritura në këtë monografi e vënë UÇK-në, respektivisht MC në fokus të veçantë, për kohën e Luftës Çlirimtare në Kosovë 1998-1999.

#### 9. Baki Rexhepi, *Kronikë nga Lugina*

Ky botim me raporte ditore të gazetarit Baki Rexhepi (bashkëpunëtor i jashtëm), është një përmbledhje kronikash, raportesh e intervistash të realizuara në tri komunat e Luginës, në Preshevë, Bujanoc e në Medvegjë, të banuara me shumicë shqiptare e që fatkeqësisht pa vullnetin e tyre administrohen nga Serbia. Libri fillon me ngjarjet e fundvitit 1996 e këtej në Luginë të Preshevës. Vite këto kur Kosova ishte në okupim klasik nga Serbia e Millosheviqit dhe ku çdo gjë e shumicës shqiptare ishte pengesë për pakicën serbe që udhëhiqte me institucionet shtetërore. E shqiptarët në shenjë revolte, rezistence dhe këmbëngulësie për atdhedashuri ngritën institucionet paralele, të cilat për vite me radhë mbajtën gjallë frymën atdhedashës ndër gjenerata. Presheva, Bujanoci e Medvegja, ishin pjesë e vazhdimësisë së etnikumit shqiptarë, e cila vazhdonte të ishte pjesë e institucioneve të Serbisë. Në vecanti, qyteza e Preshevës që udhëhiqej nga shqiptarët, në këtë periudhë, shërbeu si vendi që ndihmoi dinamikën e zhvillimit të jetës paralele në Kosovë. Qindra aktivitete kulturore, edukative, sportive të karakterit kombëtarë u zhvilluan pikërisht në Preshevë, ngjarje këto që paraqiten në këtë libër.

“Kronika nga Lugina”, vazhdon me pasqyrimin e ngjarjeve të fundvitit 1999, 2000 dhe 2001. Vite këto kur Presheva, Bujanoci e Medvegja, pas disfatës së Serbisë në Kosovë, po përjetonte një diskriminim të paparë, aq sa hakmarrja e forcave të ndryshme të organeve shtetërore serbe, kaloi çdo kufi. Kohë kur rinia e kësaj krahine u mobilizua vullnetarisht në organizimin e kryengritjes së armatosur duke themeluar Ushtrin Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Koha kur luftimet e pabarabarta vazhduan, për më se një vit e gjysmë mes

forcave të shumëllojta të armatosura të Qeverisë së Unionit Serbi - Mali i Zi në njërën anë dhe vullnetarëve të UÇPMB-së, në anën tjetër. Ndërkohë që misionarët ndërkombëtarë tashmë ishin këtu dhe monitoronin çdo moment, çdo lëvizje, duke tentuar që të ndërprisnin luftën dhe të sjellin një paq të qëndrueshme.

Pjesë të pandashme të librit janë edhe kronikat e kohës së negociatave dhe përpjekjeve për arritjen e paqes. Negociata këto që zhvilloheshin mes palës shqiptare, tashmë të unifikuar si një e vetme me palën serbo - malazeze e të ndërmjetësuar nga faktori ndërkombëtar që përfaqësohej nga i dërguari special i Aleancës Veri Atlantike - NATO dhe ai i Bashkimit Evropian. Momenti i arritjes së marrëveshjes së paqes të njohur tashmë si “Marrëveshja e Konçulit”, nisja e zbatimit të saj, si dhe momenti i tradhtisë së madhe, ai i vrasjes së kryenegociatorit të delegacionit shqiptarë, Ridvan Qazimi - Komandant Lleshi, janë të përshkruara në mënyrë autentike në kronikat e përditshme të kohës e që këtij libri ia shtojnë rëndësinë dhe vlerën historike. Të gjitha ngjarjet, takimet, vendimet, aksionet, veprimet, të paraqitura në “Kronika nga Lugina”, janë raportuar në kohë reale, në Radio Televizionin e Maqedonisë - redaksia në Gjuhën Shqipe ( MTV 2), në BBC seksioni shqip, në Radio dhe Televizionin e Kosovës e në Kosovapress.

## **2. HULUMTIMET SHKENCORE DHE REALIZIMI I PROJEKTEVE**

a) Në kuadër të *projekteve kolektive dhe atyre individuale kërkimore-shkencore*, studiuesit e Institutit kanë hulumtuar nëpër arkiva ne vecanti ato vendore.

b) *Botime shkencore në revista kombëtare e ndërkombëtare*

Punën e tyre shkencore, studiuesit e kanë prezantuar për publikimit të tyre në disa revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare si në: *Kosova, Studime Historike, Albanian Studies, Gjurmime Albanologjike, Studime Shoqërore, Iliria, Journal of Balkan Studies, Rumeli Journal of Islamic Studies, Jurnal of Awareness, Historical Research, International Peer-Reviewed Journal of History and Future, Albanologjia, Journal of Danubian Studies and Research, Journal of International Cooperation and Development*, etj.

## **3. PROJEKTET SHKENCORE KOLEKTIVE**

Gjatë vitit 2020, Instituti ka vazhduar me dy projektet kolektive: “Historia e Kosovës” dhe “Gjenocidi serb në Kosovë, 1877-1999”.

Në projektin “Historia e Kosovës” është punuar në fazën e redaktimit dhe plotësimit të temave dhe tematikave të ndryshme, të cilat kanë dalë si rezultat i sugjerimeve të anëtarëve të redaksisë.

Në projektin “Gjenocidi serb në Kosovë, 1877-1999”, është punuar në fazën e mbledhjes së të dhënave sipas komunave të Kosovës, kurse një pjesë e tyre edhe në hartimin dhe analizimin e këtyre të dhënave.

## **5. PUNËT ORGANIZATIVE DHE ADMINISTRATIVE**

### **a) *Këshilli Drejtues***

Në vazhden e rishikimit të tërësisë së akteve të brendshme të Institutit me të cilat e bazon punën e tij, janë hartuar ose plotësuar disa rregullore dhe vendime të mëhershme të Institutit të Historisë.

Sabit Syla  
Gjon Berisha





K O S O V A

45/2020

U shtyp në shtypshkronjën:  
NORD-Prishtinë

Prishtinë

2020

